SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
5 janar - 5 shkurt 2015

ANALIZA VJETORE E SHSSH

NJË VIT SFIDE DHE PROGRESI PËR MBROJTJEN SOCIALE TË GRUPEVE NË NEVOJË



Ditën e enjte, datë 29 janar 2015, në ambientet e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë u zhvillua Analiza Vjetore e punës së ShSSh për vitin 2014. Përgjatë muajit janar të gjitha strukturat e SHSSH u përfshinë në një proces analize pune, diskutimi dhe reflektimi të rezultateve mbi punën e kryer gjatë 2014. Në vijim të tij drejtues dhe punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të ShSSh, drejtorët e Drejtorive Rajonale, drejtuesit e Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror prezantuan në analizën vjetore rezultatet dhe sfidat e ndeshura. Në Analizë morën pjesë Zv. Ministrja e MMSR znj Bardhylka Kospiri, Sekretarja e Përgjithshme znj Itena Ndroqi, Drejtoresha e Politikave Sociale znj. Merita Xhafaj, Këshilltarja e Ministrit znj.EnkeledaLopari,etj.

Znj. Kospiri falenderoi drejtuesit dhe punonjësit e Shërbimit Social që "përballuan bashkarisht një vit sfidë për këtë shërbim, por edhe një vit me rezultate shumë konkrete në drejtim të përmirësimit të shërbimeve ndaj grupeve vulnerable".

Ajo vlerësoi rezultatet për përmirësimin e sistemit të mbrojtjes sociale përmes targetimit më të mirë të ndihmës ekonomike për familjet e varfra, pagesat për PAK dhe sidomos për reformat e shërbimeve sociale, për menaxhimin efektiv të rasteve të njerëzve në nevojë dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror.
"Gjashtë kanë qenë shtyllat kryesore të punës së SHSSH përgjatë 2014: (i) Drejt transformimit të programit të ndihmës ekonomike në një program për riintegrim social; (ii) Aftësia e Kufizuar: rrëzojmë barrierat; (iii) Përkujdesje sociale me standarte të përmbushura; (iv) Mirëmenxhim i shpenzimeve publike; (v) Partneriteti Social, shteti jo i vetmi aktor; (vi) shërbim proaktiv ndaj atyre që u shërbejmë"- theksoi znj. Bisha në fjalën e saj duke vijuar me arritjet kryesore të këtij institucioni.

Në një vit:

U garantua zbatimi i ligjit për ndihmën ekonomike. U kryen 344 kontrolle në njësitë vendore dhe për pasojë u larguan nga skema e NE 20.321 familje. Ky proces u shoqëruara me 86 vërejtje me shkrim, 25 largime nga puna, 59 gjoba dhe 16 kallzime për ndjekje penale të punonjësve përgjegjës.

Është forcuar mënyra interaktive e lidhjes së NE me mundësitë e punësimit. Përmes bashkëpunimit me Zyrat e Punës në Korçë u larguan nga skema 62 familje, ndërsa në Lezhë 52 gra kanë marrë çertifikim për aftësi profesionale të ndryshme.

Megjithë vështirësitë e natyrshme që ka çdo proces i ri pilotimi është e sigurt që në vazhdimësi janë shënuar rezultate konkrete në procesin e pilotimit të NE në Tiranë, Durrës dhe Elbasan.

Buletini Informativ

SHERBIMI SOCIAL

5 janar - 5 shkurt 2015





Në periudhën janar-mars nga kontrrollet në njësitë e qeverisjes vendore u larguan 1mijë persona që përfitonin pagesësn e aftësisë së kufizuar në kundërshtim me ligjin, të cilat patë efekt financiar prej 48.627. 540 lekë.

Që prej prillit Task forcat e ngritura në 12 qarqet e vendit kanë kontrolluar 312 njësi vendore ose 45.539 dosje të PAK dhe 20% e tyre kanë kaluar për rikomisionim në KMCAP Epror ose Rajonal.

Janë rikthyer në familjen e tyre biologjike 107 fëmijë, janë realizuar 67 birësime. Krahasuar me 2013 në vitin 2014 janë larguar nga institucionet rezidencaile gati 20% e fëmijëve.

Janë larguar nga situata e rrugës 59 fëmijë, 11 prej të cilëve u sistemuan në Institucionet e Përkujdesit.

Gjatë viti 2014 janë realizuar 33 monitorime, 23 në institucionet publike dhe 10 në institucionet jopublike, me qëllim vlerësimin e standardeve të shërbimeve ndaj përfituesve. Në të gjitha rastet, është bërë me seriozitet profesional monitorimi i rekomandimeve të lëna nga Inspektoriati Shtetëror të Punës e Shërbimeve Sociale si dhe nga Avokati i Popullit.

ShSSh gjatë vitit ka menaxhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë 676 familje dhe individë në nevojë, 84% e tyre janë zgjidhur dhe 14% i janë referuar pushtetit vendor për ndjekje e zgjidhje.

Përmirësime të dukshme në shërbimin në Qëndrat e Zhvillimit dhe Shtëpitë e të Moshuarve.

Shërbime të orientuara më drejt në Qëndrën Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje. Janë trajtuar dhe kanë përfituar shërbime 84 persona nga të cilët 29 gra dhe 55 fëmijë.

Gjatë vitit është synuar rritja e kapaciteteve. 14 trainime nga të cilat kanë përfituar 170 punonjës të IPSH dhe Drejtoritë Rajonale.
Buxhetim shumë më i mirë i programit të mbrojtjes sociale dhe përkujdesit. Krahasuar me vitin 2013 fondet e akorduara gjatë vitin 2014 për ndihmën ekonomike të kenë një rritje prej 27 %, ndërsa për fondet e PAK kemi një rritje praj 22 %.

Komunikim shumë më efektiv me median dhe publikun: 103 raste problematikash sociale të trajtuara mediatikisht, përgjigje ndaj çdo ankese të cdo qytetari brenda afateve ligjore.

Transparencë maksimale për aktivitetin e SHSSH: Janë publikuar 12 buletine donancionesh, 12 buletine informative. ShSSh ka patur prezencë mediatike sa herë është kërkuar prej medias së shkruar apo elektronike.

Gjatë analizës drejtuesit e SHSSH prezantuan gjerësisht arritjet, sfidat problemet e ndeshuara sipas fushës që ata mbulojnë.

Në përfundim të analizës u prezantua Plani i Veprimit të 2015-tës për të gjithë strukturën e SHSSH për të përmbushur objektivat: (I) Mbrojtja sociale efektive për familjet në nevojë; (II) Përmbushja e standarteve të shërbimit në IPSH; (III) Thellimi procesit të deinstitucionalizimit; (IV) Shërbim proaktiv ndaj qytetarëve; (V) Mirëmenaxhimi financiar i aktivitetit të ShSSh; (VI) Forcim i urave të komunikimit me median dhe qytetarët. Partneritete të qëndrueshme me donatorët dhe shoqërinë civile.

NË TAVOLINË

"SHSSH Pjesë e Përpjekjeve për të Adresuar Problemin e Dhunës në Familje"

Drejtoresha e Pergjithshme znj Etleva Bisha informoi në seancën dëgjimore publike të Nënkomisionit Parlamentar për Çështjet e të Miturve, Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje, mbi shërbimin e mbështetjes financiare të viktimave të dhunës në familje dhe Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të dhunës.

" Kemi konstatuar raste kur administratorët nuk kanë repsketuar Urdhërin e Mbrojtjes dhe nuk kanë kryer pagesën ndaj viktimës së dhunës në familje, prandaj sikurse dhe vitin e kaluar edhe këtë vit do të vijojme të trainojmë dhe asistojmë administratorët për të respketuar ligjin"- theksoi zonja Bisha.

Qendra Kombetare ka shënuar progres gjatë vitit të kaluar: Gjatë vitit 2014 kanë marrë shërbime psiko-sociale dhe juridike 84 persona nga të cilët 29 gra dhe 55 fëmijë. Raste te reja kanë qenë 59, nga këto 21 gra dhe 38 fëmijë.

Është viti i parë që viktimat në Qendër shkurtojnë kohën e qëndrimit të tyre pasi të asistuara nga stafi social, gjenden forma riintegrimi dhe jetese të pavaruar jashtë qendrës. 22 gra dhe femijët e tyre kanë lenë qendrën gjatë vitit 2014; 6 prej tyre vazhdojnë të ndiqen nga stafi i Qendrës, duke i asistuar me qira mujore apo me ndihma ushqimore deri në momentin e fuqizimit të plotë, 16 të tjera janë kthyer në familje ose janë ndihmuar nga stafi për të gjetur punë.

Është thelbësor funksionimi i mekanizmit të referimit për viktimat e dhunës në familje. Ky mekanizëm është tërësisht lokal dhe për fat të keq funksionon në shumë pak raste. Është e dukshme mungesa e reagimit të koordinuar lokal edhe në rastet që vijnë në Qendrën Kombëtare edhe në faktin se gjatë 2014 vetë Shërbimi Social ka menaxhuar 125 raste të dhunës në familje, pikërisht sepse ka munguar reagimi lokal.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
5 janar - 5 shkurt 2015

SHQIPËRI- KOSOVË: Aksion i Përbashkët për Mbrojtjen e Fëmijëve në Lëvizje



Në Prishtinë, me iniciativën e shoqatave "Terre des Hommes" dhe "Save the Children" u realizua vizitë studimore dhe takime të rëndësishme pune me ekspertë dhe drejtues të agjencive të ndryshme që punojnë në fushën e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore. Qëllimi ishte njohja në thellësi e situatës sociale të fëmijëve në lëvizje apo në situatë rruge dhe bashkërendimi i punës së strukturave të shërbimit social në Shqipëri dhe Kosovë për të parandaluar dhe zbutur fenomenin.

Në Prishtinë, me iniciativën e shoqatave "Terre des Hommes" dhe "Save the Children" u realizua vizitë studimore dhe takime të rëndësishme pune me ekspertë dhe drejtues të agjencive të ndryshme që punojnë në fushën e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore. Qëllimi ishte njohja në thellësi e situatës sociale të fëmijëve në lëvizje apo në situatë rruge dhe bashkërendimi i punës së strukturave të shërbimit social në Shqipëri dhe Kosovë për të parandaluar dhe zbutur fenomenin.

Ngritja e një grupi punë të përbashkët për të hartuar procedura standarte për trajtimin ndërvendas të fëmijëve në lëvizje apo situatë rruge, është hapi i parë i punës së përbashkët që do të vazhdojë. Në këtë takim nga pala shqiptare kanë marrë pjesë Znj. Elona Gjebrea, Zëvendësministe e Brendëshme dhe Znj Lida Leskaj, Zëvendës Drejtore e ShSSh.

NË TERREN

KUR KOORDINOJMË – RASTET ZGJIDHEN

- ✓ Pas publikimit ne median sociale të rastit të një gruaje të moshuar të braktisur të pastrehë nga komuna Dhivër, Shërbimi Social i Qarkut Vlorë dhe Gjirokastër reaguan menjëherë. Me një koordinim të shkëlqyer të tyre me Drejtorinë e Policisë Sarandë, Spitalin e Sarandës dhe Drejtoreshën e Qendres Polivalente Sarandë kjo nënë nuk është më vetëm! Shërbimi Social gjen rastin ti bëj apel çdo qytetari që në raste të ngjashme të kontaktoj menjëherë me institucionet shtëtërore për të gjetur reagimin dhe zgjidhjen e mënjeherëshme.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
5 janar - 5 shkurt 2015

NË TERREN



- Nje tjetër rast familje që jeton në varferi është ndjekur nga stafi i Shërbimit Social Shtetëror. Familja Balliu, në Bret të Krujës, pavarësisht nga pagesat që përfiton për shkak të aftësisë së kufizuar të fëmijëve, nuk arrin tu shërbeje fëmijeve. Pas vleresimit specialistet e SHSSH po punojnë për të gjetur zgjidhjet e duhura për të garantuar që fëmijet me aftësi të kufizuara të jetojnë në kushte normale.

- Rasti i familjes së Ilmi Tabakut,nga fshati Grekan i Elbasanit, i dëmtuar nga tërmeti, publikuar ne nje nga mediat kombëtare, u ndoq nga Drejtoria Rajonale Elbasan dhe Njësia e qeverisjes vendore. Familja do të mbështetet me ndihme ekonomike, ndërkaq Drejtoria Rajonale e ShSSh po mundëson realizimin e vlerësimit të situatës së gruas së tij nga mjekët specialist dhe në se është e nevojshme edhe ndjekjen e procedurave të drejtimit të rastit për vlerësim në Kemp. Për të përballuar emergjencën familja Tabaku është mbështetur me ndihma ushqimore.

- Filloi shpërndarja e pakove ushqimore nga Cate Foundation për 140 familje në nevojë nga Shoshi, Shala, Pulti, Rrethinat, Bashkia Shkodër, Velipoja, Guri i Zi, Ana e Malit, Dajci, Berdica dhe Postriba. ShSSh Shkodër falë bashkëpunimit me administratorët shoqëror të ketyre njesive bëri të mundur identifikimin e familjeve më në nevojë që do të trajtohen për një vit me pako ushqimore.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
5 Shkurt 2015 - 5 Mars 2015

FUQIA E SOLIDARITETIT!

Përmbytjet e shkurtit u shoqëruan me reagimin e gjërë human, social e solidar me banorët. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë inicioi dhe organizoi në bashkëpunim të ngushtë me biznesin, bankat dhe donatorë, ngritjen e "Rrjeti i Solidaritetit".

Qëllimi ishte i qartë: Një strukturë kompakte e solide e kujdesit të shtetit bashkë me biznesin për të ndihmuar në mënyrë të menjëherëshme banorët e zonave të përmbytyra në Qarqet Vlorë, Fier, Berat dhe Gjirokastër.



Veprim kompakt dhe i menjëherëshëm për të organizuar, menaxhuar dhe administruar sa më mirë ndihmat dhe donacionet e ofruara nga biznesi, shoqëria civile dhe individë të ndryshëm. Shërbimi Social Shtetëror u angazhua drejtpërdrejtë përmes veprimtarisë intensive të Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale Vlorë, Fier, Berat dhe Gjirokastër.

Përgjatë dy javëve mbi 50 biznese, organizata, institucione dhe qindra vullnetarë të koordinuar nga Shërbimi Social Shtetëror dhuruan jo vetëm ushqime, por edhe pajisje për shtëpitë e familjeve të përmbytura në të katër qarqet e vendit.

KUJDES PËR ÇDO RAST, SI KURRË MË PARË

Vlorë

Vetëm 24 orë pas takimit të Kryeministrit Rama me bizneset, 12 biznese dhuruan ushqime, pajisje për shtëpitë, veshje, ushqim për bagëtinë etj, në familjet e përmbytura në 6 fshatra të Komunës Novoselë. Mobilizim dhe koordinim shembullor i Emergjencave Civile, Shërbimit Social, Ushtrisë Shqiptare, Policisë së Shtetit, Prefekturës, Pushtetit vendor.

Një rrjet i admirueshëm vullnetarësh të përkushtuar punuan pa orar për magazinimin dhe shpërndarja e ndihmave shtëpi më shtëpi.





Pas fazës së parë të emergjencës në Novoselë AMC dhuroi 64 soba dhe 67 frigoriferë. Firma Salillari dhe Biznes Albania dhuruan 74 krevate dhe dyshek. Firmat Selmanaj dhe Stela dhuruan 60 ton ushqim për bagëtinë, Komuniteti Mysliman dhuroi 300 pako ushqimore.





JA REZULTATET E PARA KONKRETE PAS EMERGJENCËS

Në shtëpinë e re të Dhora Gjonit, e cila po ndërtohet nga e para pasi banesa para përmbytjes ishte në gjendje krejt të mjeruar. Ndihma, aty ku duhet.











Fier

I njëjti angazhim intensiv edhe në zonat e përmbytura në Qarkun e Fierit. Që ditën e parë 11 biznese nën koordinimin e z. Luan Bregasi dhuruan ushqime, detergjentë, veshje, jorgane për 864 familje të 16 fshatrave të prekura nga përmbytjet. U dhurua edhe ushqim për bagëtitë nga Miell Tirana.



Me shumë vlerë ndihmat e ofruara nga Kompanitë si Agna Grup, Eurofish, KMY, Fiol, Harri Lena, Mulliri i artë, Primo, Kastrati, Lufra, Ajka, Erzeni të cilat ofruan qindra pako ushqimore, dhe sasira të konsiderueshme me miell, vaj, sheqer, sallam, lëngje frutash, ujë, bulmet, veshje, ushqim për kafshët etj.

Agjensia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile pjesë e Shqipëria Solidare dhuroi 7 ton ushqime në këto zona. Transporti u mbështet nga Biznes Albania.

Gjirokastër

Solidariteti u shfaq edhe në Gjirokastër ku Kompania Birra Tirana dhe Fi Bank kontribuoi me bazë ushqimore për bagetinë.



Berat

Soba nga firma Iseni dhe nga Maqedonia për familjet e prekura nga përmbytjet në qarkun Berat. Kryegjyshata dhe Fi Bank dhuruan në Berat. Lavatriçe dhe Frigorifer nga Neptun. Kryegjyshata, OJF dhe shkolla, pjesë e solidaritetit në Berat. Përveç ushqimeve u dhuruan paisje elektroshtepiake, krevat, dyshek, çarçaf, jorgan dhe tapete. Mbresëlënës solidariteti i nxënësve dhe mësuesve të shkollave të qarkut. Kontribut me ndihma modeste por shumë domethënëse.

Dërgesa me ndihma në Urën Vajgurore nga Kompani e Donatorë si Banfi, Business Albania, Sprint, Ajka, Lufra, Fibank, SFI, etj, të cilat dhuruan krevatë, dyshekë, batanie, çarçaf, bulmet, paketa ushqimore, ushqim për kafshët, etj.







SOLIDARITET I SINQERTË

Edhe Qarku i Shkodrës dërgoi kontributet e veta materiale në shenjë solidariteti me familjet e përmbytura në Komunën Ferras të Fierit. Falë organizatave Gruaja te Gruaja, Eko Mendje, CATI Foundation, Zyra e Punësimit, Administrata e PMNZH Shkodër dhe Pukë si dhe Qëndrës së Keshillimit dhe Shërbimeve Psikologjike, bënë të mundur krijimin e pakove ushqimore me 30 kg sende ushqimore.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
5 Shkurt 2015 - 5 Mars 2015

VULLNETARË TË GATSHËM

Në përgjigje të thirrjes së Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Shërbimit Social Shtetëror, kanë qënë të shumtë qytetarët që shfaqën dëshirë dhe gatishmëri për të qënë pjesë e rrjetit të vullnetarëve që punuan natë e ditë në terren dhe pranë banorëve të zonave të përmbytura.



Gatishmeria u përkthye në detyra konkrete për paketimin e ushqimeve si dhe për të ndihmuar konkretisht familjet për stabilizimin e situatës materiale në shtëpitë e tyre.

NË FOKUS

☑ ***Vijojmë të punojmë për zbatimin e legjislacionit të NE-së dhe PAK-së***

Vazhdon kontrolli për zbatimin e legjislacionit të N.E-së dhe pagesave për PAK. Drejtoritë Rajonale të SHSSH realizuan gjatë muajit janar 26 kontrolle të pushtetit vendor për zbatimin e legjislacionit. Janë larguar nga skema e N.E. 232 familje me efekt financiar 61.796.033 lekë dhe 13 persona me AK me efekt financiar 242.854 lekë. Në shkurt janë kontrolluar 33 njësi të pushtetit vendor.
Task Forca e P.A.K. vazhdon kontrollin e dosjeve të përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar në Qarqet Shkodër, Korçë.

☑ ***Standarte të Përmbushura në ofrimin e Shërbimeve Sociale***

Monitorimi i standarteve dhe cilësia e shërbimit në Qëndrën e Zhvillimit Vlorë, Shtëpinë e Fëmijëve "Zyber Hallulli" dhe Shtëpia e të Moshuarve në Fier kanë qenë objekt i punës së Drejtorisë së Monitorimit të Standarteve në SHSSH përgjatë muajit shkurt për të vlerësuar performancën e institucioneve dhe nivelin e kënaqësisë së përfituesve të shërbimit të ofruar në këto institucione.

☑ ***Në fokus aftësia e kufizuar***

Kujdesi për personat me aftësi të kufizuara dhe plotësimi sa më mirë i nevojave të tyre është një nga prioritetet e Drejtorisë së Përgjithshme të ShSSh dhe nga Drejtoritë Rajonale të saj.
Sipas Marrëveshjes të nënshkruar midis I.S.SH.EL dhe SH.S.SH.EL, për pajisjen me karroca për personat me aftësi të kufizuara, nisi shpërndarja e tyre në Qark, sipas kërkesave të bëra dhe nevojave të identifikuara.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
5 Shkurt 2015 - 5 Mars 2015

NË TAVOLINË

✓ ***Vullnetarë, për të mbështetur, për të rritur kapacitetet***

Këtë muaj një grup vullnetarësh të Drejtorisë Rajonale të ShSSh në Lezhë udhëtoi drejt Dibrës për një seminar pune dhe shkëmbimi idesh me organizatën “Changing the Future”. Bashkë me grupin "Vizioni Rinor” ishin dhe të rinjtë e Kishës Ungjillore Lezhë & Milot, nën mbështetjen e “World Vision in Albania and Kosovo”.
Ata patën mundësinë të shohin arritjet e organizatës "Changing The Future" gjatë këtyre 4 viteve të aktivitetit të tyre, por edhe u njohën me grupe të tjera vullnetarësh që ishin në seminar.



Ishte një fundjavë shumë produktive dhe shpresëdhënëse për të gjithë ne që mendojmë të japim një kontribut për vendin ku jetojmë.
Aktivizmi qytetar dhe vullnetar është një synim strategjik i ShSSh por dhe vlerë për shoqërinë, kapital social që duhet promovuar për të mirën e përbashkët.

✓ ***Proaktiv në adresimin e problemeve të trafikimit të qënieve njerëzore***

Përfaqësuesit e D.R.Sh.S.Sh. morën pjesë në workshopin me temë “Forcimi i kapaciteteve të strukturave shtetërore në mbrojtje të viktimave të trafikimit të personave”.
Ky aktivitet u realizua nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim në bashkëpunim me Institucionin e Prefektit dhe Caritas Shqiptar, financuar nga Zyra mbi Trafikimin e Personave (J-TIP) të Departamentit të Shtetit pranë Qeverisë së SHBA dhe CRS me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të KRAT dhe tryezës teknike.



NË TERREN

Menaxhime dhe zgjidhje të rasteve të familjeve në nevojë

Në Bashkinë Krujë rasti i familjes me 5 anëtarë të Xhemal B. nga të cilët 3 prej tyre me aftësi të kufizuara të evidentuar nga TV ORA NEWS u vlerësua menjëherë nga SHSSH dhe menaxhimi i rastit u krye në terren bashkë me gazetarin e televizionit. Mbledhja e ekipit multidisiplinar dhe kujdesi i ShSSh, bëri të mundur punën për bërjen e dokumeneteve për rikomisionim në KMCAP të 3 pjestarëve të familjes dhe sigurimin e kujdestarisë.

Po punohet edhe për përmirësimin e kushteve të shtëpisë së Xhemalit. Bashkia ka marrë një rol aktiv për ta mbështetur familjen.

Rasti i familjes në nevojë dhe me 5 fëmijë në Bashkinë e Gjirokastrës u menaxhua në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të ShSSh, të cilët asistuan menjëherë nënën e pesë fëmijëve të përgatis dokumentacionin për të përfituar statusin e PAK, ndërsa bashkëshorti i saj u ndihmua për të aplikuar për përfitim të ndihmës ekonomike. Rasti vijon të mbështetet nga Drejtoria Rajonale.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
5 Prill 2015 - 5 Maj 2015

Partneriteti me biznesin: Një histori suksesi në menaxhimin e emergjencave



Vendosmëri e Qeverisë për të vazhduar procesin e mbështetjes së familjeve të përmbytyra në Qarkun e Fierit në shkurtin e këtij viti.
Kryeministri Edi Rama ishte i pranishëm gjatë dorëzimit për banorët të 680 krerë dele, të humbura gjatë përmbytjeve të shkurtit të këtij viti.



Gjithashtu ai asistoi në procesin e shpërndarjes së pajisjeve elektroshtëpiake për 110 familje.
Të gjitha këto donacione janë kontribut bujar dhe mbështetje humane e ofruar nga Kompanitë Filip Morris, Alba Call Center, Biznes Albania, koordinuar me sukses nga Shërbimi Social Shtetëror.

Bashkë për t'i fuqizuar familjet në ndihmë ekonomike përmes punësimit

Një nga prioritetet kyç të Shërbimit Social Shtetëror është fuqizimi i familjeve dhe përmbushja e këtij prioriteti kërkon ndërveprim të vazhdueshëm me programet e nxitjes së punësimit.

Në këtë logjikë dhe për të bërë sa më të mundur lidhjen organike të skemave të mbrojtjes sociale të njerëzve në nevojë me mundësinë e gjetjes së mundësive të punësimit të tyre, u realizua një takim konstruktiv i Drejtorëve Rajonal të SHSSH dhe Drejtorëve Rajonal të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Drejtuesit diskutuan gjerësisht mbi prioritet dhe rrugët e ndërveprimit mes dy institucioneve me qëllim mbështetjen reale të familjeve në nevojë.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
5 Prill 2015 - 5 Maj 2015

Përmirësojmë modelet e shërbimit dhe nxisim deinstitucionalizimin



Deinstitucionalizimi i shërbimit për fëmijët në nevojë është një nga sfidat strategjike të shërbimit social. Në këtë kuadër në Shtëpinë e Fëmijëve "Zyber Hallulli" u mbajt një takim profesionistësh lidhur me projektin pilot të deinsitucionalizimit.

Në takim morën pjesë përfaqësues të shoqatës Terre Des Hommes dhe SOS. Problematika, debate dhe diskutimet u përqëndruan në shumë aspekte. Po më shumë rendësi ishte përhapja e njohurive dhe praktikave të mira të punës për socializimin dhe kthimin e fëmijëve nga jeta në institucionet e përkujdesit social rezidencial pranë familjes.

NË FOKUS

RRISIM KAPACITETET, PËRMIRËSOJMË CILËSINË

Shërbime më cilësore për personat me aftësi të kufizuara në Qendrat tona të Zhvillimit


Duke u bazuar në Programin e Trainimeve për vitin 2015, 30 punonjës e specialist përfaqësues nga Qëndrat e Zhvillimit morën pjesë në trainimin lidhur me përmirësimin e metodave të vlerësimit të nevojave individuale dhe hartimit të Planeve të Ndërhyrjeve individuale.

Fokusi i trainimit u përqëndrua me prioritet drejt mënyrës së trajtimit të të rinjve me aftësi të kufizuar, në vecanti të rinjve të prekur nga autizmi.

Ky trajnim shërbeu specifikisht si përvojë me vlerë për drejtuesit dhe specialistët e qendrave në përmirësimin e raporteve të ndërtuara me personat me aftësi të kufizuar, si dhe për ndërtimin e marrëdhënieve konstante dhe përfshirëse me familjet e tyre. Trainimi u zhvillua nga specialisti italian i kontaktuar Prof. Dr. Francesco Nardocci, aktualisht President Kombëtar i Shoqatës së Neuropsikiatrisë për Fëmijë në Itali në bashkepunim me Projektin IADSA.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
5 Prill 2015 - 5 Maj 2015

Për një menxhim më efektiv të rasteve nga punonjësit social



Duke vlerësuar situatën e fëmijëve të pashoqëruar në emigracion, në ambjentet e SHSSH u organizua një takim me punonjësit socialë të 12 Drejtorive Rajonale të Shërbimeve Sociale.

Qëllimi i takimit ishte jo vetëm njohja më e mirë e përmasave të këtij fenomeni social, por edhe rritja e kapaciteteve lidhur me vlerësimin e familjeve të fëmijëve që ndodhen jashtë vendit të pashoqëruar, përmirësimin e metodave dhe cilësisë së punës në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë dhe mënyrat e menaxhimit dhe zgjidhjes së problemit të tyre.

Nxitje e punësimit për të rinjtë në Qarkun e Durrësit



Në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Punësimit në Durrës falë fondit që qeveria ka akorduar për nxitjen e punesimit, SHSSH

Durrës mundesoi për disa të rinj, që sapo kanë mbaruar studimet universitare dhe disponojnë një diplomë kualifikimi, të provohen duke i dhënë mundesinë e punësimit ne formën e praktikës profesionale.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
5 Prill 2015 - 5 Maj 2015

NË TAVOLINË

Ngremë kapacitetet e administratorëve socialë



Përmirësimi i punës dhe njohja e saktë e legjislacionit bazë mbi rrugët dhe mjetet e mundshme për mbështetjen e duhur të familjeve dhe individëve në nevojë në çdo njësi vendore, ishte objekti i takimit të Drejtores së Përgjithshme të SHSSH, znj. Etleva Bisha me administratorët social të Qarkut të Fierit. Diskutimi u përqëndrua jo vetëm në mbështetjen që bëhet përmes pagesës së ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, por edhe shërbimeve te tjera që nxisin fuqizimin dhe integrimin social të individëve dhe familjeve. Shkëmbimi eksperiencës, debatet për interpretimin e ligjit dhe rasteve e bënë interaktiv dhe me vlerë këtë event.

NË TERREN

Informimi është hapi i parë drejt aksesit në shërbime



Në Qendrën Komunitare Ndërkulturore në Berat, u zhvillua një seminar me përfaqësues e qytetarë të komunitetit Rom e Egjiptjan, për ti informuar në mënyrë të detajuar për të drejtat dhe shërbimet sociale që ofrohen nga strukturat sociale të pushtetit qendror e vendor për këto komunitete në nevojë.

Seminari u mundësua dhe u lehtësua nga Fondacioni ''Ndihmë për fëmijët'' - Projekti CEFA. Seminari mori trajtën e zgjeruar të informimit dhe dialogut, duke u bazuar në njohjen dhe përhapjen e mbi praktikave të mira e të vlefshme të shërbimeve të ofruara në komunitet, si dhe se njohjen me risitë që parashikon Reforma e Shërbimeve të Integruara Sociale të MMSR.

Seminare të tilla u zhvilluan gjatë prillit edhe me komunitetin rom e egjiptian në Korçë, Tiranë dhe Elbasan.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
5 Maj-5 Qershor 2015

Shërbimi i përkujdesit për të moshuarit në fokus të Shërbimit Social



Në vazhdim të ndërtimit të partneriteteve që shërbejnë për përmirësimin e shërbimeve sociale për njerëzit në nevojë në Shkodër u zhvillua seminari me temë: "Shërbimet ndaj personave me aftësi të veçanta dhe profilet profesionale sipas standarteve evropiane". Në këtë seminar morën pjesë drejtues, punonjës social e specialistë të Drejtorive Rajonale të ShSSh, institucioneve të përkujdesit social, OJF-ve, etj.
Në qëndër të seminarit ishte jo vetëm njohja me modelin e shërbimeve të decentralizuara të rajonit të Toskanës, por nevoja e vlerësimit të përgatitjes dhe kualifikimit të "figurave të ndërmjetme" të domosdoshme për organizimin e shërbimit kujdestar. Aktiviteti u mundësua nën kujdesin e Ambasadës Italiane në Shqipëri në bashkëpunim me SHSSH .

Gjithnjë e më shumë hapësirë për shërbimin e kujdestarisë

Duke qënë se alternativa e shërbimit të kujdestarisë për fëmijë në nevojë është jo vetëm në interesin më të mirë të fëmijës, por edhe një nga rrugët për të bërë realitetit deinstitucionalizimin, në 29 maj në Shtëpinë e Fëmijëve Parashkollorë në Shkodër u zhvillua trajnimi i familjeve kujdestare që do jenë ofruese të shërbimit të kujdestarisë për fëmijët që janë rezidentë në këtë institucion.
Janë katër familje që do të çertifikohen si familje kujdestare dhe pas përfundimit të procedurës gjyqësore do të ofrojnë kujdestari për fëmijët e kësaj qëndre.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
5 Maj-5 Qershor 2015

Histori suksesi

Punë e sukseshme në menaxhimin e rasteve

Sa më shumë kohë kalon, aq më shumë bindemi se është me vlera sociale shtrirja e modelit të menaxhimit të rastit si mënyra e duhur dhe praktika më e mirë e punës për parandalimin e institucionalizimit të personave me nevoja specifike.
Qytetarja A. D. një nënë e re, e ndodhur në kushte të vështira social-ekonomike kërkoi nga ShSSh që fëmijën e saj 1 muajsh ta vendoste në Institucionet Rezidenciale për Fëmijë.
Specialistët e Drejtorisë së Monitorimit në ShSSh e vlerësuan rastin me synimin pozitiv për të bërë gjithçka duhej për parandalimin e institucionalizimit të fëmijës. Me veprim emergjence, në përputhje me vlerësimin e detajuar të nevojave të nënës dhe fëmijës u dha mbështetje psikologjike, u sigurua pagesa ekonomike për 6 muaj, qumësht të përshtatshëm për ushqimin e fëmijës bashkë me paketa ushqimore për familjen, veshmbathje, asistencë ligjore, shërbim shëndetësor.
Në veprimin afatgjatë nënës i është sygjeruar gjetja e rrugës së duhur për kapërcimin e situatës, si regjistrimi në Qëndrat e Formimit Profesional dhe Zyrën e Punës, rregjistrimi i fëmijës në çerdhe. Rasti do vazhdojë të monitorohet.

Objektivi i Qëndrave të Zhvillimit: Aftësim dhe integrim social për personat me aftësi të kufizuara



Aleksi ka shprehur deshirën për të mësuar një zanat, për të qënë i kompletuar, i dobishëm në shoqëri dhe për ta patur më të lehtë në të ardhmen që të bëhet i aftë për punë.
Qendra e Zhvillimit Rezidencial Durrës në bashkëpunim me Qëndrën Rajonale të Formimit Profesional Publik bën të mundur regjistrimin në kursin për kuzhinë dhe marrjen e çertifikatës së vlefshme për të hyrë në tregun e punës. Synimi më i përgjithshëm: Aftësimi i Aleksit dhe fëmijëve të tjerë për të qënë më të sigurt për të ardhmen e tyre.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
5 Maj-5 Qershor 2015

➢ Bashkëpunime të frutshme



Qëndra Ditore Polivalente për të moshuar në Kamëz e ka bërë të vazhdueshme traditën e lidhjes me aktorë e partnerë komunitarë, që kontribuojnë me aktivitete të larmishme për argëtimin dhe socializimin e të moshuarve të qëndrës. Në këtë kontekst nxënësit e Shkollës "Ibrahim Rugova" ofruan veprimtarinë "Një ditë ndryshe për të moshuarit", shoqëruar me dhurata, ngrohtësi dhe buzeqeshjen e tyre rinore.

➢ Ambient për shlodhje, argëtim e socializim



Në sajë të kujdesit të vazhduar për përmirësimin e kushteve femijët dhe familjet e strehuar përkohësisht në Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencave, tani kanë në dispozicion sallën e re të shlodhjes dhe argëtimit. Prindërit dhe femijët e tyre mund të kalojnë në mënyrë të organizuar kohën e lirë. Fëmijët me lojra, ndërsa prindërit mund të shlodhen duke biseduar apo ndjekur emisione televizive.

➢ Informim dhe ndërgjegjësim qytetar



Në objektivat e punës dhe programet e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale të ShSSh bën pjesë edhe puna e veçantë për ndërgjegjësimin e komunitetit rom, për të qënë të informuar dhe orientuar për shërbimet që ofrohen, mënyrën si ata mund të përfitojnë nga programet sociale.
Në këtë kuadër përfaqësues të SHSSH në Njësinë Bashkiake Nr. 5 informuan qytetarët për bazën ligjore, mënyrat e përfitimit duke bashkëbiseduar dhe dialoguar me një grup të komunitetit rom. Ky aktivitet u realizua në bashkëpunim me organizatën joqeveritare "Ndihmë Për Fëmijet" që zhvillon aktivitetin në Tiranë.

Turizmi social si mundësi për zhvillim dhe përfshirje sociale



Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë organizoi në Sarandë Konferencën mbi Turizmin Social me pjesëmarrjen e gjërë të aktorëve shtëtëror lokal e kombëtar, si dhe të komunitetit të biznesit e donatorëve. "Të gjithëve na pëlqen Saranda në muajt e verës, kur është e populluar nga turistët e shumtë vendas dhe të huaj.

Por ardhja e fundit të gushtit e kthen atë në një vend ku duket sikur jeta mbaron. Por si Saranda janë dhe shumë qytete të tjera, Himara apo gjithë fshatrat e bregut të detit, ku hotelet dhe vendet akomoduese përgjatë 10 muajve të tjerë të vitit qëndrojnë bosh." – u shpreh Ministri Klosi.

"Kemi vendosur që të shfrytëzojmë infrastrukturën e ngritur, klimën e ngrohtë, por edhe afërsinë me kryeqytetet europiane, për të zhvilluar në këto zona turizmin social, turizmin për moshën e tretë, apo për personat me aftësi të ndryshme, për t'i populluar këto qytete në të gjithë muajt e vitit"- theksoi Ministri në fjalën tij. Turizmi social përveç mundësisë për zhvillim ofron dhe mundësi për përfshirje sociale të grupeve vulnërabël.

Kapacitete të reja të KMCAP-it EPROR



16 mjekë dhe 4 juristë do të jenë pjesë e katër KMCAP Epror të Shërbimit Social Shtetëror. Këto KMCAP Epror ngrihen për herë të parë për ShSSh dhe në fokus kanë: sëmundjet e shëndetit mendor, sëmundjet e përgjithshme, verbërinë dhe para-tetraplegjinë. Mjekët dhe juristët u betuan në një ceremoni të mbajtur në Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nga Ministriat Klosi, Beqja, Cani dhe Manjani.

"Që me marrjen e detyrës sime si ministër i MMSR-së u angazhova për t'u dhënë zgjidhje sa më të shpejtë kërkesave të personave me aftësi të kufizuara apo invalidëve të punës për daljen në KMCAP.

Për këtë qëllim vendosëm të shtojmë në 10 numrin e Komisioneve Eprore të Caktimit të Aftësisë për Punë, për t'i dhënë një trajtim sa më të shpejtë çdo ankese apo pretendimi që çdo individ ka për vendimet e komisioneve të nivelit të parë." – theksoi Ministri Klosi.

Reforma territoriale një mundësi e re për avancimin e shërbimeve sociale në nivel vendor

Elbasan



Rolet dhe funksionet e Bashkisë në ofrimin e shërbimeve sociale ishin në qendër të Tryezës Rajonale të organizuar nën kujdesin e Prefektit të Elbasanit dhe me pjesëmarrjen e drejtuesve të pushtetit vendor dhe shërbimeve sociale në njësitë vendore në Qark. Në takim morrën pjesë Zv. Ministrja Bardhylka Kospiri, Drejtoresha e Përgjithshme e ShSSh dhe Kryetarja e Agjensisë së Mbrojtjes së Fëmijëve.

Reforma territoriale dhe ndryshimet e rëndësishme që po ndodhin në njësitë vendore, janë moment shumë i rëndësishëm, që po vlerësohet si duhet në përpjekjet për të ngritur së pari strukturat e duhura lokale për ofrimin e shërbimeve sociale gjithëpërfshirëse dhe cilësore, e në vijim për planifikimin e ngritjen e shërbimeve që shkojnë përtej pagesave të ndihmës ekonomike.

Berat



Nën drejtimin e Prefektit të Qarkut Berat z. F. Nasufi, dhe me pjesëmarrjen e zv/Ministres së Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë zj.Kospiri, Drejtoreshës së Përgjithshme të SHSSH dhe Agjensisë Kombëtare të të Drejtave të Fëmijëve, u organizua takimi rajonal me të zgjedhurit vendor të Qarkut Berat, NJMF dhe administratorë socialë në këtë rajon, nisëm kjo e ndërmarrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror.

Kjo vjen në momentin e duhur, ku reforma territoriale do të ketë ndikimin e saj edhe në ofrimin e shërbimeve sociale ndaj qytetarëve, e në këtë kontekst roli dhe funksioni i bashkive në ofrimin e këtyre shërbimeve do të varet shumë nga menaxhimi korrekt i tyre në nivel vendor.

Vlerësimi i burimeve njerëzore, organizimi i strukturës vendore me sektorë funksionalë e me qasje bashkëkohore, do të rrisë përmirësimin e shërbimeve ndaj grupeve vulnerabël.

Lezhë



Bashkë me drejtuesit vendor të Qarkut të Lezhës diskutuam mbi rolet dhe funksionet e Bashkive në ofrimin e shërbimeve sociale për grupet vulnerabël. Shumë të rëndësishme idetë dhe shqetësimet që ata ngritën në tryezë për ta bërë mbrojten dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël një realitet të kudo ndodhur në nivelin vendor.

Tryeza

"Reflektim mbi zbatimin në praktikë të Standarteve të Përkujdesit Shoqëror në Institucionet e Përkujdesit për Fëmijët"



Me qëllim garantimin e ofrimin të shërbimeve cilësore në interesin më të lartë të fëmijëve, duke rritur kapacitetet profesionale të stafeve të qendrave rezidenciale për fëmijë, në datat 25 dhe 26 nëntor Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me organizatën "Terre des Hommes, organizoi Tryezën me teme "Reflektimi mbi zbatimin në praktikë të Standarteve të Përkujdesit Shoqëror në Institucionet e Përkujdesit për Fëmijët"

Në Tryezë morën pjesë drejtues dhe përgjegjësit e sektorit social të qendrave rezidenciale publike dhe jo publike. Diskutimet e të gjithë aktorëve u përqëndruan në zbatimin në praktikë të standarteve të përkujdesit për fëmijë, duke ndarë praktikat pozitive dhe sfidat. Pjesëmarrësit

dhanë mendime të vlefshme për nevojën e rishikimit të standarteve. 19 institucione jo-publike u përfshinë aktivisht në diskutime, në një tryezë që mblodhi për herë të parë bashkë akorët publik dhe jo-publik të shërbimeve rezidenciale

"Ti mbajmë Fëmijët të Sigurt"



Në kuadër të bashkëpunimit midis Shërbimit Social Shtetëror dhe "Terre des hommes" me synim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit dhe mbrojtjes për fëmijët në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror, përmes forcimit të kapaciteteve të stafit, për të garantuar ofrimin e shërbimeve cilësore në interesin më të lartë të fëmijëve, bazuar në standartet e shërbimeve shoqërore, në 11 Nëntor 2015, në ambientet e Shtëpisë së Fëmijës "Zyber Hallulli", u organizua trajnimi me temë" "Mbrojtja e Fëmijëve nga Abuzimi –Njohja me Politikën per Mbrojtjen e Fëmijeve, Standarte dhe Procedurat " Ti mbajmë fëmijët e Sigurt".

Në trajnim morën pjesë 24 pjesëmarrës - staf përkujdesës , kujdestarë gjithashtu kuzhinier, sanitarë, staf i ruajtjes dhe sigurisë fizike, nga Institucionet e përkujdesit Shoqëror "Zyber Hallulli" dhe "Hana Rozafa", të cilët morën njohuri të thelluara mbi konceptin e mbrojtjes së fëmijeve nga format e abuzimit, bazën ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare, standarte dhe procedura që garantojnë respektimin e të drejtës të fëmijëve për të qënë të mbrojtur nga çfarëdo lloj forme dhune, keqtrajtimi dhe abuzimi.

<u>Në Fokus të Drejtorive Rajonale</u>

Vlorë

Së bashku me Njesinë për Mbrojtjen e Fëmijëve Bashkia Vlorë, Observatori për të drejtat e Fëmijeve, World Vision dhe Njësia per mbrojtjen e fëmijeve në Këshillin e Qarkut Vlorë, u lançua nisma para anëtareve të Këshillit Bashkiak, që çdo këshilltar të përkujdeset për një grup social të caktuar, për të promovuar talentet, vlerat dhe të drejtat e fëmijëve.

Durrës



Përfaqësues nga njësitë vendore dhe aktorë të shoqërisë civile që punojnë në fushën e mbrojtjes sociale morën pjesë në një workshop të zhvilluar nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) në bashkëpunim me drejtorinë Rajonale të ShSSh Durrës.

Qëllimi i workshopit ishte ndarja e informacionit të ndërsjellë bazuar në situatën konkrete të problemeve ligjore e sociale të individëve apo grupeve në nevojë në komunitetet me të cilat punojmë.

<u>Në fokus në Qendrat e Përkujdesit</u>

Fëmijët festojnë

Me dt 27.11.2015 u zhvillua aktivitet me rastin e festës kombëtare të flamurit "28 Nëntor" që përkon edhe me 89 vjetorin e krijimit të strehës së parë Vorfnore. U zhvilluan aktivitete që përmbanin ekspozitë të pikturave dhe punimeve të tjera artistike të fëmijëve, program artistik nga grupi i fëmijëve të shtëpisë.

Në përfundim të aktivitetit u përzgjodhën dymbëdhjetë piktura më të mira nga juria, të cilat do të përdoren si imazh për realizimin e kalendarit të vitit 2016. Ndërsa çmimi i parë u përzgjodh të jetë kartolina e urimeve të fundvitit nga institucioni i fëmijëve "Z. Hallulli".

Bashkëpunim i Shtëpisë së Fëmijëve "Zyber Hallulli" dhe Shkollës së Kulinarisë

U nënshkrua një marrëveshje midis shkollës së kulinarisë Neranxi dhe Shtëpisë së Fëmijës "Zyber Hallulli". Presidenti i shkollës ofroi 7 bursa për fëmijët të moshës së rritur për të marrë një profesion duke i përgatitur fëmijët për jetëse të pavarur.

Rrisim njohuritë

Një marrëveshje e re bashkëpunimi midis Universitetit "Epoka" dhe Shtëpisë së Fëmijës "Zyber Hallulli", duke ofruar 1 vit trajnim për përdorimin e kompjuterit me nxënësit e informatikës dhe modelim me nxënësit e arkiteturës. Fëmijët e përfshirë në këtë trajnim i përkasin moshës 8-10 vjeç, pasi është mosha më e përshtatëshme për të marrë këto lloj njohurish.

16 ditë fushatë aktive kundër dhunës ndaj grave



Për 16 ditë me radhë do të angazhohemi që të hapim një debat të gjerë për të sensibilizuar çdokënd në luftën kundër fenomenit të dhunës ndaj pjesës më të mirë të familjeve dhe shoqërisë sonë, gruas. Ndërgjegjësimi nis nga të gjithe ne! Në datën 25 nëntor Strehëza Kombëtare e nisi fushatën sensibilizuese me fëmijet e shkollës 9 vjeçare "1 Qershori".

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
5 Dhjetor 2014 - 5 Janar 2015

Ministri Veliaj: "35 dollarë për familjet në nevojë që shkollojnë dhe vaksinojnë fëmijët"



Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ka zgjeruar spektrin e ndihmës dhe mbështjes sociale për familjet dhe fëmijët në nevojë.

Është bërë realitet fakti që familjet në nevojë dhe që janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike nëse i vaksinojnë fëmijët dhe i regjistrojnë ata në shkollë, do të përfitojnë një pagesë shtesë prej 35 dollarësh.

Në mbyllje të vitit 2014, Ministri Erion Veliaj priti prindër dhe fëmijë nga komuniteti rom dhe në situatë rruge. Ai i nxiti prindërit që t'i shkollojnë fëmijët tyre, si e vetmja rrugë për integrimin e këtij komuniteti dhe daljen nga varfëria.

Në fjalën e tij ministri Veliaj theksoi se "Familjet me ndihmë ekonomike jo vetëm që e morën në kohë atë, por për herë të parë në 24 vjet dhamë shpërblim si për këto familje, ashtu edhe për personat me aftësi të kufizuara".

Ai falenderoi Shërbimin Social Shtetëror dhe dhjetra organizata që u angazhuan për trajtimin e çështjes së fëmijëve në situatë rruge, për punën e tyre të mirë. "Nëse sot nuk investojmë që fëmijët të shkojnë në shkollë dhe të vaksinohen, atëherë cikli i varfërisë do të vazhdojë pafundësisht.

Ndaj qeveria ka vendosur të japë një pagesë shtesë prej 35 dollarësh për ato familje me ndihmë ekonomike që çojnë fëmijët në shkollë dhe i vaksinojnë ata", u shpreh ministri Veliaj. Me rastin e festës së Vitit të Ri, Shërbimi Social Shtetëror me mbështetjen e SFI, ADRA dhe Caritas shpërndau dhurata për 200 fëmijë rom dhe në situatë rruge.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
5 Dhjetor 2014 - 5 Janar 2015

Modelojmë shërbime që nxisin deinstitucionalizimin



Një qëndër ditore për fëmijët është një mënyrë për të parandaluar vendosjen e tyre në qëndra rezidenciale.

Një shtëpi familje i krijon mundësitë fëmijës të jetojë në një ambient të ngjashëm me familjen.

Të dyja këto shërbime janë jetësuar në Shtëpinë e Fëmijës në Shkodër që menaxhohet nga Shërbimi Social Shtetëror, përgjatë këtij viti me mbështetjen e Projektit të IADSA.

Këto dy shërbime të reja u vizituan nga Zv. ministrja e MMSR Znj. Kospiri dhe Ambasadori Italian, Z. Gaiani.

Shtëpia e fëmijës gjatë këtij viti është transformuar rrënjësisht.

Të përkushtuar për të vlerësuar çdo nevojë të personave me aftësi të kufizuar





Kujdesi për personat me aftësi të kufizuara gjatë vitit 2014 ka marrë një dimension të ri të shoqëruar me zgjerimin e shërbimeve tradicionale.

Në këtë kontekst Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Qarku Berat në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Shoqatën e Paratetraplegjikëve në Berat mundësuan ndarjen e 15 karrocave për personat me aftësi të kufizuara.

Plotësimi i kësaj nevoje mundëson përmirësimin e aksesit të tyre në jetën familjare e sociale.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
5 Dhjetor 2014 - 5 Janar 2015

NË TERREN

☑ Nga ndihma ekonomike drejt punësimit



Në muajin dhjetor në Lezhë u bë diplomimi i 45 grave që kanë mbaruar kursin e formimit profesional për rrobaqepësi, mbështetur nga Kryqi i Kuq dega Lezhë. Aktiviteti i konceptuar në formë feste, ku përveç shpërndarjes së çertifikatave të njohura dhe të miratuara nga MMSR-ja, u dhanë edhe dëshmi konkrete nga gra të cilat kanë përfunduar kursin dhe që aktualisht janë të punësuara.
Përmes këtij aktiviteti dhe donacioneve nga Restorant Rapsodia dhe Organizata World Vision, u përgatitën 25 pako ushqimore përmes të cilave u ndihmuan në prag të vitit të ri 25 familje në nevojë.

☑ Një tjetër premtim i mbajtur



Një vit më parë kur diskutohej buxheti i 2014, fëmijët e Shtëpisë "Zyber Hallulli" i kërkuan Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Erion Veliaj, mundësimin e ndërtimit të një fushe futbolli për tu stërvitur dhe dhe kaluar në mënyrë aktive kohën e lirë.
Rezultati: Premtim i mbajtur, sepse tashmë fusha është gati dhe funksionon falë mbeshtetjes së Expo Center.

☑ Performancë e shkëlqyer e Qendrës së Zhvillimit në Durrës



Një tjetër Qëndër e transformuar rrënjësisht festoi në fundvitin që kaloi. E menaxhuar në mënyrë të shkëlqyer nga Arlindi, kjo qëndër model për shërbimet për fëmijët me aftësi të kufizuara, nuk ka përmiresuar thjesht infrastrukturën e saj.
Mbi të gjitha aty ka ndryshuar rrënjësisht koncepti për shërbimin ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara e shoqëruar me përmirësimin e dukshëm të cilesië së shërbimit për 42 femijët e kësaj qendre rezidenciale.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
5 Dhjetor 2014 - 5 Janar 2015

Shqipëria Dhuroi

Për të dytin vit rradhazi Shërbimi Social Shtetëror ndërmorri përgjatë gjithë muajit dhjetor fushatën “Shqipëria Dhuron”.

Përpjekja për të nxitur solidaritetin social me familjet dhe individët në nevojë në prag të festave të fundvitit, u pasua nga përfshirja në këtë fushatë të 64 bizneseve, 63 individëve, dhe 74 institucioneve, organizatave dhe fondacioneve, që kontribuan në rrjetin e institucioneve publike dhe shpesh edhe jo publike të përkujdesit, si dhe në disa prej drejtorive rajonale të SHSSH.

Këto të fundit koordinuan dhe dërguan pranë familjeve më të varfëra pako ushqimore dhe dhurata për fëmijët.

SHSSH ka bërë publik kontributin e tyre përmes Buletinit të Donacioneve, të cilin e gjëni në adresën: www.sherbimisocial.gov.al



☒Në Shkodër rreth 800 fëmijë festuan dhe morën lodra e dhurata si dhe mbi 3000 familje në nevojë përfituan pako ushqimore.

Kjo në sajë të bashkëpunimit me Fondacionin "Rose Wilder Lane"



☒Në qarkun e Durrësit rreth 50 familje të komunave dhe bashkive të ndyshme si: Xhafzotaj, Gjepaj, Bubq, Ishëm, Shijak dhe Krujë arritën të kenë diçka në tavolinë për të festuar si të gjithë në festat e fundvitit.
Këto pako u mundësuan falë Fondacionit Nehemia, World Vizion dhe Vizion pa Kufi.

Buletini Informativ

SHERBIMI SOCIAL

5 Dhjetor 2014 - 5 Janar 2015



☒Në Elbasan, të gjithë e morën dhuratën e vitit te ri për këtë fundvit! Buzëqeshjet dhe falenderimet e 400 familjeve të varfra i dhanë kuptim kësaj nisme të këtj qarku ku u përfshin biznese dhe individ të ndryshëm.



☒Në Qarkun e Beratit u shpërndanë rreth 400 pako për familjet në nevojë të qytetit të Beratit, Kuçovës dhe Urës Vajgurore.

Këto pako u mundësuan nga DAR Berat, bashkia Berat dhe fondacione të ndryshme.



☒Të jesh solidar nuk është gjithnjë e thjeshtë! Duhet angazhim i madh, përkushtim dhe mbi të gjitha njerëz që të jenë pranë atyre që kanë nevojë për mbështetje.

Ndaj në qarkun e Vlorës u dhuruan 500 pako ushqimore dhe dhurata për familjet në skemën e ndihmës ekonomike.
Mbështetja më e madhe erdhi nga Compassion.



☒Në Korçë, nën kujdesin e Shërbimit Social Shtetëror si dhe me mbështetjen e përfaqësuesve të Societe General Bank, fëmijët e Shtëpisë së foshnjës ‘’Lulet e Vogla ‘’ kanë gëzuar dhe festuar në këtë fundvit.
Jo vetëm dhurata, por donatorët kanë menduar edhe për përmirësimin e kushteve të jetesës për fëmijët e vegjël.



☒Në Lezhë dhe rrethinat e saj u dhuruan 150 pako ushqimore dhe dhurata për fëmijët e familjeve në nevojë.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
5 Dhjetor 2014 - 5 Janar 2015





☒Edhe në Dibër festuam me fëmijët në nevojë.
Janë mbi 250 fëmijë të cilët kanë marrë dhurata për festat. Faleminderit World vision që bëri sado pak të lumtura këto familje.

☒Kukësi festoi falë bujarisë së F.K Kukës dhe Prefektit Safet Gjici.
U festua me fëmijët me aftësi të kufizuara në Kukës, me pjesmarrjen e Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Z. Erion Veliaj, dhe Drejtoreshës së Përgjithshme të SHSSH, Etleva Bisha.

Pjesë ishin dhe miq të mirë nga shoqëria civile dhe fëmijë të Qëndrës Kulturore të Fëmijëve.

Institucionet e Përkujdesit









SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2015



"Fëmijëve dhe të varfërve, të gjithë atyre që vuajnë dhe janë vetëm, jepini gjithnjë një buzëqeshje të ëmbël; Jepuni atyre jo vetëm kujdesjet, por dhe zemrën tuaj. Ka të ngjarë të mos kemi mundësi për të dhënë shumë, por mundemi gjithnjë të japim gëzim..."

Nënë Tereza

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2015

Festat duan Dashuri!

Të gjithë banorët e qendrave të Përkujdesit Social iu gëzuan disa momenteve ndryshe nga përditshmëria e tyre. Me moton "*Festat kërkojnë dashuri*" dhe nën kujdesin e kryeministrit Edi Rama, organizuam 28 festa në 28 qendrat rezidenciale të Përkujdesit Social në të gjithë vendin. Qëllim i organizimit të kësaj dite ishte sigurimi i një mjedisi festiv dhe kujdesi për njerëzit në nevojë që jetojnë në këto institucione, si dhe sensibilizimi i gjithë shoqërisë për të kontribuar përmes veprimeve vullnetare për mirëqenien e njerëzve në nevojë dhe për të treguar solidaritet jo vetëm gjatë festimeve, por gjatë gjithë vitit.



" *Kemi vendosur që këtë festë ta kthejmë në një traditë për çdo fundvit, ku njerëzit në nevojë të kenë mundësi që ashtu si edhe e gjithë shoqëria, të ndjejnë atmosferën festive.*"-theksoi Ministri Klosi.





SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2015

Një urim i vecantë, për fëmijë të vecantë



Kryeministri i Shqipërisë,Z.Edi Rama festoi së bashku me fëmijët e jashtëzakonshëm të Qendrës së Zhvillimit në Durrës festat e fundvitit dhe në të njëjtën kohë në të 28 qendrat e shërbimeve sociale në Shqipëri. Qëllimi i organizimit të kësaj dite ishte sigurimi i një mjedisi festiv dhe kujdesi për njerëzit në nevojë që jetojnë në këto institucione si dhe sensibilizimi i gjithë shoqërisë për të kontribuar përmes veprimeve vullnetare për mirëqenien e njerëzve në nevojë dhe për të treguar solidaritet jo vetëm gjatë festimeve, por gjatë gjithë vitit.



Në Shtëpinë e Foshnjës “Lulet e Vogla” Korçë



Mbështetja dhe solidaritet nga pushteti qëndror dhe vendor për Shtëpinë e Foshnjes "Lulet e Vogla" Korçë nuk ka munguar.

Të pranishëm në këto ditë festash dy miq që gjithmonë i kanë qëndruar pranë këtyre fëmijëve për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe plotësimin e standardeve, zoti Niko Peleshi - zv. Kryeministër i Republikës së Shqipërisë dhe zoti Sotiraq Filo - Kryetar i Bashkisë Korçë.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2015

Bashkë Mundemi!



Një iniciativë e shkëlqyer bashkëpunimi ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe "Fondacionit Fjala" që konsiston në themelimin e Food Bank Albania mori jetë këto ditë festash të fundvitit,në Shkodër.

Falë një risie, një bashkëpunim ndërmjet SHSSH dhe Food Bank Albania Shkodër u bë e mundur që për çdo familje të shpërndahen shporta të pasura ushqimore dhe plot lodra për fëmijë.



Nën kujdesin e Administratorit të OSSHE Ardian Çela , Zv.Min.të Kulturës Zef Çuni dhe nën koordinimin e SHSSH Shkodër , një nga 28 rezidencat ku ndamë shumë dashuri në këtë ditë feste ishte dhe Shtëpia e Foshnjës Shkodër ku fëmijët gëzuan në një ambient festiv mes plot dhuratave e surprizave.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2015

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror,Korcë



Festat Duan Dashuri!! Kjo ishte motoja dhe ky ishte mesazhi i përcjellë për fëmijët me aftësi të kufizuara, të qendrës ditore "Atelie" nga Ministri i Mjedisit Lefter Koka. Të gjithë së bashku percjellim urime, dashuri dhe integritet.

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror,Vlorë



Ministri i Çështjeve Vendore z.Blendi Çuci, NBG Bank ,Prefektja e Qarkut znj.Etjona Hoxha , Nënkryetari i Bashkisë Vlorë z. Ardian Musta, përfaqësues të shoqërisë civile si znj.Brikena Puka dhe ai i medias z.Enrik Mehmeti morën pjesë në festën e fundvitit me fëmijët e Shtëpisë së Fëmijës Vlorë. Jo vetëm festat duan dashuri, çdo punë e përditshme kërkon përkushtim, angazhim dhe dashuri, ndaj le të jetë ky motivi i një angazhimi më të madh ndaj shtresave në nevojë. Falenderojmë të gjithë ata që u bënë pjesë e nismës së MMSR !

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2015

Ministrja Gjosha,në Shtëpinë e të Moshuarve,Kavajë



TIRANE – Ministrja e Integrimit Europian, Klajda Gjosha, vizitoi Shtëpinë e Të Moshuarve në Kavajë.



"Ne sot kemi ardhur këtu me dëshirën, që në këtë fundvit, të mundemi sado pak t'ju argëtojmë, t'u shohim të kënaqur. Festat jane gjithmonë një moment reflektimi për të qenë më të mirë, më pozitivë, për të kujtuar dhe për të mos harruar se të gjithë një ditë do vijmë në moshën tuaj, ku do të kemi nevojë për më shumë përkujdesje"



Ministrja u shpreh se për të gjitha kategoritë sociale në nevojë, vëmendja e shtetit duhet të jetë maksimale. "Unë dua t'ju them se ju nuk jeni vetëm. Se vëmendja ndaj jush nuk do të mungojë,se në këtë Shtëpi do të gjeni ngrohtësi, jo vetëm kujdes. Dua t'ju uroj gjithashtu një vit sa më të mbarë e të qetë, të gëzoni shëndet të plotë."

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2015

Shqipëria Dhuron!

Mos i nënvlerëso mundësitë e tua, sepse buzëqeshja jote mund të jetë arsyeja që dikush të lulëzojë në jetë!



Shqipëria dhuron-Durrës

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Durrës u organizua për të ndihmuar familjet në nevojë në Qarkun e Durrësit për festat e fundvitit. Bashkë me Fondacionin Nehemia, World Vision, Peace Corp dhe Misionin pa Kufi u ndihmuan 132 familje, 70 fëmije dhe u strehuan përfundimisht 2 të moshuar të pastrehë, në të 3 Bashkitë e Qarkut Durrës.

Qëllimi ynë është të ndihmojmë njerëzit në nevojë duke i bërë të aftë të ndihmonin vetveten dhe sëbashku të ndërtojmë një shoqërinë të bazuar në vlera të qëndrueshme.





Ishëm 2015

"Megjithëse kemi ëndrra të mëdha, kemi edhe një përqasje "hap pas hapi" që u jep mundësinë shumë njerëzve të bashkohen me ne në udhëtimin tonë për të ndërtuar një shoqëri më të mirë ."

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2015

Të ndihemi të barabartë-Dita Ndërkombëtare e PAK



"Çdokush duhet të ndihet i barabartë në shoqëri. Ditë të tilla na shërbejnë edhe për të kuptuar se këto shtresa kanë nevojë për më shumë mbështetje shtetërore dhe shoqërore, për të thyer çdo barrierë që i mban ata larg integrimit të plotë në jetën e përditshme, pavarësisht aftësivë që zotëron."-deklaroi Ministri Klosi.



"Ishte vërtet diçka e veçantë për mua që së bashku me ambasadorin Lu të ishim pjesë e ndeshjes së basketbollit me të rinjtë me aftësi të ndryshme, pikërisht në Ditën Ndërkombëtare të PAK."-u shpreh ai.

Në rrugën e Pakthyeshme të thellimit të Reformës së Shërbimeve Sociale

Reformat në Shërbimin Social



Qyteti i Durrësit mblodhi në një tryezë të përbashkët, Zv/Ministren e Mirëqënies Sociale dhe Rinise Znj.Bardhylka Kospiri, Prefektin e Qarkut Durrës Z.Roland Xhelili, Drejtoreshën e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror Znj. Etleva Bisha dhe përfaqësues të Bashkive Durrës, Shijak dhe Krujë. U diskutua mbi detyrat funksionale të shërbimeve sociale në bashkitë kryesore, rolin dhe përgjegjësitë e njësive vendore mbi ofrimin e shërbimeve sociale si dhe format efektive të organizimit të strukturave për shërbimet në nivel bashkie.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2015

Një takim u zhvillua në Vlorë midis zv.ministres znj.Bardhylka Kospiri, Drejtores së Përgjithshme të SHSSH znj .Etleva Bisha me Kryetarët e njësive vendore dhe drejtorët e ndihmës ekonomike të 7 Bashkive të mëdha të Qarkut Vlorë për të përmirësuar rolin e pushtetit vendor dhe frymën e bashkëpunimit me MMSR dhe ShSSh.





Në Qarkun e Shkodrës u zhvillua një takim me përfaqësues të 5 njësive të reja administrative. Zv.Ministrja e MMSR Bardhylka Kospiri dhe Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH Etleva Bisha prezantuan në këtë takim praktikat dhe funksionet e NJQV në fushën sociale përsa i përket Administrimit të Pagesave CASH për Mbrojtjen Sociale si dhe Shërbimet e Përkujdesit Social.

Bashkëpunime e Partneritete

Qëndra Polivalente Ditore Kamëz



Nxënësit e Shkollës Profesionale në Kamëz të shoqëruar me mësuesit e tyre , zbatuan modulet me tema përkatëse si: të mbajnë pastër ambientin ku jetojmë të cilët sëbashku me disa të moshuar u kujdesën për lulet, një grup tjetër nxënësish trajtuan bashkëbisedime në grupe dhe individë. Kjo atmosferë e larmishme bëri të mundur që të moshuarit të ndihen të përfshirë dhe të kalojnë disa orë të këndshme.

Ky aktivitet u krye në zbatim të Misionit të institucionit, ofrimit të përkujdesit social mbi bazën e standardeve të miratuara për të moshuarit, përmirësimin e cilësise së jetës dhe nxitjen e integrimit social të tyre.Faleminderit nxënësve dhe praktikantëve vullnetarë të kësaj shkolle dega shërbimi social dhe kujdestar për mbështetjen duke bërë të mundur arritjen sa më mirë të misionit për një mirëqenie sociale për të moshuarit.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2016

Plani i Veprimit 2016



Së bashku me Drejtorët e Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorët e Institucioneve të varësisë së SHSSH, do vijojmë punën për vitin 2016 me një Plan Veprimi më të konsoliduar, me objektiva të qarta, sipas prioriteteve të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

Bashkë mund të bëjmë më shumë për grupet në nevojë...

Takim me Drejtuesit e Shtëpive Rezidenciale të Fëmijëve në Shqipëri

Takim pune së bashku me Komitetin e Birësimeve me 17 drejtues të Shtëpive Rezidenciale të Fëmijëve në Shqipëri (publike dhe jo publike). Ky takim u zhvillua për të diskutuar jo thjesht mbi praktikat e përmirësuara ligjore të birësimeve, por edhe për të punuar më fort për fuqizimin e familjeve dhe frenimin e braktisjes së fëmijëve.





Konsolidojmë partneritetin me shoqërinë civile





Si pjesë e transparencës së aktivitetit të institucionit, por edhe me vullnetin e plotë për të ndërvepruar me aktorë joqeveritar me qëllim shërbimin proaktiv ndaj grupeve në nevojë, u prezantua tek perfaqësuesit e organizatave joqeveritare dhe partnerëve të SHSSH Plani i Veprimit të vitit 2016.

Viti 2015: Arritjet dhe Sfidat

- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social, Qarku Elbasan

Në Drejtorinë Rajonale Elbasan, Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH, Znj. Etleva Bisha mori pjesë në takimin për të analizuar arritjet dhe sfidat e 2015. Pavarësisht nga sfidat në burime të limituara njerëzore dhe infrastrukurë, stafi i kësaj Drejtorie gjatë 2015 kreu kontrolle në të 50 njësitë vendore të qarkut Elbasan në lidhje me zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar. Kontrollet konstatuan 28 familje që kanë përfituar në mënyre të padrejtë ndihmë ekonomike, si dhe pagesa të padrejta për 37 invalidë pune. Krahasuar me qarqet jo pilot numri i shkeljeve të konstatuara në skemën e ndihmës ekonomike është jashtëzakonisht më i vogël, gjë që tregon për një nga epërsitë e modelit të ri. Përgjatë komisionimeve të KMCAP-it Rajonal është garantuar e drejta e personave me aftësi të kufizuar për komisionim dhe përfitim të pagesave brenda afateve ligjore. Skema e aftësisë së kufizuar në Qarkun e Elbasanit u ul gjatë vitit 2015 me 1345 individë. Janë menaxhuar 200 raste të familjeve dhe individëve në nevojë duke ofruar shërbimin e duhur dhe referimet në institucionet përkatëse, si dhe në përpjekjen për deinstitucionalizim janë kthyer në familjet bilogjike 13 fëmijë që merrnin shërbim në institucione përkujdesi.

- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social, Qarku Fier

Në Drejtorinë Rajonale Fier, Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, Znj. Etleva Bisha mori, pjesë në analizën vjetore për vitin 2015- të. U prezantuan arritjet dhe sfidat e ndeshura gjatë kontrollit të zbatimit të legjislacionit mbi ndihmën ekonomike dhe aftesinë e kufizuar. Janë kontrolluar 42 njësitë vendore të qarkut Fier dhe janë konstatuar 79 familje që kanë përfituar në mënyrë të padrejtë ndihmën ekonomike duke shkaktuar një dëm ekonomik 959. 395 leke. 90% e detyrave të lëna nga grupi i kontrollit në lidhje me largimin e familjeve dhe kthimin e dëmit ekonomik janë realizuar nga njësitë vendore. Në sajë të bashkëpunimit me zyrat e punës janë punësuar 159 individë përfitues të skemës së ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar. Skema e ndihmës ekonomike krahasuar me vitin 2014 është ulur me 11%. është garantuar e drejta e personave me aftësi të kufizuar përgjatë komisionimeve , janë komisionuar gjithsej 5180 individë . Janë ndjekur, adresuar zgjidhjet për 32 ankesat e bëra zyrtarisht nga institucione të ndryshme dhe vetë qytetarët.



Reforma e shërbimeve sociale në fokus të takimit me Drejtuesit e njësive vendore të qarkut Gjirokastër

Në vijim të takimeve me drejtuesit vendor për të diskutuar mbi reformën e shërbimeve sociale, ditën e Premte 19 shkurt 2016 Zv. Ministrja Kospiri dhe Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH, znj. Etleva Bisha u takuan me drejtuesit vendor të Bashkive të Qarkut të Gjirokastrës. Në këtë takim u diskutua gjerësisht mbi rolet dhe funksionet e Bashkive në ofrimin e shërbimeve

Në Fokus të Drejtorive Rajonale,Vlorë




Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Qarku Vlorë dhe administratorët e Bashkisë Selenicë, së bashku në një takim diskutuan mbi objektivat e vitit 2016, gjithashtu u diskutua për arritjet e një viti të mëparshëm dhe pritshmëritë për shërbime më cilësore në këtë vit. Në fokus vazhdojnë të jenë komunitetet dhe grupet e margjinalizuara. Këto takime do të vijojnë me të gjithë administratorët socialë të 7 Bashkive të mëdha të Qarkut Vlorë.



Partnerët e Rrjetit për Shëndetin Publik dhe Shërbimet Sociale Vlorë, në përmbushje të bashkëpunimit dhe koordinimit të punëve me fokusin dhe prioritetet në komunitet sëbashku me Qendrën Psiko Sociale Vatra, Qendrën Rinore, Qendrën Aulona, World Vision, Shëndetin Publik, Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve, Zyrën e Koordinatorit kundër dhunës dhe Shërbimin Social Shtetëror, projektuan një sërë ndërhyrjesh në çështjet e shëndetit riprodhues, në ngritjen e klubeve të solidaritetit në disa prej shkollave pilot, eventet e ndryshme sensibilizuese për punësimin e gruas dhe fuqizimin e familjes duke patur në fokus INFORMACIONIN E SAKTË dhe të DREJTËPËRDREJTË në komunitetet tona !

Në Bashkëpunim me OSSHE



Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror , Qarku Shkodër në bashkëpunim me OSSHE Shkodër morëm iniciativën të zgjidhin problematikat e furnizimit me energji elektrike dhe faturave të prapambetura të 27 familjeve të ngujuara të Qarkut Shkodër si dhe të mundësive të punësimit të disa prej vajzave/grave të këtyre familjeve pranë kësaj kompanie.

Mbështetje, përkujdesje, përfshirje...

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Qarku Shkodër në bashkëpunim me Fondacioni "Shpresë për Botën" iu gjend sërisht pran familjeve të ngujuara jo vetëm për të shpërndar pako ushqimore por veçanërisht për të dhurua fara zarzavatesh të ndryshme me instruksione përkatëse të mbjelljes në mënyrë që këto familje t mund të sigurojnë vetë prodhimet e kopshtit.



Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror , Qarku Lezhë

Në ambientet e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Qarku Lezhë ishin ftuar të gjitha Qendrat që ofrojnë Përkujdesje Sociale në Qarkun Lezhë. Qëllimi i këtij takimi ishte koordinimi i punës së Drejtorisë me Qendrat si dhe rrjetëzimi i Qendrave me njëra- tjetrën bazuar në shërbimet që ato ofrojnë. Në këtë takim u diskutua mbi prioritetet, sfidat apo risitë që çdo Qendër ka për vitin 2016, si dhe mbi mënyrën si të rrisim standartet e shërbimeve të ofruara.

Çdo institucion publik apo jopublik që ofron shërbime në ndihmë të individëve në nevojë, do të ketë gjithë mbeshtetjen dhe bashkëpunimin e DRSHSSH Lezhë!



Në Qendrat e Përkujdesit





Shkolla DEA vijon një bashkëpunim disa vjeçar me institucionin tonë, duke ofruar bursa studimi për disa nga fëmijët tanë, për të studiuar në këtë shkollë prestigjoze. Falenderim e mirënjohje për Drejtorin e kësaj shkolle, Z. Luan Ahmeti por edhe gjithë stafin pedagogjik.

Një gjest shumë i bukur u krye nga nxenesit e klasës së pestë të shkollës DEA, për njerën prej vajzave tona që studion në atë shkollë. Në kuadër të projektit "Dashuri Pa Kushte", të iniciuar nga këta nxënës e mësuesja kujdestare Zj. Anila Baho, Elenit të vogël i ishte përgatitur një surprizë.

Integrim në komunitet



Qendra Polivalente Kamëz kaloi një ditë ndryshe në kompleksin e Akademisë së Futbollit me të rinjtë e kësaj shkolle. Biseda të këndëshme, një takim midis brezash me shumë dashuri dhe ngrohtësi bënë të mundur që banorët e qendrës të ndihen të emocionuar dhe të vlerësuar njëkohësisht.





Qendra e Zhvillimit Rezidencial Durrës



Kisha Ortodokse bashkë me të rinjt vullnetarë janë dhe mbeten dashamirësit n çdo kohë të personave me aftësi të kufizua në Qendrën e Zhvillimit Rezidencia Durrës . Çdo ditë në këtë Qendër është mbushur me vizitorë, vullnetarë dashamirës të përhershëm të cilët jan prezent tek ne duke kaluar në harmon kohën me fëmijët.
Tashmë është krijuar një axhendë që çd ditë në Qendër të ketë vizitorë dh dashamirës të përhershëm .

Sensibilizimi krijon mundësi, bashkimi bën fuqi, humanizmi i të rinjve gjimnazistë të shkollës "Gjergj Kastrioti" s'ka limit. Falenderojmë dhe në emër të fëmijëve me aftësi të kufizuar vullnetarët më të rinj në Qendër.





SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
PRILL 2016

#UnëMbrojFëmijët



#Tiranë

Në 21 Prill Ministri i Mirëqënies Sociale, Blendi Klosi i shoqëruar nga Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dhe Kryetarja e Agjensisë për Mbrojtjen e Fëmijëve inaguroi ambientet e emergjencës në Shtëpinë e Fëmijës" Zyber Hallulli" në Tiranë. Të gjitha shtëpitë e përkujdesit për fëmijët në të gjithë vendin, do të kenë shërbimin e emergjencës për fëmijët në nevojë.

Çdo rast i raportuar apo denoncuar për fëmijë në situatë rruge apo rreziku dhe që kërkon mbrojtjen e menjëhershme të shtetit, do të sistemohet në këto qëndra emergjence. Çdo rast do të adresohet nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve deri në zgjidhjen e plotë të situatës. Alo 116 111 – është një tjetër mundësi për të raportuar çdo rast që shihni. Interesi më i lartë i fëmijës është detyrimi ynë i përbashkët.



#Elbasan



Përgjatë muajit prill Drejtoria Rajonale e Sh.S.Sh.Elbasan, në kuadër të aktiviteteve të ndërmarra në zbatim të Planit Kombëtar Unë Mbroj Fëmijët,zhvilloi biseda me nxënësit e shkollave të Bashkisë Elbasan. Qëllimi i këtyre takimeve është prezantimi i fëmijëve me të drejtat e tyre dhe diskutimi rreth problematikave të dhunës/trafikimit ndaj fëmijëve. Gjithashtu, nxënësit patën mundësi të informohen më tepër mbi çështjen e duhanit dhe efekteve negative të tij, prezantuar nga specialistë të Shëndetit Publik Elbasan. Në vijim Sh.S.Sh.El do të jetë prezent në shkolla të tjera të qytetit të Elbasanit dhe në Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
PRILL 2016

#Berat

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Berat, organizoi një takim pune me drejtuesit dhe stafet e qendrave rezidenciale dhe ditore të zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar që veprojnë në Berat e Kuçovë. Garantimi I zbatimit të standarteve në këto qendra për ofrimin e shërbimit cilësor ndaj përfituesve, por edhe respektimi I të drejtave të fëmijëve në këto qendra ishte thelbi I diskutimit të zhvilluar.



Mbrojta Sociale

Mbrojtje sociale pa dallim për çdo familje dhe individ në nevojë



Shërbimi Social Shtetëror ishte pjesë e Seminarit të 3-të me fokus integrimin e Komunitetit Rom dhe Egjyptian, në kuadër të Dialogut Shqipëri – BE nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Delegacioni Europian në Shqipëri në 20 prill 2016. Në një prej tryezave të zhvilluara si pjesë e këtij seminari përfaqësues të Shërbimit Social Shtetëror informuan mbi modelin e ri të ndihmës ekonomike dhe mundësitë që ai ka krijuar për mbulim më të mirë dhe përfshirje në skemë të familjeve më të varfëra të këtij komuniteti.

Kontrolle të vazhdueshme për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike

Në përmbushje të detyrimit ligjor për kryerjen e kontrolleve pranë njësive vendore në lidhje me zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar strukturat e Shërbimit Social Shtetëror për muajin prill kanë kontrolluar 58 njësi administrative në të cilat janë konstatuar shkelje në dhënien e ndihmës ekonomike për 318 familje me dëm ekonomik 1.253.571 lekë, si dhe pagesa të kryera jo saktë për 24 familje me efekt 362.338 lekë. Në lidhje me pagesat për personat me aftësi të kufizuar janë evidentuar pagesa të kryera në kundërshtim me legjislacionin për 114 PAK me efekt 2.261.709 lekë dhe 38 invalidë pune me efekt 275.359 lekë. Kontrollet vijojnë.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
PRILL 2016

Në betejën me autizmin jemi të gjithë bashkë

#Elbasan

634 persona me autizëm në Qarkun e Elbasanit përfitojnë një pagesë mujore paaftësie si dhe një person kujdestar mbështetës. Në Elbasan funksionojnë Qendra dhe Shoqata që trajtojnë probleme të spektrit autik që koordinojnë veprimtaritë e tyre. Shërbimi Social Shtetëror Elbasan në bashkepunim me Qendrën e Autizmit Elbasan, organizoi aktivitetin sensibilizues për fëmijët autik që trajtohen në këtë qendër. Të gjithë bashkë mund të arrijmë më shumë për të mundësuar realisht shërbime cilësore dhe integrim të plotë në shoqëri si bashkëmoshatarët e tyre.



#Durrës



Qendra e Zhvillimit Rezidencial Durrës ofron shërbime psiko-sociale dhe shëndetësore për personat me aftësi të kufizuar dhe autizëm. Falë marrëdënieve që kemi krijuar me vullnetarët, nxënësit e shkollave dhe donatorët si palë të treta punojmë që personat në nevojë të kenë të gjitha të drejtat e liritë themelore, të jenë të integruar me komunitetin duke ja plotësuar të gjitha kushtet, mundësitë, dhe format e ndryshme të argëtimit.

#Tiranë

Fëmijët e Shtëpisë "Zyber Hallulli" iu bashkuan ditës botërore të autizmit duke vizituar Qendrën e Shërbimeve Sociale "Ndihmoni Jetën".



Autizmi Flet...

Është Koha ta dëgjojmë....

Buletini Informativ
SHERBIMI SOCIAL
PRILL 2016

Rrisim kapacitetet e stafeve të Shërbimeve Sociale

Administratori shoqëror hallkë e rëndësishme e sistemit të mbrojtjes sociale



Pas kontrollit për pagesat e NE-së dhe PAK në Bashkinë Peqin ka vijuar Trajnimi me administratorët social të kësaj Bashkie për përmirësimin e punës për përpilimin sa më të saktë të Evidencave Statistikore.

Trainimet e administratorëve shoqërorë janë proces i vazhdueshëm i punës së të gjitha Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

"Ndihma e parë" në qendrat e përkujdesit

Trajnim dhe aftësim profesional të punonjësve për mënyrat e dhënies së "Ndihmës së Parë". Shërbimi Social Shtetëror, bazuar në Planin e Veprimit për rritje kapacitetesh dhe trajnime të stafit të punonjësve për vitin 2016 në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar ka bërë të mundur tema specifike të trajnimit që po zhvillohen sipas një kalendari të përcaktuar në çdo Institucion të Përkujdesit Shoqëror. PërfunDoi me sukses trajnimi për Dhënien e Ndihmës së Parë në Shtëpinë e të Moshuarve në Poliçan, në Sarandë, ndërkohë po vijojnë trajnimet edhe në institucionet e tjera të përkujdesit. Ato do zhvillohen në çdo qendër përkujdesi nga degët e Kryqit të Kuq Shqiptar.



Kujdestarë për të Moshuar



Në kuadër të trajnimeve, ngritjes profesionale dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për përfituesit, personeli i Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë që prej muajit prill do të marrë pjesë në kursin "Kujdestarë për të Moshuar". Kursi zhvillohet nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Nr.4 dhe është do të zgjasë tre muaj. Në fund të kursit personeli do të pajiset me certificatën e njohurive të marra. Cilësia e shërbimit në Shtëpitë e të Moshuarve buron nga cilësia e stafeve, prandaj ngritja e kapaciteteve të tyre është domosdoshmëri dhe do të jetë proces i vazhdueshëm.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
PRILL 2016

Në Qendrat e Përkujdesit

8 Prilli, Dita Ndërkombëtare e Komunitetit Rom festohet në QKTE

Përfituesit e shërbimeve në këtë Qendër, familje të komunitetit rom, nën kujdesin e stafit të qendrës dhe në bashkëpunim me Organizatën "Shkej" dhe Terre Des Hommes" festuan 8 Prillin, Ditën Nderkombëtare të komunitetit rom. Qendra prej më shumë se dy vitesh ka zgjeruar shërbimet që ofron për të mbështetur familjet jo thjesht me strehim, por edhe për nxitjen e punësimit, formimit profesional, arsimimin e fëmijëve dhe kujdesin shëndetësor. 23 Familje në dy vitet e fundit lanë qendrën për shkak të mbështetjes me shërbime që solli ndërtim te jetesës së pavarur jashtë qendrës.



Të rinj dhe të moshuar



Të moshuarit në ambientet e shkollës profesionale me përgjegjësinë dhe emocionin e gjyshërve për tu njohur mbi mbarëvajten në mësime të nipërve dhe mbesave.. Ditë fantastike e mbushur plot dashuri, dhe krenari tek shikoje këta të rinj të ofronin ngrohtësi për këta gjyshër..duke demostruar praktikën profesionale.

Nxënësit e Shkollës "Talenti" pranë fëmijëve me aftësi të kufizuara

Mirësia, humanizmi dhe bashkëpunimi me të rinjtë nxënës të Shkollës "Talenti" bëri të mundur organizimin e një tjetër aktiviteti të rëndesishëm në dobi dhe në shërbim të personave me aftësi të kufizuar në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës, duke dhënë kontributin e tyre në ndihma, banketin e krijuar për fëmijët dhe argëtimin sipas programit. Sensibilizimi në komunitet dhe shkolla bën që vëmendja të shtohet për të qenë më afër përfituesve në Qendrat e Përkujdesit të administruara nga Shërbimi Social Shtetëror.



Buletini Javor

SHERBIMI SOCIAL

30 mars 2014

PREZANTOHET NISMA "MIQTË E SHËRBIMIT SOCIAL"



Shërbimi Social Shtetëror prezantoi më 25 mars në prani të përfaqësuesve të biznesit, organizatave ndërkombëtare dhe partnerëve lokalë nismën më të re të titulluar "Miqtë e Shërbimit Social." Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH-së, zj Etleva Bisha tha se kjo nismë synon të bashkojë në një aks të gjithë përpjekjet për një Shqipëri solidare.

"Ne nisëm tre muaj më parë përmes fushatës "Shqipëria dhuron" një bashkëpunim frymëzues me 350 biznese në të gjithë Shqipërinë dhe me mijëra individë e vullnetarë që iu bashkuan nismës sonë, tha zj Bisha. " Sot duam të shkojmë më tej: të nisim një program konkret bashkëpunimi pa datë skadence , të koordinuar dhe të bazuar në vullnetin e mirë të tre paleve: shtetit, biznesit dhe shoqërisë civile për për të rritur cilësinë e shërbimeve në institucionet që trajtojnë grupet më në nevojë: të moshuarit, fëmijët, persona me aftësi të kufizuar, viktima të trafikimit dhe dhunës në familje." Ministri I Mirëqënies Sociale dhe Rinisë Erion Veliaj përshëndeti pjesëmarrësit dhe shpërndau Çertifikatat e Mirënjohjes për disa biznese e organizata që dhanë kontribut të veçantë gjatë fushatës "Shqipëria Dhuron".

NË TERREN



- 20 karrocat e para lëvizëse janë shpërndarë në Qarkun e Durrësit në kuadër të një bashkëpunimi mes SHSSH-së dhe Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar . 120 karrocat e tjera do të shpërndahen për persona paraplegjikë e tetraplegjikë në rajonet e Vlorës, Gjirokastrës, Lezhës, Kukësit, Fierit dhe Korçës (20 në çdo rajon).Deri tani ka përfunduar vlerësimi në rajonin e Korçës dhe këtë javë ka nisur vlerësimi në rajonin e Gjirokastrës. Sipas parashikimeve të FSHDPAK, vlerësimi dhe shpërndarja e karrigeve me rrota do të përfundojë në fund të muajit maj.
- Drejtoria Rajonale e SHSSH Lezhë njofton se pas shumë shtyrjeve të seancave gjyqesore u bë e mundur që ditën e martë më 25 mars të merrej urdhri i mbrojtjes për një vit për një grua të dhunuar.
- Drejtoria Rajonale e SHSSH në Berat në bashkëpunim me Observatorin e Fëmijeve në Këshillin e Qarkut, mundësoi ekzaminimin falas të nje gruaje dhe të një vajze 15 vjeç të komunitetit egjiptian në kushte shumë të veshtira social-ekonomike, në Kliniken private AKS Berat. Mirenjohje per Administratoren e kesaj klinike zj. Aferdita Zere, dhe Dr. Adrianin.
- Dy denoncime të reja për administratorët socialë në komunën Remas të Fierit dhe Gruemirë të Shkodrës janë depozituar në Prokurori pas kontrolleve për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe pagesat e aftësisë së kufizuar. Dëmi ekonomik I konstatuar është përkatësisht 4,783,300 lekë në Remas dhe 5 196 000 lekë në Gruemirë.

Inbox

"Takimi me "Miqtë e Shërbimit Social" shumë interesant - një mendësi dhe qasje e re për të cilën jam shumë e kënaqur dhe mirënjohëse per ata që e inicuan! "

Elga Mitre,
oficere programesh,
Ambasada Hollandeze në Tiranë



Buletini Javor

SHERBIMI SOCIAL

30 mars 2014

NË TAVOLINË



 Drejtoresha e përgjithshme e SHSSH-së Etleva Bisha prezantoi në Kosovë rolin e Shërbimit Social në adresimin e nevojave të viktimave të trafikimit në një konferencë dypalëshe që synonte arritjen e një bashkëpunimi më efektiv ndërkufitar mes Kosovës dhe Shqipërisë në këtë fushë.

 Në Lezhë, Drejtoria rajonale e SHSSH është pjesë e projektit 4 mujor mes Drejtorisë arsimore dhe World Vision me qëllim forcimin e rrjetit të bashkëpunimit mes aktorëve të fushës sociale në gjithë qarkun për mbrojtjen e fëmijëve. Workshopi i parë u krye me 27 mars dhe në të morën pjesë 46 psikologë e punonjës socialë të qendrave që ofrojnë shërbime shoqërore në Qark. Në workshop u trajtuan tema si: ligji për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve, njohja me sistemin antitrafik, njohja me rolin e NJDF dhe NJMF-ve, demonstrim menaxhim rasti nga SHSSH-ja dhe nga psikologet e shkollave, etj

 Në Vlorë, SHSSH ishte pjesë e fushatës sensibilizuese për të drejtat e personave me sindromën Down në ditën e tyre ndërkombëtare 21 mars. Një poster gjigand u vendos në rrugën kryesore të qytetit si dhe u organizua një aktivitet i përbashkët me forumin e të rinjve.





Standard

Mbi 5000 Euro ishte fondi i mbledhur nga ambasada italiane gjatë sfilatës së bamirësisë në Tiranë për shtëpinë e foshnjës në Durrës. Kjo shumë do të shërbeje si bazë për fillimin e një projekti në bashkëpunim me Bashkinë e Durrësit për riparimin e godinës ku strehohen foshnjat.

Me iniciativën e studentit të Universitetit Ndërkombëtar të Tiranës, Ariol Greca, studentët e Universitetit në praninë e shumë personaliteteve të fushave të ndryshme, si art, muzikë, letërsi, gazetari etj, organizuan një festë madhështore për ditëlindjet e fëmijëve të lindur në mars.

Faleminderit të gjithëve!

Buletini Javor

SHERBIMI SOCIAL

1 mars 2014

KONTROLLI i NE DHE PAK

Si rezultat i kontrolleve në skemën e NE dhe PAK janë nxjerrë nga skema 10478 familje dhe 1100 nga PAK. Janë përfunduar kontrollet në 40 njësi vendore dhe vazhdon puna sipas planit në njësitë e tjera.



NË TERREN

- Agim Rapollari, baba i 2 fëmijëve të mitur, i gjendur papritur pa të ardhura për të përballuar jetesën, gjeti mbështetjen e SHSSH nëpërmjet partneritetit me organizatën ARSIS dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Historia e Agimit u rrëfye nga Agon Channel në programin "Ça Thu?".
- 3 fëmijë dalin nga situata e rrugës në Tiranë. Pas sinjalizimit të marrë për 3 fëmijë në trotuar, më i madhi 13 vjeç dhe më i vogli 3 vjeç, SHSSH sistemoi fëmijët në institucionet e përkujdesit deri në një zgjidhje afatgjatë, ndërkohë që policia dhe gjykata po veprojnë me prindërit e tyre për moskujdesje dhe shfrytëzim.

Shërbimi Social Shtetëror po monitoron dhe menaxhon rast pas rasti këtë kategori fëmijësh në nevojë, ndërkohë që Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë po përfundon planin e ndërhyrjes për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge.

- Pas marrjes së njoftimit nga Fiks Fare të një rasti të tre fëmijëve jetimë nga nëna që jetonin në kushte të vështira në një lagje në Tiranë, Shërbimi Social Shtetëror ndërmjetësoi që vajza më e madhe të përfitojë pagesë kujdestarie për dy vëllezërit më të vegjël si dhe gjeti një punë për të. Ndërkohë SHSSH dërgoi disa ndihma emergjente në ushqime dhe mobilje të thjeshta në banesë, si dhe sensibilizoi Fondacionin Mirënjohja që i dhuroi një çek 15000 lekë fëmijëve.
- Shërbimi Social Shtetëror mori në përkujdesje Fatjonën, jetimen invalide nga Saranda, çështja e së cilës ishte mediatizuar. Pas nje vlerësimi të hollësishëm dhe të kujdesshëm të rastit, Fatjona është sistemuar në një institucion përkujdesi social ku do të marrë të gjithë ndihmën që i takon.
- Rrezet e fushatës humanitare "Shqipëria dhuron" vazhdojnë të ngrohin ende. Mjekët e Spitalit Amerikan realizuan falas një operacion të vështirë për Sebastianin nga Vlora."S'do mungojë asgjë për fëmijët që rriten në institucionet e MMSR," u shpreh ministri Veliaj gjatë vizitës në spital pas operacionit që i riktheu shikimin djalit.

Inbox



"Një falenderim të madh për Etleva Bishën, drejtuesen e Shërbimit Social që veproi menjëherë lidhur me rastin e një fëmije të braktisur. Kam përshtypjen se Shërbimi Social ka filluar të jetë një institucion më aktiv se më parë dhe më i gjendshëm në raste të vështira. Këtë e kam verifikuar të paktën disa herë." "

Erion Kristo, aktivist.

Buletini Javor

SHERBIMI SOCIAL

1 mars 2014

NË TAVOLINË

SHSSH bashkëpunoi me ALB_AID ne kuadrin e Programit të Veprimit ndaj Minave për të kryer regjistrimin e viktimave të municioneve në 6 qarqe dhe identifikimin e nevojave të tyre për shërbime mjekësore e sociale. Nga studimi u identifikuan 296 persona të aksidentuar nga municionet në qarqet Durrës, Dibër , Gjirokastër, Elbasan, Korçë dhe Berat, nga të cilët 22 femra. Qasja e rekomanduar për trajtimin e problemeve që lidhen me këtë grup është multidisiplinore duke përfshirë mjekun, psikologun, zyrat e punës dhe Shërbimin Social. Rreth 61% nuk janë përfshirë në programin e mbrojtjes sociale. Në Shqipëri numërohen rreth 1000 viktima nga municionet.

SHSSH referoi përvojën me menaxhimin e Qendrës Tranzitore të Emergjencave në tryezën e dialogut të lartë me BE-në për politikat e përfshirjes se komuniteteve rome e egjyptiane". Qendra u ngrit në muajin tetor 2013 në përgjigje të një situatë emergjence me 53 familje rome të mbetura pa banesë dhe në shkurt Këshilli Administrativ i SHSSH miratoi kthimin e Qendrës në Qendrën Kombëtare të Emergjencave për Kategoritë në Nevojë. Statuti dhe rregullorja e qendrës do të miratohen në mbledhjen pasardhëse.





Standard

Qendra e Zhvillimit Rezidencial Durres po vendos një standard të ri në ofrimin e shërbimeve për kategorinë e fëmijëve me aftësi të kufizuar. Biznese të zonës si "AMA&AGI", "Anisa &Noemi","Call Center", "Beba Cosmetic", kanë ndihmuar Qendrën me pajisje dhe veshmbathje ndërsa është rehabilituar dhe këndi i lodrave. Më herët, Qendra ka zhvilluar nje takim me prindërit e fëmijëve që marrin shërbim këtu.

Buletini Javor

SHERBIMI SOCIAL

15 mars 2014

NË TERREN



✔ Java ka nisur e mbarë për Lefterin, i cili jetonte që prej 7 vitesh në spitalin e Përmetit. Ai ka tashmë një shtëpi ku mund të marrë përkujdesjen që i takon: Shtëpinë e të Moshuarve në Gjirokastër, falë përkushtimit të Drejtorisë Rajonale të SHSSH Gjirokastër dhe drejtorit të shtëpisë së të moshuarve Arianit Muho.

✔ Fundjava do të fillojë ndryshe për 12 vjeçarin që i kalonte ditët e netët vetëm në rrugë në mes të Bllokut gjysëm i zhveshur. Me skuadrën e ARSIS dhe drejtoreshën e Shtëpisë së Fëmijës Zyber Hallulli, Shërbimi Social Shtetëror mori në përkujdesje fëmijën, i cili nga dje ka një strehë dhe njerëz që kujdesen për të.

✔ Evis Rrahmani dhe stafi i Drejtorisë Rajonale të SHSSH-së në Tiranë i kanë kthyer buzëqeshjen të moshuarit K.D, i cili kishte 2 javë që jetonte në trotuar në ish stacionin e fundit të Tiranës së Re. Drejtoresha mori kontakt me Qendrën e motrave "Nënë Tereza", e cila u tregua e gatshme për ta ristrehuar zotërinë në këtë Qendër. I moshuari i braktisur nga fëmijët dhe pa të ardhura ekonomike, i shoqëruar nga stafi i Drejtorise Rajonale u transportua dhe u akomodua pranë kësaj Qendre për të marrë shërbimet e ofruara.

Inbox



" Kur bëhen bilance, të gjithë duhet ta nisim nga vetja. Sot në Shërbimin Social Shtetëror nga 27 pozicione drejtuese, 22 drejtohen nga gra. Në Drejtorinë e Pergjithshme 56% e punonjësve jane gra e vajza. Unë nuk jam krenare për shifrat, jam krenare për cilësinë e punës suaj! Për profesionalizmin dhe përkushtimin tuaj që po e transformon gradualisht Shërbimin Social drejt një shërbimi cilësor e gjithëpërfshirës. Jam e lumtur që po e ndaj sfidën me profesioniste të shkelqyera!

Thellësisht mirënjohëse,
Etleva Bisha, Drejtore e Përgjithshme.

Buletini Javor

SHERBIMI SOCIAL

15 mars 2014

NË TAVOLINË

Shërbimi Social Shtetëror ishte në Vjenë më 4-5 Mars me ekipin e MMSR-së në work-shopin e Bankes Botërore për Ballkanin Perëndimor. Jemi kudo ku diskutohet për punësim dhe fuqizim ekonomik, sepse kjo është rruga për të ofruar mbrojtje sociale efikase!
15 punonjës socialë dhe edukatore që punojnë në Institucionet e Përkujdesit Social në Tiranë dhe Durrës, ndoqën një trajnim për aftësitë rigjeneruese të fëmijeve dhe të rinjve. Trajnimi u mundësua nga Shërbimi Social Ndërkombëtar në bashkëpunim me OJF-në hollandeze VJK.

Standard



57 buqeta me lule dhe një letër mesazh nga ana e Ministrit Veliaj u nisëm më 7 Mars në drejtim të Shtëpive të Fëmijëve në Tiranë, Vlorë dhe Shkodër, në Qendrat e Zhvillimit në Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Berat për t'u thënë FALEMINDERIT të gjitha mësueseve që edukojnë fëmijët në këto institucione përkujdesi. Falë Arsis, Shërbimi Social Shtetëror uron:
Gezuar 7 Marsin!



Dita e Verës u festua me shumë ngjyra në Institucionet e Përkujdesit Social. Në Durrës, Pastiçeri Pelikan dhuroi akullore për fëmijët, në Elbasan, trupa e vullnetarëve shfaqi premierë pjesën "Falma dashurinë", Qendra e zhvillimit Pëllumbat organizoi eskursion në kodrat e Liqenit artificial, ndërsa fëmijët e shtëpisë së fëmijës "Zyber Hallulli" në Tiranë dhe të QTE-së morën dhurata nga Unioni i Shefave e Kuzhinës.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
15 prill 2014

Një familje për çdo fëmijë



4 prill 2014- Shërbimi Social Shtetëror shpalosi strategjinë dhe vizionin e vet për t'u siguruar fëmijëve që strehohen në Institucionet e Përkujdesit të drejtën e të jetuarit në një mjedis familjar sa më shpejt të jetë e mundur. E pranishme në mbledhjen e grupit të punës për nenin 5 (të Kodit të Familjes që sanksionon këtë të drejtë) Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH-së, zj Etleva Bisha tha se moto-ja « të mos ngremë institucione, por të ofrojme shërbime » është në bazë të procesit të deinstitucionalizimit të fëmijëve.

« Vizioni ynë për deinstitucionalizimin është transformimi i shërbimeve rezidenciale në shërbime me fokus fëmijën dhe familjen. Për ne, deinstitucionalizim nuk do të thotë kthim mekanik i fëmijëve jetim social në familjet e origjinës, por ofrim shërbimesh për rritjen e kapaciteteve social- ekonomike të familjeve të origjinës në nivelin e marrjes së përgjegjësisë për mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijës.", -nënvizoi zj Bisha.

Më pas, ajo ndau me të pranishmit një panoramë të gjerë të shifrash dhe faktesh, të cilat diktojnë nevojën e ndryshimeve rrënjësore në qasjen ndaj institucionalizimit të fëmijëve. Kështu, vitet e fundit numri i fëmijëve të braktisur në maternitet është rritur: vetëm për vitin 2013 numërohen 41 fëmijë të braktisur, ndërsa fëmijë "jetim social" të sistemuar në institucionet e përkujdesit për vitin 2013 janë rreth 80.

NË TERREN



- Një grua me urdhër mbrojtjeje nga gjykata, që jetonte në kushte të vështira ekonomike bashkë me 3 fëmijët e saj, pas bashkëpunimit me shoqatën "Të ndryshëm, po të barabartë", ka tashmë asistencën e duhur mjekësore dhe psikologjike. Njëkohësisht International Friends of Tirana dhe nxënësit e shkollës Kosova i dhuruan familjes disa ndihma.

- Nisur nga një mesazh në postën elektronike të SHSSH-së në rrjetet sociale, morëm njoftim për rastin e një nëne që kërkonte ndihmë për trajtim të specializuar për fëmijën me aftësi të kufizuar. Stafi I SHSSH-së verifikoi rastin dhe e vuri në lidhje me qendrat që ofrojnë terapi.



- Këtë muaj nis rindërtimi i mjedisit krijuese për fëmijë në Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencave në Tufinë të Tiranës me kontributin e UNDP-së. Qendra menaxhohet prej nëntorit të vitit të kaluar nga Shërbimi Social Shtetëror dhe ofron shërbim të plotë mjeko-social për 53 familjet rome që jetojnë aty. Më 8 prill, banorët e qendrës festuan ditën e tyre ndërkombëtare me miq nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Shërbimi Social Shtetëror, Ministria e Shëndetësisë, UNDP, Fondacioni Vodafone Albania, gazetarë e aktivistë.

- 40 karroca lëvizëse për paraplegjikët dhe tetraplegjikët e qarkut të Korçës dhe të Gjirokastrës u shpërndanë nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me aftesi të Kufizuar dhe SHSSH në dy ceremoni simbolike, mundësuar nga LDS. Programi ofron 140 të tilla në 7 rajone, 3 nga të cilat kanë përfunduar.

- Shërbimi Social Shtetëror organizoi aktivitete të larmishme në mbështetje të Ditës Ndërkombëtare të Autizmit. Në Durrës, u hap një ekspozitë me punimet e fëmijëve autikë në Pallatin e Kulturës Aleksandër Moisiu, ndërsa vullnetarët e Shërbimit Social shpërndanë fletëpalosje me informacion rreth autizmit. Të njëjtën gjë bënë vullnetarët e SHSSH-së Elbasan në komunën Shirgjan si dhe dhanë shfaqje në sheshin kryesor të qytetit . Kujdestaret te Qendra e Zhvillimit Pëllumbat u organizuan një festë dy vajzave autike që kishin ditëlindjen, ndërsa shokët e shoqet u kishin përgatitur një shfaqje me kukulla. Në Vlorë , SHSSH në bashkëpunim me ABA Albania do të organizojë workshop me prindërit e fëmijëve me autizëm.

Inbox

"Ne pas kaq vitesh po shohim për herë të parë se si Shërbimi Social mund të angazhojë burimet ekzistuese (njerëzore dhe materiale) që ka për të ndihmuar njerëzit në komunitet.
Ne jemi shumë të frymëzuar nga mënyra se si ju po punoni.
Ju përgëzojmë sinqerisht!

Mariana Meshi, Shoqata "të Ndryshëm, por të barabartë"



"Po bëni një punë të shkëlqyer, sidomos me invalidët dhe me njerezit në nevojë. "
Dritan Seferi, Karbunarë, Lushnjë

SHERBIMI SOCIAL

Buletini Informativ

15 prill 2014

NË TAVOLINË

- ACITAD është miku më i ri i Shërbimit Social Shtetëror! Dhoma Shqiptare e Tregëtisë Ndërkombëtare dhe Zhvillimit pas takimit me drejtuesit e SHSSH-së, shprehu vullnetin për të bashkëpunuar në të ardhmen dhe për të dhënë kontributin e vet në realizimin e përgjegjësisë sociale të bizneseve që përfaqësojnë. Ndërkohë Konfindustria është ndalesa e rradhës për të prezantuar nismën Miqtë e Shërbimit Social.

- Filluan më 11 prill trajnimet për drejtuesit dhe specialistët e drejtorive rajonale të SHSSH që do të vijojnë gjatë gjithë muajit në zbatim të objektivit për përmirësim të performancës në ofrimin e shërbimeve. Trajnimet do të mbahen nga ekspertët e Terre des homes dhe do të trajtojnë çdo javë tematika të ndryshme si psh "Të drejtat e fëmijëve", "Menaxhimi i rastit", 25 prill "Dhuna ne familje" me pas 2 maj "Trafikimi"dhe 9 maj vazhdim i Menaxhimit te rastit"

STANDARD





- Muaj i ri, faqe e re. Shërbimi Social Shtetëror ka rikonceptuar faqen e vet në internet, www.sherbimisocial.gov.al duke ofruar më shumë informacion dhe transparencë për publikun rreth punës dhe misionit të SHSSH. Kemi shtuar buletinin e donacioneve dhe buletinin javor si dhe hartën e shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin. Mirëpresim komentet dhe sugjerimet tuaja në info@shssh.gov.al

- Çfarë ngjyre ka buzëqeshja e fëmijëve? Vullnetarët e organizatës rinore "Mendo Pozitiv" kanë menduar ta konkretizojnë idenë në Shtëpinë e Fëmijëve "Zyber Hallulli", duke zbukuruar mjediset e brendshme me vizatime tematike që përcjellin mesazhe pozitive, dritë dhe ngrohtësi. Në fundjavë kanë përfunduar mjediset e katit te trete dhe po vazhdohet me të tjerat.

- Banorët e Shtëpisë së të Moshuarve në Tiranë e filluan javën me erë deti, falë bujarisë së Fondacionit Aleksandrite, që u mundësoi një eskursion në Durrës më 7 mars. Aktivitetet social-kulturore janë po aq të rëndësishme sa dhe shërbimet ditore bazë në institucionet e përkujdesit për moshën e tretë.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
01 Maj 2014

Mosha e tretë kujdes dinjitoz dhe sa me pranë familjes



Tiranë, 25 prill 2014- Thellimi i procesit të deinstitucionalizimit të shërbimeve, mbetet rruga më e mirë e zgjidhjes së problemeve sociale të moshës së tretë. Ky ishte thelbi i mesazhit që përcolli Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror në konferencën ndërkombëtare "Probleme të mprehta dhe nevojat e moshimit në shoqërinë shqiptare" mbajtur në Akademinë e Shkencave në Tiranë. Konferenca pati për qëllim shkëmbimin e përvojave më të mira në botë dhe njohjen e rolit të secilit aktor shoqëror në përmirësimin e asaj që quhet "kulturë moshimi".
Duke iu referuar prirjes në rritje të peshës specifike demografike që zenë të moshuarit në Shqipëri (aktualisht 11-12 % e popullsisë) si dhe kërkesave në rritje për trajtim rezidencial nga shteti të tyre, zj Bisha vuri në dukje se strategjia e SHSSH-se për të adresuar këtë problematikë mbështetet në tre shtylla kryesore:

Së pari, kthim të vëmendjes drejt familjes, kuptimit të rolit dhe përgjegjësisë që ato kanë për brezat e moshuar, detyrimin moral për të kthyer pozitivisht kontributin ndaj të moshuarve, në mënyrë që të jetojnë me dinjitet.
Së dyti, vëmendje më të madhe nga pushteti vendor. Qarqet, Bashkitë dhe Komunat duhet të bëjnë vlerësime objektive të nevojave që kanë për trajtimin e të moshuarve në nevojë, për të moshuarit që kanë në komunitet dhe juridiksionin e tyre.
Së treti, modelimi i shërbimeve të reja për të moshuarit në shtëpi, si psh me skuadra lëvizëse, si dhe qëndra ditore të vogla për kalimin e kohës së lire dhe asistencë psiko-sociale dhe mjekësore.
"Qëllimi ynë është të ndjekim ato politika sociale, që përmirësojnë strategjinë e ndërtimit të një shoqërie për të gjithë moshat", tha zj Bisha.

NË TERREN

Specialistët e Drejtorisë së Përgjithshme e ShSSh-së po ndihmojnë dy fëmijet 10 vjeç dhe 4 muajsh të një nëne qe vuan nga probleme të shëndetit mendor të marrin kujdesin e duhur.
Për foshnjën u sigurua ushqim i menjëhershëm (qumësht për një periudhë gjashtë mujore) ndërsa po punohet për të siguruar kujdestarinë e fëmijve tek të afërmit e tyre.

164 raste të fëmijëve të vlerësuar në situatë rreziku janë menaxhuar nga Shërbimi Social Shtetëror për periudhën tetor 2013-prill 2014. Në 85 % të rasteve janë ofruar shërbime alternative pranë familjes sipas strategjisë së ShSSh për intersin më të lartë të fëmijës.


155 vajza dhe gra në situatë rreziku janë trajtuar nga Shërbimi Social Shtetëror bashkë me fëmijët e tyre që nga tetori i vitit 2013 deri tani. Nga këto 50 % kanë marrë shërbime alternative ndëersa 11 gra të strehuara në qendrat e rehabilitimit janë punësuar.

20 karrocat lëvizëse për paraplegjikët dhe tetraplegjikët e qarkut të Fierit u shpërndanë Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar sipas projektit të përbashkët me ShSSh-në në 7 rajone.



Dërgohet në Prokurori dosja e shkeljeve për ndihmën ekonomike dhe PAK në komunen Qender Bulgarec, Qarku Korçë. Pas Kontrollit të ushtruar në muajin shkurt 2014 nga Drejtoria Rajonale e SHSSH-së për zbatimin e legjislacionit për përfitimin e pagesës së ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar si dhe realizimin e detyrave të lëna nga kontrolli i meparshëm, u konstatuan një sërë shkeljesh me një dëm ekonomik të përgjithshëm prej 3 607 400 leke.
Fillon kontrolli I imtësisshëm i dosjeve të pagesave të aftësisë së kufizuar në të gjitha Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së, përforcuar me mjekë të Institutit të Shëndetit Publik .

Inbox



"Qendra Sociale "Shtëpia e Përbashkët" në Tiranë ka parë me vëmendje përkrahjen tuaj për shtresat në nevojë. Specifikisht ,ju falenderojmë për ndihmën që na keni dhënë për raste që ne i kemi paraqitur prej jush për zgjidhje."

Buletini Javor

SHERBIMI SOCIAL

1 Maj 2014

NË TAVOLINË



Shërbimi Social Shtetëror mori pjesë në seminarin tre ditor për të diskutuar modelin danez të bashkëpunimit Shkollë-Shërbime Sociale-Polici për parandalimin e krimit tek të rinjtë.

Drejtoresha e përgjithshme e ShSSh -ë Etleva Bisha zhvilloi një takim me kryetarin e Bashkisë së Sarandës Stefan Çipa për të diskutuar rrugët e bashkëpunimit me pushtetin lokal në përmirësimet e standarteve për institucionet e përkujdesit social në këte qytet. Z.Çipa garantoi se bashkia do të mbështesë financiarisht një pjesë të punimeve për rehabilitimin e mjediseve të brendshme të Shtëpisë së fëmijës ,që do të shërbejë si bazë për ndërhyrje të mëtejshme nga dy kompani private.

Gulf Oil është miku më i ri i Shërbimit Social Shtetëror. Në një takim me drejtorin ekzekutiv të kësaj kompanie , Z.Guram Gogeshvili u diskutuan rrugët e bashkëpunimit për përmiresimin e kushteve në institucionet e kujdesit social të menaxhuar nga ShSSh.



Standard

Të moshuarit/at e Qendrës Ditore Polivalente,mbajnë gjallë traditën e qytetit.Në mjediset e qendrës ku marrin shërbim 55 të moshuar kanë krijuar një dhomë muze me objekte tradicionale të punuara me dorë. Sapo kanë përfunduar kampionatin e punës me dorë dhe po përgatiten për të marrë pjesë në Festën e Midhjes në 9 Maj.

Në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës u zhvillua takimi i dytë me prindërit e fëmijëve që marrin shërbim në qendër si një praktikë që forcon lidhjen me familjen dhe ndihmon deinstitucionalizimin e shpejtë të tyre.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
15 Maj 2014

Fuqizojmë familjen!



Me rastin e Ditës Botërore të Familjes, Shërbimi Social Shtetëror ndërmori një fushatë të gjerë sensibilizimi dhe informimi për rolin dhe vlerat e familjes në shoqërinë shqiptare. Fushata përfshiu të gjitha qytetet e Shqipërisë ku SHSSH ka Drejtoritë Rajonale. Ekspozita fotografike me të rinjtë, konkurse vizatimesh me fëmijët, biseda, debate, ese, teatër rruge, seminare e konferenca si dhe panaire të OJF-ve janë disa nga aktivitetetet që u zhvilluan në Lezhë, Kukës, Berat, Fier, Vlorë, Elbasan, Gjirokastër, Durrës, Shkodër e Tiranë.

"Qëllimi i kësaj fushate, siç thotë edhe slogani i zgjedhur, është kthimi i vëmendjes tek vlerat dhe roli i familjes. Fuqizimi i familjes është një strategji kyçe që SHSH po e ndjek në punën e vet për të ofruar mbrojtje sociale për individët në nevojë, qofshin këta fëmijë, të moshuar apo persona me aftësi të kufizuar. Duam të falenderojmë të gjithë partnerët që na u bashkuan në këtë nismë dhe jemi të bindur se të gjithë bashkë mund t'ia dalim.", tha zj Etleva Bisha Drejtore e Pergjithshme e Shërbimit Social Shtetëror.

Me mbështetjen bujare të UNICEF-it, u përgatit një spot televiziv i cili po transmetohet në televizionin publik dhe në linjat urbane të kryeqytetit, ndërsa u përgatitën 10 postera me vizatimet e fëmijëve më temë "Kjo është familja ime". Fuqizimi i familjes është një nga përparësitë e punës në SHSSH dhe kjo duket në rritjen e numrit të shërbimeve pranë familjes dhe komunitare në krahasim me shërbimet rezidenciale të gjitha rastet e menaxhuara prej tij që shkojnë në 319 për periudhën tetor 2013-prill 2014.

Kalendari I aktiviteteve

FIER- Ekspozite fotografie dhe Konkurs letrar me teme" Familja".
KORÇë-Aktivitet ndërgjegjësues prane nje qendre të re komunitare





VLORE- Konference "Sfidat e një familjeje të shëndoshë me ndryshimet social ekonomike."





GJIROKASTER- Ekspozite me punimet e fëmijeve nga të 5 komunitetet etnike





Elbasan- konkurs vizatimi me shkollat tetëviecare







Buletini Javor

SHERBIMI SOCIAL

15 Maj 2014

DURRES-Ekspozitë fotografike për të rinjte me temën "Familja"/Panair I OJF-ve, 18 maj





LEZHE- Klubi i debatit me të rinjtë me temë "Familje e shëndetshme, shoqëri e shëndoshë"





KUKES- Seminar OJF per rëndësinë e familjes/Aktivitete me fokus familjen/Koncert për fëmijët

TIRANE- "Luaj me mua", aktivitet me vullnetarë për lojëra familjare/ Panair OJF





Buletini Javor

SHERBIMI SOCIAL

15 Maj 2014

BERAT- Aktivitete me shkollat dhe Bashkitë e Urës Vajgurore, Berat, Kuçovë, Poliçan dhe Qendren Polivalente të të moshuarve Poliçan.
SHKODËR-Ndeshje miqësore futbolli mes femijeve te Shtepise se Femijes dhe nxenesve te Shkolles Ismail Qemali/Workshop me gjimnazistet rreth vlerave, funksioneve dhe sfidave te familjes sot/Takim me të moshuarit dhe nxënësit e Shkollës"Mati Logoreci".





NË TERREN

- Më 6 maj festuam vitin e ri rom dhe Ederlezin (ShenGjergjin) me banoret e Qendres Tranzitore te Emergjencave që organizuan nje minikampionat futbolli me ndihmën e FSHF dhe Terre des Hommes ne Kamëz. Gezuar!
- Shoqata e personave me Aftësi të Kufizuar- dega Përmet, Bashkia Përmet dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Rajonal, Gjirokastër organizuan për herë të parë kampionatin e basketbollit për personat me aftësi të kufizuar.





Buletini Javor

SHERBIMI SOCIAL

15 Maj 2014

NË TAVOLINË



- Në Fushë-Kruje moderuam takimin prezantues të sistemit të ri te modernizuar per ndihmën ekonomike, që po pilotohet në tre rajone:Tiranë, Durrës, Elbasan.
- SHSSH ishte pjesë e ekipit në vizitën studimore në Zvicër për modelet e shërbimeve sociale, mundësuar nga organizata "Shpresë për jetën".
- Trajnimi i rradhës për stafet e SHSSH-së ishte për dhunën në familje, mundësuar nga PNUD me fonde te qeverisë suedeze.

Inbox

"Nuk e prisja që të gjeja në Shqipëri të njëjtin model të shërbimeve sociale si në Suedi. Në këta 5 muaj praktikë pune kam parë të materializuar teorinë që kam mësuar unë në shkollë dhe pikërisht fuqizimi I familjes është ai që këshillohet më shumë në programet e mbrojtjes sociale. Faleminderit për gjithcka mësova pranë jush!"

Fatlume Selmani, praktikante nga Universiteti I Goteborgut, Suedi



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
1 Qershor 2014

Miqtë e Shërbimit Social në veprim



Dy muaj pas ngritjes së tij, rrjeti Miqtë e Shërbimit Social sjell rezultatin e parë. ALBtelecom dhe Eagle Mobile së bashku me Fondacionin "Shpresë për Botën" dhe Bashkinë e Sarandës do të rehabilitojnë godinën e Shtëpisë së Fëmijës në këtë qytet me një investim që kalon 20 mijë euro . Po kështu, AlbTelecom &Eagle Mobile do të investojnë 5000 euro në Shtëpinë e Fëmijës në Vlorë për mobilimin e dhomave të fëmijëve.

Projektet u paraqitën në një ceremoni festive të organizuar nga AlbTelecom and Eagle në Shtëpinë e fëmijës Sarandë më 20 maj.

Të pranishëm në këtë event kanë qenë Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, z. Erion Veliaj, Drejtoresha e Shërbimit Social Shtetëror, znj. Etleva Bisha, Drejtori i Përgjithshëm i ALBtelecom, Dr. Erkan Tabak dhe Kryetari i Bashkisë së qytetit të Sarandës, z. Stefan Çipa. Që nga 25 marsi kur u prezantua nisma e Miqve të Shërbimit Social , rradhët e tij janë shtuar me kompani e organizata të tjera, të cilët po negociojnë projekte të veçanta me SHSSH-në për institucionet e përkujdesit social.

NË TERREN



- Denoncohen ne Prokurori shkeljet me ndihmen ekonomike ne komunen Fushë Çidhen, Dibër. Pas kontrollit të ushtruar në muajin shkurt 2014, u konstatua se Këshilli i Komunës Fushë-Çidhen, ka përdorur fondin e ndihmës ekonomike të buxhetit të shtetit në vlerën 3 630 000 lekë për detyrime të tjera (për ndërtimin e ujësjellësit të fshatrave Laces dhe Bllicë) dhe jo sipas destinacionit të përcaktuar, në shkelje të ligjit duke cënuar interesat e ligjshme të shtetasve. Nga ky veprim, 472 familje që trajtohen me ndihmë ekonomike në këtë komunë, nuk kanë marrë pagesën për muajt prill, maj dhe gusht të vitit 2013.Veprimet e mësipërme ngarkojne me përgjegjësi Kryetarin dhe anëtarët e Këshillit të Komunës Fushë-Çidhen dhe Kryetarin e Komunës për të cilët është depozituar kallëzim penal në Prokurori nga Drejtoria Rajonale e SHSSH-së.

Buletini Javor

SHERBIMI SOCIAL

1 Qershor 2014

NË TERREN



- Përfundoi shpërndarja e 20 karrigeve me rrota në qarkun e Lezhës, një projekt I Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Aftësisë së Kufizuar dhe SHSSH-së në 7 qarqe.

- Me Zv.Presidenten e Bankës Botërore Laura Tuck, prezantuam në Njësinë 6 në Kombinat, shërbimin e ri të dixhitalizuar të ndihmës ekonomike. Skema e re "Shqipëria Solidare" prej 40 milion dollarësh është transparente, ndihmon rreth 100,000 familje në nevojë. Nga 1 Qershori Ndihmën Ekonomike do ta marrin vetëm gratë, plus bonus për shkollimin e vaksinimin e fëmijëve në skemë!" u shpreh Ministri Veliaj.

- Shërbimi Social Shtetëror si pjese integrale e planit të ndërhyrjes për fëmijët në situatë rruge mori pjesë në prezantimin e studimit dhe reformës në këtë fushë nga MMSR më 19 maj.

Inbox

"Ne e vlerësojmë shumë bashkëpunimin që kemi pasur deri tani me të gjitha Drejtoritë Rajonale,si për proçesin e identifikimit ashtu dhe atë të shpërndarjes së karrigeve me rrota."

Narbis Ballhysa,Fondacioni Shqiptar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar



Buletini Javor

SHERBIMI SOCIAL

1 Qershor 2014

NË TAVOLINË

- Vazhdojnë kontaktet për të shtuar rradhët e Miqve të Shërbimit Social. Me menaxheren e CityPark dhe me drejtorin ekzekutiv të Unionit Financiar Tiranë biseduam për mundësitë e bashkëpunimit në një të ardhme të afërt.

- BKT nisi një fushatë online për rehabilitimin e shtepisë së pushimit të fëmijëve në Velipojë, që shpresojmë të sjellë fondin e mjaftueshëm për t'u dhuruar fëmijëve të IPSH-ve një mjedis të këndshëm për pushimet e tyre verore.

- Personeli i Qendrës për Trajtimin e Viktimave të Dhunës në Familje ndoqi trajnimin "Barazia gjinore dhe sherbimet sociale,parandalimi i dhunes ne familje dhe trajtimi i viktimave te saj" më 27-28 maj.





Standard

Fëmijët në institucionet e përkujdesit social e festuan 1 Qershorin të rrethuar me vëmendje dhe dashuri.Nën kujdesin e veçantë të Ministres së Zhvillimit Urban dhe Turizmit Znj. Gjermeni , fëmijët e shtëpisë "Zyber Hallulli" në Tiranë vizituan muzen e Krujës, më pas u pritën nga Avokati i Popullit, vizituan Muzeun Historik Kombëtar dhe e mbyllën me një festë madhështore ofruar nga City Park ku fëmijët shfaqën dhe talentin e tyre me një koncert . Në Durrës, Qendra e Zhvillimit Rezidencial organizoi një ekspozitë me punët e fëmijëve si dhe një drekë më familjarët e tyre.
Në Elbasan, Drejtoria Rajonale e SHSSH-së dhe Komiteti Shqiptar I Kulteve gëzuan fëmijët pa kujdes prindëror me dhurata të ndryshme. Në Fier, Shërbimi Social në bashkëpunim me organizata të tjera organizuan një koncert bamirësie për fëmijët pa kujdes prindëror.
Në Shkodër, Shtëpitë e fëmijës parashkollor e shkollor organizuan më 28 maj Panair me punët e fëmijëve me ndihmën e Fondacionit Shpresë për Botën, si dhe koncert me emra të njohur të muzikës shqiptare.

SHERBIMI SOCIAL

Buletini Informativ

15 Qershor 2014

Qendra Tranzitore e Emergjencave-standard i ri menaxhimi nga SHSSH



8 muaj pas hapjes së saj, në Qendrën Tranzitore të Emergjencave kemi rezultatet e para të punës së stafit dhe partnerëve. 40 familje nga 53 janë vetëpunësuar. Nga këto, 6 familje janë ndihmuar me mikrokredi dhe 5 të tjera janë në proces. 35 fëmijë janë regjistruar dhe frekuentojnë shkollën, ndërsa 24 të tjerë shkojnë në kopësht. 37 familje janë ndihmuar të aplikojnë për banesa sociale pranë Bashkisë së Tiranës dhe 67 persona janë regjistruar te Zyrat e Punës si punëkërkues. Nga këta, 20 persona kanë filluar kurset e formimit profesional në qershor.

Stafi i qendrës ka ofruar këshillim psikosocial për 36 raste, ndërsa është profesionalizuar më tej lidhur me trajtimin e problematikës komplekse me të cilën përballet ky komunitet.Ky është standardi i menaxhimit të institucioneve publike në varësi të SHSSH-së!

NË TERREN



- Vendi i fëmijëve është shtëpia, jo rruga. Në Ditën Ndërkombëtare të Ndalimit të Punës së Fëmijëve ishim në Qendrën Tranzitore te Emergjencave me Policinë, Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Terre des Hommes bashkë me vullnetarët në një bashkëbisedim sensibilizues me komunitetin rom rreth mirëqenies së fëmijëve dhe përgjegjësisë prindërore. Ky është vetëm hapi i parë i një rruge të gjatë!



- Vijon turi i Shqipërisë Solidare për shpjegimin e reformës në ndihmën ekonomike. Në Durrës, Elbasan dhe në Krujë prezantuam sistemin e ri elektronik që disiplinon shpërndarjen e ndihmës ekonomike në mënyrë më transparente dhe më pak burokratike për mijëra familje në Tiranë, Durrës dhe Elbasan.

Inbox



Falenderojmë grupin e vullnetarëve hollandezë të shoqatës "MARA" të Universitetit te Roterdamit, të cilët i dhuruan Qendrës së Zhvillimit "Pëllumbat", pajisje elektroshtëpiake dhe enë kuzhine. Mirënjohje.

Edo Sherifi, drejtore, Qendra e Zhvillimit, Pëllumbat

Buletini Javor

SHERBIMI SOCIAL

15 Qershor 2014

NË TERREN



- Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH-së organizoi një takim me mjekët e KMCAP Epror për problematikën e vërejtur me pagesat e aftësisë së kufizuar. Në takim u kërkua mbështetje nga KMCAP Epror për përballimin e kërkesave në rritje për trajtim si pasojë e kontrolleve të imta në komisionet rajonale të dosjeve të personave që pretendojnë pagesë për aftësinë e kufizuar.

- Duke filluar nga data 1 korrik, SHSSH ka ndryshuar procedurën e dhënies së librezave të verbërisë, parapalegji/tetraplegjisë si dhe të statusit të jetimëve , me qëllim lehtësimin e qytetarëve.Më shumë informacion në: www.sherbimisocial.gov.al

NË TAVOLINË



- Filloi në Shkodër projekti "Shërbimet Sociale Inovative për grupet vulnerabël", në kuadër të përmbushjes së standarteve të decentralizimit dhe deinstitucionalizimit. Projekti, i financuar me fonde te qeverise italiane IADSA do të gjejë zbatim në Shtëpinë e të Moshuarve dhe Shtëpinë e Fëmijës 3-6 vjeç , ku janë vendosur dhe koordinatorët e projektit me stafet respektive. Ju urojmë suksese!

- Tre përfaqësues nga SHSSH ndoqën punimet e konferencës së Bankës Botërore mbi "Zvogëlimin e gabimeve, mashtrimeve dhe korrupsionit në programet e mbrojtjes sociale" Kroaci, 9-11 qershor së bashku me 70 pjesëmarrës nga Britania e Madhe, Rumania, Kroacia, Ukraina, Moldavia, Brazili, Indonezia, Botsvana, etj. Shkëmbim përvojash të vlefshme sidomos tani që po zbatojmë projektin pilot për modernizimin e ndihmës ekonomike.

Standard



Shtëpia e Fëmijës shkollor Zyber Hallulli ka pritur e përcjellë shumë mysafirë këtë dyjavor. 10 vullnetaret nga Fakulteti i Shkencave Sociale mbas një pune 2 mujore mbyllën angazhimin e tyre me një festë të bukur. Ndërkohë shkolla jopublike Univers i përfshiu fëmijët në një Panair gatimesh, promovim tradite në veshje dhe muzikë ', ndërsa Orkestra Rinore TransAlbania, shkolla 'International Albanian School', kompania 'ORBICO' dhe Fondacioni Shpresë për botën u dhuruan fëmijëve pasdite të këndshme dhe lodra.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
1 Dhjetor 2014

E para Konventë e Shërbimeve Sociale në Shqipëri: Drejt shërbimeve sociale të integruara në nivelin lokal



Shumë nga problemet që pengojnë mirëqenien e fëmijëve dhe familjeve në Shqipëri do të mund të parandalohen nëse atyre do t'ju mundësohen shërbimet e mbrojtjes sociale. Për këtë arsye, Shërbimi Social Shtetëror organizoi në datat 2 dhe 3 dhjetor një konventë me qëllim, përmirësimin e shërbimit të kujdesit social për shtresat në nevojë.

Konventa, e zhvilluar në Pallatin e Kongreseve u organizua nën kujdesin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me mbështetjen e UNICEF dhe Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri me pjesëmarrje e rreth 200 ekspertë, profesionistë dhe punonjës të shërbimeve sociale në nivel lokal e kombëtar.

Në objektivat e Konventës ishin qartësimi i rolit, funksioneve dhe detyrave të Shërbimit Social Shtetëror në fushat e tij të funksionimit (ndihma ekonomike, personat me aftësi të kufizuar, të shërbimeve); për të ndarë praktikat e punës dhe mësimet e nxjerra, për të kuptuar dhe për të identifikuar pikat e përbashkëta dhe fushat e përmirësimeve në kontekstin e perspektivave të BE-së për programet e mbrojtjes sociale; për të identifikuar punën me njësitë e qeverisjes vendore, për të siguruar ndikimin reciprok konstruktiv, që të ketë një vizion të përbashkët mbi shërbimet e integruara sociale dhe variante të mundshme për të aplikuar.

Duke përshëndëtur Konventën Kryeministri Rama tha së kjo "nuk është një konferencë e rradhës, por një moment për të bërë një bilanc të rëndësishëm me rezultate konkrete dhe për të konsoliduar një institucion të rëndësishëm si Shërbimi Social në luftën ndaj varfërisë dhë përjashtimit social."

Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Erion Veliaj pasi falenderoi të gjithë ekipin e punonjësve socialë anëmbanë Shqipërisë, theksoi se "reforma në vazhdimësi dhe decentralizimi i ofrimit të shërbimeve në sektorë kyç, duke përfshirë shërbimet shëndetësore, ofrimin e kujdesit ditor dhe pagesat e asistencës sociale ofrojnë një mundësi për t'i dhënë formë të ardhmes së shërbimeve shoqërore për Shqipërinë, në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të integruar. Si pjesë e procesit integrues të Shqipërisë në BE, ne jemi të vendosur të përmirësojmë të drejtat shoqërore dhe ekonomike të qytetarëve tanë, "- theksoi Ministri Veliaj.

"Shërbimet sociale duhen trajtuar me kujdes të vecantë. Ato janë pjesë e sistemit që ndihmojnë në zbutjen e varfërisë, reduktojnë pabarazinë, dhe fuqizojnë qytetarët në mënyrë që ata të arrijnë potencialin e tyre", deklaroi zëvendës Shef i Misionit të Ambasadës së Zvicrës, z Holger Tausch.

"UNICEF mbështet partnerët tanë në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Shërbimin Social Shtetëror, në këtë mundësi të vetme për të vendosur mekanzimat e duhur për një shpërndarje efektive dhe të integruar të asistencës sociale.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
1 Dhjetor 2014







Jemi në kohën e duhur të vazhdimësisë së decentralizimit të reformës, që ka hapur mundësinë e rishikimit të disa aspekteve të reformës në rrafshin institucional, fiskal dhe teknik të saj", u shpreh Antonella Scolamiero, përfaqësuesja e UNICEF në Shqipëri.

"Qëllimi ynë është që të ndërtojmë një platformë të përbashkët pune që identifikon fushat që kanë nevojë për përmirësime, në kontekstin e perspektivës evropiane për programet e mbrojtjes sociale", tha zj Etleva Bisha, Drejtore e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror. "Në këtë kontekst, Konventa do të vlerësojë punën e bërë deri tani nga të gjitha institucionet që ndërtojnë sistemin e mbrojtjes sociale në Shqipëri- Shërbimi Social Shtetëror, njësitë e qeverisjes vendore dhe organizatat e shoqërisë civile – dhe do të përcaktojë rolin e secilit prej tyre në planifikimin, menaxhimin dhe shpërndarjen e shërbimeve shoqërore. "

Pjesa më e madhe e legjislacionit parësor për të mbështetur zbatimin e reformës është në fuqi. Korniza e Decentralizimit dhe Plani i Veprimit janë hartuar. Kjo Konventë, solli më pranë se kurrë më parë vizionin ku çdo fëmijë dhe familje merr shërbime cilësore sociale. Për të kthyer këtë vizion në realitet, ministritë me përgjegjësi për çështjet sociale si Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, do të duhet të punojnë së bashku mbi mënyrën se si ata do të krijojnë një sistem të kujdesit social.Roli i çdo ministrie në lidhje me bashkëveprimin e tyre për të krijuar një sistem të kujdesit social do të jetë: më i drejtë, duke mbështetur njerëzit të marrin ndihmën që u nevojitet; më efektiv, duke e thyer ciklin e varësisë në mbështetjen e shtetit duke lehtësuar e rikthimin në fuqinë punëtore; duke reduktuar kostot e mirëqenies për Qeverinë dhe taksapaguesit; më e thjeshtë, duke përmirësuar mekanizmin e marrjes së shërbimit social nëpërmjet një punonjësi social lokal për të ndihmuar grupet vulnerabël.

Përgjatë dy ditëve të Konventës pjesëmarrësit diskutuan gjerësisht jo vetëm mbi rolin e Shërbimit Social Shtetëror në ofrimin, planifikimin, buxhetimin dhe monitorimin e shërbimeve sociale, por edhe të pushtetit vendor dhe aktorëve të tjerë joqeveritar që punojnë në fushën e shërbimeve sociale. Ndërkohë modeli I shërbimeve sociale lokale të integruara u diskutua dhe nda gjerësisht gjatë Konventës me punonjës lokal e kombëtar të shërbimeve sociale dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare pjesëmarrëse aktive të saj.

Konkluzionet e Konventës po përmblidhen në një dokument të integruar dhe do të ushqejnë reformën e Shërbimeve Sociale që po zbatohet nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

SHERBIMI SOCIAL

Buletini Informativ

1 Dhjetor 2014

Rezultate në 1 vit

- 25% më pak abuzues në skemën e ndihmës ekonomike
- Ndihma ekonomike për gratë, bonus për vaksinim dhe shkollim
- Zbatim i plotë i legjislacionit për aftësinë e kufizuar
- 56% më pak fëmijë në institucione rezidenciale krahasuar me 2013
- 20% fëmijë më shumë se në 2013 të kthyer pranë familjeve biologjike
- Ulje me 30% e numrit të të moshuarve vendosur në Shtëpitë e të Moshuarve krahasuar me 2013
- Kryerja në kohë e pagesave të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar

3 Dhjetori, Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi te Kufizuar



Zv. Ministrja Kospiri: " Angazhim i qeverisë shqiptare për të promovuar modele të deinstitucionalizimit dhe riintegrimit në jetën ekonomike dhe sociale të personave me aftësi të kufizuara"

Të gjitha Qendrat e Zhvillimit që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara u përfshinë në një numër eventesh në Ditën Ndërkombëtare të Aftësisë së Kufizuar. 3 Dhjetori është një moment reflektimi për të gjithë aktorët social, familjet, komunitetin, median, politikën, institucionet shtetërore për më shumë mbështetje dhe reagim ndaj nevojave specifike që ka kjo shtresë e shoqërisë dhe mundësitë e

Ndërsa në Konventën e Shërbimit Social diskutohej mbi shërbimet e integruara lokale edhe për perosnat me aftësi të kufizuara, Qendra e Zhvillimit Pëllumbat ka treguar në 3 Dhjetor sesi arrihet kjo në praktikë. 20 fëmijë që marrin shërbime në këtë qëndër po aftësohen në profesione të ndryshme dhe 6 prej tyre frekuentojnë kurset në Qendrat e Aftësimit Profesional. Qendra Ditore dhe ky model I aftësimit dhe integrimit në tregun e punës është ngritur në saj të projektit të mbështetur nga IADSA. Ambientet dhe shërbimet e kësaj qendre u vizituan nga zv. Ministrja e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë znj. Kospiri, e cila theksoi angazhimin maksimal të qeverisë shqiptare për të promovuar modele të deinstitucionalizimit dhe të integrimit në jetën sociale dhe ekonomike të personave me aftësi të kufizuara.

NË TAVOLINË



-Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror znj. Etleva BISHA, pati një takim pune me Administratorët Social te Njësive Vendore dhe Drejtorinë Rajonale Qarku Berat, për të nxitur Bashkitë/Komunat në rritjen e përgjegjësive për ofrimin e praktikave të reja të shërbimit të integruar ndaj familjeve ne nevoje, duke ridimensionuar sherbimin social ndaj tyre.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
1 Dhjetor 2014



-Te diskutojmë jo vetëm mbi objektivat e Shërbimit Social Shtetëror, por edhe te dëgjojmë problemet dhe shqetësimet e punës së administratoreve shoqerorë të njësive vendore, ky ishte qëllimi i takimit që u realizua nga zyra rajonale e SHSSH Korcë, me pjesëmarrjen e drejtoreshës së përgjithshme të SHSSH Znj.EtlevaBisha.

Diversiteti i mendimeve sjell ndryshime pozitive në procesin e realizimit te objektivave.

- Takime me këtë objektiv u realizuan edhe në Qarkun e Shkodrës dhe Dibrës.

NË TERREN

Kjo eshte bota jone portokalli #16ditet kunderdhunesndajgruas



Vullnetarët dhe aktivistët e shërbimit social ne kuader të fushatës ndergjëgjsuese kundër dhunes ne familje shpërndan flet –palosje me mesazhe sensibiluzuese kundër dhunës në familje.

Qendra Kombëtare e Viktimave të Dhunës në Familje nuk mjaftohet vetëm me ofrimin e shërbimeve reabilituese dhe riintegruese për viktimat e dhunës. Ajo është përfshirë drejtpërdrejtë në fushatën e ndërgjegjësimit për të parandaluar dhunën në familje. Pëgjatë 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas stafi i kësaj Qëndre ka realizuar në 6 shkolla të mesme të kryeqytetit evente sensibilizuese me nxënës e mësues. Ndërkohë fushata vazhdon!



Asnjë fëmijë në rrugë



Nga rruga, në çerdhe. Një fëmijë 16 muajsh që nxirrej në rrugë për të lypur bashkë me të ëmën dhe dy vëllezër të tjerë, pas identifikimit nga skuadra e terrenit e task forcës, është regjistruar dhe frekuenton rregullisht çerdhen në Tiranë pas regjistrimit në gjendjen civile dhe dokumentacionin për në çerdhe me ndihmën e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve në minibashkinë nr 6, e cila së bashku me organizatën ARSIS i ka ofruar paketa ushqimore familjes, ndërsa është futur në skemen për ndihmë ekonomike në masën 5000 lekë në muaj deri në gjetjen e një pune për nënën. Të tre fëmijët janë vaksinuar si dhe janë ndihmuar me medikamente.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Edicion Special
15 Korrik 2014

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR NË 300 DITË

SHËRBIM CILËSOR, PËRGJEGJËSI DHE SOLIDARITET

PRIORITETI 1. TRANSFORMIMI I PROGRAMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE NË NJË PROGRAM PËR RIINTEGRIM SOCIAL	
SHTATOR 2013	**NË 300 DITË**
Abuzivizëm në dhënien e ndihmës ekonomike • 106.000 familje në skemën e ndihmës ekonomike • 25% e njësive vendore të pakontrolluara prej më shumë se dy vitesh • Vetëm 35% e njësive vendore të kontrolluara përgjatë 9 muajve	*Skemë që targeton varfërinë* • 85.000 familje në skemën e ndihmës ekonomike. Shmangia e abuzimeve sjell trajtim te familjeve më të varfëra në skemë. • 62% e njësive vendore të kontrolluara në 7 muajt e parë të këtij viti. • Ligji i zbatuar me të gjithë forcën e tij ✓ 14 raste të denoncuara në prokurori ✓ 97 masa me vërejtje me shkrim ✓ 46 gjoba ✓ 11 propozime për largim nga puna
Modeli i ndihmës ekonomike: • përjashtues për një numër familjesh të varfëra për shkak të kritereve ligjore • hapësirë e provuar për abuzim • keqpërdorim i fondeve dhe i masës së pagesës së përfituesve	*Reformim i skemës* Një sistem elektronik i ngritur në tre qarqe të vendit, mundëson: • shënjestrim më të mirë të varfërisë • mirëadministrim i fondeve të ndihmës ekonomike • shmangie e abuzivizmit dhe keqpërdorimit politik të ndihmës ekonomike
Ndihma ekonomike i vetmi shërbim për familjet pa të ardhura	*Punë në vend të ndihmës ekonomike* Për herë të parë Shërbimi Social Shtetëror po punon

	ngushtë me Sherbimin e Punesimit me qëllim punësimin e familjeve në ndihmë ekonomike. *Në 8 qarqe 525 persona nga skema e ndihmës ekonomike u punësuan në sajë të këtij bashkëpunimi*.

PRIORITETI 2. RRËZOJMË BARRIERAT E AFTËSISË SË KUFIZUAR	
SHTATOR 2013	**NË 300 DITË**
Skemë e dalë jashtë kontrollit për shkak të abuzivizmit • Pagesa të pakryera ndaj personave me aftësi të kufizuara që prej korrik-gushtit 2013 • Rritje e skemës së aftësisë së kufizuar me 12% përtej çdo projeksioni vjetor (3-6%)	*Viti i parë që skema e aftësisë së kufizuar ka rënie më 2%* • Përgjegjshmëri dhe rol aktiv i Shërbimit Social pranë komisioneve mjekesore. Objektivi: Shmangie e abuzimeve. • 18% e personave me aftësi të kufizuar të rikomisionuar janë larguar nga skema. • 12 grupe task force të ngritura pranë Drejtorive Rajonale në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë për kontrollin e dosjeve të aftësisë së kufizuar.

PRIORITETI 3. PËRKUJDESJE SOCIALE ME STANDARTE TË PËRMBUSHURA	
SHTATOR 2013	**NË 300 DITË**
23 institucione me borxhe në vlerën e 66 milion lekëve.	Buxheti i rritur me 100 milion lekë ose me 34 % më shumë se viti i kaluar.

Rol i zbehtë i Shërbimit në garantimin e standarteve të shërbimeve në institucione përkujdesi	Po zbatohet Udhëzimi i Ministrit të Mirëqënies për vijimin e trajtimit në institucione përkujdesi të fëmijëve deri në moshën 18 vjeçare, gjë që krijon mundësinë që *fëmijët të mos dalin në rrugë në moshën 16 vjeç* siç edhe ka ndodhur. *Prioritet deinstitucionalizimi*: Për herë të parë është ngritur mekanizmi i ndërveprimit mes punonjësve social në institucione dhe në Drejtoritë Rajonale pranë komunitetit me qëllim fuqizimin e familjeve dhe rikthimin e fëmijëve në familjet e tyre biologjike. *Standartet e shërbimeve në qendrat e përkujdesit:* • Modeli i "shtëpisë familje" në të dy qëndrat e përkujdesit që menaxhohen nga Shërbimi Social Shtetëror. • Praktikë e re bashkëkohore në monitorimin profesional të shërbimeve nga Shërbimi Social Shtetëror. • Për herë të parë të gjitha shtëpitë e fëmijës po përfshihen në një proces supervizimi të stafeve nga ekspertë të jashtëm me qellim ofrimin e sherbimit profesional duke përmbushur standartet e përcaktuara.
Ndihma ekonomike dhe institucionet e përkujdesit- i vetmi rol i Shërbimit Social ndaj grupeve vulnerabël	*Shërbim proaktiv ndaj grupeve vulnerabël* • 389 raste të menaxhuara nga strukturat e Shërbimit Social- praktikë e re dhe model për t'u ndjekur nga njësitë lokale të shërbimeve sociale. • *Qendra Tranzitore e Emergjencës* e ngritur dhe ofron- për 53 familjet rome aktualisht e për familje vullnerabël në vijim- shërbime psikosociale, ndërmjetësim për punësim, formim profesional, strehim për familjet, garanton ndjekjen e shkollës dhe kopshtit për fëmijët e qendrës.

PRIORITETI 4. MIRËMENAXHIMI I SHPENZIMEVE PUBLIKE	
SHTATOR 2013	**NË 300 DITË**
Vetëm 35% e institucioneve të planifikuara ishin audituar ne lidhje me menaxhimin e financave publike.	Përdorimi efikas i parave publike i garantuar përmes forcimit e zbatimit të disiplinës financiare në menaxhimin e fondeve publike. Janë audituar 80 % e institucioneve krahasuar me planin si 6 mujor. Është dhënë masa e largimit nga puna për 5 persona, masa e zhdëmtimit në vlerën 1 878 mijë lekë, janë lënë rreth 80 rekomandime për përmirësimin e aktivitetit të subjekteve të varësisë.
Fondet e NE dhe PAK të planifikuara pa mbajtur në konsideratë treguesit statistikor	Mirëmenaxhim i fondeve të ndihmës ekonomike dhe PAK përmes përmirësimit të mbledhjes së informacionit statistikor. Udhëzimet e Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë kanë krijuar të gjithë hapësirën për një planifikim dhe mirëadministrim të këtyre fondeve, duke ju referuar kështu nevojave reale për fonde.

PRIORITETI 5. PARTNERITETI SOCIAL, SHTETI JO I VETMI AKTOR	
SHTATOR 2013	**NË 300 DITË**
Përgjegjësia sociale e korporatave e pakoordinuar me nevojat e institucioneve te perkujdesit social	• "Shqipëria dhuron" përfshiu 300 biznese, dhe mbështeti 4700 individë në festat e fundvitit. • Rrjeti "Miqtë e Shërbimit Social" funksional, përuruar më 25 mars 2014. Bizneset të informuara për rolin, reformat dhe nevojat e institucioneve të përkujdesjes sociale. Kërkesa në rritje për të ndihmuar IPSH-të nëpërmjet SHSSH-së. ***6 institucione përkujdesi të mbështetura drejtpërdrejt nga 8 Miq të Shërbimit Social. 5 Biznese po vlerësojnë projekt-propozimet tona.***
Partneritet sporadik me shoqërinë civile	OJF-të partnere në dhënien dhe përmirësimin e shërbimeve sociale për qytetarët. • Bashkëpunime kontante për menaxhimin e rasteve me ARSIS, TdH, Down Syndrome Albania, CRCA,

	Save the Children, World Vision, Shkej, Ndihmë për fëmijët, UNICEF, Fondacioni MARA-Hollandë, ADRA, FSHDPAK, Papa Giovani, Projekti Shpresa, Bethany, Shpresë për Botën etj. • Bashkëaplikantë me OJF në projekte të ndryshme për përmirësimin e shërbimeve sociale.
Marrëdhënie inegzistente me median	Ndjekje në kohë reale e rasteve të paraqitura në media për çështje që lidhen me Shërbimin Social, sidomos raste të varfërisë ekstreme

PRIORITETI 6. PËRGJEGJËSIA NDAJ ATYRE QË U SHËRBEJMË	
SHTATOR 2013	**NË 300 DITË**
Mungesë e mekanizmave që garantojnë transparencën dhe llogaridhënien	***Rritje e transparences dhe llogaridhënies*** Faqe transparente, informuese dhe llogaridhënëse në internet. Trefishuam numrin e personave që ndjekin veprimtarinë e SHSSH-së nëpërmjet faqes në rrjetin social Facebook. Buletin dyjavor informativ për veprimtarinë e SHSSH-së Buletin mujor për donacionet Fushata ndërgjegjësuese "Fuqizojmë familjen" 15 maj 2014 Transparencë përmes medias: 15 njoftime per shtyp, përgjigje ndaj çdo kërkese të gazetarëve për informacion, reagim i menjëhershëm ndaj denoncimeve të qytetarëve përmes verifikimit të rasteve me grupe kontrolli. ***Një shërbim i lirë nga korrupsioni*** Janë krijuar hapësirat për të denoncuar korrupsionin jo vetëm përmes internetit, postës elektronike, letrave, por edhe takimeve të menjëhershme me titullarët më të lartë të institucionit.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
1 Korrik 2014

Pëllumbat në oborrin e Doganës



16 qershor- Mario e ngriti balonën e vet në nje mjedis shumë të veçantë: në oborrin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ku bashkë me shokët e shoqet e tjera të Qendrës së Zhvillimit "Pëllumbat" ishin mysafirë në një festë të jashtëzakonshme organizuar nga punonjësit e kësaj Drejtorie. Muzikë, lojëra me animatorë, biçikleta, tullumbace po edhe një Panair me punët e fëmijëve dhe adoleshentëve të Qendrës, qenë mengjesi ndryshe i ofruar nga DPD, në mbështetje të vizionit të Shërbimit Social Shtetëror për integrim dhe përfshirje të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. Faleminderit zj Blertë Kraja, zvdrejtore e përgjithshme e Doganave për idenë, stafit për organizimin dhe punonjësve për kontributin monetar dhe shpirtëror. Bashkëpunimi mes dy institucioneve do të vijojë edhe në të ardhmen në Qendra të tjera të përkujdesit social.

NË TERREN



- Hapet kursi i rrobaqepsisë për 15 gra/vajza egjiptiane në Librazhd. Me nismën e Drejtorisë Rajonale Elbasan dhe në bashkepunim me Qendrën Rajonale të Formimit Profesional, 15 gra dhe vajza te Komunitetit Egjipitian në Qytetin e Librazhdit nisën kursin më 23 qershor, falë dhe bashkëpunimit me kreun e komunitetit egjiptian R. Shaka.

- Kelmend: Rasti i një të miture që dhunohej nga babai ka vënë në lëvizje SHSSH-në në Shkodër, policinë, pushtetin vendor dhe priftin e murgeshat e zonës, të cilat për një periudhë dymujore kanë punuar intensivisht për të siguruar një ambient të sigurt për vajzën. Pas arrestimit të babait dhunues, vajza është rikthyer tek nëna biologjike, të cilën nuk e shihte prej 14 vjetësh. Administratori social monitoron çdo ditë gjendjen e vajzës në mjedisin e ri.

Inbox



Sot isha në një aktivitet shumë serioz organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror. Bëmë si bëmë dhe i bëmë fëmijët për të qeshur. S'ka gjë më të bukur se sa t'i shikoje të qeshnin. Kishte me dhjetëra punime te tilla me gjëra si fara, lajthi, arra, fasule. Pra, këta fëmijë kishin prodhuar art. Të gjithë ne mund të shndërrohemi në instrumente të së mirës. Një bast më pak, një buzëqeshje më shumë për fëmijët.

Erion Kristo, aktivist

Buletini Javor

SHERBIMI SOCIAL

1 Korrik 2014

NË TERREN



- Korçë: Një 12 vjeçare që rritej pa kujdes prindëror për shkak të problemeve në familje, u regjistrua në gjendjen civile nga DR e SHSSH-së Korcë, ndërkohë që u mundësua lidhja me nënën biologjike, e cila tashmë ka një punë dhe një strehë falë bashkëpunimit të disa institucioneve vënë në lëvizje nga SHSSH.

- Drejtoria Rajonale e ShSSH-së Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Punësimit bëri të mundur sistemimin në punë të M. Rapit në programin nxitës "Formim nëpërmjet punës" për 6 muaj në firmën e ndërtimit "Eurokonstruksion BG " dhe më pas do të sigurojë edhe vazhdimësinë e punësimit të këtij prindi të përkushtuar për fëmijët e tij të braktisur nga nëna. Fëmijët do të ndjekin kampin veror të organizuar nga Bashkia e Korçës.

- Falë përkushtimit dhe profesionalizmit të stafeve të Drejtorive Rajonale të Sh.S.Sh-së në Berat dhe Shkodër, mundëm të akomodonim znj.M, ish-viktimë e dhunës në familje dhe person me aftësi të kufizuara pranë Projektit Shpresa. Vajzës, jo vetëm iu sigurua shërbim i specializuar, por sëbashku me përfituesit e tjere të projektit iu ofruan dhe pushime në plazhin e Velipojës.

- Ka përfunduar kontrolli për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe pagesat e aftësisë së kufizuar në 192 njësi vendore ose afro 50% e totalit. Të dhënat janë për periudhën janar-maj 2014.

NË TAVOLINË



- Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH-së zj Etleva Bisha, mori pjesë në konferencën e organizuar nga Caritas Albania dhe Organizata Austriake për Zhvillim "Shanse të Barabarta për personat me Aftësi të Kufizuara" më 17 qershor 2014. Zj Bisha informoi të pranishmit për gjendjen aktuale dhe vizionin e SHSSH-së për përmirësimin e shërbimeve për aftësinë e kufizuar nëpërmjet qendrave komunitare.

- SHSSH mori pjesë seminarin ndërkufitar " Ndërtimi i një plani Social të Zonës dhe Tryezat Bashkërenduese", një projekt i Qendres Rinore Vlorë.

- SHSSH ishte pjesë e studimit "Zhvillimi i ndërmarrjeve sociale- potencial për krijimin e vendeve të punës për grupet e dizavantazhuara" nga Partnerët Shqipëri , i cili u prezantua më 23 qershor. Të dhënat e marra nga SHSSH për familjet në nevojë dhe gratë kryefamiljare kanë ndihmuar projektet e ndryshme për ndërmarrjet sociale në targetimin më të mirë të papunësisë.

Buletini Javor

SHERBIMI SOCIAL

1 Korrik 2014

NË TAVOLINË

- #Raporto! #Shpeto! Ju tashmë keni një mënyrë për të raportuar thjesht dhe shpejt raste trafikimi apo të dyshuara si të tilla. Ju mund të dërgoni në mënyrë anonime një mesazh të shkurtër përmes aplikacionit për telefonat smart Android "Raporto! Shpëto!", i cili u shkon menjëherë dhe njëkohësisht 6 zyrtarëve të ndryshëm publikë ose mund të telefononi falas 116 006.

- Banka Intesa San Paolo i bashkohet zyrtarisht rrjetit "Miqtë e Shërbimit Social". Në një takim me drejtoren e Divizionit Operacional të Bankës, zj. Albina Ahmetaj, u ra dakord që të bashkëpunohej në vijim për mbështetjen e qendrave të përkujdesit.





Standard

*Në Velipojë kanë filluar punimet e rehabilitimit të Shtëpisë së Pushimit për fëmijët pa kujdes prindëror! Me dy donacione private dhe me shumën e mbledhur nga fushata online e Bankës Kombetare Tregtare dhe SHSSH-së do ta bëjmë gati shtëpinë për pushimet e këtij viti!

*Standarde dhe siguri në institucionet e përkujdesjes shoqërore. Shërbimi Social Shtetëror dhe Policia për Mbrojtjen nga Zjarri të Qarkut Tiranë organizoi trajnime për personelin e IPSH-ve të kryeqytetit për masat e mbrojtjes nga zjarri.

*Katër muaj pas themelimit, Miqtë e Shërbimit Social janë shtuar, duke ofruar kushte më të mira banimi dhe jetese për institucionet publike të përkujdesit social ku marrin shërbim fëmijë pa kujdes prindëror, të moshuar, persona me aftësi të kufizuar, gra të dhunuara apo viktima të trafikimit, etj.Kompania GLOBE që operon prej vitesh në fushën e elektroshtëpiakeve iu bashkua kësaj nisme me dhurimin e 13 pajisjeve që do të shkojnë për Qendrën Polivalente të të Moshuarve Poliçan (1), Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë (1), Qendrën Tranzitore të Emergjencave (6) dhe Qendrën Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit (5). Ceremonia e dhurimit u organizua në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë më 28 qershor.



SHERBIMI SOCIAL

Buletini Informativ

1 Gusht 2014









"Fëmijët e Lumtur" në QTE

Kampi veror "Fëmijet e Lumtur" I hapi dyert më 21 korrik në Qendrën Tranzitore të Emergjencave. Trajnuam animatorët sociale me stafin e Qendrës dhe sjellim praktikat më të mira për menaxhimin e shërbimeve sociale. 71 fëmijë të moshave 4-15 vjeç do të luajnë e mësojne gjate dy javëve të kampit veror, përgatitur me profesionalizëm e përkushtim nga punonjësit socialë të qendrës. Faleminderit Terre des Hommes për bashkepunimin!







NË TERREN

- Takime intensive me administratorët socialë për shpjegimin e skemës pilot të ndihmës ekonomike në Tiranë, Durrës e Elbasan për adresimin e problemeve në kohe dhe pa kosto për qytetarët. Ndërkohë në Shkodër, Drejtoria Rajonale e SHSSH-së ka kërkuar nga administratoret sociale respektim të afateve për mbledhjen e këshillave që akordojnë ndihmën ekonomike, ndërsa në Vlorë iu eshte shpjeguar përfituesve ndryshimet në ligjin e ndihmës ekonomike.

Inbox



"Në kuadër të bashkëpunimit mjaft të frytshëm me Institucionin tuaj në lidhje me pacientin Th.Z, do të donim t'ju falenderonim ju dhe stafin tuaj, në veçanti zj Ermira Gjata dhe zj Migena Spaho për impenjimin dhe humanizmin e treguar në rastin konkret."

Ilir Qefalia, Drejtor, Shërbimi Onkologjik në Banesë

SHERBIMI SOCIAL

Buletini Informativ

1 Gusht 2014

NË TERREN





- Pas përfundimit të kontrollit të dosjeve të PAK në qarkun Gjirokastër (2500 në total), afro 1/3 prej tyre shkon per rikomisionim (806). Ekipet e përbashkëta të SHSSH-se dhe ISHP-së ia dolën që në 3 muaj të përfundojnë një punë voluminoze për të disiplinuar një nga programet e rëndësishme të mbrojtjes sociale. Njëkohësisht në të njëjtën periudhe gati 3 mujore, një punë e konsiderueshme u krye nga specialistët e Drejtorisë së Shërbimit Social, të cilët përfunduan një bazë të dhënash për secilin përfitues.

- Në kuadër të deinstitucionalizimit dhe fuqizimit të familjeve të jetimëve social të rikthyer, Drejtoria Rajonale Elbasan kreu një vizitë në shtëpinë e fëmijës A.E, me qëllim monitorimin e ecurisë së femijes. Në bashkëpunim me vullnetarët e SHSSH-së, u dhuruan disa paketa ushqimore për mami Albanën. "Fëmijën e gjetëm shumë mirë me shëndet, të lumtur në familjen e tij dhe entuziast për integrimin në komunitet me fëmijët e tjerë të lagjes ku banonte", raporton DRSHSSH.

- 65 fëmijë nga mosha 6-17 vjeç nga Shtëpitë e Fëmijës Tiranë, Shkodër dhe Sarandë ishin në bordin e anijes TARA , një nga anijet më të rralla për ekspedita detare, sjellë në Shqipëri nga Agjensia Kombetare e Bregdetit. Fëmijët u pritën nga stafi shkencor dhe kapiteni i anijes, ku dëgjuan mbi kërkimet shkencore , zbulimet e anijes TARA dhe panë një koleksion fotosh të bëra nga shkencëtarët francezë në brigjet e Antarktidës.

NË TAVOLINË



- Dy specialistë të Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH-së ishin pjesë e vizitës studimore në Londër, Angli, nga data 4-7 gusht për të parë nga afër shërbimet sociale dhe për të diskutuar cështje të mirëqenies së fëmijëve me punonjësit socialë të Departamentit të Kujdesit për Fëmijët në Croydon. Gjatë vizitës, u vëzhguan një sërë shërbimesh si mbrojtja e fëmijëve, kujdestaria dhe birësimi, sigurimi i cilësisë dhe garantimi i jetës, mbështetja e familjeve, ndihma e hershme, etj. Vizita studimore ishte pjesë e bashkëpunimit mes MMRS dhe Britanisë së Madhe për ngritjen e një mekanizmi që do të lehtësojë kthimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të fëmijëvë të pashoqëruar shqiptarë që gjenden në Angli.

- SHSSH Shkodër mori pjesë në trajnimin nga "Save the Children" për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë.

SHERBIMI SOCIAL

Buletini Informativ

1 Gusht 2014

NË TAVOLINË



 Shërbimi Social Shtetëror mirëpriti mbi 30 studentë të Programit Veror të MMSR-së për praktikë pune në strukturat e veta në të gjithë Shqipërinë. Studentët në vitin e fundit të studimeve për punë sociale dhe psikologji, po shohin nga afër dhe po aftësohen të përballojnë dinamikën e çështjeve të cilat trajton SHSSH-ja dhe institucionet e përkujdesit social.

Standard

 Për herë të parë, standardet e shërbimit për fëmijë në Institucionet e Përkujdesit Social do të mbikqyren edhe nga ekspertë të jashtëm. Sipas praktikave më të mira botërore, SHSSH po bashkëpunon me Terre des Hommes për të ngritur dhe ofruar një supervizim profesional për stafin psiko- social që shërben në IPSH-të për fëmijë në Tiranë, Durrës, Vlorë, Sarandë dhe Shkodër. Punonjësit e Pavarur të TdH do të mbështesin gjithashtu hartimin, zbatimin dhe rishikimin e Planit të Kujdesit për çdo fëmijë në institucione.

 Kemi poete ne Shtepine e te Moshuarve Tirane. Si Liza, qe pershendet bashkemoshataret e vet me kete poezi:

"Për ju të moshuarit e moshës së tretë
që rrobat e lagura në trup ju thanë
e rrota makine bëtë këmbët
shuajt e këpucëve rrugëve ju ranë

Jeni kontigjenti i luftës e i punës
e vendit i dhatë aq shume vlerë
Po kushedi c'do bënit
po të ishit të rinj edhe njëherë.

Sa herë mendoj për ty, fisnikja gjeneratë
më del para syve rruga e gjatë
here me të përpjeta, here me tatëpjeta
po nuk shmangesh dot se kështu e ka jeta.

Asnjeri në botë s'e harron pleqëria
mendo se nje ditë plaket dhe fëmija."

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
1 Shtator 2014

Përfundon rivitalizimi i Shtëpisë së Pushimit në Velipojë-investim i Miqve të Shërbimit Social





Shkodër, 20 gusht 2014- Pas dy muajsh punimesh intensive, Shtëpia e Pushimit në Velipojë ka një fytyrë të re. Kështu një tjetër projekt i rrjetit Miqtë e Shërbimit Social është përmbyllur me sukses duke u dhuruar fëmijëve pa kujdes prindëror një mjedis çlodhës dhe me standarde të përmirësuara. Falë donacioneve nga Banka Kombëtare Tregtare që financoi pajisjet elektroshtëpiake , Gulf Albania që kontribuoi për kompleksin e lodrave në oborr dhe

Fishta që kreu të gjitha punimet brenda e jashtë godinës dhe Fondacionit "Shpresë për Botën" që arredoi pjesën e brendshme, Shtëpia e ngritur që në vitet '60 ofron 960 metra katror të gatshme për të pritur grupe nga shtëpitë e fëmijës në të gjithë Shqipërinë për të kaluar pushimet verore ose aktivitete të tjera çlodhëse. Në ceremoninë e përurimit, zvdrejtoresha e përgjithshme e SHSSH-së, zj Lida Leskaj, theksoi se ky projekt është një dëshmi suksesi i filozofisë së bashkëpunimit mes aktorëve të ndryshëm për të garantuar një mbrojtje më të mirë sociale për qytetarët shqiptarë.

"Ne u jemi mirënjohës të gjithë atyre që i janë bashkuar nismës sonë "Miqtë e Shërbimit Social", një rrjet vullnetar që bashkon të gjithë ato organizata e biznese që duan të ndihmojnë grupet në nevojë. Roli ynë si Shërbim Social është të koordinojmë këtë energji pozitive dhe burimet financiare e njerëzore që shoqëria ka të disponueshme për grupet në nevojë, duke garantuar monitorimin e standarteve të shërbimit dhe përmirësimin e tyre të vazhdueshëm. Shtëpia e Pushimit në Velipojë do të pasohet nga shumë investime të tjera që po kryhen në institucionet e përkujdesit social në të gjithë Shqipërinë".

NË TERREN

⊗ Si rezultat i kontrolleve të Drejtorive Rajonale të SHSSH-së për ligjshmërinë e pagesave për aftësinë e kufizuar, në qershor lista e pagesave ka 2338 persona më pak (pa përfshirë invalidët e punës) ose 2.5% krahasuar me janarin.

⊗ 17 raste të menaxhuara në Tirane nga task-forca "Ndihmë për familjet dhe fëmijët në situatë rruge", koordinuar nga Shërbimi Social Shtetëror dhe Agjensia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në vetëm tre muaj.

Inbox



"E dini që shteti ka filluar të funksionojë dalëngadalë? Pas publikimit të kronikës për familjen Beleri në Cërrave të Pogradecit kanë ardhur një sërë reagimesh,së pari Shërbimi Social Shtetëror është ofruar të ndihmojë fëmijët."

Artin Halili, gazetar, Ora News

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
1 Shtator 2014

NË TERREN

Sfida është e madhe, po rezultatet e para janë shpresëdhënës. "Përfshirja ndërinstitucionale sipas një modeli ndër sektorial dhe të integruar të mbështetur në parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, është garancia më e mirë për zgjidhjen e këtij problemi kompleks"- thote koordinatorja e sekretariatit të nismës, zj Lida Leskaj, zvdrejtoreshë e përgjithshme e SHSSH-së.



⊗ Në Elbasan, një fëmijë në rrezik trafikimi është sistemuar në një qendër përkujdesi, ndërsa në Shkodër një familjeje që jetonte në qiell të hapur iu afrua ndihma e nevojshme për ndihmën ekonomike dhe dy fëmijët e mitur. Bashkisë iu kërkua që të ndihmonte me strehimin.

⊗ Dy fëmijë të mitur të një çifti me probleme ekonomike dhe ligjore u morën në përkujdesje nga Shërbimi Social Shtetëror në Lezhë pas referimit nga World Vision. Ata u sistemuan në një qendër rezidenciale , ndërkohë që nëna e tyre po mbështetet me një plan të mirëfilltë kujdesi që fëmijët të mund të rikthehen pranë saj sa më shpejt.

⊗ Drejtoria Rajonale e SHSSH-së në Gjirokastër ka mbështetur psikologjikisht Yllkën, nënë e dy fëmijëve në Tepelenë që u dhunua nga xhaxhai i të shoqit të ndjerë. Gjithashtu, zonja do të mbështetet për rehabilitim dhe fuqizim në një nga qendrat e përkujdesit që trajtojnë rastet e dhunës në familje.

NË TAVOLINË

⊗ Shërbimi Social Shtetëror mirëpriti mbi 30 studentë të Programit Veror të MMSR-së për praktikë pune në strukturat e veta në të gjithë Shqipërinë. Studentët në vitin e fundit të studimeve për punë sociale dhe psikologji, panë nga afër dhe u aftësuan të përballojnë dinamikën e çështjeve të cilat trajton SHSSH-ja dhe institucionet e përkujdesit social.





Standard

☒ Përfunduan në mënyrë të suksesshme aktivitetet verore me fëmijët në nevojë të zonave të Durrësit të Ri (ish-Kënetës) & Porto-Romano-s. Falë kontributit të palodhur të të rinjve vullnetarë të Shërbimit Social Shtetëror & Durrës Youth Movement - CSDC Durrës, me mbështetjen e World Vision Albania, Zyra e Durrësit rreth 200 fëmijë u argëtuan në lojra të ndryshme psiko-sociale.

☒ Klub Futboll "Tirana" do të kujdeset për dy talente të futbollit nga Shtëpia eFëmijëve Zyber Hallulli në Tiranë duke I futur në seancat e veta stërvitore. Vendimi erdhi pas një takimi të drejtuesve të Klubit dhe futbollistëve me fëmijët e Z.H, të cilët ishin të ftuar special në ndeshjen e parë të kampionatit. Gjithashtu, KF Tirana dhuroi për fëmijët veshje dhe mjete shkollore.

Buletini Informativ

SHERBIMI SOCIAL

1 Tetor 2014









Fëmijët që jetojnë në qendrat publike të përkujdesit social e nisën vitin e ri shkollor si të gjithë bashkëmoshatarët e tyre. Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, zj Etleva Bisha u uroi vitin e ri shkollor fëmijëve të "Zyber Hallullit", ndërsa në Shkodër, Shtëpia e Fëmijës Parashkollor përcolli 5 fëmijë për në klasë të parë, ndërsa 10 të tjerë në parashkollor. Ndërkohë në Tufinë, 48 fëmijët e Qendrës Tranzitore të Emergjencave e kanë filluar vitin e ri shkollor me një surprizë të bukur nga kompania e mirënjohur BIC ALBANIA: lapsa, ngjyra dhe stilolapsa për secilin prej tyre. Përkushtimi i SHSSH dhe UNDP për funksionimin e QTE-se si një qendër model shërbimi ndaj grupeve në nevojë, përfshire komunitetin rom, vazhdon.

Po kështu, Shoqëria tregtare BIC Albania dhe Programi i PNUD-it për Barazinë Gjinore bashkëpunuan për t'u dhuruar fëmijëve të Strehëzës Kombëtare për të Mbijetuarit e Dhunës në Familje, mjete të ndryshme me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor. Këta fëmijë dhe nënat e tyre largohen nga abuzimi në familje dhe rindërtojnë një jetë të re, të lirë nga dhuna, përmes një programi rehabilitimi në Strehëz.

Suksese të gjithëve!

NË TERREN



 Kujdes dhe mbështetje për 5 fëmijë nga Komuna Lumas, të mbetur jetimë nga nëna dhe me baba të pamundur për t'u kujdesur për ta. Drejtoria Rajonale e SHSSH-se në Berat në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme mundësoi vendosjen e fëmijëve në qendrat e kujdesit social. Shërbimi Social do jetë gjithmonë i gatshëm të ofroje mbrojtje për ata që kanë nevojë, po rezultatet do të jene më të qëndrueshme me pushtetin lokal përkrah.

Inbox



"Më ka bërë përshtypje afrimiteti i stafit, buzeqeshja e tyre nuk na ka munguar asnjëherë. Stafi na rrin kudo aq afër, për mua kta jane familja ime, një familje shumë e dashur."

Përfituese e strehezës kombëtare për viktimat e dhunës në familje

Buletini Informativ

SHERBIMI SOCIAL

1 Tetor 2014

NË TERREN



 Shërbim 24 orë për të moshuarën Panajota Gjoni, e cila para dy javësh jetonte në rrënojat e një ndërtese.Fale bashkëpunimit dhe dashamirësisë së fondacionit Kenedi, e moshuara u sistemua tek Vila Kenedi në Korçë.

 Bashkë me mjekët e Shërbimit Rajonal Shëndetësor, SHSSH iu gjend pranë tre fëmijëve më aftësi të kufizuar në Klos, që trajtoheshin në mënyrë jo të denjë nga prindërit e tyre, duke ofruar ndihmë emergjente me anë të Kryqit të Kuq, por dhe monitorim të vazhdueshëm të familjes.

 12 vogëlushë Rom , disa të shoqëruar edhe nga nënat , filluan aktivitetin pedagogjik edukativ në qendrën ditore në Shkodër sipas projektit Italo-Shqiptar IADSA .

 Nën moton "Asnjë fëmijë në rrugë" , Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror dhe grupe vullnetarësh, vazhdon ndërgjegjësimin e qytetarëve në Tiranë për reduktimin e kësaj dukurie që dëmton të ardhmen e fëmijëve. Qytetarët mund të telefonojnë në numrat:067 60 13 639 numri i telefonit të Task Forcës dhe 116 111 ose të mbështesin qendrat e shërbimit për fëmijë që janë të listuara në faqen e internetit ose në fletëpalosje!

NË TAVOLINË





 Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH-së Etleva Bisha bisedoi gjatë javës me qytetarët dhe administratorët e njësisë 6 dhe 1 në kryeqytet, në Kavajë, Shijak, Gramsh dhe Librazhd lidhur me skemën pilot të ndihmës ekonomike. "Modeli ka rezultuar i suksesshëm për një numër të madh familjesh. Problemet po minimizohen dhe po marrin zgjidhje. Ky është një model transparent që e shtyn qytetarin drejt punësimit si alternativë të ardhurash, jo drejt pasivitetit," - tha zj Bisha. Per me shume informacion, vizitoni http://www.sherbimisocial.gov.al/pyetje-pergjigje/

Buletini Informativ

SHERBIMI SOCIAL

1 Tetor 2014

NË TAVOLINË



 Disiplinimi i pagesave të aftësisë së kufizuar pas asaj të ndihmës ekonomike ishte në fokus të mbledhjes së drejtorëve rajonalë në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH-së më 5 shtator 2014. Gjatë mbledhjes u bë një analizë e situates së deritanishme, efektet e punës me task force të përbashkët dhe u dhanë udhëzime për ndjekjen nga afër të situatës, duke nxitur edhe bashkëpunimin me qytetarët në denoncimin e rasteve abuzuese.

Që nga 16 shtatori është vënë në dispozicion numri 067 2222 102 për denoncimin e abuzimeve me pagesat e aftësisë së kufizuar.

 Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Qarku Berat, u bë pjesë e tryezës së diskutimit, organizuar nga organizata "Gruaja rome" në mjediset e Qendrës Ndërkulturore Komunitare, Berat mbi problematikat e sfidat qe ka komuniteti rom e sidomos gruaja rome në integrimin e saj në shoqëri.







Standard

 Pesë makina qepëse u dhuruan nga Albanian Community Assist (ACA) për Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje që menaxhohet nga Shërbimi Social Shtetëror. "Synimi ynë është që rezidentet të aftësohen në formim profesional në mënyrë që ta kenë më të lehtë integrimin në shoqëri pas daljes nga Qendra", tha zvdrejtoresha e Përgjithshme e SHSSH-së, zj Lida Leskaj, e pranishme gjate dorëzimit të pajisjeve.

 Ka përfunduar procesi i ndërhyrjeve të riparimeve në Shtëpinë e Fëmijës Vlorë! Ashtu sikurse u lajmërua më datë 21 Maj , me donator Albtelecom &Eagle Mobile, ka përfunduar lyerja totale e Shtëpisë, montimi i parketit në dhomën qëndrore, vendosja e abazhurëve dhe ndërhyrja në hidro sanitare.

 Me nismë të shoqatës "Qëndistaret", në bashkëpunim me Drejtorine e Trajnimit dhe Formimit Profesional si dhe Shërbimit Social Korçë, u çertifikuan 15 gra nga komuniteti egjiptian për trajnimin që zhvilluan mbi punën me dorë.

 Në Vlorë, mbërrin projekti i SHSSH me Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar për shpërndarjen e 10 karrigeve me rrota për personat para dhe tertraplegjikë.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
1 Nëntor 2014





Bashkë për një pleqëri të shëndetshme

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Moshuarve, institucionet e përkujdesit social në varësi të Shërbimit Social Shtetëror organizuan aktivitete të larmishme. Nën moton "Bashkë" Shtëpitë e të Moshuarve dhe Qendrat Ditore që ofrojnë shërbime për moshën e tretë në Tiranë, Kamëz, Durrës, Polican, Gjirokastër, Shkodër e Kavajë mblodhën dhjetëra qytetarë, fëmijë e të rinj, artistë e sipërmarrës për të kujtuar me ta kontributin dhe sfidat me të cilat përballet kjo kategori.

"Natyrisht, do të ishte më mirë që në këtë ditë të ishit në shtëpi me familjet tuaja, por në kushtet kur ju keni bërë këtë zgjedhje, detyra jonë është që të sigurohemi që standartet e shërbimeve në qëndrat e përkujdesit janë në lartësinë e duhur, -tha zv.drejtoresha e përgjithshme e SHSSH zj Lida Leskaj. "Pleqëria e shëndetshme është në themel të politikave tona për mirëqënien sociale dhe të gjithë aktorët duke filluar nga individi, pushteti lokal dhe qeveria duhet të punojnë së bashku për këtë qëllim."

Aktualisht ka filluar zbatimi i projektit me fonde të qeverisë italiane për ridimensionimin e Shtëpive të të Moshuarve.

NË TERREN





- Sipas kalendarit të përcaktuar më parë dhe me qëllim intensifikimin e punës në qarqe, Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH-së Etleva Bisha vizitoi këtë muaj Vlorën, Korçën dhe Dibrën. Në takimet me administratorët socialë të këtyre qarqeve u theksua rëndësia e bashkëpunimit me qëllim realizimin e një mbrojtje më efikase të qytetarëve shqiptarë nëpërmjet programeve të ndihmës ekonomike dhe pagesave për aftësinë e kufizuar. Administratorët vlerësuan takimet si shumë të vlefshme dhe ndanë shqetësimet e përbashkëta duke sugjeruar dhe zgjidhjet përkatëse. Zj Bisha vizitoi dhe disa institucione përkujdesi, të cilat kanë patur buxhet më të rritur për këtë vit, mbështetje nga donatorë dhe për pasojë standarde më të mira shërbimi.

- Sigurohet transporti publik për banorët e Qendrës tranzitore të emergjencave për kategorite ne nevojë. Pas takimeve negociuese te vazhdueshme, nga Shërbimi Social Shtetëror, si dhe stafit të QTE është arritur vendosja e stacionit te autobusit, që përfshin dhe QTE. Kjo zgjidh shumë nga sfidat me të cilat janë përballur familjet për marrjen e shërbimeve.

Buletini Informativ

SHERBIMI SOCIAL

1 Nëntor 2014

NË TERREN





 DRSHSSH Lezhë vazhdon mbështetjen për familjen Metalla, në fshatin Fullqet të Klosit. Pasi u verifikua qe dy fëmijët e kësaj familje ishin përfitues të pagesës së Aftësisë së Kufizuar me kujdestari dhe gjithashtu te pagesës së Ndihmës Ekonomike, duke parë situatën shumë të vështirë ekonomike u ndërhy edhe me ndihma konkrete për këtë familje. Falë kontributit bujar të Kryqit të Kuq Dega Lezhë u mundesuan 30 kg ushqime, veshmbathje dhe paketa higjeno-sanitare për secilin anëtar të familjes , enë guzhine, batanije, çarçafë etj.

 Shërbimi Social jo vetëm do të auditojë dhe verifikojë cdo rast të abuzimeve me skemat sociale por do te vazhdojë të jetë mbështetje konkrete për familjet më në nevojë!

 Një 24 vjecare me aftësi të kufizuar që jetonte në kushte të mjerueshme në Ersekë, pas publikimit të historisë në media, u mor në përkujdesje nga SHSSH derisa nëna e saj biologjike që e kish braktisur në moshën 1 vjeçare ta marrë përfundimisht në kujdestari jashtë vendit.

NË TAVOLINË



 Duke folur ne workshopin e organizuar nga IOM, Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH-së Etleva Bisha informoi se SHSSH ka firmosur një Urdhër të Përbashkët me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me qëllim kryesisht koordinimin e proçesit të rikthimit të fëmijëve të pashoqëruar. Në të gjitha Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social janë trajnuar punonjësit social për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë, menaxhimin e rasteve te viktimave të trafikimit dhe të dhunës së familje. Po ashtu, Drejtoritë Rajonale janë përfshirë në informimin e popullatës për detyrimin ligjor të prindërve ndaj fëmijëve dhe penalitetet ndaj prindërve kur nuk e plotesojnë këtë detyrim, por kërkohet rol i rritur i administratorëve socialë pranë pushtetit lokal, të cilët kanë kontaktet direkte me familjet.Shërbimi Social gjatë vitit të fundit ka asistuar gjashtë raste të fëmijëve të pashoqëruar, tre prej te cilëve jane riatdhesuar dhe riintegrimi i tyre ndiqet në vazhdimesi nga SHSSH dhe shoqata Terre Des Hommes dhe IOM.

Inbox



"Ne përfundim të tre projekteve sociale që ALBtelecom dhe Eagle Mobile nisën së bashku me Shërbimin Social Shtetëror, sa i takon rehabilitimit të ambjenteve të Shtëpive të Fëmijëve në qytetet e Sarandës, Vlorës dhe Tiranës, dëshiroj t'ju falenderoj për bashkëpunimin e suksesshëm dhe t'ju bejë me dije se kompania ka vendosur të ofrojë një vit internet falas për Shtëpine e Fëmijëve, Shkodër."

Ledina Ferhati, supervizore, njësia e përgjegjësisë sociale të koroporatës, Albtelecom &Eagle Mobile

SHERBIMI SOCIAL

Buletini Informativ

1 Nëntor 2014

NË TAVOLINË





- Në Shkodër, Drejtoria Rajonale inicioi takimet periodike me psikologët e shkollave te qytetit,administratorët socialë, përfaqesues të Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve, përfaqësues të Njësisë Kundër Dhunës në Familje dhe psikologë të Policisë së Qarkut Shkodër, për të vënë në dinamike sistemet e referimit të problemeve të fëmijëve dhe për ti parandaluar ato që në fazë fillestare.

- SHSSH iu bashkua marshimit ndërgjegjësues "Eja të kesh një shok për kokë" ndërmarrë nga Down Syndrome Albania, për t'i falenderuar dhe mbështetur në punën që bëjnë.

- DR Shkodër organizoi një takim me drejtuesit dhe punonjësit social të institucioneve te përkujdesit për të ritheksuar vlerat dhe praktikat e deinstitucionalizimit në mënyrë që këto rezidenca të mos mbipopullohen nga persona që me pak suport për familjet e tyre mund të qëndrojnë pranë tyre. Takimi u asistua nga specialistët e "Cooperativa sociale il Melograno" nga Piza e Italisë si eksperte të vjetër të shërbimeve de-institucionalizuese.







Standard

-- Nga sot, Shtëpia e Fëmijës Zyber Hallulli ka një sallë kinemaje të restauruar me ndihmën e "Miqve" të Shërbimit Social, Albtelecom&Eagle Mobile. U përmbyllën me sukses 3 nga 4 projektet që kompania kishte me Shtëpitë e Fëmijës: në Vlorë, Sarandë dhe së shpejti në Shkodër- 1 vit internet falas për shtëpinë e fëmijës shkollor.

-- Fondacioni Nehemiah Gateway Albania dhuroi 30 karrocave për personat me aftësi të kufizuar në Fier dhe 30 në Korcë .

-- Shkolla Rilindja në Vlorë organizoi një pritje për fëmijët e shkollës Speciale PLM. Ideja e këtij takimi mes dy shkollave ishte solidarizimi dhe përfshirja konkrete e fëmijëve me aftësi të veçanta në aktivitetet e nxënësve të shkollave të qytetit. Jemi në punë e sipër të fuqizimit të bordit të prindërve dhe përfshirjen e tyre në çështjet sociale. Kemi nevojë për prindërit dhe angazhimin e tyre nëper shkolla !

-- Pas aplikimit online, 9 vullnetare u paraqitën në takimin e organizuar në Drejtorinë e Përgjithshme dhe po atë ditë iu bashkuan ekipit të projektit "Në ndihmë te familjeve dhe fëmijëve në situatë rruge", i cili si çdo të enjte, vazhdon të ndërgjegjësojë qytetarët për rolin e tyre në reduktimin e kësaj dukurie. Suksese!

-- SHSSH iu bashkua Javës Kombëtare antitrafik me një kalendar të ngjeshur aktivitetesh. Qendra Kombëtare për integrimin e viktimave të trafikimit organizoi panair me punimet artizanale të vajzave që strehohen në qendër, ndërsa bisedoi në forume të hapura me të rinjtë e shkollavë të mesme dhe studentët në Qytetin Studenti rreth rreziqeve të trafikimit dhe mënyrave për ta raportuar atë. Qendra Tranzitore e Emergjencave organizoi një bashkëbisedim dhe panair me punët e fëmijëve romë banorë në qendër, ndërsa në Vlorë u organizua një spot TV, biseda si dhe ekspozita pikure. Gjirokastra, Korça dhe Durrësi iu bashkuan fushatës me vullnetarët e tyre.

-- Të moshuarit e Shtëpisë së Tiranës ishin në Vlorë në një eskursion qe u mbështet bujarisht nga Fondacioni ALTRI dhe Fondi Besa.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
JANAR 2017

IMPAKTI I MIRËQENIES SOCIALE

#Mbështesim Bashkitë me kapacitete në fushën e shërbimeve sociale



Në 16 Janar 2017 përfaqësues të 61 Bashkive, 12 Drejtorive Rajonale dhe Drejtorisë së Shërbimeve Shoqërore të SHSSH morën pjesë në workshop-in mbi planet sociale. Në muajt Nëntor-Dhjetor 2016 punonjësit social të 12 Drejtorive Rajonale të SHSSH, si dhe 61 përfaqësues të Drejtorive të Shërbimeve Sociale të Bashkive u trainuan në lidhje me legjislacionin, menaxhimin e rasteve sociale, monitorimin e shërbimeve sociale dhe mbledhjen e të dhënave sociale.

Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Z. Blendi Klosi gjatë fjalës së mbajtur në takim u shpreh: "*2017 është viti i shërbimeve. Bashkë me bashkitë do t'i japim një fytyrë të re shërbimit ndaj qytetarëve. Përmbyllja e planeve sociale nga çdo njësi e pushtetit vendor, krijimi i hartës së plotë të shërbimeve, qëndra përkujdesi në çdo bashki do të jenë të gjitha nën marrëveshjen kombëtare të imPaktit të Mirëqenies Sociale.*"

Ndërkohë Kryetari i Bashkisë Tiranë, Z. Erion Veliaj theksoi: *"Bashkia Tiranë do të angazhohet për të ngritur shërbime të tjera sociale në territorin e bashkisë në funksion të nevojave të grupeve vulnerabël"*



Në përputhje me ligjin, drejtoritë rajonale kanë detyrimin të ndërveprojnë me Bashkitë gjatë procesit të hartimit të planeve sociale, prandaj ngritja e kapaciteteve të punonjësve social të drejtorive rajonale është po aq e rëndësishme sa edhe përgatitja e stafeve të Bashkive.

Projekti "Ngritja e kapaciteteve të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH) dhe Drejtorive Rajonale në kuadër të sistemit të ri të shërbimeve sociale", po zbatohet nga organizatat Ballkan Youth Link Albania, dhe Instituti "Bennusi" në bashkëpunim me SHSSH dhe me mbështetjen e UNICEF.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
JANAR 2017

ImPakti social



Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Z. Blendi Klosi, në kuadër të reformës së shërbimeve sociale, prezantoi Ligjin e Ri për Shërbimet Shoqërore në Qendrën "Balashe" Elbasan. Gjithashtu, u firmos me 7 Kryetarët e Bashkive të Qarkut Elbasan "Pakti Social". Ky Pakt Social për vitin 2017, ka si objektiv kryerjen e detyrimeve reciproke nga secila palë (MMSR-Bashki) me në fokus qytetarin. Konkretisht çdo Bashki merr përsipër ngritjen e shërbimeve sociale në funksion të nevojave të grupeve vulnerabël në territorin e bashkisë. Ligji i Ri për Shërbimet Shoqërore vjen si një ligj inovator në fushën e shërbimeve shoqërore, duke përbërë kështu bazën e rregullimeve të saj.

Në Tavolinë

#Analiza e Punës e vitit 2016 të Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror të SHSSH



Drejtoritë Rajonale të SHSSH kanë zhvilluar në Tiranë Analizën e Punës për vitin 2016. Në ndryshim nga vitet e tjera, këtë vit 12 Drejtoritë Rajonale e kanë zhvilluar së bashku Analizën e Punës duke pasur si qëllim jo vetëm paraqitjen e arritjeve dhe sfidave të çdo Drejtorie Rajonale, por edhe mundësinë e shkëmbimit të eksperiencës mes stafeve të drejtorive.

Qëndrat e Përkujdesit Shoqëror të SHSSH kanë zhvilluar Analizën e Punës për vitin 2016. Në këtë analizë u pasqyruan sfidat dhe arritjet e vitit 2016 duke pasur si qëllim jo vetëm paraqitjen por dhe transparencën e tyre.



Buletini Informativ
SHERBIMI SOCIAL
JANAR 2017

Aktivitete nga Drejtoritë e SHSSH

#Drejtoria e Monitorimit të Shërbimeve Sociale

Gjatë muajit Janar 2017 është mbledhur Komisioni për Vlerësimin e Nevojave të përsonave të moshuar dhe fëmijë që kërkojnë të sistemohen pranë Institucioneve Rezidenciale të Përkujdesit Shoqëror. Komisioni ka shqyrtuar 15 kërkesa të të moshuarve dhe 11 kërkesa për fëmijë për sistemim ose transferim në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror.

#Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK

Në datat 23-26 Janar 2017, Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK ka zhvilluar kontroll në Drejtorinë Rajonale të SHSSH Durrës, dhe Bashkinë Fushë-Krujë. Qellimi i grupit të kontrollit ka qënë verifikimi i punës së bërë mbi zbatimin e legjislacionit të NE, PAK dhe invalidëve të punës për periudhën Janar-Dhjetor 2016.

Në terren

#Berat

M. Shkurtaj, nënë kryefamiljare me 5 fëmijë, e gjendur në kushte të vështira jetese, gjeti mbështetjen e Drejtorisë Rajonale të SHSSH Berat. Thirrjes për solidaritet të D.R.SH.S.SH Berat iu përgjigjën familjet beratase të cilët dhuruan pako ushqimore, veshmbathje, lodra dhe materiale shkollore për fëmijet. Nuk do të mungojë mbështetja e bizneseve të zonës, të cilat kanë marrë përsipër mobilimin, rregullimin e çatisë dhe të ambjenteve të brendshme të shtëpisë. Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve pranë Bashkisë Berat gjithashtu po menaxhon situatën e fëmijëve nëpërmjet një plani menaxhimi për çdo fëmijë. Rasti i M. Shkurtaj u referua nga banorë të zonës së Njësisë Administrative Otllak.

#Shtëpia e të Moshuarve Tiranë



Nxënës të shkollave "Sami Frashëri", "Kongresi i Lushnjës" , dhe të rinj të Kishës Biblike "Babtista" Tiranë, gjatë muajit janar kanë vizituar Shtëpinë e të Moshuarve. Të rinjtë kanë organizuar aktivitete, lojëra, duke kaluar disa orë në shoqëri me të moshuarit.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
SHKURT 2017

VITI 2016 NË FOKUS TË ANALIZËS SË SHSSH

#Vlorë,Shkurt 2017

Përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH, 12 Drejtorive Rajonale të saj dhe 11 Institucioneve të Përkujdesit në varësi të SHSSH u mblodhën në Vlorë për të analizuar aktivitetin një vjecar të këtij institucioni. Në Analizë morri pjesë Ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë z. Blendi Klosi, drejtues të Institucioneve të Përkujdesit që menaxhohen nga Bashkitë, si dhe drejtues e përfaqësues të organizatave partnere të SHSSH.





"Nuk është e lehtë të analizosh në pak kohë akvititetin një vjeçar të një institucioni dinamik si Shërbimi Social Shtetëror. Dinamik për nga gjerësia e fushës së veprimit të tij dhe sfidues për shkak të kompleksitetit të vetë problemeve sociale që bartin familje dhe individë përfitues të këtyre shërbimeve. SHSSH është institucioni ku po jetësohen tre reformat ë rëndësishme të MMSR: ndihmës ekonomike, aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve shoqërore", theksoi në fillim të prezantimit të punës një vjeçare të SHSSH Drejtoresha e Përgjithshme e këtij institucioni Znj. Etleva Bisha.

Në emër të institucionit që drejton znj. Bisha në një analizë krahasuese me vitin 2013 prezantoi gjerësisht ***22 arritjet e vitit 2016*** në të tre drejtimet kryesore të punës së SHSSH, në përputhje me objektivat dhe aktivitetet e parashikuara në Planin e Veprimit të 2016. Pjesë e prezantimit të saj ishin gjithashtu edhe ***problematikat e konstatuara në secilin prej tre sektorëve,*** të cilat përbëjnë edhe sfidat në vijim për t'u kapërcyer nga ky institucion.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
SHKURT 2017

Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, z. Blendi Klosi, duke vlerësuar punën e SHSSH gjatë vitit 2016 në fjalën e tij ndër të tjera theksoi: *"Dua të falenderoj të gjithë stafin e SHSSH për përkushtimin e treguar në këto 3 vjet dhe për punën e palodhur. Ne duam të ofrojmë shërbime cilësore për njerëzit më në nevojë, për më të varfërit e më të varfërve, ndaj MMRS është e përkushtuar për të rritur mirëqenien e shqiptarëve, dhe këtij angazhimi i shërbejnë paktet sociale që po nënshkruajmë me të gjitha bashkitë e vendit."*







Duke artikuluar qartësisht vizionin e MMSR për përmbushjen e tre objektivave madhore të reformave të ndihmës ekonomike, aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve shoqërore, Ministri Klosi theksoi se*:*

"Sfidat që kemi përpara janë të mëdha dhe kërkojnë angazhimin e ju të gjithëve. Reformat që kemi ndërmarrë për modernizimin e skemës së ndihmës ekonomike, pagesave të aftësisë së kufizuar apo shërbimeve shoqërore janë prioritet i Qeverisë Shqiptare dhe MMSR, dhe bashkë me Shërbimin Social Shtetëror do t'i implementojmë në mënyrën e duhur".

Pas diskutimeve të pjesëmarrësve u prezantuan objektivat dhe prioritetet e SHSSH, të cilat janë baza e Planit të Veprimit 2017 miratuar në muajin janar e që po ndiqen e zbatohen nga të gjitha institucionet e SHSSH.

Për t'u informuar në detaje mbi prezantimin e Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH mbi arritjet dhe problematikat e vitit 2016, si dhe objektivat dhe prioritetet e 2017, lutem klikoni në :

- ***http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2017/03/Analiza.pdf* (Prezantimi i Analizës Vjetore 2016)**
- ***http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2017/03/Objektivat-2017.pdf* (Objektivat dhe Prioritetet 2017)**

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
SHKURT 2017

AKTIVITETE NGA DREJTORITË E SHSSH

Kontrollojmë zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe shërbimet e përkujdesit

 # Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK



Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK ka zhvilluar kontroll në Drejtorinë Rajonale të SHSSH Elbasan, dhe Njësinë Administrative Gjocaj. Qellimi i grupit të kontrollit ka qenë verifikimi i punës së bërë mbi zbatimin e legjislacionit të NE, PAK dhe invalidëve të punës për periudhën Janar-Dhjetor 2016. Kontrollet e ushtruara nga SHSSH, në përputhje me legjislacionin synojnë jo vetëm zbatimin korrekt të ligjit nga njësitë vendore në kryerjen e pagesave për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar, por edhe sqarimin e administratorëve shoqëror me qëllim përmirësimin e punës së tyre.

Që prej vitit 2014 SHSSH përmes Drejtorisë së Përgjithshme dhe 12 Drejtorive Rajonale ka kryer kontrolle të plota dhe të përvitshme në çdo njësi të qeverisjes vendore duke mundësuar shmangien e abuzimeve me skemën e ndihmës ekonomike në masën 20% që nga viti 2013 deri në vitin 2016. SHSSH së bashku me Drejtoritë Rajonale bazuar në Planin e Veprimit për vitin 2017 do të vazhdojë të kontrollojnë të gjitha njësitë vendore të Shqipërisë, për të shmangur dëmin ekonomik, për të identifikuar problemet e hasura, dhe për të larguar të gjithë abuzuesit nga skema e përfitimit të NE dhe PAK.

 # Drejtoria e Monitorimit të Shërbimeve Sociale



Tre qendra të përkujdesit social në Bashkinë Korçë u monitoruan nga specialist të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në SHSSH. Monitorimi u fokusua në përmbushjen e standarteve, në ofrimin e shërbimit në secilën prej qendrave. Grupet e monitorimit në përfundim të procesit zhvilluan trainime specifike për stafin e qendrave, duke u fokusuar në çështjet e identifikuara si problematike gjatë monitorimit të kryer. Në fokus ishin çështjet e komunikimit, kodit të sjelljes, të drejtat e përfituesve të bazuara në konventa dhe ndjekja e proçedurave për mbrojtjen e përfituesve nga abuzimi.

Gjatë vitit 2016 janë trajnuar 337 punonjës të qendrave të përkujdesit për fëmijë, aftësi e kufizuar, të moshuar, ndërsa për vitin 2017 janë planifikuar trajnime të tjera për fuqizimin akoma më tej të stafeve të IPSH-ve në bashkëpunim me organizata të ndryshme, partnere të SHSSH.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
SHKURT 2017

NË TERREN

Rrisim kapacitetet e stafeve për t'i bërë reformat cilësisht të zbatueshme

#Trainim mbi përdorimin e Regjistrit Elektronik të Shërbimeve Shoqërore



Në kuadër të modernizimit të shërbimeve shoqërore nisën trajnimet mbi ngritjen e Sistemit të Informacionit për Administrimin e Integruar të Shërbimeve Shoqërore. Gjatë muajit Shkurt u organizuan trainime në të gjithë qarqet e Shqipërisë. Qëllim i këtij trainimi është krijimi i aftësive të nevojshme nga përdoruesit e Regjistrit Elektronik të Shërbimeve Shoqërore. Në këtë sistem do të kenë akses të gjithë aktorët publikë dhe jo publikë të cilët menaxhojnë dhe ofrojnë shërbime sociale për grupet në nevojë.

Në trainimet e zhvilluara kanë marrë pjesë punonjësit social të Drejtorive Rajonale të SHSSH, Administratorët Shoqërorë të Njësive Administrative, përfaqësues të shoqatave të ndryshme, përfaqësues të qendrave të ndryshme ditore ose rezidenciale që ofrojnë shërbime, si edhe përfaqësues të Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve. Këto trainime mundësohen nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, dhe do të zhvillohen në 12 qarqet e Shqipërisë.

#Drejtoritë Rajonale në Durrës dhe Fier trainojnë administratorët shoqëror



Modernizimi i skemës së ndihmës ekonomike eshtë prioritet i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Shërbimit Social Shtetëror. Skema e re e ndihmës ekonomike u pilotua me sukses në qarqet Tiranë, Durrës, Elbasan gjatë vitit 2014-2015, nga viti 2016 ka filluar proçesi për shtrirjen e saj në 9 qarqet e tjera. Në vitin 2016 janë trajnuar 480 administratorë shoqërorë të njësive vendore, dhe stafet e Drejtorive Rajonale të SHSSH mbi përdorimin e sistemit të dixhitalizuar. Në këtë kuadër Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Durrës dhe Fier gjatë muajit shkurt 2017 kanë organizuar takime me administratorët e qarqeve respektive për të diskutuar në lidhje me ndryshimet e reja ligjore për përfitimin e Ndihmës Ekonomike dhe të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
SHKURT 2017

#Drejtoria Rajonale Shkodër përgatitet për arkivën dixhitale të PAK



Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Shkodër gjatë muajit shkurt ka zhvilluar takim me 33 administratorët shoqërorë të njësive administrative të qarkut Shkodër. Qëllimi i këtij takimi ishtë diskutimi mbi proçesin e inventarizimit të dosjeve të PAK në funksion të ngritjes së arkivës dixhitale të aftësisë së kufizuar. Specialistët e Drejtorisë Rajonale të SHSSH Shkodër sqaruan administratorët shoqërorë për të gjitha paqartësitë që kishin sa i përket këtij proçesi që ka filluar në të gjithë Shqipërinë. Modernizimi i skemës së aftësisë së kufizuar është një tjetër prioritet i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Shërbimit Social Shtetëror, për të përmirësuar cilësinë e shërbimit ndaj këtij grupi specifik.

Parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore, prioritet për SHSSH

#Drejtoria Rajonale Korçë

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë në bashkëpunim me organizatën "Tjetër Vizion" dhe Sektorin për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm, organizuan një takim informues me 100 studentë të Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Fan Noli" të Korçës. Qëllimi i takimit ishte shkëmbimi i informacionit me studentët mbi fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore, identifikimin e rasteve dhe rolin qe çdo qytetar duhet të luajë për ta parandaluar atë. Specialistët e SHSSH Korçë ndanë me studentët informacion mbi proçedurat standarte që ndiqen në rastet kur referohet një viktimë e mundshme trafikimi. Drejtoria Rajonale e SHSSH Korçë, si edhe drejtoritë e tjera rajonale në gjithë Shqipërinë janë pjesë e Komiteteve Rajonale të Luftës Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, për identifikimin, referimin, dhe menaxhimin e rasteve të ndryshme që dyshohen si viktima të mundshme të trafikimit. Të gjitha Drejtoritë Rajonale të SHSSH, në Planet e Veprimit për vitin 2017, kanë të parashikuar organizimin e aktiviteteve sensibilizuese për përfshirjen e komunitetit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
SHKURT 2017

 # Drejtoria Rajonale Kukës



Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Kukës në bashkëpunim me organizatën "D&A" ka organizuar një trainim me 15 nxënës të përzgjedhur nga shkolla të Bashkisë Kukës. Qarku Kukës është një ndër 4 qarqet e përzgjedhura për zbatimin e projektit "Fuqizimi i të rinjve për sensibilizimin ndaj luftës kundër trafikimit". Të rinjtë janë trajnuar për përgatitjen e sloganeve, banerave, fletëpalosjeve dhe materialeve identifikuese të grupit të të rinjve.

Gjatë 3 muajve në vazhdim të rinjtë, me mbështetjen e SHSSH Kukës, Prefekturës, Bashkisë Kukës, DAR, do të organizojnë 10 aktivitete sensibilizuese në të gjitha fshatrat e rrethit Kukës. Ky trainim është pjesë e takimeve që SHSSH Kukës organizon në kuadër të aktiviteteve për sensibilizimin dhe përfshirjen e komunitetit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Çdo ditë sjell diçka të re në Shtëpinë e të Moshuarve në Tiranë

Shërbimi Social Shtetëror i konsideron organizatat, shoqatat dhe qytetarë të ndryshëm partnerë në përmbushjen e misionit për mbrojtjen sociale të shtresave në nevojë. Përfaqësues të tyre mbështesin vazhdimisht me aktivitete, donacione qendrat tona të përkujdesit. Në kuadër të përmbushjes së këtij misioni të përbashkët, nxënës të shkollës " 1 Maji", të rinj vullnetarë të Organizatës "IYF" nga Korea e Jugut dhe Medreseja e Tiranës gjatë muajit Shkurt kanë vizituar përfituesit e institucionit. Të rinjtë kanë organizuar aktivitete, shfaqje, lojëra, duke kaluar disa orë në shoqëri me të moshuarit. Solidarizimi me të moshuarit në Shtepinë e të Moshuarve Tiranë, vazhdon çdo muaj, ku organizata, donatorë, grupe të ndryshme vizitojnë qendrën.



Qendra e Formimit Profesional pranë fëmijëve me aftësi të kufizuara



Miqtë e Shërbimit Social vazhdojnë të na mbështesin në përmbushjen e misionit tone në ofrimin e shërbimeve shoqërore për fëmijët me aftësi të kufizuara. Këtë muaj Qendra e Zhvillimit Rezidencial Durrës është vizituar nga nxënës të Qendrës së Formimit Profesional të qytetit. Të rinjtë kanë kaluar disa orë të këndshme nën shoqërinë e përfituesve të qendrës, duke i shoqëruar ata gjatë drekës së shtruar në qendër. Bashkëpunimi me Qendrën e Formimit Profesional është i vazhdueshëm, pasi nuk është hera e parë që nxënësit e vizitojnë Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
MARS 2017

#ImPaktiSocial

 # Konferenca Kombëtare: "ImPakti i Mirëqenies Sociale #Për një shoqëri që siguron shërbime sociale për çdo qytetar"



Në kuadër të reformës së shërbimeve sociale u organizua Konferenca Kombëtare "ImPakti i Mirëqenies Sociale – Për një shoqëri që siguron shërbime sociale për çdo qytetar".

I pranishëm në Konferencën Kombëtare, ishte kryeministri Edi Rama, Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Blendi Klosi, kryetari i Bashkisë, ErionVeliaj, Ministrja e Re e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Olta Xhaçka, drejtues vendor dhe ambasadorët e vendeve mbështetëse të reformës së shërbimeve sociale.

Ky Pakt Social për vitin 2017, ka si objektiv përmbushjen e detyrimeve reciproke nga secila palë (MMSR-Bashki) me në fokus qytetarin. Konkretisht çdo Bashki merr përsipër ngritjen e shërbimeve sociale në funksion të nevojave të grupeve vulnerabël në territorin e bashkisë. Ligji i Ri për Shërbimet Shoqërore vjen si një ligj inovator në fushën e shërbimeve shoqërore, duke përbërë kështu bazën e rregullimeve të saj.

 # Skema e re e Ndihmës Ekonomike në fokus të takimit të Drejtoreshës së Përgjithshme të SHSSH, znj. Etleva Bisha me administratorët shoqërorë të Qarkut Elbasan.

Në kuadër të zbatimit të reformës së Ndihmës Ekonomike dhe ofrimit të shërbimeve shoqërore, Drejtoresha e Pergjithshme e SHSSH, znj.Etleva Bisha ka zhvilluar në Elbasan një takim me 72 administratorët shoqërorë të Qarkut Elbasan.



Ndryshimet ligjore për ndihmën ekonomike, problemet e identifikuara në punën e tyre nga grupet e kontrollit të SHSSH, së bashku me sfidat që ata ndeshin, ishin në qendër të diskutimit me administratorët shoqërorë. Administratorët shoqërorë kanë rol kyç në zbatimin e skëmës së re të NE-së, prandaj fuqizimi i tyre është prioritet i SHSSH.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
MARS 2017

AKTIVITETE NGA DREJTORITË E SHSSH

Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK

Fuqizojmë Drejtoritë Rajonale



Ndërkohë që në 9 qarqet e vendit njesitë vendore po presin aplikimet e qytetarëve për të ngritur rregjistrin elektronik të ndihmës ekonomike, ne vijojmë të përgatisim Drejtoritë Rajonale për të menaxhuar me sukses këtë model të ri që po shtrijmë në të gjithë vendin.

Përgjatë dy ditëve drejtuesit dhe stafi i drejtorive rajonale që do të kenë detyrën e verifikimit të deklarimeve të aplikantëve dhe marrjes së vendimit për përfitimin e ndihmës ekonomike janë ushtruar praktikisht për kryerjen e këtyre dy proçedurave të rëndësishme.

Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Rrisim kapacitetet e stafeve për ti bërë reformat cilësisht të zbatueshme.

Në zbatim të Planit të Veprimit 2017, Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore në SHSSH organizoi trainim me 15 punonjës socialë të Drejtorive Rajonale të SHSSH për monitorimin e Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror.

Në fokus të trainimit ishin realizimi i detyrave funksionale, përfshirja e punonjësve socialë në planet e përkujdesit për fëmijë, si punonjës të pavarur dhe administrues të kërkesave në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror.

Duke pasur si qëllim interesin më të lartë të fëmijëve, pjesmarrësit u trainuan për ndjekjen e proçedurave dhe udhëzuesve për mbrojtjen dhe sigurinë e përfituesve në IPSH.

Për vitin 2017 janë planifikuar trajnime të tjera për fuqizimin akoma me tej të stafeve të IPSH-ve dhe Drejtorive Rajonale në bashkëpunim me organizata të ndryshme, partnere të SHSSH.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
MARS 2017

#Monitorojmë Institucionet e Përkujdesit Shoqëror për të garantuar ofrimin e shërbimeve cilësore.



Në zbatim të Planit të Veprimit 2017, në kuader të monitorimit të IPSH-ve dhe forcimit të kapaciteteve të stafeve, Drejtoria e Sherbimeve Shoqërore në SHSSH gjatë muajit mars ka monitoruar aktivitetin e Shtëpinë e Foshnjes në Durrës, Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës dhe Berat.

Objekti i monitorimeve ishte: vlerësimi i përgjithshëm i shërbimeve të ofruara sipas tipologjive; monitorimi i aktivitetit ditor; kontroll i dokumentacionit të stafit; vlerësimi i frekuentimit të shërbimeve të ofruara.

Pas monitorimeve 2 ditore, specialistët e Drejtorisë së Shërbimeve Shoqërore kanë trajnuar stafet për elementët në punë që duhen përmiresuar. Në fokus të trainimit ishin temat e komunikimi me perfituesit e sherbimeve, kodi i sjelljes, të drejtat e përfituesve të bazuara në konventa dhe ndjekja e proçedurave për mbrojtjen e përfituesve.

NË TERREN

#Shkodër : Mbështesim personat me aftësi të kufizuara

FShDPaK në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, Drejtorinë Rajonale SHSSH Shkodër dhe me mbështetjen e Kishës së Jesu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme zhvilloi trajnimin me 15 administratorë shoqërorë, të 15 njësive administrative të qarkut Shkodër dhe 2 specialistëve të DRSHSSH, në lidhje me shërbimin e ofrimit të karrigeve me rrota. Ky trajnim ofroi për pjesemarrësit njohuri teorike dhe praktike në përputhje me standartet e OBSH për këtë shërbim. Pjesëmarrësit do të çertifikohen për këtë shërbim duke u dhënë mundësinë që në të ardhmen, në njesitë administrative ku punojnë, të jenë ata vlerësuesit e personave me aftësi të kufizuara që kanë nevojë të pajisen me karrige me rrota.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
MARS 2017

#Fier :Fushatë komunikimi me qytetarët për skemën e re të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar.



Në kuadër të informimit të qytetareve për skemen e re të Ndihmës Ekonomike dhe të proçedurave të Komisionimit të Caktimit të Aftesisë për Punë, Drejtoria Rajonale e SHSSH Fier në bashkepunim me Qendrën e Sherbimeve Sociale Italo-Shqipëtare ka zhvilluar në Lushnje aktivitete informuese dhe sensibilizuese mbi kuadrin ligjor të ndihmës ekonomike dhe keshilla mjekësore për njerëzit në nevojë.

Kjo fushatë informimi dhe sensibilizimi do të shtrihet në të gjitha bashkitë e Qarkut Fier, falë bashkëpunimit të SHSSH me organizata partnere që operojnë në mbështetje të njerëzve në nevojë.

#Bashkëpunojmë me njësitë vendore për implementimin e skemave të NE dhe PAK

#Elbasan



Në zbatim të Planit të Veprimit 2017, Drejtoria Rajonale e SHSSH Elbasan ka organizuar një takim me drejtorët e shërbimeve sociale të 7 bashkive të Qarkut Elbasan. Në fokus të takimit ishtë ecuria e Sistemit të NE, reformën e PAK dhe hapat e mëtejshëm në kuadër të hartimit të Planeve Sociale të Bashkive. Me qëllim fuqizimin e administratorëve socialë të Qarkut Elbasan, gjatë muajit Prill janë planifikuar trainime me administratorët për secilën bashki.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
MARS 2017



#Korçë

Në kuadër të implementimit të skemës së re të Ndihmës Ekonomike, Drejtoria Rajonale e SHSSH Korçë ka organizuar një trainim më administratorët shoqërorë të qarkut. Gjatë takimit administratorët u njohën me ndryshimet e reja ligjore dhe udhëzimet përkatëse. Me qëllim zbatimin në kohë dhe cilësi të reformës së NE, takimet dhe trainimet me administratorët do të vazhdojnë çdo muaj.

#Trainojmë stafet e IPSH-ve për të rritur sigurinë në instuticionet tona

Qendra Zhvillimit Rezidencial Durrës bashkë me personelin dhe specialistin z.Fatmir Tare të PMNZSH, finalizoi Trajnimin me Temë: "Masat që nevojiten dhe parandalimi në kohë i zjarrit". Ky bashkëpunim efikas me Policinë e Zjarrefikësve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, krijon mundësinë për rritjen më tej të sigurisë në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror për Personat me Aftësi të Kufizuar.

#Festojmë së bashku në ditën e verës

Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje



Dita e Verës erdhi plot gëzim e diell edhe për banorët e qendrës së viktimave të dhunës në familje. Të gjithë së bashku kaluan një ditë vere festive në kodrat e liqenit të Kasharit. Fëmijët luajtën me top, zhvilluan lojëra me litar si dhe pikturuan. Ky aktivitet solli qetësi, socializim por edhe shume zbavitje për të gjithë.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
MARS 2017

Qendra Polivalente Ditore për të Moshuar- Kamëz



Në ditën e verës nxënësit e Shkollës Profesionale Kamëz kanë vizituar qendrën e Përkujdesit Ditor për të moshuar. Mesueset Elidona dhe Anita të cilat krahas zhvillimit të moduleve që mbeshtesin qendrën rreth sherbimeve që ofrohen, mundesuan një ditë ndryshe për të moshuarit duke festuar me të moshuarit dhe nxënësit

#Shtëpia e Fëmijës "Zyber Hallulli" merr pjesë në Panairin e Punës 2017.

Me qëllim stimulimin e të rinjve, për tu rritur profesionalisht, si sipërmarrës të ardhshëm, si dhe promovimi I aftësive dhe talenteve që ata zotërojnë, Shtëpia e Fëmijës "Zyber Hallulli" ka marrë pjesë në Panairin e Punës 2017 në Pallatin e Kongreseve.



Institucioni u perfaqësua me disa punime si: piktura, varëse të punuara me rruaza, byrzylyqe të punuar me fije plastike dhe rruaza, crafte(kartolina, mbajtëselapsash, piktura, qirinj, etj). Këto punime u prezantuan nga të rinjtë e Shtëpisë së Fëmijës "ZyberHallulli", të cilët kanë ndihmuar në përgatitjen e tyre.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
PRILL 2017

#ImPaktiSocial

 # Informojmë komunitetet për skemën e re të ndihmës ekonomike"



Berat, 22 Prill: Shërbimi Social Shtetëror po zbaton një fushatë komunikimi në të 9 qarqet ku pritet të shtrihet skema e re e ndihmës ekonomike. Synojmë ti informojmë komunitetet për të gjitha proçedurat që duhet të ndjekin për të përfituar ndihmën ekonomike, si dhe për vizionin e ri të lidhjes së kësaj skeme me shërbime të tjera që nxisin fuqizimin e familjeve në nevojë. **"**Qytet më qytet, shtëpi më shtëpi, familje më familje - kështu do të promovohet skema e re e ndihmës ekonomike në të gjithë vendin"- u shpreh Ministrja . Xhaçka në takimin me familje e drejtues vendor në Bashkinë Berat.

Duke folur për ndyshimet ligjore znj. Xhaçka theksoi se "skema synon mbrojtjen e më të varfërit, riintegrimin e qytetarit në nevojë nëpërmjet një skeme aktive për mirëqenien e atyre që sot kanë më shumë nevojë për të". Skema e re e ndihmës ekonomike dyfishon dhe trefishon masën e përfitimit për familjet që kanë marrë ndihmë të pjesshme dhe ndihma e pjesshme nuk do të jetë më. Ndihma e re ekonomike, siguron transparencë dhe ka eleminuar totalisht kriteret përjashtuese për aplikantët. Që prej vitit 2014 ndihmon familjet me pagesë shtesë për çdo fëmijë që ndjek shkollën dhe që vaksinohet.

 # Ministrja Xhaçka në Shtëpinë e të Moshuarve: "Është rradha jonë të kujdesemi për ju"

Ministrja e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë znj. Olta Xhaçka, firmosi Paktin Social për ngritjen e shërbimeve sociale në Bashkitë e Vorës dhe Rrogozhinës. Ministrja Xhaçka tha se Pakti Social nuk është thjesht një marrëveshje, por është një hap drejt më shumë akteve të solidaritetit dhe respektit. Pakti Social për më shumë mirëqenie, u firmos në Shtëpinë e të moshuarve në Tiranë. Kjo ditë, sipas Ministres Xhaçka është një ditë që simbolizon edhe një ditë solidariteti brezash, modeli vullnetarizmi dhe përkujdesje nga të rinjtë, pasi për të moshuarit e kësaj qendre u përkujdesen nxënësit e arsimit profesional për pamjen e tyre dhe drekën e shtruar. Ministrja Xhaçka u tha të moshuarve të kësaj qendre se është rradha jonë të kujdesemi për ju me të njëjtin respekt dhe vendosmëri, siç keni bërë ju për ne, fëmijët tuaj, gjatë të gjithë jetës.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
PRILL 2017

 # Tiranë dhe Durrës, 27-28 prill 2017: Përgatitja e administratorëve shoqëror thelbësore për të rritur cilësinë e shërbimit



Në kuadër të shtrirjes së skemës së re të ndihmës ekonomike, Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH znj. Etleva Bisha ka qenë në Durrës në një diskutim të gjatë me administratorët socialë të këtij qarku. Ndryshimet ligjore për ndihmën ekonomike, problemet e identifikuara në punën e tyre nga grupet e kontrollit të SHSSH, së bashku me sfidat që ata ndeshin, ishin në qendër të diskutimit. Shumë e rëndësishme që çdo familje dhe individ i interesuar për ndihmën ekonomike të jetë i informuar për ndryshimet ligjore. Jo vetëm administratorët dhe stafet e SHSSH por edhe çdo qytetar i informuar mund të ndihmojë në këtë proçes.

 # Bashkëpunojmë me njësitë vendore për implementimin e skemave të NE dhe PAK

#Berat

Në kuadër të informimit të qytetareve për skemen e re të Ndihmës Ekonomike dhe të proçedurave të Komisionimit të Caktimit të Aftesisë për Punë, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Berat ka vijuar takimet informuese mbi shtrirjen e dixhitalizimit të skemës së NE, jo vetëm mbi njohjen dhe zbatimin e detyrave të përcaktuara në ligj, por edhe të kryerjes së këtij proçesi si një ekip me administratorët social, kryepleqte, kryetarët e njësive administrative, punonjësit e kadastrës, punonjësit e zyrës së punës dhe e sekretarit të Keshillave Bashkiakë. Implementimi i skemës së re të NE, kërkon angazhimin e të gjithë aktorëve, pasi proçesi është zinxhir dhe çdo hallkë është e rëndësishme, në mënyrë që ndihma të shkojë realisht tek më të varfërit, por edhe duke nxitur punësimin tek grupmosha aktive për punë.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
PRILL 2017



 # Lezhë

Në kuadër të implementimit të skemës së re të Ndihmës Ekonomike, Drejtoria Rajonale e SHSSH Lezhë ka organizuar një trainim me administratorët shoqërorë të 7 njësive administrative të Bashkisë Mirditë, si edhe të 4 njesive administrative të Bashkisë Kurbin. Gjatë takimit administratorët u njohën me ndryshimet e reja ligjore, udhëzimet përkatëse dhe sfidat e ndeshura gjatë implementimit të skemës se rë të NE. Me qëllim zbatimin në kohë dhe cilësi të reformës së NE, takimet dhe trainimet me administratorët do të vazhdojnë çdo muaj.

NË TERREN

- *Shkodër – Raste Suksesi*

Jetmira, një vajzë 20-vjeçare paraplegjike gjeti mbështetjen e Shërbimit Social Shtetëror Shkodër. Thirrjes së familjes së vajzës për të siguruar një karrocë të re, iu përgjigj Hysniu, babai i një tjetër vajze paraplegjike duke dhuruar një karrocë për Jetmirën. Karroca së bashku më disa ushqime u dërguan pranë familjes Bajrami nga përfaqesues të Shërbimit Social Shtëtëror Shkodër dhe dhuruesit të karrocës. Këtë herë gëzuam Jetmirën por do të vazhdojmë akoma të gëzojmë të tjerë përsona që kanë nevoja për karroca, falë bashkëpunimit jo vetëm me vullnetarët, por edhe me Shoqata dhe Fondacione që SHSSH Shkodër tashmë ka lidhur marreveshje bashkepunimi.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
PRILL 2017

➢ *Vijojnë kontrollet për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe shërbimet e përkujdesit*



Grupi i kontrollit të D.R.SH.S.SH Kukës realizoi kontrollin e zbatimit të legjislacionit të Ndihmës Ekonomike dhe Pagesës së Personave me Aftësi të Kufizuar në Njesinë Administrative Llugaj, Bashkia Tropojë. Kontrollet e ushtruara nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH, në përputhje me planin vjetor synojnë jo vetëm zbatimin korrekt të ligjit nga njësitë vendore në kryerjen e pagesave për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar, por edhe sqarimin e administratorëve shoqëror me qëllim përmirësimin e punës së tyre.

DRITARE: JETA NË QENDRAT E PËRKUJDESIT

➢ *Qendra e Zhvillimit Rezidencial Durrës*

Miqtë e Shërbimit Social vazhdojnë të na mbështesin në përmbushjen e misionit tone në ofrimin e shërbimeve shoqërore për fëmijët me aftësi të veçanta. Në muajin Prill Qendra e Zhvillimit Rezidencial Durrës është vizituar nga të rinjtë e shkollës "Leonik Tomeo". Falë impenjimit dhe dashamirësisë të të rinjve dhe mesueses Etleva Isli, fëmijët me aftësi të veçanta kaluan momente gëzimi dhe argetimi. Kur ka deshirë, vullnet dhe mundësi të gjitha arrihen. Mirenjohës ndaj këtyre të rinjve që kanë cilësi dhe zemër të madhe



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
PRILL 2017



Në përmbushje të standarteve për shërbimet shoqërore, Qendra e Zhvillimit Rezidencial Durrës ka zhvilluar takim me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara që marrin shërbim në këtë qendrës. Në fokus të takimit ishtë forcimi i bashkëpunimit me prindërit, për të ofruar shërbime sa më cilësorë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Gjithashtu në takim u diskutua dhe për sfidat që stafi i qendrës së bashku me prindërit duhët të menaxhojnë së bashku. Në Qendrës e Zhvillimit për PAK durrës, aktualisht përfitojnë shërbim 35 fëmijë me aftësi të kufizuara.

- *Fundjavë ndryshe e fëmijëve të Qendrës Kombëtarë të Trajtimit të Viktimave në Familje.*



Stafi i QKTVF ka organizuar një të dielë ndryshe për fëmijet e qendrës. Me moton "larg telivizonit – më afër realitetit" fëmijët kanë qenë të pranishëm tek Cirku i Tiranës. Për rreth 60 minuta fëmijët kanë shijuar artin, shfaqjet, spektaklin e aktorëve të cirkut. Shërbimi Social Shtëtëror së bashku me institucionet në varësi synon krahas ofrimit të shërbimeve të përkujdesit edhe organizimin e aktivitete social kulturore për përfituesit.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
MAJ 2017

INFORMOJMË QYTETARËT PËR SKEMËN E RE TË NDIHMË EKONOMIKE NË TË GJITHË SHQIPËRINË

#Dibër



Në kuadër të fushatës së informimit të qytetarëve për skemën e re të Ndihmës Ekonomike, Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH Znj.Etleva Bisha, ishtë e pranishmë në Qarkun e Dibrës. Gjatë takimit u shpjeguan ndryshimet ligjore për ndihmën ekonomike, mënyrën e aplikimit, dhe të gjitha risitë që skema e re e NE sjell për qytetarët. Të pranishëm në takim ishin shumë qytetarë që kanë përfituar ndihmë ekonomike me skemën e vjetër, dhe qytetarë që tashmë kanë aplikuar me skemën e rë të NE.

Risia e skëmës së re të NE është se nuk ka kritere përjashtuese për asnjë qytetar që dëshiron të aplikojë, pasi është formula e pikëzimit që përcakton se kush përfiton ndihmë ekonomike. Skema e re e NE është pilotuar në qarqet e Tiranës, Durrësit, Elbasanit, dhe brenda vitit do të shtrihet në 9 qarqet e tjera të Shqipërisë. Fushata e Komunikimit do të vazhdojë në të gjitha qarqet për të informuar sa më shumë qytetarë për skemen e re të NE.

#Pogradec



Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH Znj.Etleva Bisha, ishte e pranishmë në Qarkun e Korçës, në Pogradec në kuadër të fushatës së informimit të qytetarëve për skemën e re të Ndihmës Ekonomike. Znj.Bisha informoi qytetarët dhe administratorët e pranishëm në takim për mënyrën e aplikimit dhe zyra ku duhet të drejtohen për të gjetur mbështetje. Të pranishmit në takim u njohën me risitë që skema e re e NE sjell për qytetarët, si në rritjen e masës së pagesës, ashtu edhe në transparencën sa i përket vendimarrjes dhe shpërndarjes së pagesave të NE.

Aplikimi bëhet tek zyra e administratorit shoqëror në njësinë administrative ku qytetari banon. Administratori shoqëror jep të gjitha sqarimet mbi aplikimin, përsonat përgjegjës për kryerjen dhe verifikimin e aplikimeve, deri tek përsoni që merr vendimin për NE. Fushata e Informimit për skemën e re të NE është kryer nga SHSSH në të gjithë Shqipërinë për ta bërë sa më të zbatueshme.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
MAJ 2017

#Pukë dhe Malësi e Madhe



Drejtoresha e Kontrollit të NE dhe PAK, në Drejtorinë e Përgjithshme Zj.Miranda Pashaj shpjegoi me detaje çdo aspekt mbi mënyrën e aplikimit për të përfituar ndihmën ekonomike me skemen e re elektronike. Familjet e pranishme në takim të interesuar për të aplikuar me skemen e rë shprëhën interes për të ditur më tepër detaje për skemën e re, dhe risitë që kjo skemë sjell për ta.

Skema e re e NE mat më mirë varfërinë duke sjellë dyfishinm deri trefishim të masës së përfitimit të pagesës së NE për familjet dhe qytetarët në nevojë. Një takim i ngjashëm u zhvillua nga Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH, Znj. Etleva Bisha në Malësi të Madhe.



Fuqizojmë kapacitetet e punonjësve socialë në qendrat e përkujdesit

Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me UNAIDS kanë zhvilluar një trajnim me 28 punonjës të institucioneve publike të përkujdesit social.

Ekspertë të fushës ofruan trajnimin mbi "Programin Kombëtar të HIV/AIDS" dhe specifikisht mbi aspektin mjekësor dhe social që shoqëron atë dhe të prekurit. Gjatë trajnimit, me qëllim përmbushjen sa më efiçente të misionit të çdo punonjësi social në institucionet përkatëse të përkujdesit shoqëror, pati prezantime mbi:

- Ndikimin e HIV/AIDS në Shqipëri dhe në Botë,
- HIV/AIDS - Këshillimi dhe Testimi Vullnetar dhe Konfidencial,
- Legjislacionin shqipëtar mbi parandalimin e HIV/AIDS,
- Trajtimin dhe kujdesin ndaj personave që jetojnë me HIV/AIDS,
- Stigma dhe Diskriminimi në lidhje me HIVdhe AIDS,
- E drejta për edukim dhe arsimim e fëmijëve që jetojnë me HIV në Shqipëri.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
MAJ 2017

Për vitin 2017 janë planifikuar trajnime të tjera për fuqizimin akoma me tej të stafeve të IPSH-ve dhe Drejtorive Rajonale në bashkëpunim me organizata të ndryshme, partnere të SHSSH.

NË TERREN

Shërbimi Social Shtetëror mbështet Bashkitë për hartimin e planeve

#Elbasan



Në Elbasan është mbledhur tryeza teknike për Hartimin e Planeve Sociale për Bashkitë e Qarkut Elbasan. Takimi i rradhës ishte në Bashkinë Gramsh, me të ftuar përfaqësues të Institucioneve Publike (Polici, DAR, Dr.Shëndetit) si dhe Jo-publike (OJF, ASED dhe Motrat Vinçensiane). Në këtë takim u vendos ngritja e Grupit të Punës për të hartuar Planin Social të Bashkisë Gramsh. Drejtoria Rajonale SHSSH Elbasan vazhdon të koordinojë punën midis Bashkive dhe Institucioneve të tjera për vijimin e këtij proçesi deri në finalizimin me sukses të Hartimit të Planit Social në Qarkun Elbasan. Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë ka nënshkruar Paktet Sociale me të gjitha Bashkitë e vendit për hartimin e planeve sociale, dhe marrjen e përgjegjesive që u takon secilës palë për të ofruar shërbime sociale për të gjithë familjet dhe qytetarët

#Berat

Në zbatim të Planit të Veprimit 2017 Drejtoria Rajonale SHSSH Berat ka organizuar një takim më drejtuesit e zyrave të shërbimit social pranë bashkive të Qarkut Berat. Në fokus të takimit ishtë ecuria e Sistemit të NE, reforma e PAK dhe hapat e mëtejshëm në kuadër të hartimit të Planeve Sociale të Bashkive. Në takim u diskutua për ofrimin e shërbimeve të integruara ndaj grupeve vulnerable për nxitjen dhe orientimin e strukturave vendore sociale drejt programimit të fondit social vendor shoqëruar me kritere të miratuara në Këshillat Bashkiakë në përputhje me specifikat vendore.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
MAJ 2017

#Kukës



Drejtoria Rajonale e SHSSH Kukës ka zhvilluar kontroll në Bashkinë Tropojë. Qëllimi i grupit të kontrollit ka qenë verifikimi i punës së bërë mbi zbatimin e legjislacionit të NE, PAK dhe invalidëve të punës. Kontrollet e ushtruara nga SHSSH, në përputhje me legjislacionin synojnë jo vetëm zbatimin korrekt të ligjit nga njësitë vendore në kryerjen e pagesave për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar, por edhe sqarimin e administratorëve shoqëror me qëllim përmirësimin e punës së tyre.

#Lezhë

Të rinjtë janë bashkëpunëtorët tanë në luftën anti-trafikim



Drejtoria Rajonale SHSSH Lezhë në bashkëpunim me organizatën "Të ndryshëm dhe të barabartë" kanë organizuar një aktivitet të zgjeruar më DAR Lezhë dhe përfaqësues të institucioneve që janë pjese e tryezës teknike antrafik e ngritur në Prefekturën e Lezhës. Ky aktivitet vjen në kuadër të fuqizimit të të rinjve për të zhvilluar një fushatë anti-trafikim, me pjesmarrjen e vullnetarëve të Drejtorisë Rajonale të SHSSH Lezhë.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
MAJ 2017

#Korçë



FSHDPAK në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, Drejtorinë Rajonale SHSSH Korçë, zhvilloi trajnimin me 15 administratorë shoqërorë, në lidhje me shërbimin e ofrimit të karrigeve me rrota. Ky trajnim ofroi për pjesëmarrësit njohuri teorike dhe praktike në përputhje me standartet e OBSH për këtë shërbim. Pjesëmarrësit do të çertifikohen për këtë shërbim duke u dhënë mundësinë që në të ardhmen, në njesitë administrative ku punojnë, të jenë ata vlerësuesit e personave me aftësi të kufizuara që kanë nevojë të pajisen me karrige me rrota.

Mesazhet që vijnë nga Institucionet e përkujdesit social në Ditën Botërore të Familjes





❖ Qendra e Zhvillimit "Pëllumbat"

Në 15 Maj, në kuadër të Ditës Botërore të Familjes në Qendrën e Zhvillimit "Pëllumbat" u organizua një aktivitet social-kulturor nga stafi i qendrës në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror. E pranishme në aktivitet ishte nën/Drejtoresha e SHSSH, znj.Lida Leskaj, e cila u shpreh se *misioni i SHSSH është fuqizimi i familjes, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve sociale cilësore në 28 Institucionet e Përkujdesit në të gjithë Shqipërinë.* Të ftuar në takim ishin prindër të fëmijëve që marrin shërbime pranë qendrës, të moshuar nga Qendra Ditorë Polivalente Kamëz, nxënës të gjimanzit "Ismail Qemali" dhe nga Liceu Artistik të cilët ndoqën programin artistik të përgatitur për Ditën e Familjes.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
MAJ 2017

❖ *Qendra Zhvillimit Rezidencial, Durrës*



Dita Botërore e Familjes është festuar edhe në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial në Durrës. Nën kujdesin e stafit të institucionit, me mbështetjen e deputetes së Kuvendit të Shqipërisë, znj.Klodiana Spahiu, u organizua një festë me femijët e qendrës, prindër të tyre, të ftuar nga institucione të ndryshme, dhe miq të SHSSH. Në Ditën Botërore të Familjes u përcollën mesazhet se një familje e shëndetshme është baza për një shoqëri të shëndetshme, ndaj nevojitet kontributi i të gjithëve për të fuqizuar familjen shqiptare.

❖ *Shtëpia e të Moshuarve, Tiranë*



Miqtë e Shërbimit Social Shtetëror vazhdojnë të mbështesin institucionet e përkujdesit shoqëror. LEAD Albania 2017, Albania - American Devolopment Foundation gjatë muajit maj ka vizituar Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë, duke sjellë dhurata për të moshuarit e institucionit.

Lead Albania gjithashtu dhuroi disa stola për oborrin e shtëpisë, për të ofruar më tepër komodidet për të moshuarit. Biznesmenë dhe donatorë të ndryshëm janë partnerë të Shërbimit Social Shtetëror në ofrimin me cilësi të shërbimeve shoqërore për familjet dhe individët në nevojë, duke marrë përsipër përgjegjësi sociale.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2017

#Masat e marra nga Shërbimi Social Shtetëror garantuan shmangien e abuzimeve me ndihmë ekonomike gjatë periudhës së fushatës elektorale

Mirëadministrimi i skemës së ndihmës ekonomike në periudhën e fushatës elektorale dhe mos lejimi i përdorimit të fondit të ndihmës ekonomike për qëllime elektorale ishte prioritet i punës së Shërbimit Social Shtetëror për të gjithë periudhën janar-qershor 2017. Përveç kontrollit konstant mbi bazën e planeve të kontrolleve të miratuara për të 12 Drejtoritë Rajonale, më 5 qershor 2017 Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH përmes Urdhërit Nr.116 " Për mirëmenaxhimin e skemës së ndihmës ekonomike" ngarkoi 12 drejtoritë rajonale me detyrën e kontrollit të hyrjeve të reja në skemën e ndihmës ekonomike në muajt maj dhe qershor. Këto të fundit në zbatim të këtij Urdhëri përfunduan brenda datës 20 qershor kontrollin e dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike në të 61 Bashkitë e vendit. Nga kontrolli i 2002 dosjeve hyrje të reja apo rihyrje në skemë të ndihmës ekonomike u konstatuan shkelje të ligjit në përfitimin e ndihmës ekonomike për 135 familje në shkallë vendi. Grupet e kontrollit për çdo shkelje të konstatuar lanë detyrë largimin e familjeve nga skema, si dhe kthimin e fondeve në buxhetin e mbrojtjes sociale. Rikujtojmë se në fushatën elektorale të 2013 u konstatuan shkelje në dhënien e ndihmës ekonomike për 23.000 familje. Drejtoritë rajonale po vijojnë me kontrollet për muajin qershor.

Kontrollohen 49 njësi vendore për zbatimin e legjislacionit për pagesat e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar

Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK ka zhvilluar kontroll në Bashkinë Kamëz. Qëllimi i grupit të kontrollit ka qenë verifikimi i punës së bërë mbi zbatimin e legjislacionit të NE, PAK dhe invalidëve të punës. Nga kontrolli janë konstatuar: 35 familje me pagesa të parregullta me efekt financiar 558.000 lekë, për shkak të mosdeklarimit të pagesës së aftësisë së kufizuar, për të cilat është lënë detyra arkëtimi i shumës. Gjithashtu gjatë rakordimit me postën u konstatua se 56 familje nuk kanë tërhequr pagesa për 3 muaj, si dhe u konstatuan 5 familje me deklarim të rremë gjatë vizitës në shtëpi. Është lënë detyrë largimi nga skema e ndihmës ekonomike për muajin maj-qershor 2017. Për pagesat e aftësisë së kufizuar u konstatua pagesë e parregullt për një individ PAK në vlerën prej 11.510 lekë dhe 1 invalid pune me efekt 3300 lekë.



Buletini Informativ

SHERBIMI SOCIAL

Qershor 2017



Grupi i Kontrollit bëri gjithsej 15 vizita në familje, nga të cilat 3 nuk u gjetën në shtëpi dhe është lënë detyrë t'i kryhet vizita nga administratori shoqëror. Vetëm në një familje kishte mospërputhje me deklarimin duke lënë si detyrë për drejtorinë rajonale refuzimi në muajin qershor për deklarim të rremë.

Për muajin Qershor 2017, Drejoritë Rajonale të SHSSH kanë kontrolluar 47 njësi vendore. Nga kontrollet e ushtruara janë konstatuar 47 familje që kanë përfituar në kundërshtim me aktet ligjore me dëm ekonomik 681.224 lekë, 92 familje janë paguar me tëpër me efekt 457.625 lekë, dhe në total efekti financiar për NE është 1.222. 729 lekë. Lidhur me kontrollin për pagesat e aftësisë së kufizuar janë konstatuar pagesa të parregullta për 40 persona me aftësi të kufizuar me efekt 5.099.848 lekë dhe 1 invalid pune me efekt 406.300 lekë.

Kontrollet e ushtruara nga SHSSH, në përputhje me legjislacionin synojnë jo vetëm zbatimin korrekt të ligjit nga njësitë vendore në kryerjen e pagesave për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar, por edhe sqarimin e administratorëve shoqërorë me qëllim përmirësimin e punës së tyre.

Gjithashtu, Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK gjatë muajit qershor ka kryer kontroll tematik në Bashkinë Peqin në njësitë administrative Peqin, Karinë, Përparim dhe Shezë. Grupi i kontrollit ka verifikuar çdo dosje hyrje të re e rifutje në skemën e NE. U kontrolluan gjithsesj 32 dosje për ligjshmërinë në dokumentacionin e kërkuar nga ku rezultoi se vetëm në 3 dosje mungonte dokumenti i tokës. Gjithashtu për 2 familje, në njërën u gjet procesverbali për refuzim i vizitës në shtëpi dhe tek dosja tjetër për ndarje të qëllimshme është lënë detyrë refuzimi nga skema e NE për muajin qershor.



SHSSH së bashku me Drejtoritë Rajonale bazuar në Planin e Veprimit për vitin 2017 do të vazhdojë të kontrollojnë të gjitha njësitë vendore të Shqipërisë, për të shmangur dëmin ekonomik, për të identifikuar problemet e hasura, dhe për të larguar të gjithë abuzuesit nga skema e përfitimit të NE dhe PAK.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2017

#Jo vetëm monitorim, por edhe mbështetje e stafeve me kapacitete



Në zbatim të Planit të Veprimit për vitin 2017, dhe forcimit të kapaciteteve të stafeve të IPSH-ve, Drejtoria e Shërbimeve Sociale në SHSSH, ka zhvilluar një trajnim me stafin e Shtëpisë së Moshuarve në Shkodër.

Në fokus të trajnimit ishin temat:

- 1-Komunikimi me përfituesit e shërbimeve,
- 2-Kodi i sjelljes,
- 3-Të drejtat e përfituesve,
- 4-Ndjekja e procedurave për mbrojtjen e përfituesve

Për vitin 2017 janë planifikuar trajnime të tjera për fuqizimin akoma me tej të stafeve të IPSH-ve dhe Drejtorive Rajonale në bashkëpunim me organizata të ndryshme, partnere të SHSSH.

#ImPaktiSocial

#Në Kukës

Në zbatim të marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet MMSR dhe Bashkisë Tropojë, vazhdon bashkëpunimi me stafin e Shërbimeve Sociale në këtë Bashki, për hartimin e Planit Social. Drejtoria Rajonale SHSSH Kukës vazhdon të koordinojë punën midis Bashkive dhe Institucioneve të tjera për vijimin e këtij procesi deri në finalizimin me sukses të hartimit të Planit Social në Qarkun Kukës. Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë ka nënshkruar Paktet Sociale me të gjitha Bashkitë e vendit për hartimin e planeve sociale, dhe marrjen e përgjegjesive që u takon secilës palë për të ofruar shërbime sociale për të gjithë familjet dhe qytetarët në nevojë.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2017

#Në Gjirokastër

Drejtoria Rajonale SHSSH Gjirokastër, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale të Bashkisë Gjirokastër, organizuan një takim konsultativ. Tema e diskutimit ishte: Vlerësimi i Nevojave për Kujdesin Shoqëror në Bashkinë Gjirokastër, në kuadër të Hartimit të Planit Social për këtë Bashki. Hartimi i Planit Social, është një proces i rëndësishëm, dhe që mund të realizohet më së miri përmes partneritetit të të gjithë faktorëve lokalë.



#Në Fier



Edhe Drejtoria Rajonale SHSSH Fier në kuadër të hartimit të planeve sociale ka zhvilluar një takim me strukturat e Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike të Bashkisë Fier me fokus vlerësimin e nevojave të përkujdesit shoqëror të planit social. Ky proces gjithashtu siguron një ndërgjegjësim më të mirë rreth nevojave në komunitet në bazë të vlerësimit të nevojave, duke sugjeruar veprime konkrete për të ofruar shërbime më cilësore për komunitetin.

#Rrisim sigurinë në Qendrën Polivalente Ditore Kamëz të përkujdesit social



Qendra Polivalente Ditore Kamëz bashkë me personelin dhe specialistë të PMNZSH, finalizoi Trajnimin me Temë: "Masat që nevojiten dhe parandalimi në kohë të zjarrit". Ky bashkëpunim efikas me Policinë e Zjarrëfikësve të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, krijon mundësinë për rritjen më tej të sigurisë në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror për Personat me Aftësi të Kufizuar. Njohja dhe zbatimi i këtyre rregullave janë të detyrueshme si për personat që frekuentojnë këtë qendër, por edhe për stafin.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2017

#Korçë : Shërbimi për karrike me rrota për personat me aftësi të kufizuara

FShDPaK në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, Drejtorinë Rajonale SHSSH Korçë zhvilloi trajnimin me administratorë shoqërorë, të njësive administrative të qarkut Korçë dhe specialistëve të D.R.SH.S.SH, në lidhje me shërbimin e ofrimit të karrikeve me rrota. Ky trajnim ofroi për pjesëmarrësit njohuri teorike dhe praktike në përputhje me standardet e OBSH për këtë shërbim. Pjesëmarrësit do të certifikohen për këtë shërbim duke u dhënë mundësinë që në të ardhmen, në njësitë administrative ku punojnë, të jenë ata vlerësuesit e personave me aftësi të kufizuara që kanë nevojë të pajisen me karrike me rrota.



#ÇDO DITË DIÇKA TË RE PËR TË MOSHUARIT



Gjatë muajit qershor, me ftesë të drejtuesve të teatrit "Metropol" banorët e Shtëpisë së të Moshuarvë në Tiranë, kanë ndjekur shfaqjen "Fundi i Lojës". Me të ardhurat nga biletat, grupi i artistëve bëri dhurata për të moshuarit, si dhe kaluan një pasdite me ta. Shtëpia e të Moshuarve vizitohet çdo muaj nga grupe të ndryshme për t'u gjendur pranë banorëve, duke u solidarizuar me ta, për t'i bërë të ndihen si në familje. Falenderimet shkojnë për grupin e artistëve, teatrin "Metropol" dhe çdo njeri që gjen kohë për të qendruar pranë të moshuarve.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Korrik 2017

Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK ka ushtruar kontroll në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Njësinë Administrative Proptisht

Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK ka ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Njësinë Administrative Proptisht. Qëllimi i grupit të kontrollit ka qenë verifikimi i punës së bërë mbi zbatimin e legjislacionit të NE, PAK dhe invalidëve të punës. Nga kontrolli në Njësinë Administrative Proptisht janë konstatuar pagesa në kundërshtim me legjislacionin në skemën e ndihmës ekonomike: 11 familje që janë trajtuar me ndihmë ekonomike që kanë gjendjen civile në këtë njësi por nuk banojnë me efekt 32600 lekë dhe 13 familje që janë trajtuar me NE pa marrë konfirmimet nga institucionet me efekt 38600 lekë. Për muajin korrik 2017, Drejtoritë Rajonale kanë kontrolluar 35 njësi vendore. Nga kontrollet e ushtruara janë konstatuar 30 familje që kanë përfituar në kundërshtim me aktet ligjore me dëm ekonomik 50084 lekë, 64 familje paguar më tepër me efekt 280912 lekë. Në total efekti financiar për NE është 330996 lekë. Lidhur me kontrollin për pagesat e aftësisë së kufizuar janë konstatuar pagesa të parregullta për 32 persona me aftësi të kufizuar me efekt 84.860 lekë dhe 16 invalid pune me efekt 55.200 lekë.

#Shkëmbim eksperiencash midis Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror

#Durrës

Në kuadër të shtrirjes së skemës se re të NE, dhe forcimit të kapaciteteve të stafeve, Specialistët e Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shkodër, Lezhë, Vlorë dhe Gjirokastër ishin në Durrës për t'u njohur me proçedurat e sistemit dixhital të Ndihmës Ekonomike. Ky sistem, i cili tashmë ka mbi 3 vite që operon suksesshëm në qarqet pilot Durrës, Tiranë dhe Elbasan, në Shtator do të shtrijë efektet e tij në të gjithë Shqipërinë. Risitë që sjell skema e re e NE kanë të bëjnë si me rritjen e masës së pagesës, ashtu edhe në transparencën për sa i përket vendimarrjes dhe shpërndarjes së pagesave të NE, por edhe me mungesën e kritereve përjashtuese për çdo qytetar që dëshiron të aplikojë, pasi është formula e pikëzimit që përcakton se kush përfiton ndihmë ekonomike. Aplikimi bëhet tek zyra e administratorit shoqëror në njësinë administrative ku qytetari banon.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Korrik 2017

#SHSSH vazhdon mbështetjen për stafet e IPSH-ve

Drejtoria e Shërbimeve Sociale në SHSSH, ka zhvilluar një trajnim me stafin e Qendrës së Zhvillimit Vlorë dhe Lezhë. Qëllimi i trajnimit ka qenë forcimi i kapaciteteve të stafeve të IPSH-ve, në këto 2 Qendra.



Në fokus të trajnimit ishin temat:

- Komunikimi me përfituesit e shërbimeve,
- Kodi i sjelljes,
- Të drejtat e përfituesve,
- Ndjekja e procedurave për mbrojtjen e përfituesve.

Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka planifikuar trajnime të tjera për fuqizimin akoma më tej të stafeve të IPSH-ve dhe Drejtorive Rajonale në bashkëpunim me organizata të ndryshme.

#ImPaktiSocial

#Në Lezhë

Në Bashkinë Kurbin, është mbledhur tryeza teknike për Hartimin e Planeve Sociale për këtë bashki. Në takim morën pjesë përfaqësues të Institucioneve Publike (Polici, DAR, Dr.Shëndetit). Në këtë takim u vendos ngritja e Grupit të Punës për të hartuar Planin Social të Bashkisë Kurbin. Drejtoria Rajonale SHSSH Lezhë, vazhdon të koordinojë punën midis Bashkive dhe Institucioneve të tjera për vijimin e këtij proçesi deri në finalizimin me sukses të Hartimit të Planit Social në Qarkun Lezhë. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Lezhë, në bashkëpunim me Caritas Albania, zhvilluan dialogun social me grupet e interesit për gjithëpërfshirjen e tyre në planin social që po hartohet në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Korrik 2017

#Në Berat

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Berat në bashkëpunim me stafin e Qendrës së Zhvillimit "Unë jam si Ju", ka organizuar tryezën teknike të grupit multidisiplinar. Qëllimi i këtij takimi ishtë përcaktimi i planeve 6-mujore të zhvillimit për përfituesit e kësaj qendre. Gjatë takimit u diskutua për hartimin e planeve të kujdesit social për çdo përfitues në Qendrën e Zhvillimit, duke pasur paraysh interesin më të lartë të fëmijës për zhvillimin psiko-social të tij.



Me mbështetjen e vazhdueshme ligjore dhe profesionale të punonjësve socialë të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Berat, stafi i qendrës po përgatit planet e kujdesit për të ofruar shërbime cilësorë sipas standarteve për përfituesit. Shërbimi Social Shtetëror kryen në vazhdimësi monitorime në Institucionet e Përkujdesit Social, duke ofruar gjithashtu mbështetje për forcimin e kapaciteteve të stafeve të këtyre institucioneve.

#Në Vlorë



Bazuar në këtë marrëveshje, ky rrjet ofrues i shërbimeve do të ketë takime periodike të koordinuara nga Bashkia Vlorë, me synimin për të garantuar që shërbimet për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara, në nivel qarku, të jenë gjithëpërfshirëse, multidisiplinare dhe të bashkërenduara.

Për herë të parë, nën drejtimin e Drejtorive Rajonale të Sherbimit Social Shtetëror, Qarku Vlorë me mbështetjen e Save the Children, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet aktorëvë kryesorë lokal, që ofrojnë shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara në Qarkun e Vlorës.

Institucionet nënshkruese të kësaj marrëveshje janë: Drejtoria Rajonale Arsimore, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë, Zyra Rajonale e Punësimit, Inspektoriati Rajonal i Punës, organizata World Vision në Shqipëri (zyra Vlorë), si dhe qendra e Shërbimeve me Bazë Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara, e ngritur dhe e mbeshtetur nga Save the Children.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Korrik 2017

"Nuk shihet mirë përveç se me zemër"



Falë bashkëpunimit të Qendrës së Zhvillimit Rezidencial Durrës me Shkollën "Beqir Cela", ambjenti i jashtëm i qendrës do jëtë akoma më i bukur. Nxënësti e shkollës të cilët kanë zgjedhur arsimin profesional për të studiuar kanë përgatituar për përfituesit me aftësi të kufizuara të qendrës, stola me ngjyra të ndryshme të vendosur në oborrin e jashtëm.

Miqte e Shërbimit Social Shtetëror janë përhërë pranë përfituesve të shërbimeve sociale në institucione për të kontribuar në ofrimin e shërbimeve sipas standarteve të përcaktuara.

"Nuk shihet mire përveç se me zemer"; ky ishte mesazhi i miqve nga Italia që lyen ambjentet e brendshme te Qendrës së Zhvillimit Rezidencial Durrës.

#Shoqata "Konsujt e Nderit Shqipëri" mbështesin artistët e vegjël të Shtëpisë së Fëmijës "Zyber Hallulli".

Shoqata "Konsujt e Nderit në Shqipëri", në bashkëpunim me Shtëpinë e Fëmijës "Zyber Hallulli" dhe Galerinë Kombëtare të Arteve u kanë dhuruar 20 fëmijëve një kurs 6 mujor pikture. Në këtë kurs pjesmarrës kanë qënë fëmijë të grup-moshave 5-9 vjeç dhe 10-14 vjeç. Qëllimi i këtij programi ka qënë t'i formojë fëmijët për të kuptuar artin figurativ duke u shprehur nëpërmjet tij, duke i pajisur me njohuri për bazën materiale, proceset dhe teknikat, në realizimin e një pune artistike në përshtatje me këtë nivel. Në përfundim të kësaj nisme, punimet e fëmijëve u ekspozuan në një nga ambientet e Galerisë Kombëtare të Arteve.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Gusht-Shtator 2017

Kontrollohen 24 njësi vendore në Gusht dhe 40 në Shtator për zbatimin e legjislacionit për pagesat e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK



Gjatë muajit gusht, Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK në SHSSH ka dërguar raportin e kontrollit për njësinë Proptisht te kryetari i bashkisë Pogradec dhe Prefektit Korçë lidhur me konstatimet dhe detyrat e lëna për këtë njësi. Gjatë kontrollit u konstatuan shkelje në zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike për 11 familje që trajtohen me ndihmë ekonomike që kanë lëvizur vendabanimin me efekt 32.600 lekë dhe për 13 familje me efekt 38.600 lekë, trajtuar pa marrë konfirmimet nga institucionet përgjegjëse.
Masat e propozuara: largimi i 24 familjeve nga skema e ndihmës ekonomike dhe shpërblimi i dëmit dhe vërejtje me shkrim për 2 administratorët shoqërorë të njësisë.

Lidhur me kontrollet e ushtruara janë konstatuar: **88 familje që kanë përfituar në kundërshtim me legjislacionin me efekt financiar 400.392 lekë, 15 përfitues të aftësisë së kufizuar konstatuar me probleme me efekt financiar 285.770 lekë dhe 4 përfitues invalid pune më efekt 63.000 lekë.** Nga raportimi i muajit gusht janë propozuar: 1 gjobë dhe 13 vërejtje me shkrim për administartorët shoqëror.

Gjatë muajit Shtator në zbatim të planit të veprimit për vitin 2017 Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK për muajin shtator ka kryer Kontrolle në Drejtorinë Rajonale Kukës dhe në Bashkinë Has.
Ndërsa Drejtoritë Rajonale kanë kontrolluar 40 njësi vendore.
Nga kontrollet e ushtruara janë konstatuar: **97 familje që kanë përfituar në kundërshtim me aktet ligjore me dëm ekonomik 770.073 lekë, 148 familje të paguar më tepër me efekt 568.892 lekë.**
Në total efekti financiar për NE është 1.338.965 lekë.



Lidhur me kontrollin për pagesat e aftësisë së kufizuar janë konstatuar pagesa të parregullta për 22 persona me aftësi të kufizuar me efekt 488.490 lekë dhe 40 invalid pune me efekt 308.000 lekë.
SHSSH së bashku me Drejtoritë Rajonale bazuar në Planin e Veprimit për vitin 2017 do të vazhdojë të kontrollojnë të gjitha njësitë vendore të Shqipërisë, për të shmangur dëmin ekonomik, për të identifikuar problemet e hasura, dhe për të larguar të gjithë abuzuesit nga skema e përfitimit të NE dhe PAK.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Gusht-Shtator 2017

#Fuqizim të stafeve të Institucioneve të Përkujdesit

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale



Në zbatim të Ligjit 121/2016 " Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror" dhe Planit të Veprimit lidhur me monitorimin në institucionet e përkujdesit shoqëror Drejtoria e Shërbimeve Sociale për muajin Shtator ka realizuar 3 monitorime dhe trajnime me stafet e institucionit të Shtëpisë së Moshuar Tiranë, Shtëpisë së Moshuar Fier, dhe Shtëpia e Fëmijës, Sarandë. Monitorimi u fokusua: në gjetjet dhe problematikat e dala gjatë aktivitetit të tyre ditor dhe në ofrimin e shërbimit për përfituesit. Tematikat kryesore ishin: ndjekja dhe proçedurat për mbrojtjen e përfituesve nga dhuna, respektimi i të drejtave të përfituesve, prezantimi i kodit të sjelljes dhe komunikimi.

Në institucion trajtohen aktualisht 47 të moshuar (19 gra dhe 28 burra). Nga konstatimet rezultoi se 8 përfitues janë me aftësi të kufizuar me KMCAP, për disa përfitues janë nisur proçedurat e daljes për rikomisionim. Për vitin 2017 kanë hyrë në institucion 11 përfitues të rinj.

Shtëpia e të Moshuarve, Fier: Në institucion trajtohen 58 të moshuar, (15 gra dhe 43 burra). Nga konstatimet rezultoi se 5 të moshuar janë me aftësi të kufizuar dhe 10 të moshuar nuk kryejnë vetë-shërbim.

Në Shtëpinë e Fëmijës, Sarandë marrin shërbim 31 fëmijë nga 50 përfitues që është kapaciteti. Në kuadër të deinstitucionalizimit janë transferuar 4 fëmijë, 2 fëmijë kanë kaluar në familje kujdestare dhe 2 fëmijë kanë dalë nga institucioni.



Në çdo institucion funksionon ekipi multidisiplinar për plotësimin e planeve të kujdesit dhe ndjekjen e zbatimit të standardeve. Për vitin 2017 janë planifikuar trajnime të tjera për fuqizimin akoma me tej të stafeve të IPSH-ve dhe Drejtorive Rajonale në bashkëpunim me organizata të ndryshme, partnere të SHSSH.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Gusht-Shtator 2017

NË TERREN

#Mbështetje dhe aktivitete për Fëmijët e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial Durrës



Përfituesit e shërbimeve sociale të Qendrës së Zhvillimit Rezidencial Durrës gjatë muajit gusht kanë vizituar qytetin e Krujës. Kjo vizitë kishte për qëllim njohjen e fëmijëve me historinë dhe me pikat turistike të këtij qyteti. Fëmijët shoqëroheshin nga prindër, personeli i Qendrës së Zhvillimit Rezidencial, vullnetarë të cilët së bashku kaluan një ditë ndryshe jashtë ambjenteve të qendrës. Udhëtimi u mundësua falë mbështetjes të Miqve të Shërbimit Social Shtetëror të cilët janë përhërë pranë përfituesve të shërbimeve sociale në institucione për të kontribuar në ofrimin e shërbimeve sipas standarteve të përcaktuara.

Gjithashtu gjatë muajit shtator, Qendra Rezidenciale Durrës falë bashkëpunimit me "World Vision" dhe Pushtetin Vendor finalizoi një donacion për të përmirësuar kushtet e qendres. Në këtë mënyrë përmirësojmë ndjeshëm ambjentet e klasave të cilët fëmijët me aftësi ndryshe praktikojnë metodat e mësimdhënies dhe zyrat e personelit brenda standarteve të përcaktuara.

#Çdo ditë në mbështetje të të moshuarve

Gjatë muajit gusht Emisioni Investigativ “Stop” në bashkëpunim me Shoqatën Motoristike të Krishterë kanë qenë pranë përfituesve të Shtëpisë së të Moshuarve, Tiranë. Qëllimi i vizitës ishtë dhurimi i disa paisjeve për të moshuarit në mënyrë që të lehtësojë levizjen e tyre. Shtëpia e të Moshuarve vizitohet çdo muaj nga grupe të ndryshme për t’u gjendur pranë banorëve, duke u solidarizuar me ta, për t’i bërë të ndihen si në familje. Falenderimet shkojnë për Emisionin “STOP” dhe Shoqatën Motoristike të Krishterë dhe çdo njeri që gjen kohë për të qendruar pranë të moshuarve.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Gusht-Shtator 2017

#Kukës



Drejtoria Rajonale e SHSSH Kukës ka zhvilluar kontroll në Bashkinë Tropojë. Qëllimi i grupit të kontrollit ka qenë verifikimi i punës së bërë mbi zbatimin e legjislacionit të NE, PAK dhe invalidëve të punës. Kontrollet e ushtruara nga SHSSH, në përputhje me legjislacionin synojnë jo vetëm zbatimin korrekt të ligjit nga njësitë vendore në kryerjen e pagesave për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar, por edhe sqarimin e administratorëve shoqëror me qëllim përmirësimin e punës së tyre.

#Bashkëpunojmë me njësite vendore për ofrimin cilësor të shërbimeve sociale

#Berat

Në zbatim të Planit të Veprimit 2017 dhe forcimit të bashkëpunimit me njësite vendore, u zhvillua takim me njësitë vendore të Qarkut Berat duke nxitur vazhdimisht njësitë vendore të këtij qarku, për zbatimin e ligjit të shërbimeve shoqërore e sidomos për funksionimin e grupeve multidisiplinare, si një mekanizëm vendor i rëndësishëm në parandalimin e rasteve problematike dhe menaxhimin e tyre. Bashkia Skrapar, ka bërë funksional këtë mekanizëm duke bërë bashkë të gjithë aktorët e faktorët e kësaj bashkie. Të gjithë bashkë jemi të vendosur në mbrojtje e mbështetje të grupeve të marxhinalizuara të Qarkut Berat dhe të gjithë Shqipërisë.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2017

#Aktivitete të organizuara nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH në kuadër të Muajit Kundër Trafikimit Të Përsonave



Shërbimi Social Shtetëror në kuadër të Muajit Kundër Trafikimit të Personave në bashkëpunim të ngushtë me Drejtoritë Rajonale të SHSSH, institucionet e tjera të linjës si dhe organizatat jo-qeveritare, ka zhvilluar një plan aktivitetesh në mbarë vendin gjatë muajit tetor, duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit mbi trafikimin e qënieve njerëzore si dhe promovimin e përpjekjeve që janë ndërmarrë nga të gjitha palët e interesuara në këtë fushë. Motot e përdorura në aktivitetet e organizuara ishin të ndyshme si: "Informo! Raporto! Denonco! Shpëto jetë!", "Të parandalosh është më mirë se të kurosh", "Stop trafikimit dhe Po Punësimit" etj. Në 12 qarqet e vendit Drejtoritë Rajonale të SHSSH kanë koordinuar dhe organizuar trajnime, seminare, dëgjesa, marshime, tryeza pune duke u fokusuar kryesisht tek nxënësit e shkollave, dhe aktorët lokalë për të forcuar rolin e secilit në luftën kundër trafikimit të personave.

Shërbimet mbështetëse për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit ofrohen nga të dy aktorët si shtetërore dhe private të cilat plotësojnë njëri-tjetrin për shërbimet e munguara sipas rastit apo me ekspertizë më të lartë në aspekte të caktuara. Gjatë vitit 2016 në Qendrën Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit janë asistuar 30 përfitues, nga këto 20 raste të reja për vitin 2015 dhe 10 raste të mbartura nga viti 2015. Prej të cilave 25 raste janë riintegruar jashtë institucionit. Për vitin 2017 janë trajtuar në qëndër 24 raste si VT/VMT dhe 16 raste janë integruar.



Trafikimi i personave është një krim i rëndë që shkel të drejta dhe liritë themelore të njeriut. Si i tillë, ai nuk mund të luftohet i vetëm. Vetëm strukturat shtetërore nuk mund ta shkulin nga rrënjët këtë fenomen. Duhet angazhim mbarë shoqëror.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2017

Zv/ Drejtoresha e SHSSH Znj. Lida Leskaj merr pjesë në Konferencën Kombëtare #Bashkë Mundemi! #Ndalojmë Trafikimin!

Ministria e Brendshme/Koordinatori Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin dhe Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik, në kuadër të Muajit të Luftës kundër Trafikimit të Personave organizuan sot me 18 Tetor 2017 Konferencën Kombëtare kundër Trafikimit të Personave #BASHKË MUNDEMI! #NDALOJMË TRAFIKIMIN!

Në konferencë mori pjesë Zv/drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH, Znj. Lida Leskaj e cila në fjalën e saj theksoi rëndësinë që ka bashkëpunimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë ndërmjet aktoreve publik dhe jo publik, ndarja e roleve dhe marrja e përgjegjësive përkatëse, për të arritur një qasje efikase dhe të harmonizuar në mbrojtjen e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, për shkatërrimin e skllavërise së re, që grupe të caktuara të krimit kërkojnë të vendosin mbi gra, vajza e fëmijë që ndodhen në situatë vulnerabël.

Gjithashtu ajo nënvizoi se nuk do të kishim sukses në këtë "betejë" pa mbështetjen dhe përfshirjen e të gjithë shoqërisë. Prandaj punonjësit e ShSSh nuk presin muajin tetor por e bëjnë këtë punë çdo ditë të vitit, me çdo individ dhe familje që takojnë, nëpërmjet programeve të mbrojtjes sociale duke ndihmuar individë apo familje për të dalë nga gjendja e vulnerabilitetit, duke synuar të parandalojnë kalimin e gruas vajzës apo fëmijës në viktime trafikimi, apo duke i dhënë atyre mbështetje dhe mbrojtje të specializuar deri në riintegrimin e plotë në shoqëri".



Në aktivitet mbajtën fjalë Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj, Ambasadorja e BE në Shqipëri Romana Vlahutin, Ambasador i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri Bernd Borchardt, Donatella Bradic Drejtuese për Projektet Rajonale të IOM etj.

Roli i SHSSH në trajtimin e VT lidhet jo vetem me identifikimin por edhe me mbrotjen e viktimave.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dhe 12 Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social në 12 Qarqe, janë të përfshirë drejtpërdrejt në proçesin e identifikimit dhe referimit të VT.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2017

#1 Tetori - Dita Botërore e të Moshuarve u festua në të gjitha IPSH-të në vend

Në Ditën Botërore të Moshuarve në të gjitha Shtëpitë e të Moshuarve janë organizuar aktivete të ndryshme për të qenë pranë tyre në ketë ditë, në mirënjohje për kontributin e tyre në shoqëri.

Perfaqësues të Qeverisë, studentë, aktorë të shoqerisë civile iu bashkuan në këtë ditë aktiviteteve me të moshuarit në shtëpitë e të moshuarve.

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Ogerta Manastirliu ishte e pranishme në Shtëpinë e të Moshuarve në Tiranë, e cila drekoi me të moshuarit në këtë ditë të shënuar. Znj. Manastirliu premtoi përmirësim të shërbimeve social-shëndetësore dhe kushteve infrastrukturore të këtyre qendrave në të gjithë vendin.



MShMS ofron shërbime social-shëndetësore në 6 qëndra rezidenciale dhe 2 qëndra ditore, duke u përkujdesur për rreth 340 të moshuar, shërbime këto që menaxhohen nga Shërbimi Social Shtetëror.

Angazhimi ynë i përbashkët në këtë ditë është rritja e shërbimeve komunitare në kuadër të procesit të deinstitucionalizimit, për të rritur cilësinë e jetesës së të moshuarve.

#Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Znj. Ogerta Manastirliu dhe Zv/Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH, Znj. Lida Leskaj vizitojnë Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër

Ministria znj.Ogerta dhe nën drejtoresha e përgjithshme e SHSSH znj.Lida Leskaj vizituan Shtëpinë e të moshuarve Shkodër ku u vu theksi tek përmirësimi i kushteve dhe shërbimit për Moshën e Tretë.

U pa nga afër infrastruktura dhe ndërhyrjet që janë bërë, të cilat i kanë sjellë një transformim rrënjësor këtij institucioni të përkujdesit social.
“Sapo kemi përfunduar pjesën e parë të investimit në Shtëpinë e të Moshuarve këtu në Shkodër dhe do të nisim menjëherë me fazën e dytë të rikonstruksionit të pjesës së mbetur të godinës. Prioriteti ynë do të jenë edhe përmirësimi i shërbimeve të integruara social shëndetësore për moshën e tretë”, u shpreh znj. Manastirliu.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2017

#Fëmijët e Q. K.T.V.DH.F argëtohen në Cirkun Kombëtar të Tiranës



Fëmijët e Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje kanë kaluar një ditë ndryshe në Cirkun Kombëtar të Tiranës. Artistët e cirkut kanë dhënë një shfaqje para fëmijëve të cilet u argëtuan dhe shijuan të gjithë numrat e paraqitur në skenë. Q.K.T.V.DH.F së bashku më Cirkun Kombëtar të Tiranës kanë arritur një marrëveshje bashkëpunimi, duke u mundësuar fëmijëve të qendrës që një të dielë të çdo muaji ata të ndjekin falas shfaqjet e tyre.

#Drejtoria e Kontrollit të Ne dhe PAK

#Kontrollohen 38 njësi vendore në Tetor për zbatimin e legjislacionit për pagesat e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar

Gjatë muajit Tetor, Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK dhe Drejtoritë Rajonale të SHSSH në përputhje me misionin dhe objektivat, kanë kontrolluar 38 njësi vendore në 12 qarqet e vendit. Qëllimi i grupit të kontrollit ka qenë verifikimi i punës së bërë mbi zbatimin e legjislacionit të NE, PAK dhe invalidëve të punës.

Nga kontrollet e ushtruara janë konstatuar 125 familje që kanë përfituar NE në kundërshtim me aktet ligjore me dëm ekonomik 1.331.722 lekë. 42 familje të paguara më tepër me efekt 972.402 lekë. Në total efekti financiar për NE është 1.403.173 lekë.

Lidhur me kontrollin për pagesat e aftësisë së kufizuar janë konstatuar pagesa të parregullta për 26 persona me aftësi të kufizuar me efekt 1.070.575 lekë dhe 28 invalid pune me efekt 190.252 lekë.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2017

#Shkodër – Takim me Administratorët Shoqërorë të Malësisë së Madhe



Gjatë muajit Tetor u realizua një pjesë e planit me takime të Administratorëve Shoqëror. Takimi i radhës u bë me Administratorët Shoqëror të Njësive Administrative të Bashkisë Malësi e Madhe. Në fokus të takimit ishte realizimi i detyrave të lëna, nga njesitë administratrive. Detyra të lëna nga kontrollet e Drejtorisë Rajonale. Në takim u diskutua gjithashtu edhe reforma e aftësisë së kufizuar. Drejtoritë Rajonale të SHSSH zhvillojnë takime periodike me administratorët shoqërorë me qëllim zbatimin korrekt të ligjit nga njësitë vendore në kryerjen e pagesave për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar, por edhe sqarimin e tyre për përmirësimin e punës dhe realizimin e obiektivave të vendosur.

#Durrës – Vazhdojnë kontrollet e pranifikuara në Fushë – Krujë dhe Qendra Ditore e të Moshuarve.

Specialistët e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Durrës vazhduan kontrollet periodike të Ndihmës Ekonomike dhe PAK. Kësaj rradhe në njësinë Administrative Fushë-Krujë. Gjithashtu u monitorua dhe Qendra Ditore e të Moshuarve, Fushë-Krujë. SHSSH së bashku me Drejtoritë Rajonale bazuar në Planin e Veprimit për vitin 2017 do të vazhdojë të kontrollojnë të gjitha njësitë vendore të Shqipërisë, për të shmangur dëmin ekonomik, për të identifikuar problemet e hasura, dhe për të larguar të gjithë abuzuesit nga skema e përfitimit të NE dhe PAK.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Nëntor 2017

Kontrollohen 43 njësi vendore

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK



Gjatë muajit Nëntor, Shërbimi Social Shetëror në zbatim të legjislaconit të ndimës ekonomike dhe aftëisisë së kufizuar, ka kontrolluar 43 njësi vendore.
Gjatë kontrolleve janë konstatuar: 61 famije që kanë përfituar ndihmën ekonomike në kundërshti me legjilsacionin në fuqi me efekt financiar 667.800 dhe 59 familje që janë paguar më tepër se sa masa që i takon sipas strukturës së familjes me efekt financiar 438.419 lek. Lidhur me pagesat e aftësisë së kufizuar janë konstatuar pagesa të parregullta për 30 individ ë PAK me efekt financiar 862.945 lekë dhe 25 invalid pune me efekt 172.700 lek. Grupet e kontrollit të SHSSH kanë propozuar masa për shpërblimin e dëmit dhe kthimin e kësaj shume si për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar në buxhetin e shtetit si dhe masa administrative për personat përgjegjës.

#Drejtoria Rajonale Shërbimit Social, Berat



Informojmë qytetarët e Beratit për skemën e re të ndihmës ekonomike dhe ofrimin e programeve efektive të mbrojtjes sociale.
Drejtoresha e Përgjithshëm e SHSSH, Znj. Luneda Sufali ka zhvilluar në Bashkinë Berat, një bashkëbisedim me qytetarët për t'i informuar ata mbi skemën e re të ndihmës ekonomike.
Në takim merrnin pjesë Prefekti i Qarkut Berat, Z. Harrila Dafa, Nën/Kryetarja e Bashkisë Berat, Znj.Teuta Muçogllava, familje që janë aktualisht në skemën e NE, familje të reja aplikuese, administratorë shoqërorë dhe përfaqësues të shoqatave të ndryshme.

Në këtë takim qytetarët u informuan për risitë dhe lehtësirat që ofron skema e re e NE, në krahasim me skemën e vjetër. Familjet e pranishme në takim bënë pyetje dhe diskutime në lidhje me funksionimin e skemës së re të NE që do të aplikohet.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Nëntor 2017

Ndër risitë kryesore që lidhen me pyetjet e qytetarëve rëndisim:

- ✓ Me skemën e re të Ndihmës Ekonomike nuk ka më kritere përjashtuese, nuk ka më familje të varfëra që për shkak të disa kritereve nuk kishin mundësine e aplikimit.
- ✓ Procedura e aplikimit është e shpejtë dhe kryhet perms sistemit elektronik, ndryshe nga skema e vjetër që aplikimi bëhej me shkrim.
- ✓ Me skemën e re të NE shmangim në maksimum burokracitë, dhe dokumenta me copa letrash pa fund. Aplikohet vetëm me kartën e identitetit dhe dokumentin për pronësinë e tokës për familjet që disponojnë tokë.
- ✓ Sistemi elektronik i ndihmës ekonomike është i lidhur me sistemet elektronike të institucioneve shtetërore dhe mundëson verifikim real të deklarimeve të aplikantëve.
- ✓ Rritet masa e përfimit të ndihmës ekonomike: Me sistemin e vjetër ndihma ekonomike ishte e plotë ose e pjesshme, me sistemin e ri është më e e plotë, dhe masa e pagesës për familjet përfituese është rritur.

Qeveria shqiptare me mbështetjen e Bankës Botërore prej 4 vitesh po piloton skemën e re të ndihmës ekonomike në Tiranë, Durrës dhe Elbasan. Ministria e Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shetëror kanë ndërrmarë një fushatë komunikimi me qytetarët, me qëllim informimin e çdo familje në nevojë për mundësinë e aplikimit për ndihmë ekonomike si dhe ofrimin e programeve efektive të mbrojtjes sociale. Skema e re e NE nga Janari i vitit të ardhshëm do të aplikohet edhe në 9 qarqet e tjera të vendit.

#Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social, Fier



Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social, Fier zhvilloi takimin e radhës me Bashkinë Fier për konsultimin e dy draft VKM-ve që do të dalin në zbatim të ligjit 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ”:

1.Procedurat e referimit dhe menaxhimit të rastit, hartimi e përmbajtja e Planit Individual të Mbrojtjes, financimi i shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimi i masave të mbrojtjes . (Neni 54/5)

2.Funksionimi i grupit teknik ndërsektorial .(Neni 52/6)

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Nëntor 2017

Insitucionet e Përkujdesit Social

Shumë dashuri dhe lajme të mira nga Shtëpia e Foshnjës "Hannah dhe Rozafa". Këtë muaj Arti i vogël mbushi 4 vjeç dhe festuam të gjithë bashkë duke i uruar plot vite të gëzuara.
Ndërsa Vanesa bukuroshja duke filluar nga sot do të ketë familjen e saj të re.
Rasti i suksesit i Vanesës na jep besim të përkushtohemi akoma më shumë për të fuqizuar familjet dhe të gjithë fëmijët të kenë përkujdesjen që meritojnë.

Ne, në SHSSH besojmë se sado mirë të kujdesemi në institucionet tona, asgjë nuk e zëvëndëson familjen.



#Shtëpia e Fëmijës "Hannah dhe Rozafa"



Fuqizojmë stafet e institucioneve të përkujdesit.
Shtëpia e Foshnjës 0-5 vjeç "Hannah dhe Rozafa" në bashkëpunim me Qendrën "Bethany" kanë organizuar një trajnim me stafin e Shtëpisë per përkujdesjen ndaj fëmijeve 3-6 vjeç.
Temat e trajnimit ishin:

- Trajtimi i rasteve emergjente,
- Dhënia e ndihmës së parë,
- Mbrojtja nga infeksionet.

Ky trajnim do të rrisë akoma më tepër kapacitetet profesionale të stafit, duke pasur në fokus interesin më të lartë të fëmijëve. Qendra "Bethany" do të ofrojë një trajnim të ngjashëm me stafin duke pasur në vemëndje fëmijët e moshës 0-3 vjeç.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Nëntor 2017

Rrisim kapacitetet profesionale të stafeve



Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH në bashkëpumim me Organizatën "Terre Des Hommes" në ambientet e Shtëpisë së Fëmijës 6- 15 vjeç " Zyber Hallulli" Tiranë, organizuan trajnimin për stafet e IPSH-ve të Qëndrës Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Trafikimit, Qëndrës Pritëse e Viktimave të Dhunës në Familje, Qëndrës Kombëtare e Emergjencës dhe Shtëpia e Fëmijës 0- 6 vjeç "Hanna dhe Rozafa".

Tema e trajnimit ishte “Terapia e Artit tek fëmijët”.

Objektivat:

- U prezantua Terapia e Artit si një metodë pune në eksplorimim dhe zhvillimin psikologjik tek fëmijët dhe tek të rriturit.
- Fuqizimi i aftësive profesionale të secilit pjesëmarrës përmes njohurive teorike dhe përvojës personale.
- Nxitja e rritjes personale të secilit pjesëmarrës, përfshirë zhvillimin dhe funksionimin brenda grupeve.

#Qëndra Polivalente Ditore Kamëz

Qëndra Polivalente Ditore Kamëz në bashkëpunim me Autoritetin e Shëndetit Publik dhe me Qëndrën Shëndetësore Kamëz kanë kryer vaksinimin kundër gripit, për të moshuarit që vizitojnë çdo ditë qendrën tonë. Specialistët kryen vaksinimin kundër gripit për 30 të moshuarit e Q.P.D Kamëz duke u dhënë këshillat përkatëse, që do i ndihmojë ata për të parandaluar virozat gripale të stinës.
Nga MShMS ofrohen shërbime social-shëndetësore në 6 qëndra rezidenciale dhe 2 qëndra ditore, duke u përkujdesur për rreth 340 të moshuar, shërbime këto që menaxhohen nga Shërbimi Social Shtetëror.
Në qendrën tonë ditore angazhohemi që të moshuarit të kalojnë kohë të mirë nën shoqërinë e njëri tjetrit, duke u socializuar nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme ditore. Specialistët e Q.P.D Kamëz janë përhërë në shërbim të të moshuarve për të gjitha nevojat që ata mund të kenë.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Nëntor 2017

#Shtëpia e Fëmijës "Zyber Hallulli"



100 Vjetori i çeljes së "Strehës së parë Vorfnore" u festua dhe në shtëpinë tonë të madhe së bashku me të gjithë mbështetësit tanë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimin Social Shtetëror mbështet çdo ditë shtëpizën për përballjen e sfidave për interesin më të lartë të fëmijëve.

#Qëndra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit



Qëndra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit zhvilloi një vizitë turistike në qytetin e Beratit "Qyteti i një mbi një dritareve". Gjatë vizitës një rëndësi e veçantë iu kushtua Kalasë dhe Muzeut Ikonografik "Onufri".

#Shtëpia e Të Moshuarve, Tiranë



Në Shtëpinë e të Moshuarve, Tiranë janë paraqitur për të kryer praktikën mësimore 2 studente të degës Administrim Politikash Sociale në Fakultetin e Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës.

Suada dhe Nertila do të monitorohen nga një specialiste e Shtëpisë së Moshuarve gjatë kohës së praktikës, duke pasur një program të përcaktuar, dhe në fund do të bëhet vlerësimi përkatës.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Nëntor 2017

#Qëndra Kombëtare Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje



Festat Komëtare na japin një tjetër dimension të të parit të atëdheut. Qëndra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje bashkë me përfituesit e saj ishin pranë sheshit "Skënderbej" për të parë nga afër këtë atmosferë feste.

NË TERREN

#Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social, Dibër



Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social, Dibër iu bashkua nismës "Të pastrojmë Shqipërinë" . Stafi punoi me përkushtim duke përcjell mesazhin "Bashkë mundemi të mbajm vendin pastër".

#Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social, Korçë



Me rastin e ditës Universale të të drejtave të fëmijëve, Drejtoria Rajonale e SHSSH-së Korçë u bë pjesë e aktivitetit të organizuar nga Bashkia, Korçë. Ky aktivitet mblodhi të gjithë aktorët që kujdesen dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve, në një panel, ku të ftuar ishin edhe fëmijët e shkollave 9-vjeçare, të cilët bënë pyetje lidhur me rolin e çdo institucioni për mbrojtjen e fëmijëve.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Nëntor 2017

#Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social, Shkodër

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Qarku Shkodër ishte e ftuar në takimin e organizuar nga Shkolla 9-vjeçare "Skëndërbej" në bashkëpunim me "World Vision", në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Ky takim u drejtua nga DAR, Shkodër me moton "Gëzo të drejtat pa dhunë". Ky aktivitet filloi dhe mbaroi vetëm me interpretimin e shkëlqyer të fëmijëve të kësaj shkolle, duke na bërë apel ne dhe të gjithë institucioneve për të qënë të përgjegjshëm në Realizimin e të Gjithë të Drejtave të Tyre.



SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH, Znj Luneda Sufali zhvilloi takim pune me drejtorët e Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror

Në fokus të takimit ishin sfidat që këto institucione ndeshin çdo ditë për ofrimin e shërbimeve shoqërore sipas standarteve të përcaktuara.

Znj. Sufali theksoi rëndësinë e bashkëpunimit që drejtuesit e IPSH-ve duhet të kenë me Drejtorinë e Përgjithshme dhe me njëri tjetrin, për ti shërbyer sa më mirë përfituesve që u ofrohen shërbime në këto institucione. Një tjetër pikë me rëndësi që iu diskutua në takim ishte forcimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit me individë, donatorë, institucione të tjera apo organizata të ndryshme për ofrimin dhe plotësimin e nevojave të përfituesve në këto IPSH.



Angazhimi ynë i përbashkët është rritja e shërbimeve komunitare në kuadër të procesit të deinstitucionalizimit, për të rritur cilësinë e jetesës së njerëzve në nevojë, dhe ofrimin e shërbimeve ndaj tyre sipas standarteve të përcaktuara.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Nëntor 2017

Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH, Znj Luneda Sufali takim pune me 12 drejtorët rajonalë të SHSSH



Në fokus të takimit ishin sfidat në vazhdim të SHSSH, shtrirja e skemës së re të Ndihmës Ekonomike në të gjithë Shqipërinë, dhe pilotimi i skemës së aftësisë së kufizuar.
Znj. Sufali duke falenderuar drejtorët për punën e berë nga drejtoritë rajonale, theksoi rëndësinë që ka komunikimi dhe sqarimi i vazhdueshëm i qytetarëve në lidhje me shërbimet që SHSSH ofron.
"Pritja, sqarimi dhe orientimi i çdo qytetari për skemën e re të ndihmës ekonomike, të pagesave të aftësisë së kufizuar apo të çdo informacioni që qytetari kërkon dhe lidhet me misionin e SHSSH, duhet të jetë në fokus të punës suaj të përditshme" – theksoi Znj. Sufali para drejtorëve.
Në fund të takimit 12 drejtorët rajonalë ndanë mendimet dhe sugjerimet e tyre me synim arritjen e objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit për vitin 2017.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2017

Shërbimi Social Shtetëror dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Në 28.12.2017 u festua në 28 IPSH në mbarë vendin. Të gjithë u mobilizuan për të qënë më pranë familjeve dhe individëve në nevojë për t'ua bërë këto ditë festash më të bukura dhe plot solidaritet.

Shërbimi Social Shtetëror bashkë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ishin në bashkëveprim të sinkronizuar si një familje e madhe për të dhuruar dhe për të bërë 28 Dhjetorin një ditë të shënuar për të gjitha Insitucionet e Përkujdesit Social në mbarë vendin. Partnerë dhe donatorë, miq të Shërbimit Social, bënë të mundur mbulimin e kësaj dite feste që nga IPSH-të e fëmijëve e deri tek ato të të moshuarve. Në këto qëndra u dhuruan jo vetëm dhurata, por edhe një solidaritet nga të gjithë personazhet politike dhe qytetarë të thjeshtë.

Festat duan DASHURI!





#VAZHDOJNË TRAJNIMET NE QARQE PËR SHTRIRJEN E SISTEMIT TË NE

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK



Gjatë muajit Dhjetor, në të gjitha qarqet u mbajtën takime me të gjithë aktorët e pushtetit vendor lidhur me fushatën e informimit pë sistemin e ri të NE.

Në këto takime, fokusi kryesor iu kushtua përditësimit të të dhënave të aplikimeve në Skemën e re të Ndihmës Ekonomike që do të kryhet nga administratorët, me të gjithë familjet që kanë ndryshime në të dhënat e tyre ekonomiko-sociale. Kjo fushatë u mbajt nga drejtorët rajonalë duke qënë se ata janë hallka kyçe për implementimin e kësaj skeme në Janar 2018.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2017

#Drejtoria Rajonale, Kukës



U bë trajnimi me Administratorët Social të Njësive Administrative të Qarkut Kukës.

Në këtë takim, fokusi kryesor ishte përditësimi i të dhënave për aplikimet në Skemen e Re të Ndihmës Ekonomike e cila pritet të implementohet në mbarë vendin në muajin Janar 2018.

#Muaji dhjetor i përket edhe sensibilizimit kundër Dhunës



Në ditën e të drejtave të njeriut, në strehëzën Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje u mbajt aktiviteti sensibilizues për të drejtat e këtyre "viktimave". E drejtë parësore është liria, fuqia e grave që ja kanë dalë t'a mposhtin dhunën në familje e të krijojnë një jetë të re. Kjo strehëz është shpresë për të gjitha ato gra që ende kanë vështirësi të integrohen, por e kanë bërë hapin e parë të guximshëm duke u shkëputur nga dhuna. Në strehëzën kombëtare të viktimave të dhunës gra e vajza kanë mbështetjen dhe mundësitë që të rindërtojnë të ardhmen e tyre.

#Qëndra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit



Në Qëndrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit u festuan Krishtlindjet. Donatorët dhe miqtë mundësuan këtë festë për të bërë këtë ditë sa më të bukur. Falenderojmë për mbështetjen financiare të AAPSK-së (Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara).

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2017

#3 Dhjetori, Dita Botërore e Personave me Aftësi të Kufizuar Qëndra e Zhvillimit "Pëllumbat"



U festua si çdo vit, çdo 3 Dhjetor, dita Botërore e Personave me Aftësi të Kufizuar. Këta persona nuk kanë asgjë ndryshe nga pjesa tjetër e njerëzve. Ata gëzojnë të drejta të barabarta.

Me fëmijët e Qëndrës tonë, ne e festuam këtë ditë të shënuar.

NË TERREN

#Jemi aty ku janë njerëzit në nevojë

#Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social, Lezhë



Ky muaj shënoi dhe vazhdimësinë e bashkëpunimit të SHSSH me organizatat jo qeveritare për t'u ardhur në ndihmë familjeve në nevojë. Drejtoria Rajonale SHSSH Lezhë, bashkë me World Vision shpërndanë pako me ushqime në disa familje në Lezhë dhe njësinë Administrative Shënkoll. Drejtoritë Rajonale të SHSSH në të gjithë Shqipërinë bashkëpunuan me organizata, partnerë, donatorë të ndryshëm për t'u ardhur në ndihmë familjeve në nevojë të prekura nga rreshjet e para disa ditëve, dhe që janë në skemën e ndihmës ekonomike.

#Drejtoria Rajonale Shërbimit Social, Berat



Gjatë ditëve me shi dhe pas përmbytjeve të disa zonave në Berat, Drejtoria Rajonale e Qarkut Berat, së bashku me sektorin social pranë Bashkisë Berat shkuan në çdo familje të dëmtuar nga përmbytjet pranë zonave të ndryshme të Beratit, duke dhuruar paketa ushqimore të grumbulluara nga Shërbimi Sociali Shtetëror i këtij Qarku.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Janar 2018

Zhvillohet analiza vjetore për 12 Drejtoritë Rajonale të SHSSH
Arritjet e vitit 2017 dhe sfidat

Me përgjegjësi për sukseset, arritjet por dhe mangësitë e konstatuara, kjo ishte fryma e Analizës Vjetore e ShSSh për vitin 2017. E veçanta e analizës së këtij viti është se të 12 Drejtoritë Rajonale prezantuan arritjet konkrete në zbatimin e skemave të mbrojtjes sociale dhe punën për plotësimin e objektivave të institucionit në përputhje me prioritetet strategjike të SHSSH për mbrojtjen sociale të shtresave dhe individëve në nevojë.

Analiza mbi bazën e treguesve dhe fakteve u përqëndrua në zbatimin e objektivave të vitit 2017, sfidat e ndeshura në zbatimin e programve të NE, PAK dhe Shëbimet në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror.

Objektivat konkrete të punës për vitin 2018 u bënë objekti kryesor i debateve dhe diskutimeve për drejtuesit e Drejtorive Rajonale. Lidhur me këto objektiva dhe punën që duhet bërë për realizimin e Programit të Mbrojtjes Sociale, përmirësimin që duhen bërë në fushën e menaxhimit, administrimit të skemave dhe sidomos të sjelljes dhe etikës së komunikimit me njerëzit në nevojë, foli Drejtori i Përgjithshëm i ShSSh znj Luneda Sufali.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Janar 2018

VAZHDOJNE TRAJNIMET PER SHTRIRJEN E SISTEMIT TE RI TE NDIHMES EKONOMIKE NE QARQE TE NDRYSHME

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK, SHSSH

Skema e re e NE e pilotuar me sukses në Tiranë, Durrës, Elbasan, që nga muaji Janar 2018 po shtrihet pas procesit të pilotimit në Qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit edhe në 9 Qarqet e tjera të vendit. Në këtë kuadër është bërë gjithçka dhe janë përgatitur kapacitetet e duhura që duhen për verifikuesit dhe IT në Drejtoritë Rajonale. Ata kanë marrë trajnimin e radhës për ta zbatuar me sukses skemën e re të NE. Me skemën e re:

- Më pak dokumenta për aplikim,
- Targetim më i mirë i varfërisë,
- Transparencë maksimale,
- Kritje e masës së përfitimit,
- Riintegrim.

 # Drejtoria Rajonale e Sherbimit Social Shtetëror, Berat

Drejtoria Rajonale e Sherbimit Social Shtetëror Berat, duke vleresuar rolin e Keshillit Bashkiak, si një hallkë shumë e rëndësishme në proçesin e vendimarrjes për ecurinë e reformës së ndihmës ekonomike, ndjek nga afër çdo mbledhje të këshillave bashkiakë të Qarkut Berat. Qëllimi është forcimi i bashkëpunimit si kusht për të patur sukses në zbatimin e kërkesave të reja të Reformës së NE-së. Bashkëpunimi i DRSHSH dhe Bashkisë Berat jo vetëm synon informimin për kërkesat e ligjit të NE, por edhe ndërgjegjësimin për rolin e rëndësishëm që ata kanë në vendimarrjen në kohë, verifikimit të listës së aplikantëve, si dhe të përcaktimit të kritereve të familjeve të varfëra që do të përfitojnë nga 6% i blloknd ihmës.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Janar 2018

#Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social, Lezhë



Drejtoria Rajonale e Lezhës, në kuadër të bashkëpunimit me aktorë e faktorë komplementarë rajonalë organizoi një veprimtari të përbashkët me të gjithë aktorët social që veprojnë në Qarkun e Lezhës. Qëllimi i takimit dhe objektivi i debateve dhe diskutimeve ishte njohja e situatës sociale dhe problematikave të grupeve të pafavorizuara dhe njerëzve në nevojë. Në këtë kontekst stafi i Drejtorisë Rajonale të ShSSh Lezhë informoi në mënyrë të detajuar dhe me kompetencë profesionale aktorët mbi ndryshimet e reja të standarteve dhe Shërbimeve Shoqërore. Në takim u diskutua mbi problematikat e hasura gjatë vitit 2017, dhe në përfundim dolëm me rekomandime për mbarëvajtjen e punës për vitin 2018. Një model shumë i mirë i bashkëpunimit dhe përcaktimit të roleve dhe ndarjes së përgjegjësive sociale në nivel Qarku.

#Për forcimin e standarteve dhe cilësisë së shërbimeve

Sipas planit të veprimit Drejtorisë Rajonale të ShSSh të Qarkut Elbasan, ka realizuar procesin e monitorimit dhe verifikimin e cilësisë dhe standarteve të shërbimit të ofruar në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror "Misionaret e Bamirësisë, Motrat e Nënë Terezës dhe Qendra Publike Sociale "Balashe". Gjatë këtyre monitorimeve u vëzhguan nga afër përfituesit e kategorsë fëmijë, të rinj me AK dhe të moshuar, si dhe u punua për Planet Individuale të Zhvillmit të tyre. Pjesë e këtij monitorimi ishte dhe inspektimi i Kutisë së Ankesave, si një ndër standardet e parashikuara nga legjislacioni në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve për IPSH-të



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Janar 2018

#Bashkëpunime të frytshme



Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Berat, së bashku me stafin e Qendrës Rezidenciale e ditore "Lira" Berat, organizuan mbledhjen e tryezës teknike të grupit multidisiplinar, për përcaktimin e kërkesave të përmirësuara të "Planeve Individuale" 6-mujore të kujdesit për përfituesit rezidencial. Qëllimi është vlerësimi sa më i personalizuar i nevojave, kërkesave dhe ndërhyrjeve individuale për të përmirësuar punën dhe treguesit e zhvillimit individual. Mbi këtë bazë u realizua një punë e detajuar, me vlerësime të diferencuara për secilin rast, duke përcaktuar objektiva spicifikë për zhvillimin e çdo fëmije.

INSITIUCIONET E PËRKUJDESIT SOCIAL

#Krijimtari e aktivitete në Qëndrën Kombëtare të Viktimave të Trafikimit



Veprimtaria e QKPVT është vazhdimisht duke u dinamizuar dhe po bëhet më e larmishme. Trajtimi i personave me qëndrim të përkohshëm gjithnjë e më tepër po i shmanget kornizave të ngushta të rezidencializmit pasiv. Në këtë kontekst u zhvillua një aktivitet krijues me punime artistike. Një risi kjo në aktivitetet që zhvillohen në këtë qëndër sociale. Synimi ishte që të zhvillohej një veprimtari që është në funksion të zhvillimit të imagjinatës artistike. E veçanta e këtij aktiviteti të rradhës ishte se punimet që u drejtuan me asistimin e mësueses së artit, u realizuan me produkte ushqimore (Oriz dhe Makarona). Ky aktivitet dhe publikimi i tij u mundësua me mbështetjen financiare të AAPSK-së. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Janar 2018

#Histori Jete

Kështu i quajnë banorët e Qëndrës Ditore Polivalente në Kamëz aktivitetet që zhvillojnë për të festuar ditëlindjen e cilitdo prej të moshuarve të kësaj qëndre sociale. Para ca ditësh aty u festuan ditëlindjet e tre banorëve, të kësaj "shtëpize e vogël" por me zemër të madhe.

"Histori jete" janë ditë të shënuara që sjellin kënaqësi të veçanta për banorët e shtëpisë ditore. Muaji janar në këtë qëndër sociale filloi me këto aktivitete jashtë ambienteve të institucionit. Ky aktivitet u mundesua nga Deputeti Z. Manja dhe Z. Genti pronar restorantit, duke dhuruar buzeqeshje në këtë ditë urimi per Aliun, Lemen dhe Saliun.



FESTOJME SE BASHKU

#E gëzofsh ditëlindjen Ili!



Është bërë traditë poztive në Qëndrën e Zhvillimit "Pëllumbat" festimi i ditlindjëve të fëmijëve. Një ritual që fëmijët e presin me kënaqësi dhe emocion. Ditët e fundit aty u festua ditëlindja e Ilit. Një atmosferë e gëzuar që u zhvillua përmes lojrave të bukura, muzikës së gëzuar fëminore. Doemos që nuk mund të mungonin në këtë festë të Ilit edhe dhuratat. Këto festa janë raste për më shumë buzëqeshje dhe gëzimi që shfaqet në sytë e ktyre fëmijëve.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2018

#12 Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së Prezantojnë Analizën Vjetore të Punës për Vitin 2017

Drejtoritë Rajonale kanë prezantuar Analizën Vjetore të Punës së institucionit në përputhje me prioritetet strategjike të SHSSH-së dhe MSHMS-së në fushën e mbrojtjes sociale. Konkretisht:



- Objektivat vjetorë
- Arritjet sipas sektorëve (NE, PAK, Shërbime Sociale)
- Sfidat e ndeshura gjatë vitit 2017
- Objektivat për vitin 2018
- Sugjerime për përmirësimin akoma më tej të punës

Të pranishëm në prezantimin e analizave ishin Drejtori i Përgjithshëm Luneda Sufali, dhe drejtorët e drejtorive në SHSSH. Të tjera sfida na presin, por jemi te vendosur të jemi pranë njerëzve në nevojë.

#Zbatimi me sukses i skemës së re të Ndihmës Ekonomike në fokus të 12 Drejtorive Rajonale të SHSSH



Kanë vazhduar edhe gjatë muajit shkurt kontrollet sistematike për 12 Qarqet lidhur me sistemin e ri të NE që po zbatohet**.** Po bëhen Verifikimet Elektronike të të dhënave, për të konfirmuar, vërtetësinë e deklarimeve të qytetarëve gjatë proçesit të Aplikimeve. Skema e re e Ndihmës Ekonomike:

- ✓ Targeton më mirë më të varfërit,
- ✓ Shmang abuzuesit,
- ✓ Lehtësi në aplikim,
- ✓ Nuk ka kritere përjashtuese në aplikim,
- ✓ Mundësi reale për punësim.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2018

#Lehtësira për personat me aftësi të kufizuara. Me ndryshimet e reja vendimi i KMCAP-ve u shkon në shtëpi.



Reforma e Qeverisë Shqiptare për të lehtësuar qytetarët nga burokracitë në zyrat e administrates ka ndryshuar mënyrën e funksionimit të Komisioneve Mjeksore të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Me ndryshimet e reja, asnjë person me aftësi të kufizuara nuk do të paraqitet pranë ambjenteve ku zhvillohen KMCAP. Ndryshe nga sa ndodhte më parë, vendimi do të merret nga komisioni bazuar në dokumentacionin e dosjes dhe përgjigjia i dërgohet qytetarit në shtëpi nga administrator shoqëror në njësinë vendore ku banon.

Bazuar në VKM 813 datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 618 datë 07.09.2006 "Për përcaktimin e kritereve, dokumentave dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar" si dhe Urdhërin Nr.47, datë 11.01.2018 për Miratimin e Rregullores "Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e komisionit mjekësor të caktimit të aftësisë për punë për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe komisionit mjekësor të përcaktimit të verbërisë", Kapitulli III/1. Rregullat e drejtimit, mënyra e shqyrtimit dhe marrja e vendimit në KMCAP, saktësohet se:

Kur qytetari paraqitet për here të pare për vlerësim ose rivlerësim të aftësisë për punë, mjeku specialist plotëson saktë, qartë dhe me përgjegjësi "Fleta e Drejtimit për në KMCAP" dhe "Epikrizën Përcjellëse" për rastet e rivlerësimit të cilave u bashkëngjiten të dhënat e ID së personit, dhe ekzaminime, që janë të domosdoshme për evidentimin e plotë të gjendjes shëndetësore të qytetarit

Pra siç shpjegohet më sipër, qytetari që aplikon për herë të parë për përfitimin e pagesës për aftësi të kufizuar, paraqitet vetëm tek mjeku specialist në spital, dhe më pas merr në banesë vendimin final të KMCAP-it.

Kur vlerësimi bëhet për here të parë, dosja shqytrohet brenda 30 ditëve nga KMCAP-i, ndërsa kur bëhet rivlerësim, dosja duhet të partaqitet nga administrator shoqëror në Drejtorinë Rajonale të SHSSH dy muaj para përfundimit të afatit të vendimit të fundit.

Me këtë ndryshim në Rregullore qytetarët nuk do të sorollaten më zyrave të shtetit dhe nga ana tjetër do të shmangen në maksimum mundësitë për korrupsion.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2018

#BASHKËPUNOJMË PËR TË LUFTUAR TRAFIKUN E QENIEVE NJERËZORE.



Drejtoria Rajonale e SHSSH Shkodër ka marrë pjesë në takimin e Komitetit Rajonal Anti-Trafik në Prefekturën e Shkodrës. KRAT Shkodër ka zhvilluar një takim pune me përfaqësues të Departamentit Ndërkombëtar, Kundër Trafikimit të Qënieve Njerezore në Mbretërinë e Bashkuar, që kanë një mision Britanik në Shqipëri. Në fokus të takimit ishte forcimi i bashkëpunimit mes anëtarëve të KRAT me partnerët ndërkombëtarë për të parandaluar trafikimin e paligjshëm dhe emigrimin e pakontrolluar. D.R SHSSH Shkodër si pjesë e KRAT shpjegoi rolin e saj në këtë komitetit, arritjet dhe sugjerime për përmirësimin e punës në luftën e përbashkët kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

#SHTËPIA E TË MOSHUARVE TIRANË ËSHTË E MBUSHUR ÇDO DITË ME DASHURI

Gjatë muajit Shkurt Shtëpia e të Moshuarve Tiranë është vizituar nga shumë të rinj. Vizitorët e rradhës kanë qenë nxënësit e shkollës “Aleks Buda”. Ata zgjodhën të kalojnë fundjavën me të moshuarit e qëndrës sonë duke diskutuar me ta lidhur me tematika të ndryshme, dhe duke marrë në shkëmbim këshillat e gjyshërve tanë.

Të rinjtë e kësaj shkolle na premtuan se do të vijnë përsëri në Shtëpinë tonë.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2018

Endërr e bërë realitet: Të moshuarit marrin pjesë në sfidën "100 milion" në Top Channel



Dy të moshuar, banorë të Shtëpisë të të Moshuarve Tiranë morën pjesë në një nga edicionet e sfidës "100 Milion" në televizionin Top Channel. Në një atmosferë mjaft të ngrohtë dy të moshuarit iu përgjigjën të gjitha pyetjeve të moderatorit Eno Popi, duke marrë dhe duatrokitjet e publikut. Kush guxon edhe fiton. Dy të moshuarit na bënë krenar duke i shkuar deri në fund sfidës duke fituar shumën prej 5 milion lekë (të vjetër).

Shtëpia e të Moshuarve Tiranë është një nga institucionet model të SHSSH dhe është në fokusin e qytetarëve që e vizitojnë çdo ditë, donatorëve që e mbështesin. Të moshuarit duan dashuri.

Të moshuarit vazhdojnë të punojnë për të ardhmen tonë. 10 pemë të mbjellura te Liqeni Artificial.



Të moshuarit e Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë së bashku me Kryetarin e Bashkisë, Erion Veliaj kanë mbjellë 10 pemë mimozash te Liqeni Artificial. Ata që punuan dëri në pleqëri për të ardhmen tonë, vazhdojnë të përcjellin mesazhin se nuk ka rëndësi mosha për të vazhduar të kontribuosh në zhvillimin e vendit tënd. Të moshuarit e Shtëpisë më të famshme të të Moshuarve në Shqipëri organizon çdo muaj aktiviete social kulturore dhe sensibilizuese duke u bërë shembull pozitiv për brezat e rinj.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2018

Informojmë qytetarët për Ndihmën Ekonomike

Gjatë muajit Mars, Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH, Znj. Luneda Sufali ka marrë pjesë në një takim pune me administratorët shoqërorë të bashkive të Qarkut Kukës.

Në fokus të takimit ishte implementimi i skemës së re të ndihmës ekonomike, që ka filluar shtrirjen në gjithë Shqipërinë, pasi është pilotuar me sukses në qarqet Tiranë, Durrës dhe Elbasan.

Në takim u diskutua për:
- Orientimin dhe informimin e qytetarëve për të aplikuar në mënyrën e duhur,
- Plotësimi i saktë i formularëve të aplikimit,
- Përdorimi i duhur i fondit 6% të ndihmës ekonomike nga bashkitë,
- Bashkëpunimi me Zyrat e Punës për fuqizimin e familjeve që marrin NE.

Në takim merrnin pjesë Prefekti i Qarkut Kukës, Z. Zenel Kuçana, Drejtoresha e Kontrollit të NE dhe PAK, Znj. Miranda Pashaj, Drejtoria Rajonale SHSSH, Kukës dhe administratorë shoqërorë të qarkut Kukës.

Skema e re e ndihmës ekonomike targeton më mirë varfërinë, dhe shmang në maksimum abuzuesit. SHSSH do të vazhdojë takimet me Drejtoritë Rajonale dhe administratorët shoqërorë që skema e re e NE të zbatohet me sukses, familjet më të varfëra të përfitojnë NE dhe abuzuesit të dalin nga skema.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2018

KUSHDO QË ABUZON ME LIGJIN, DUHET TË MBAJË PËRGJEGJËSI PENALE.

Falë bashkëpunimit me mediat dhe qytetarët ky mision realizohet me shpejt dhe më mirë.

Ndaj jeni të mirëpritur për të referuar çdo rast abuzimi që dyshoni. Drejtoresha e Shërbimit Social të Tiranës, Luneda Sufali u shpreh se pas denoncimit të emisionit "Stop", Shërbimi Social Shtetëror zhvilloi një audit, nga ku rezultoi se ishin përfshirë edhe 5 administratorë të tjerë në abuzim.

"Shërbimi social ngriti grupin e auditit dhe vëzhgoi komplet familjen Qema. Në këtë situatë nuk është përfshirë vetëm një administratore, zonja Dhurata Çali, por janë përfshirë edhe 5 administratorë të tjerë. Sipas VKM-së, numër 955, të vitit 2016, anëtari madhor i familjes është i detyruar të paraqitet për të plotësuar deklaratën 3-mujore të ndryshimit social ekonomik. Kjo deklaratë është hedhur në sistemin e regjistrit elektronik të ndihmës ekonomike nga 6 administratorë: Sinan Çerpja, Rilinda Dauti, Luan Xhika dhe kryesisht peshën më të madhe e mban Dhurata Çali, Alltana Dura dhe Esmeralda Troçi". Drejtoresha Sufali deklaroi se institucioni që drejton ka bërë kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor për të gjashtë administratorët e rastit abuziv të ndihmës ekonomike dhe se gjithashtu Rabie Mema, administratorja që ka tërhequr çdo muaj pagesën e ndihmës ekonomike për familjen Qema, duhet të kthejë dëmin financiar të shkaktuar nga ky abuzim, me vlerën e 228,960 lekë të reja. SHSSH do të punojë çdo ditë për të larguar abuzuesit nga përfitimi i ndihmës ekonomike, dhe për t'u siguruar që më të varfërit ta përfitojnë atë.

#Drejtoria e Kontrollit NE dhe PAK

Gjatë muajit Mars në Drejtorinë e Përgjithshme u mbajt takim me 12 Drejtoritë Rajonale. Ky takim u organizua me qëllim punësimin e anëtarëve të familjeve që janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike dhe të familjeve që janë ende pjesë e skemës. Ky bashkëpunim vjen dhe në saj të mbështetjes së vazhdueshme që kemi dhe me zyrat e punësimit.
Në takim kanë marrë pjesë 12 drejtorët rajonalë të SHSSH, Drejtoria e NE dhe Pak si dhe Drejtoresha e Përgjithshme.

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale

#SfidatgjatëMenaxhimit

Nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale janë realizuar për muajin Mars 9 sistemime fëmijësh në IPSH. Janë pranuar 4 të moshuar në IPSH dhe 2 të moshuar janë transferuar. Janë rinovuar 32 statuse jetimi. Gjithashtu janë realizuar 25 vlerësime për fëmijët e pashoqëruar, janë rikthyer 6 fëmijë të pashoqëruar dhe 3 raste VT/VMT, lajm i mirë mbetet fakti që për muajin Mars kemi 20 raste të menaxhuara me sukses.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2018

#8 Marsi Dita Ndërkombëtare e Gruas



Nuk kishte si të mungonte mesazhi i Shërbimit Social Shtetëror dhe ditën e 8 Marsit ku Drejtoresha e SHSSH, Luneda Sufali ka uruar Ditën Ndërkombëtare të Gruas nga Qëndra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit.

Në fokus të fjalës së saj ishte fuqizimi i grave dhe vajzave për një jetë të pavarur ku çdo njëra vendos me vullnet të lirë për veten.
Drejtoresha Sufali theksoi se mbështetja e SHSSH për të gjitha gratë dhe vajzat dhe kryesisht për viktimat e trafikimit do të jetë e vazhdueshme, deri në integrimin e tyre të plotë në shoqëri, nëpërmjet programeve të mbeshtetjes pë edukim, formim profesional dhe punësim.

#DITA BOTËRORE E SHËNDETIT ORAL

Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me Klinikën Stomatologjike Universitare dhe Fakultetin e Mjekësisë Dentare, organizuan një aktivitet sensibilizues tek Shtëpia e Fëmijës "Zyber Hallulli". Ky aktivitet u organizua në kuadër të Ditës Botërore të Shëndetit Oral, e vendosur nga Federata Dentare Botërore, dhe organizohet çdo vit në 20 Mars.



Kjo ditë synon të rrisë ndërgjegjësimin, si dhe të tregojë rëndësinë e madhe që ka shëndeti oral në shëndetin e përgjithshëm dhe mirëqenien. Higjiena e mirë e gojës është shumë e rëndësishme sepse favorizon një shëndet të mirë.

Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH, Luneda Sufali, e pranishme në aktivitet, duke falenderuar bashkëpunëtorët për aktivitetin e organizuar theksoi se: "Fëmijët e Shtëpisë "Zyber Hallulli" por edhe të gjithë përfituesit në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror në varësi të SHSSH kanë nevojë për përkujdesje në çdo

ditë të vitit, dhe jo vetëm në ditë të shënuara botërore. Përkujdesi social dhe shëndetësor ndaj shtresave më në nevojë nuk do të mungojë në asnjë ditë vitit dhe Shërbimi Social Shtetëror do të bashkëpunojë çdo institucion, organizatë apo grupe qytetare për t'u shërbyer me përkushtim cilësi. Ndaj bashkëpunime të tilla janë të mirëpritura në vazhdimësi".

Në këtë aktivitet fillimisht, fëmijëve iu shpjegua rëndësia e shëndetit oral, që u krye nga studentet e vitit të pestë të FMD bashkë me mjekët e klinikës, dhe më pas u zhvilluan demonstrime mbi mënyrat korrekte të larjes së dhëmbeve (në mulazhe), të mbajtjes së higjenës dentare etj, në kuadrin e të cilave u shpërndanë furça dhe pasta dhëmbësh.

Për fëmijët është parashikuar dhe vizitë pranë Klinikës Stomatologjike Universitare me qëllim mirëmbajtjen e higjenës së gojës. Ky shërbim ofrohet falas për të gjithë fëmijet dhe familjet në nevojë, me qëllim për t'u kujdesur për shëndetin oral të të gjitha familjeve që nuk kanë mundësi ekonomike për të shkuar tek dentisti.

Të tilla aktivitete sensibilizuese, dhe shërbime falas në klinikë të përfituesve të IPSH-ve apo familjeve në nevojë do të organizohen në vazhdimësi falë bashkëpunimit me Klinikën Stomatologjike Universitare, Fakultetin e Mjekësisë Dentare dhe partnerë të tjerë.

Lajm i mirë nga Berati . Sistemohet në insitucion i moshuari në nevojë

Gjatë këtij muaji Drejtoria Rajonale SHSSH Berat pas referimit nga Drejtoria e Policisë Vendore të rastit të Sherif Shani 82 vjeç, ka mundësuar sistemimin e këtij të fundit në Shtëpinë e të Moshuarve Poliçan.

Z. Shani jetonte i vetmuar, dhe duke u ngrohur kishte pësuar djegie të lehtë tek këmbët, por Forcat e Policisë kanë mbërritur në kohë për të shmangur tragjedinë, duke e dërguar tek Urgjenca e Spitalit Rajonal Berat dhe duke i ofruar ndihmën e parë mjekësore.

Duke filluar që nga sot, Sherifi do të jetojë në Shtëpinë e të Moshuarve Poliçan me bashkëmoshatarët e tij, në përkujdesjen shoqërore dhe mjekësore të stafit të qendrës.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2018

#Qëndra E Zhvillimit " Pëllumbat"



Dita e 14 Marsit është ditë e cila na sjell në vëmendje verën, fëmijët e "Qëndës së Zhvillimit Pëllumbat" festuan këtë ditë në oborrin e kësaj qëndre.

Kjo ditë ishte plot me diell dhe argëtim pasi fëmijët vendosën zbukurimet e tyre të përgatitura enkas për këtë ditë.

Si gjithmonë prezent në festat tona janë vullnetarët e mrekullueshme Ana dhe Marina të cilat nuk janë kursyer kurrë për të kaluar kohë produktive me fëmijët. Kësaj here iu bashkua dhe grupi rinor aktiv i Kishës Ortodokse.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill 2018

VIZITË NË QËNDRËN LIRA NË BERAT



Drejtoresha e Përgjithshme Luneda Sufali vizitoi qendrën Lira në Berat ku përfitues të kësaj qendre janë persona me aftësi ndryshe. Gjatë këtij takimi drejtoresha u shpreh: "Shumë mirënjohje për punën fantastike të stafit të qendrës "Lira" në Berat. Është për t'u vlerësuar përkushtimi i stafit ndaj personave me aftësi ndryshe që marrin shërbime këtu. Zhvillimi dhe integrimi i tyre është i dukshëm teksa ata përfshihen në punët e përditshme të qendrës si mirëmbajtja e kopshtit apo mbjellja e perimeve, duke synuar jetesën e pavarur nëpërmjet aftësimit të tyre. Jo vetëm ambjentet e brendshme por edhe organizimi i përditshëm i punës janë modele të mira për stafet e institucioneve tona të përkujdesjes sociale. SHSSH mbështet ngritjen e sa më shumë qendrave ditore përkujdesjeje nga bashkitë gjithnjë e më pranë komunitetit ku jetojnë.

FUQIZOJMË STAFET NË BASHKËPUNIM ME ORGANIZATAT DHE PARTNERËT STRATEGJIK



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill 2018

Në bashkëpunim me organizatën ASED, kanë zhvilluar në Berat në ambjentet e Qendrës "Lira", një trajnim me drejtuesit e qendrave të zhvillimit. Ky trajnim vjen në kuadër të projektit që kjo organizatë po zhvillon për ngritjen e atelieve në institucionet e tyre. Përmirësimi i shërbimit në qendrat e zhvillimit drejt përfshirjes së përfituesve në punë sipas aftësive të tyre është dhe do të mbetet një objektiv i rëndësishëm. Trajnimi i stafeve sociale të qendrave të zhvillimit për krijimin e atelieve në qendra synon fuqizimin e qendrave nëpërmjet krijimit të kooperativave brenda qendrave me qëllim integrimin dhe aftësimin e personave më aftësi ndryshe .SHSSH mbështet këtë projekt duke ofruar gjithë mbështetjen e nevojshme për riorganizimin e qendrave me qëllimin final "Ndihmë ndaj personave me aftësi ndryshe për një jetese të pavarur dhe të integruar në shoqëri".

#Elbasan, Muaji i Autizmit



Gjatë muajit Prill mbahen aktivitete të ndryshme lidhur me javën që i dedikohet Autizmit dhe sensibilizimin për ndërgjegjësimin e njerëzve lidhur me këtë spektër. Drejtoresha e Përgjithshme ishte e pranishme në Elbasan në Panairin ndërgjegjësues për Autizmin. Ky ishte një nga shumë aktivitetet që u organizuan në të gjithë Shqipërinë gjatë muajit Prill, që njihet dhe si Muaji i Ndërgjegjësimit mbi Autizmin. Drejtoresha e Përgjithshme shprehu kënaqësinë dhe mbështetjen e saj lidhur me këtë aktivitet dhe vizitoi disa nga qëndrat të cilat operojnë në këtë qark për këtë kategori personash. Panairi ishte organizuar nga Bashkia Elbasan në bashkëpunim me institucione publike, jo publike apo qendra të ndryshme. Ishte një mundësi e mirë për t'i falenderuar nga afër për punën fantastike që bëjnë çdo ditë të vitit në shërbim të personave të prekur nga çrregullime të spektrit autik, dhe dashurinë që u ofrojnë atyre.

Elbasani është një nga qarqet me më shumë qendra zhvillimi private dhe publike për personat e prekur nga çrregullime të spektrit autik, duke u bërë model për t'u ndjekur nga kushdo që i është bashkuar kauzës në shërbim të personave me çrregullime të spektrit autik.

SHSSH do të vazhdojë bashkëpunimin me bashkitë e vendit, organizatat jo-fitimprurëse në mbështetje të personave me çrregullime të spektrit autik për fuqizimin e tyre drejt një jetese të pavarur.

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesës NE & PAK

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill 2018

Gjatë këtij muaji janë pritur dhe sqaruar 50 qytetar të cilët kishin ankesa të ndryshme lidhur me ndihmën ekonomike. Qytetarët janë njohur me ligjin dhe janë informuar për mënyrën e përfitimit. Gjithashtu rastet janë deleguar dhe në Drejtoritë Rajonale të SHSSH, pranë Bashkisë apo Zyrave të Punës.

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Gjatë këtij muaji në këtë drejtori kanë marr shërbim: 8 të moshuar të cilët janë sitemuar në IPSH. Janë rinovuar 35 statuse për jetim. Kanë përfituar statusin e jetimit 47 persona. Janë realizuar 22 vlerësime për fëmijët e pashoqëruar. Janë rikthyer 14 fëmijë të pashoqëruar. 7 raste VT/VMT. Dhe 31 raste të menaxhuara me sukses.

#Shtëpia e të Moshuarve, Shkodër



Gjatë muajit Prill në ambientet e "Shtëpisë të të Moshuave Shkodër" u zhvillua një konsult dentare për të gjithë përfituesit. Nga ky kontroll dentar u dhanë këshilla dhe orientim për një kujdes në vazhdim për higjenën dentare. Shërbimi Social do të jetë gjithmonë krahë inistucioneve të varësisë për një cilësi jete sa më të mirë të përfituesve.

Fuqizojmë komunitetin rom



Në Drejorinë Rajonale, Gjirokastër me mbështetjen e organizatës Rom " Active Albania", gjatë muajit Prill u mbajt një takim në kuadër të Ditëve të Kulturës Rome. Takimi kishte për qëllim informimin e banorëve të komunitetit rom për probleme të skemës së ndihmës ekonomike, problematikat e tyre, dhe mundësitë për integriminin social të tyre, nëpërmjet programeve të punësimit dhe arsimimit profesional. Takimi u organizua në Qëndrën Komunitare që menaxhohet nga Bashkia Gjirokastër dhe RAA. Të ftuar ishin edhe përfaqësues të Bashkisë Gjirokastër, Drejtorisë Rajonale të Punësimit, Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional, etj.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill 2018

#Qëndra Kombëtare Tranzitore Emergjencave

Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencave ka organizuar aktivitet social - kulturore në Javën Ndërkombëtare të Romëve. Çdo aktivitet social ka për qëllim integimin dhe edukimin e këtij komuniteti.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Maj 2018

Përfaqësim dinjitoz i #SHSSH në Panairin Kombëtar të Punës 2018

Në 1- Maj në Ditën Ndërkombëtarë të Punës, SHSSH i'u bashkua Panairit Kombëtar të Punës. Në stendën e SHSSH të ngritur në Sheshin "Skënderbej" specialistët e Shërbimi Social Shtetëror i'u dhanë përgjigje dhe orientime qytetarëve, për çdo pyetje që ata kishin në lidhje me programet e mbrojtjes sociale. Interesimi i qytetarëve lidhej kryesisht me mënyrën e aplikimit të ndihmës ekonomike, pagesës së aftësisë së kufizuar apo funksionimin e IPSH-ve. Stenda jonë u vizitua dhe nga Kryeministri, Edi Rama, i cili ndaloi për disa momente duke dëgjuar më tepër mbi rolin dhe funksionimin e SHSSH për ti inkurajuar për të vazhduar punë për ofrimin e shërbimeve cilësore.

SHSSH dhe SHKP kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me qëllim që anëtarët madhorë të familjeve në ndihmë ekonomike të mbështeten për të gjetur punë, apo për të marrë formim profesional që do u mundësonte gjetjen e një punë të mirëpaguar.

Ne besojmë se zgjidhja nuk është ndihma ekonomike, por punësimi. SHSSH do të vazhdojë të mbështesë të gjitha familjet dhe individët në nevojë drejt fuqizimit social-ekonomik me synim **#Punësimin** e tyre si zgjidhjen e vetme, kjo edhe falë marrëveshjes tonë me **#SHKP**. Të tilla Panaire të Punës po organizohen në të gjitha qarqet e vendit, ku SHSSH do të jetë e përfaqësuar në secilën prej tyre nëpërmjet Drejtorive Rajonale të SHSSH.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Maj 2018

Vijojnë takimet e Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH në Drejtoritë Rajonale dhe IPSH

Në vijimësi të aktiviteteve dhe punës së Shërbimit Social Shtetëror, Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH, Znj. Luneda Sufali zhvilloi një vizitë pune në Qarqet e Shkodrës dhe Vlorës. Gjatë vizitës në Shkodër Znj. Sufali zhvilloi një takim pune me stafin e Drejtorisë Rajonale Shkodër, ku në fokus të takimit ishin problematikat dhe arritjet, duke vënë në qendër shërbimin që i ofrohet qytetarit. Vëmendje në këtë takim iu kushtua implementimit me sukses të skemës së re të Ndihmës Ekonomike që po zbatohet në 12 qarqet e vendit, dhe bashkëpunimin me Zyrat e Punës për punësimin e anëtarëve madhore të familjeve në ndihmë ekonomike si e vetmja zgjidhje për fuqizimin e tyre. Znj. Sufali në vizitën e saj u ndal dhe në disa prej familjeve që kanë marrë mbështetje të vazhdueshme nga SHSSH. Gjithashtu në kuadër të "Projektit Shpresa" u vizitua ambjenti i qendrës, ku u panë nga afër standardet që ofron kjo qendër për personat me aftësi të kufizuara.



Ndalesa e radhës e Drejtoreshës së SHSSH, Znj. Luneda ishte në Drejtorinë Rajonale Vlorë në kuadër të bashkëpunimit me aktorë të fushave të shërbimeve sociale për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe efikase në të gjithë sektorët që Ne si Shërbim Social mbulojmë. Pjesë e takimit të punës ishte dhe vizita në Qendrën që ofron shërbime me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuar në Qarkun e Vlorës. Drejtoresha e Përgjithshme u shpreh se: "Misioni ynë është shërbimi cilësor dhe sa më i shpejtë për qytetarët." SHSSH do të vazhdojë të mbështesë individët dhe familjet në nevojë deri në fuqizimin social ekonomik të tyre.

SHSSH një familje e madhe, 15 Maj – Dita Botërore e Familjes

Në Ditën Botërore të Familjes në Drejtoritë Rajonale dhe IPSH në varësi të Shërbimit Social Shtetëror u organizuan aktivitete të ndryshme social-kulturore me një mesazh të unifikuar "SHSSH është një familje e madhe!"

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Maj 2018



Në 15 Maj Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH, Znj. Luneda Sufali morri pjesë në një aktivitet të organizuar në Qendrën e Zhvillimit "Pëllumbat" në Tiranë, duke u shprehur se SHSSH për të gjithe njerëzit në nevojë do të jetë një familje që kujdeset vazhdimisht për ta. Kjo ditë duhet të sherbejë si moment thirrjeje ku çdo njeri të fuqizojë familjet e veta dhe nga ana tjetër të solidarizohet me ata individë që nuk e kanë pasur mundësinë të kenë një familje.

Ne besojmë në një shoqëri ku zgjidhja për fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara është familja e shëndoshë dhe e qëndrueshme. Ashtu si në familjet tona kujdesemi për anëtarët e saj, edhe në Instuticionet e Përkujdesit Social angazhohemi çdo ditë me përkushtim dhe dashuri për t'i ofruar përfituesve tanë shërbime dhe një jetesë dinjitoze.

20 Maj - Dita Kombëtare e Jetimëve



Në kuadër të Ditës Kombëtare të Fëmijëve Jetimë, COD organizoi ceremoninë e hapjes së ekspozitës "Të zhvillojmë potencialin nëpërmjet talentit", me piktura e vizatime të fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijës "Zyber Hallulli" Tiranë.
Me nismën e COD, në mbështetje të zhvillimit të talentit të këtyre fëmijëve pa familje, janë solidarizuar edhe institucione vendase dhe ndërkombëtare, të cilët dhuruan kurse arti dhe profesionale falas, bazë materiale si edhe dhurata të ndryshme për të gjithë fëmijët.

Gjithashtu dhe tek Shtëpia e Foshnjës HANNA & ROZAFA u zhvillua një aktivitet për vogëlushët.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Maj 2018

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK takim me administratorët shoqërorë në Shkodër



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK në SHSSH ka zhvilluar një takim pune me administratorët shoqërorë të Qarkut Shkodër. Në këtë takim mori pjesë Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK, Znj. Miranda Pashaj. Ky takim u zhvillua në kuadër të menaxhimit të sistemit të ri elektronik të NE, si dhe kontrolleve efikase të zbatimit të legjislacionit. Në takim u diskutua për problematikat e hasura gjatë hedhjes së të dhënave të aplikimeve të qytetarëve për Ndihmë Ekonomike me Sistemin e Pikëzimit dhe adresimin e tyre drejt zgjidhjes. Në këtë takim fokusi kryesor ishte përpjekja e përbashkët për menaxhimin cilësor të implementimit të skemës së re të Ndihmës Ekonomike që po shtrihet në 12 qarqet e vendit.

Drejtoria e Shërbimeve Sociale në krye të detyrës për monitorimet e IPSH dhe komisionimet

Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka si detyrë të saj monitorimin e IPSH dhe komisionimet për personat që shprehin interes të përfitojnë shërbim në 11 Institucionet e Përkujdesit Social në varësi të SHSSH. Gjatë muajit maj kanë qenë 30 rastet të cilave u janë adresuar problematika. Në varësi të nevojave të secilës kategori është realizuar koordinimi dhe referimi për zgjidhjen e problematikave. Gjithashtu:

- 1 fëmijë me aftësi të kufizuara është sistemuar në IPSH, ndërsa 2 fëmijë të tjerë me AK janë transferuar.
- Janë sistemuar në IPSH 9 fëmijë jetimë, janë transferuar 4 fëmijë dhe janë rikthyer 3 fëmijë të pashoqëruar.
- Janë kryer 8 vlerësime social-ekonomike për fëmijët e pashoqëruar. Gjithashtu janë rinovuar 28 libreza të statusit të jetimit.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Maj 2018

Drejtoria e Shërbimeve Sociale kryen çdo muaj monitorime dhe komisionime duke synuar vazhdimisht rritjen e përformancë së stafeve në ofrimin e shërbimeve sociale për përfituesit në nevojë.

Aktorja e mirënjohur Mariana Kondi jep shfaqje në Shtëpinë e të Moshuarve, Tiranë



Aktorja e mirënjohur e skenës shqiptare Mariana Kondi ka dhënë një shfaqje për përfituesit e Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë. Në Shtëpinë e të Moshuave Tiranë u luajt drama "Hënat e Fundme", me regji të Milto Kutalit, me performancën e shkëlqyer të aktorëve Mariana Kondi, Bajram Dosti dhe Klajdi Zeqaj. Një pjesë teatrale e mrekullueshme që përcolli shumë emocione. Të tilla aktivitete janë të vazhdueshme në Shtëpinë e të Moshuarve.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2018

#Fëmijët gëzojnë dhe festojnë ditën e tyre, 1 Qershorin



Në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve festuam me çdo fëmijë në të gjitha institucionet e përkujdesit social në Shqipëri. Kudo ku ka fëmijë. Është dita dhe festa e tyre!

Në këtë kuadër Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror znj. Luneda Sufali, ishte e pranishme në aktivitetin e organizuar në Qendrën e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje. Ndërkohë që fëmijët e Qendrës së Zhvillimit Durrës realizuan një aktivitet kulturor ku e pranishme ishte Nën/drejtoresha e SHSSH, znj. Lida Leskaj.

Por aktivitete sensibilizuese dhe kulturore janë zhvilluar edhe në IPSH e tjera në varësi të SHSSH, si QKTE, Qendra e Trajtimit Viktimave të Trafikimit, Qendra e Zhvillimit Tiranë, Shtëpia e Fëmijës "Zyber Hallulli". Kudo festë, hare fëminore.

Për Ne fëmijët janë të parët në çdo ditë të vitit. 1- Qershori është ditë feste me fëmijët, por edhe një tjetër ditë për t'u angazhuar më shumë në përmbushjen e misionit tonë, për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe sigurimin e një familjeje për të gjithë. Deri sa çdo fëmije në IPSH-të tona t'u sigurohet një familje, Ne do vazhdojmë të kujdesemi për ta me përkushtim dhe dashuri si një familje.

#Një rast suksesi: Kujdesi për të moshuarit në nevojë, një obligim i vazhduar i ShSSh



Një ngjarje e dhimbshme për dy të moshuar të braktisur. Megjithatë Shërbimi Social Shtetëror si gjithmonë bëri vlerësim social, human e professional të rastit dhe i vendosi qytetarët e moshuar në mbrojtje sociale duke i akomoduar në një qendër sociale.

Çifti i të moshuarve Lumturie dhe Fadil Mane nga qyteti i Korçës, të mbetur të pastrehë pas nxjerrjes padrejtësisht nga shtëpia prej fëmijëve të tyre, janë sistemuar në Qendrën Polivalente, Poliçan. Lumturia dhe Fadili kanë tashmë një shtëpi të ngrohtë për të jetuar, një staf që i dedikohet me dashuri sigurimit të një qëndrimi cilësor dhe dinjitoz në institucion.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2018

#Rritim kapacitetet, përmirësojmë cilësinë e stafeve dhe përfshijmë edhe fëmijët



Në vijimësi të përmbushjes së misionit për zbatimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e mbrojtjes sociale, SHSSH në muajin Qershor mbajti takim mbi rëndësinë e ngritjes së kapaciteteve të stafit të saj në të gjithë Shqipërinë. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, në bashkëpunim me Save the Children, po zhvillon trajnimin me temë "Paketa Burimore për Përfshirjen e Fëmijëve në Procesin e Monitorimit", i cili synon ngritjen e kapaciteteve të stafit të SHSSH për të përfshirë fëmijët në inspektimin e shërbimeve që u ofrohen.

Punojmë çdo ditë nën moton "Shërbime efikase, të shpejta dhe të orientuara nga qytetarët".

#Drejtoria e Kontrollit të pagesës NE & PAK

Veprime dinamike, të planifikuara dhe me synim zbatimin korrekt të legjislacionit për Ndihmën Ekonomike dhe Pagesat për Personat me Aftësi të Kufizuara. Në këtë kontekst, gjatë muajit qershor Shërbimi Social Shtetëror nëpërmjet 12 Drejtorive Rajonale dhe Drejtorisë së Kontrollit të Pagesës së NE& PAK ka planifikuar kontrolle në 57 njësi vendore dhe janë realizuar 100% në përputhje me planin vjetor të SHSSH 2018.

Gjatë këtij muaji në kontrollet e ushtruara janë kryer 897 verifikime social ekonomike në familjet përfituese të ndihmës ekonomike , nga të cilat për 148 familje i është lënë detyrë njësisë vendore modifikimi i aplikimit pasi janë konstatuar ndryshime nga aplikimi dhe për 59 familje verifikimet social ekonomike kanë rezultuar me deklarim të rremë të cilat Drejtoritë Rajonale të SHSSH i kanë refuzuar gjatë vendimarrjes së muajit qershor në bazë të legjislacionit.

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Vazhdon ndjekja me përparësi e problematikave komplekse për zgjidhjen e problemeve sociale. Gjatë këtij muaji nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në ShSSh janë kryer 8 vleresime social-ekonomike për fëmijët e pashoqëruar. Janë rinovuar 32 libreza të statusit të jetimit dhe janë sisitemuar 11 të moshuar dhe 3 transferime në insitucione të tjera, etj.

#Insitucionet e Përkujdesit Social Qëndra Polivalente Ditore, Kamëz

Buletini Informativ

SHERBIMI SOCIAL

Qershor 2018



Në rrugëtimin tonë në Muajin Qershor u njohëm dhe një herë me historinë e vendit tonë.

Duke rifreskuar dhe një herë në memorjen tonë historinë, vlerat dhe virtytet e popullit tonë, të moshuarit u përfshinë në diskutime të ndryshme duke nxjerr në pah patriotizmin.

#Shërbimi Social i bashkohet nismës "SHPËTONI 3 JETË NË 10 MINUTA"



Shërbimi Social Shtetëror i'u përgjigj thirrjes së #MSHMS për t'iu bashkuar fushatës së dhurimit të gjakut. ShSSh, të asistuar nga mjekët specialistë tanë, dhuruan gjak për t'u ardhur në ndihmë personave që kanë nevojë.

Në këtë përvojë u dha mesazhi "Shërbimi Social nuk u ndodhet pranë vetëm personave që kanë problem social-ekonomike, por dimensioni ynë për njerëzit në nevojë është dhe humanitar"

#Shërbimi Social Shtetëror reagon, zgjidhje për çdo qytetar në nevojë!

Pas publikimit në median elektronike të rastit të familjes Memoci nga fshati Budull i qytetit të Krujës, Shërbimi Social Shtetëror ka reaguar duke kryer menjëherë vlerësimin socio-ekonomik të familjes, nga i cili është konstatuar se familja jeton në gjendje të vështirë ekonomike dhe banesa e tyre është e amortizuar. Duke u mbështetur në rezultatet e vlerësimit socio-ekonomik është orientuar kryefamiljari për plotësimin e dokumentacionit dhe aplikimin në skemën e ndihmës ekonomike. Shërbimi Social nodhet gjithmonë pranë çdo qytetari në nevojë!

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Korrik 2018

#BASHKË NË ÇDO SFIDË NË TË MIRË TË PËRFITUESVE TANË!



Gjatë këtij muaji garantuam një shërbim të suksesshëm dhe shumë të nevojshëm për moshën e tretë.
Ky shërbim ishte një paketë e plotë shërbimesh social-shëndetësore për të moshuarit në institucionet tona.

Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror znj. Luneda Sufali bashkë me ministren znj.Manastirliu prezantuan programin e kujdesit shëndetësor për të moshuarit që jetojnë në institucionet e përkujdesit në Shqipëri. Në të gjitha qendrat e përkujdesit u bënë vizita okulistike për të moshuarit dhe u vendosën syze falas për ata që kishin nevojë.

#Shërbimet Sociale



Gjatë muajit Korrik u mbajt takimi lidhur me "drejtësinë për të mitur" e cila është pjesë e rëndësishme e Reformës në sistemin e drejtësisë dhe shërbimeve sociale. Slogani i Konferencës ishte "drejtësi miqësore për të gjithë të miturit në konflikt me ligjin, qofshin ata autorë, viktima apo dëshmitarë". Pikërisht ky problem u trajtua në mënyrë të integruar dhe nga shumë aktorë në konferencën me temë: "Forcimi i kapaciteteve të profesionistëve të drejtësisë për të mitur.

Në debatet dhe diskutimet e zhvilluara edhe ShSSh si pjesë e kësaj reforme, solli përvojën e institucioneve të përkujdesit për fëmijë dhe rolin aktiv të Drejtorive Rajonale të ShSSh në trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin.

#Rrisim standartet, përmirësojmë cilësinë e ambienteve dhe kushtet për fëmijët



Shtëpia e pushimit në Velipojë, tashmë është gati për të pritur fëmijët e inistucioneve të përkujdesit nga i gjithë vendi. Kujdesemi që çdo fëmijë të jetë i lumtur dhe i shëndetshëm duke përmirësuar standartet e qendrave tona dhe cilësinë e jetës së çdo fëmije ashtu siç e meriton.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Korrik 2018

#Drejtoria e Kontrollit të pagesës NE & PAK

Gjatë këtij muaji grupi i kontrollit ishte në Qarkun Fier në njësitë administrative Karbunar, Bashkia Lushnjë.

Në kontrollet e ushtruara janë kryer 5 verifikime social ekonomike në familjet përfituese të ndihmës ekonomike, nga të cilat, 3 prej këtyre familjeve i është hequr e drejta për NE për deklarim të rreme.

Gjithashtu gjatë këtij muaji ka përfunduar procesi i vendimarrjes në të gjitha drejtoritë rajonale për muajin Korrik.

#Insitucionet e Përkujdesit Social



Fëmijët e qendrës sonë të varësisë janë përfshirë në kampin veror të organizuar nga Global Care.

Ata kanë zhvilluar aktivitete të ndryshme psiko-sociale. Këto aktivitete i japin dinamizëm ditës dhe jetës së këtyre fëmijëve.

Loja zhvillon kujdesin mbi ndjenjat dhe mirëqënien e fëmijëve dhe në këtë mënyrë ata mësojnë të ballafaqohen me sfidat.

Lojërat e fëmijëve janë çelësi i fëmijërisë së lumtur!

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Gusht 2018

#SHSSH

#Punojmë çdo ditë për të qenë afër njerëzve në nevojë

Drejtoresha e përgjithshme znj.Luneda Sufali solli në vëmendje një nga rastet e shumta ku #SHSSH punon për të menaxhuar në kohë reale rastet. Ky është një nga rastet e suksesshme ku vajza me inicialet D.B mori shërbimin e nevojshëm.
Sapo rasti u raportua, nga Drejtoria Rajonale e SHSSH-së Vlorë, u morën menjëherë masa për të bërë vlerësimin social-ekonomik gjatë së cilit u konstatua se:

- Vajza ishte e braktisur nga të dy prindërit, jetonte me gjyshërit dhe kishte probleme të rënda shëndetësore (probleme me shtyllën kurrizore).
- U punua maksimalisht për t'i lidhur pagesën e aftësisë së kufizuar, si një e drejtë e mohuar prej vitesh për shkak të burokracirave ligjore lidhur me tërheqjen e pagesës në mungesë të prindërve.
- Aktualisht po punohet që vajza të përfitojë grupin e parë të invaliditetit, ashtu si e parashikon ligji. Së bashku me mësuesen e vogëlushes, po mbahet kontakt me mjekët pranë QSUT-së, për të mbyllur procedurat e nevojshme për pajisjen me Fletën e Drejtimit për Kemp dhe për të mundësuar shansin për një ndërhyrje kirurgjikale.

#Shërbimet Sociale

Drejtoria e Shërbimeve Sociale gjatë këtij muaji ka monitoruar rastin e një të moshuari në Shtëpinë e të Moshuarve Poliçan ku dhe është mbyllur raporti për këtë monitorim.

Eshtë mbyllur raporti i të dhënave për 3 mujorin e Task Forcës së PAK.

Eshtë riparë konventa për të drejtat e Fëmijëve 2002-2018.

#Drejtoria e Kontrollit të pagesës NE & PAK



Gjatë këtij muaji janë zhvilluar kontrolle nga drejtoritë e ndryshme rajonale sipas planit të punës 2018.

Këto kontrolle janë ushtruar nga drejtoritë tona rajonale në Njësitë Administrative të qarqeve respektive.

Nga kontrollet e ushtruara u lanë rekomandimet e tyre.

#IPSH

#Fëmijët të parët



Gjatë muajit Gusht, ne nuk u kujdesëm që fëmijët të shkojnë vetëm në plazh, por të shohin dhe argëtohen edhe në mënyra të tjera. Fëmijët e QKTE kaluan një ditë ndryshe pranë Shkollës së Qenëve ku fëmijët u njohën nga afër me trajnimet dhe mësimet që marrin qenë të ndryshëm.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shtator 2018

DREJTORESHA E PËRGJITHSHME NË DITËN E PARË TË SHKOLLËS DHA NJË MESAZH PËR FËMIJËT E IPSH



Drejtoresha e përgjithshme nga Qendra Pritëse e Viktimave të Dhunës në Familje duke shoqëruar fëmijët në ditë e parë të shkollës dha këtë mesazh:

Suksese në rrugën e dijes, i urojmë të gjithë fëmijëve të institucioneve të përkujdesit shoqëror.
Të gjithë ne të behemi bashkë dhe të vendosemi në rolin e prindërve për të gjithë ata fëmijë të cilët janë pa kujdes prindëror duke iu ofruar sado pak ngohtësi dhe dashuri.
Eshtë kënaqësi të shoqëroja fëmijët e grave të dhunuara në ditën e parë të shkollës.

#Në kohë reale pranë njerzve në nevojë



Një rast tjetër suksesi! Dy djem të mitur kishin mbetur pa kujdes prindëror pas arrestimit të babait dhunues ndaj nënës. Shërbimi Social Shtetëror morri nën kujdes të dy djemtë duke i strehuar në një nga qendrat e përkujdesit shoqëror. Ndërkohë që nëna po merr kujdes të specializuar në QSUT, ne kujdesmi që fëmijët të marrin mbështetjen dhe kujdesin maksimal psiko-social. Bashkë mundemi t'ia dalim duke qenë afër çdo personi i cili ka nevojë për ndihmë. Misioni ynë primar është shërbime të shpejta dhe efikase në shërbim të qytetarit.

#Drejtoria e Kontrollit të pagesave të NE dhe PAK



Në kuadër të Planit të Kontrollit 2018, vazhdojnë kontrollet në të gjitha Qarqet dhe Njësitë Administrative të vendit për pagesat NE & PAK këto kontrolle janë shoqëruar dhe me vizitat në familje.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shtator 2018

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Gjatë muajit Shtator janë kryer 29 vlerësime social-ekonomike për fëmijët e pashoqëruar.

Janë rikthyer 11 fëmijë të pashoqëruar. Eshtë vlerësuar dokumentacioni për fëmijët dhe janë sistemuar 5 fëmijë në IPSH dhe 4 janë transferuar.

Gjithashtu janë menaxhuar 4 raste VT/VMT si dhe janë shqyrtuar 35 dosje nga të cilat janë vendosur në institucion 17 të moshuar.

#Insitucionet e Përkujdesit Social



Fëmijët e Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit kanë gjetur një mënyrë të veçantë për të shprehur mirënjohjen ndaj akteve humanitare të Nënë Terezës në Ditën e Shenjtërimit të saj.

Punonjësit dhe fëmijët e qendrës ia kanë dedikuar këtë ditë zhvillimit të një aktiviteti me temë "Nga njerëzorja tek e shenjta, e jona dhe e mbarë botës Nënë Tereza" ku fëmijët kanë paraqitur krijueshmërinë e tyre përmes vizatimeve.

#Qëndra Kombëtare Tranzitore Emergjencave



Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencave ka organizuar aktivitet social - kulturore në Javën Ndërkombëtare të Romëve.

Çdo aktivitet social ka për qëllim integimin dhe edukimin e këtij komuniteti.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2018

#Tetori- Muaji i Ndërgjegjësimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore



Në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe institucionet tona të përkujdesit, kanë zhvilluar fushata ndërgjegjësimi mbi fenomenin e trafikimit pranë shkollave të ndryshme 9- vjeçare dhe të mesme.

Motoja që ka udhëhequr fushatën ndërgjegjësuese gjatë këtij muaji e vë theksin mbi informimin si themel për ç'rrënjosjen e këtij fenomeni shoqëror shkatërrues.

#Në çdo kohë pranë qytetarëve në nevojë



Shërbimi Social Shtetëror reagon ndaj thirrjes për ndihmë të znj. F.LL, banore e njësisë administrative Dajt dhe nënë e 3 fëmijëve të mitur të cilët jetonin në kushte të mjerueshme.

Përveç kushteve të vështira të jetesës, zonja ishte edhe viktimë e dhunës nga ish-bashkëshorti dhe ish-vjehrri. Pas marrjes së urdhërit të mbrojtjes nga gjykata zonja mbeti e pastrehë bashkë me fëmijët e saj. Nga verifikimi i Drejtorisë Rajonale të SHSSH Tiranë në bashkëpunim me punonjësët e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në njësinë Dajt e Farkë u konstatua gjendja e rënduar socio-ekonomike dhe znj. F.LL me 3 fëmijët u sistemuan pranë QKTE, ku po marrin të gjitha shërbimet e nevojshme nga një staf i përkushtuar.

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK



Në vijimësi të zbatimit të Planit të Kontrollit 2018, Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka realizuar kontrollet dhe vizita në familjet përfituese në disa Qarqe dhe Njësi Administrative në vend lidhur me pagesat e NE dhe PAK.

Në të njëjtën kohë, në kuadër të fushatës së komunikimit mbi Skemën e Ndihmës Ekonomike janë zhvilluar takime me Administratorët Shoqërorë të qarqeve Lezhë, Dibër, Kukës, Elbasan dhe Korçë lidhur me problematikat e aplikimit të NE dhe zbatimin e legjislacionit.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2018

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale



Përgjatë muajit Tetor, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka kryer 21 vlerësime social-ekonomike të fëmijëve të pashoqëruar. Është vlerësuar dokumentacioni për fëmijët dhe janë sistemuar 16 fëmijë në IPSH dhe janë kryer 3 transferime. Një fëmijë me AK është sistemuar në institucion, ndërsa një tjetër është transferuar.

Në lidhje me të moshuarit janë shqyrtuar 39 dosje, nga të cilët janë sistemuar në institucion 17 të moshuar dhe 3 janë transferuar.

Janë shqyrtuar dokumentacionet e aplikantëve për Statusin e Jetimit. Kanë përfituar këtë status 40 persona dhe janë rinovuar 29 libreza.

#Institucionet e Përkujdesit Shoqëror



Qëllimi kryesor i punës së institucioneve të përkujdesit është ri-integrimi në shoqëri i çdo përfituesi të shërbimeve tona.

Si rezultat i punës së shkëlqyer të stafit të Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit Durrës, u bë i mundur kthimi në familjen biologjike i një vajze 27-vjeçare e cila prej 4 vitesh përfitonte shërbim pranë këtij insitucioni.

SHERBIMI SOCIAL

Buletini Informativ

Nëntor 2018

#NËNTORI I 16 DITËVE TË AKTIVIZIMIT KUNDËR DHUNËS

Nëntori është Muaji i Ndërgjegjësimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore. Pabarazia gjinore, normat diskriminuese dhe stereotipet gjinore janë pengesat më të mëdha në ç'rrënjosjen e këtij fenomeni.



Në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore janë organizuar rreth 100 aktivitete ndërgjegjësuese mbi fenomenin e dhunës tek nxënësit e shkollave 9-vjeçare, të mesme dhe studentët në të gjithë Shqipërinë. Këto aktivitete mbështesin gratë dhe vajzat që ia kanë dalë t'i mbijetojnë dhunës dhe përpiqen t'i japin fund kulturës së heshtjes kundrejt dhunës së përjetuar.

#RIINTEGRIMI NË SHOQËRI MBETET PRIORITETI I PUNËS SONË



Nëntori ka nisur me raste suksesi në Qendrën e Zhvillimit Durrës. Kemi realizuar me sukses riintegrimin në familje të një prej përfitueseve të Qendrës së Zhvillimit Durrës. Dorina ka përfituar shërbim psiko-social dhe shëndetësor në qendër për rreth 7 vjet, ndërsa tashmë ajo është ribashkuar me familjen e saj biologjike.

Riintegrimi në familje dhe shoqëri është prioritet në të gjitha institucionet tona të përkujdesit.

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK

Në vijimësi të zbatimit të Planit të Kontrollit 2018, Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka realizuar kontroll dhe vizita në familje në qarkun Berat lidhur me zbatimin e legjislacionit për Ndihmën Ekonomike.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Nëntor 2018

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale




Përgjatë muajit Nëntor, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka kryer 22 vlerësime social-ekonomike të fëmijëve të pashoqëruar. Është vlerësuar dokumentacioni për 4 fëmijë dhe është kryer 1 transferim. 2 fëmijë me AK janë sistemuar në institucion.

Në lidhje me të moshuarit janë shqyrtuar 26 dosje, nga të cilët janë sistemuar në institucion 13 të moshuar dhe 1 është transferuar.

Janë shqyrtuar dokumentacionet e 50 aplikantëve për Statusin e Jetimit. Kanë përfituar këtë status për herë të parë 3 persona dhe janë rinovuar 44 libreza. Gjithashtu janë menaxhuar 2 raste të VT/VMT.

#Shërbim i plotë okulistik për të gjithë përfituesit e qendrave tona të përkujdesit shoqëror



Institucionet e Përkujdesit Shoqëror ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh socio-shëndetësore. Shërbimi i plotë okulistik falas, pas Shtëpive të Gjyshërve, është ndalur pranë vogëlushëve të familjes sonë të madhe.

Gjatë muajit Nëntor janë realizuar vizita okulistike dhe syze falas për të gjithë fëmijët që kishin nevojë pranë Shtëpive të Fëmijës.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2018

#Festat duan dashuri-shËrbimi social shtetëror



Në 29 Qendra Përkujdesi në të gjithë vendin në datën 29 Dhjetor u zhvilluan aktivitete të ndryshme nën sloganin "Festat duan Dashuri", dhe jo vetëm në këtë ditë por edhe përgjatë gjithë muajit Dhjetor donator të ndryshëm u vetëofruan për të dhuruar si nga ana materiale dhe nga ana shpirtërore duke u vendosur në pozitën e përfituesve në qendra të ndryshme të vendit.

Një falenderim i madh shkon për të gjithë ata që na mbështën dhe u gjendën pranë njerëzve më në nevojë si kompania Aluflor,Teleperformace Albania, Banka Bkt, Avokati i Popullit, Ojf SFI, Zepa Natyral, studentët e Shkencave Sociale, nxënës shkollash, etj.

#Drejtoria e Kontrollit të NE dhe PAK



Vijoi dhe gjatë muajit Dhjetor fushata kombëtare për informimin e qytetarëve për risitë e skemës të Ndihmës Ekonomike, në Vlorë, në Shkodër dhe Elbasan. U riinformuan qytetarët lidhur me skemën e re ku:

- Targetohen më të varfërit.
- Nuk ka kritere përjashtuese, çdo qytetar mund të aplikojë në skemë.
- Qytetarët përfitojnë pagesën e ndihmës ekonomike të plotë, jo më të pjesshme.

Nga 7 dokumente, sot aplikohet vetëm me dy dokumente.
Ndihma ekonomike është një ndihmë e përkohëshme për familjet në nevojë. Alternativa jonë është riintegrim nëpërmjet aftësimit profesionale dhe punësimit. Këto ishin mesazhet që u përcollën tek qytetarët për të kuptuar qartë qasjen e skemës së re të ndihës ekonomike.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2018

#Drejtoria e Komisionit të PAK



Gjatë muajit Dhjetor u zhvillua fushata e komunikimit për shtrirjen e modelit të vlerësimit bio-psiko-social nga kompania e kontraktuar nga MSHMS.

Kompania në bashkëpunim me SHSSH dhe DRSHSSH, organizuan 6 takime me punonjës sociale, punonjës të bashkive, mjekë. Takimet janë realizuar në Tiranë më datën 21 dhe datën 27 dhjetor, në Durrës më datë 24 dhe më datë 26 dhjetor dhe në Elbasan më datë 24 dhe 26 dhjetor.

Gjatë takimeve u prezantua procedura e vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar që po pilotohet aktualisht në njësitë administrative nr.6 dhe nr.7, Tiranë.

#Rrisim standartet. 3 dhjetor IPSH



Në Qendrën e Zhvillimit **#Durrës** në ditën ndërkombëtare të Aftësisë së Kufizuar për shërbimin e karrigeve me rrota **#falas** për personat me aftësi të kufizuar.

Punohet çdo ditë për më shumë për të pasur shërbime socio-shëndetësore por kemi ende shumë për të bërë për barazi dhe gjithëpërfshirje sociale për personat me aftësi ndryshe. Në këtë qendër dita ditës rriten shërbimet dhe standartet për ata persona që kanë nevoja specifike.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2018

#Histori suksesi



Nga Shkodra gjatë muajit Dhjetor na kanë ardhur vetëm lajme të mira!

Falë kontributit dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit me OJF "The Door" të përfaqësuar nga Kastriot Faci, dy gjyshër kanë dy karroca në formë motorri që do t'ia lehtësojnë atyre dhe familjarëve lëvizjen në qytet, pas problemeve shëndetësore që ata kanë patur, gjë që kufizonte jetesën normale të këtyre zotërinjëve.

"The Door" janë mbështetës të vyer të grupeve në nevojë!

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Janar 2019

#RRITJE E KAPACITETEVE PËR TË LEHTËSUAR MODERNIZIMIN E ASISTENCËS SOCALE



Në kuadër të projektit për "Modernizimin e Asistencës Sociale", në Korçë është zhvilluar një trajnim për rritjen e kapaciteteve të profesionistëve të Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Trajnimi kishte në fokus hedhjen e të dhënave në sistemin e NE dhe njohuritë e marra do të përcillen në formë zirxhir tek Administratorët Shoqërorë në mënyrë që puna për modernizimin e sistemit të vijojë pa pengesa.

#REAGOJMË MENJËHERË PËR TË NDIHMUAR QYTETARËT NË NEVOJË



Familja e M.SH prej pak kohësh është rikthyer në Shqipëri nga emigracioni dhe i janë drejtuar Shërbimit Social Shtetëror Shkodër për ndihmë.

Familja është orientuar për të aplikuar në skemën e Ndihmës Ekonomike, ndërkohë që vajza e çiftit po ndjek një kurs profesional dhe pas përfundimit të tij do të ndërmjetësohet për punë nga Zyra e Punës Shkodër.

Qëllimi i punës sonë në çdo rast është zgjidhja e problemeve të qytetarëve përmes ri-integrimit në tregun e punës dhe në shoqëri.

SHERBIMI SOCIAL

Buletini Informativ

Janar 2019

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale gjatë muajit Janar, duke përpunuar të dhënat e dërguara prej tyre. Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark.

Gjithashtu në kuadër të projektit për "Modernizimin e Asistencës Sociale" është realizuar një trajnim lidhur me modulin e kontrollit dhe ankimimit me 12 drejtorët e Drejtorive Rajonale, IT dhe Drejtorinë e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK.

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Gjatë muajit Janar, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka kryer 33 vlerësime social-ekonomike të fëmijëve të pashoqëruar. Është vlerësuar dokumentacioni për 5 fëmijë dhe janë sistemuar në IPSH 4 prej tyre. 2 fëmijë me aftësi të kufizura janë sistemuar në institucione.
Në lidhje me të moshuarit janë shqyrtuar 17 dosje, nga të cilët janë sistemuar në institucion 9 të moshuar dhe 1 është transferuar.
Janë shqyrtuar dokumentacionet e 108 aplikantëve për Statusin e Jetimit dhe janë rinovuar 43 libreza.



#Institucionet e Përkujdesit Shoqëror



Puna që kryhet çdo ditë në institucionet e përkujdesit konsiderohet vërtetë e arrirë kur përfituesit e shërbimeve tona ri-integrohen në shoqëri.

Rikthimi në familjen biologjike është tregues i përpjekjeve tona për jetësimin e De-institucionalizimit. Fëmija M. L u rikthye në gjirin e familjes pas qëndrimit në Shtëpinë e Fëmijës prej vitesh.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2019

#TRAJNIMET DHE MODERNIZIMI I SKEMËS SË NDIHMËS EKONOMIKE



Gjatë muajit Shkurt, në vijim të përpjekjeve për modernizimin e asistencës sociale, është zhvilluar një tjetër trajnim 2 ditor me profesionistët e Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Fokusi i këtij trajnimi të mbajtur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH ishte skema e Ndihmës Ekonomike dhe metodologjia e re e kontrollit.

Ky trajnim rrit nivelin e aftësive të profesionistëve që punojnë në këtë fushë dhe garanton zbatimin e drejtë të legjislacionit në fuqi.

#PUNËSIMI ËSHTË E VETMJA ZGJIDHJE E QËNDRUESHME



Fationa ka përfituar shërbime sociale dhe shëndetësore prej 5 vitesh në Qendrën e Zhvillimit Durrës. Gjatë këtyre viteve ajo ka ndjekur rregullisht shkollën speciale dhe kurse të ndryshme profesionale në Qendrën e Formimit Profesional Publik, për të cilat është çertifikuar.

Fationa është 29 vjeç dhe duke qënë se ka mbushur moshën e qëndrimit në qendër, iu ofrua punësim me kohë të pjesshme si sanitare në mënyrë që ajo të ri-integrohet sa më shpejt në shoqëri.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2019

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin. Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark.

Gjithashtu, Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka kryer kontroll në Drejtorinë Rajonale Durrës lidhur me zbatimin e legjislacionit për Ndihmën Ekonomike dhe metodologjinë e re të kontrollit si edhe zbatimin e legjslacionit për PAK në periudhën Janar-Dhjetor 2018.

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Gjatë muajit Shkurt, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka kryer 24 vlerësime social-ekonomike të fëmijëve të pashoqëruar. Është vlerësuar dokumentacioni për sistemimin e 8 fëmijëve në institucionet e përkujdesit. Janë sistemuar në institucione të përkujdesit shoqëror 2 fëmijë me aftësi të kufizuara.

Në lidhje me të moshuarit janë shqyrtuar 15 dosje, nga të cilët janë sistemuar në institucion 10 të moshuar dhe janë transferuar 3 të moshuar të tjerë.

Janë shqyrtuar dokumentacionet për rinovimin e 68 librezave të Statusit të Jetimit. Në lidhje me Viktimat e Trafikimit është menaxhuar 1 rast i ri.



#Institucionet e Përkujdesit Shoqëror



Shtëpia e të Moshuarve Shkodër tashmë i ofron të gjitha për përfituesit e saj. Institucioni iu nënshtrua rikonstruksionit të plotë disa muaj më parë, duke përmirësuar në këtë mënyrë standardet e shërbimeve që ofron.

Përveç rikonstruksionit, tashmë në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër ofrohet një paketë e plotë shërbimesh që përfshin shërbimin psiko-social, shërbimin ambulator dhe kushtet për kryerjen e gjimnastikës për përfituesit.

Të gjitha këto ndryshime janë kryer në funksionon të garantimit të një shëndeti të shkëlqyer për gjyshërit përfitues.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2019

#GATI PËR TË PLOTËSUAR NEVOJAT E TË GJITHË QYTETARËVE NË NEVOJË



Zonja Dh. M nga qyteti i Fierit prej vitesh qëndron në një karrocë me rrota, e cila tashmë është e vjetëruar. Familjarët e zonjës i'u drejtuan Shërbimit Social Shtetëror për ndihmë.

Menjëherë pas kërkesës së marrë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror duke u koordinuar me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier, i mundësuan zonjës një karrocë tërësisht të re dhe të përshtatur për të.

#PANAIRI I AFTËSIVE



Në Qendrën Rinore të Tiranës është mbajtur për herë të parë panairi i punimeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Gjashtë qendra të zhvillimit në të gjithë Shqipërinë kanë prezantuar punimet e fëmijëve në pikturë, skulpturë dhe punime të ndryshme dore.

Fëmijët në qendrat e zhvillimit marrin çdo ditë përkujdes dhe shërbime terapeutike me qëllimin e vetëm të sigurimit të pavarësisë dhe rikthimit pranë familjes.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2019

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka kryer kontroll në Njësinë Administrative Libofshë, Qarku Fier lidhur me zbatimin e legjislacionit për Ndihmën Ekonomike dhe metodologjinë e re të kontrollit për periudhën Janar-Dhjetor 2018.



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin. Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark.

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Gjatë muajit Mars, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka kryer 28 vlerësime social-ekonomike të fëmijëve të pashoqëruar si edhe janë riatdhesuar 12 fëmijë të pashoqëruar. Janë menaxhuar 5 raste VT/VMT dhe viktima të dhunës në familje.



Gjatë muajit mars është mbledhur komisioni për fëmijët dhe janë sistemuar në institucione 11 fëmijë. Është kryer transferimi i 3 fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe është pranuar 1 PAK në një OJF.

Janë rinovuar 33 libreza të statusit të jetimit.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2019

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Erdhi Hirushja te Shtëpia e Foshnjës “Hannah dhe Rozafa”

Fëmijët e Shtëpisë së Foshnjës “Hannah dhe Rozafa” kanë kaluar një ditë të mrekullueshme nën shoqërinë e stafit të CFO Farma dhe animatorëve socialë. Ky aktivitet u mbështet nga CFO Farma, të cilët prej kohësh janë miq të fëmijëve të familjes sonë të madhe. CFO Farma, përveç dëshirës për t’i dhuruar fëmijëve një ditë ndryshe, kanë kontribuar gjithashtu me produkte të ndryshme farmaceutike për fëmijë.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill 2019

#DITA BOTËRORE E LIBRIT NË SHTËPINË E FËMIJËS "ZYBER HALLULLI"



Librat janë miqtë më besnikë të fëmijëve dhe një pasuri shumë e madhe për të gjithë shoqërinë.

Këtë vit, Dita Botërore e Librit na gjeti pranë Shtëpisë së Fëmijëve Shkollorë "Zyber Hallulli". Shërbimi Social Shtetëror organizoi një aktivitet i cili theksoi rëndësinë e librave dhe leximit tek formimi i fëmijëve. Pjesë e aktivitetit ishte edhe pasurimi i bibliotekës së institucionit me libra të rinj të llojeve të ndryshme, të cilat fëmijët po presin me padurim t'i lexojnë në kohën e lirë.

#PUKË, PËRKRAHJA PËR FËMIJËT E MBETUR JETIMË




Mbrëmjen e 9 Prillit një zjarr i papritur në banesë shkaktoi largimin e parakohshëm nga jeta të prindërve të 4 fëmijëve nga Puka. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Shkodër vizitoi menjëherë fëmijët dhe gjyshërit për të lehtësuar sado pak dhimbjen e tyre.

Familja u ndihmua me ushqime, veshmbathje dhe mjete të tjera për banesën. Përveç ndihmës së menjëhershme, u morën masa për të përcaktuar sa më shpejt familjen kujdestare për 4 fëmijët. Gjithashtu gjyshja e paralizuar e fëmijëve u asistua në plotësimin e dosjes për përfitimin e statusit të para-tetraplegjisë, si edhe iu dhurua një karrocë e re për t'i lehtësuar lëvizjen.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill 2019

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka kryer kontroll në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier lidhur me zbatimin e legjislacionit për Ndihmën Ekonomike për periudhën Mars 2018-Mars 2019.



Janë monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin. Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark.

Për 12 Drejtoritë Rajonale është monitoruar procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes.

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Gjatë muajit Prill, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka kryer 30 vlerësime social-ekonomike të fëmijëve të pashoqëruar si edhe janë riatdhesuar 10 fëmijë të pashoqëruar, për të cilët është koordinuar puna për pritjen në aeroport. Janë menaxhuar 2 raste VT/VMT dhe viktima të dhunës në familje.



Komisioni për Fëmijët ka shqyrtuar dokumentacionin dhe ka sistemuar në IPSH 2 fëmijë, ndërsa 1 fëmijë tjetër është transferuar. Është sistemuar një fëmijë me aftësi të kufizuara në IPSH.

Është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit, ku janë rinovuar 56 libreza dhe e kanë përfituar për herë të parë këtë status 51 jetimë.

Gjatë muajit Prill Komisioni për të Moshuarit ka komisionuar 14 të moshuar për t'u sistemuar në IPSH.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill 2019

#Institucionet e Përkujdesit Shoqëror



Në Shtëpinë e Foshnjës "Hannah dhe Rozafa" është zhvilluar festa e lamtumirës për një foshnjë e cila është birësuar dhe ka tashmë një vatër të ngrohtë familjare në Kanada.

Çdo fëmijë meriton një familje dhe këto raste tregojnë gjithnjë e më tepër se si ka marrë jetë procesi i de-institucionalizimit, i cili për ne është proces shumë i rëndësishëm.

Prindërit birësues të foshnjës kanë qënë mbështetës të vazhdueshëm të institucionit. Edhe në këtë ditë ata kanë dhuruar medikamente dhe dhurata për të gjithë foshnjat e tjera, si edhe kanë dhënë kontributin e tyre në rinovimin e një ambienti të institucionit.

Vogëlush shumë urime dhe jetë të lumtur pranë familjes tënde të re e të bukur!

#PANAIRI I IDEVE NË DURRËS

Qendra e Zhvillimit Rezidencial Durrës u prezantua në "Panairin e Ideve" me punimet e fëmijëve përfitues.

Në këtë aktivitet u paraqitën punimet e fëmijëve me aftësi ndryshe në fusha të tilla, si: pikturat, skulptura dhe punime të tjera krijuese me dorë.

Të gjithë fëmijët që marrin shërbime pranë Qendrave tona të Zhvillimit ndjekin një program të rregullt me terapi, pjesë e së cilave janë edhe këto punime artistike.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Maj 2019

#DITA BOTËRORE E FAMILJES 2019



Më 15 Maj u zhvilluan festimet për Ditën Botërore të Familjes. Në kuadër të fushatës "Ndihmo edhe ti një familje këtë 15 Maj" prezantuam 2 familje të cilat përfitonin ndihmë ekonomike dhe falë nismës së Shërbimit Social Shtetëror u punësuan në dy subjekte private. Këto raste suksesi nuk do të mbeten me kaq, thjesht kanë hapur siparin e rasteve të suksesshme që do të pasojnë.

Në Ditën Botërore të Familjes, e cila vendos në plan të parë sigurisht familjen e bashkuar e të shëndetshme, një nga fëmijët e shtëpisë sonë të madhe të Zyber Hallullit u rikthye në familje.

Mesazhin që qëndron në themel të kësaj dite dhe ndihmën që çdokush prej nesh mund t'i ofrojë një familjeje në nevojë, ne duam ta kthejmë në një traditë që do t'i qëndrojë kohës.

#SHKODËR, PRANË ÇDO QYTETARI NË NEVOJË



Shërbimi Social Shtetëror është në gadishmëri për të ndihmuar çdo qytetar që ka nevojë për ndihmë. Alfonsi nga fshati Reç, Malësi e Madhe, ka pësuar një aksident tetorin e vitit 2018. Për fat të keq prej asaj dite ai është dëmtuar dhe ka marrë statusin e personit tetraplegjik.

Shërbimi social dhe "The Door" vendosi ta ndihmojë Alfonsin duke i dhuruar një karrocë në formë motorri me anë të së cilës do mund të lëvizë lehtësisht jashtë mjedisit të shtëpisë. Fokusi jonë është t'i vijmë në ndihmë çdo qytetari duke i plotësuar nevojat që e bëjnë atë të jetojë i pavarur.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Maj 2019

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka kryer kontroll në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastër lidhur me zbatimin e legjislacionit për Ndihmën Ekonomike për periudhën Mars 2018-Mars 2019. Gjithashtu është kryer kontroll në Njësinë Administrative Kallmet, Lezhë lidhur me zbatimin e legjislacionit për PAK.



Për 12 Drejtoritë Rajonale është monitoruar procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes. Janë monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin. Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark.

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Gjatë muajit Maj, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 5 raste VT/VMT dhe është koordinuar puna për pritjen e një rasti në kufi.



Komisioni për Fëmijët ka marrë vendim për sistemimin e 5 fëmijëve në institucionet e përkujdesit. Janë shqyrtuar 4 kërkesa për sistemim të PAK në institucione.

Është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit, ku është shqyrtuar dokumentacioni dhe kanë përfituar status 42 jetimë.

Gjatë muajit Maj Komisioni për të Moshuarit ka komisionuar 13 të moshuar për t'u sistemuar në IPSH dhe janë transferuar 3 të moshuar.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Maj 2019

#Institucionet e Përkujdesit Shoqëror



Një angazhim i ri për fëmijët e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial Durrës!

Disa studentë të Qendrës së Formimit Profesional vizituan në muajin Maj Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës. Në bashkëpunim me stafin e përkushtuar të qendrës u vendos t'i jepej fëmijëve me aftësi ndryshe mundësia për të mësuar disa zanate të ndryshme me qëllim aftësimin e tyre dhe pse jo përgatitjen për t'u punësuar në sektorë të ndryshëm përmes ndërmjetësimit të Zyrës së Punës Durrës.

Ky bashkëpunim do të jetë frytdhënës për të ardhmen e këtyre fëmijëve pas largimit të tyre nga institucioni.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Korrik 2019

#30 KORRIKU I DEDIKOHET NDËRGJEGJËSIMIT KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE



Në kuadër të Ditës Botërore kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Trafikimit zhvilloi aktivitete me natyrë informuese dhe ndërgjegjësuese në Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencave dhe Qendrën Komunitare Shkozë.

Fokusi i aktivitetit ishte në informimin mbi fenomenin e trafikimit dhe parandalimin e tij përmes njohjes së faktorëve të riskut. Trafikimit mund t'i themi STOP vetëm duke qenë të ndërgjegjësuar mbi të.

#ZGJIDHJE AKTIVE PËRMES PUNËSIMIT PËR FAMILJET NË NEVOJË



Brunilda është nënë e dy fëmijëve dhe ka qenë përfituese e skemës së ndihmës ekonomike. Pasi kreu një kurs formimi profesional u punësua në një biznes privat në Kuçovë, falë bashkëpunimit të Shërbimit Social Shtetëror me Shërbimin Kombëtar të Punësimit.


Ne lobojmë gjithmonë për zgjidhje aktive dhe integrim në shoqëri përmes punësimit.

SHERBIMI SOCIAL

Buletini Informativ

Korrik 2019

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Korrik ka përfunduar dhe dërguar draft raportin përfundimtar të kontrollit në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Lezhë për përmirësimin e zbatimit të legjislacionit për Ndihmën Ekonomike.

Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark dhe është monitoruar procesi i mbledhjes së Këshillave Bashkiakë për marrjen e vendimeve.

Është monitoruar procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale të SHSSH. Janë monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin.

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale



Gjatë muajit Korrik, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 7 raste VT/VMT dhe është koordinuar puna për pritjen e një rasti në kufi.

Është mbledhur Komisioni për Fëmijët dhe ka marrë vendim për sistemimin e 3 fëmijëve në institucionet e përkujdesit shoqëror.

Është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit, ku është shqyrtuar dokumentacioni për 73 raste, nga të cilat 34 raste kanë përfituar këtë status për herë të parë, 35 libreza janë rinovuar dhe 4 raste janë refuzuar.

Komisioni për të Moshuarit ka shqyrtuar 13 raste të moshuarish për t'u sistemuar në IPSH, janë sistemuar 5 dhe janë transferuar 3 raste.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Korrik 2019

#Institucionet e Përkujdesit Shoqëror



Vera kërkon me patjetër plazh dhe qejf për të qenë e bukur!

Fëmijët e institucioneve tona të përkujdesit gjatë Korrikut kanë pushuar dhe janë argëtuar në Shtëpinë tonë të Pushimit në plazhin e Velipojës.

Ne kujdesemi që përpos shërbimeve me standarde bashkëkohore brenda në institucion, përfituesve të shërbimeve tona të mos i mungojë argëtimi!

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2019

#TETORI I DEDIKOHET LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT



Në kuadër të Muajit të Ndërgjegjësimit kundër Trafikimit, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social kanë zhvilluar gjatë të gjithë muajit Tetor fushatat e ndërgjegjësimit dhe informimit për të luftuar fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore.

Duke besuar se përmes informimit mund të ç'rrënjosim trafikimin, QKTVT dhe Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, kanë zhvilluar takime dhe kanë shpërndarë fletë-palosje në të gjitha shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në Shqipëri!

#1 TETORI- DITA NDËRKOMBËTARE E MOSHËS SË TRETË



E nisëm muajin Tetor në Shtëpinë e Gjyshërve të Shërbimit Social Shtetëror në Tiranë. 1 Tetori është Dita Ndërkombëtare e Moshës së Tretë, një ditë në të cilën gjithnjë e më tepër duhet të promovojmë një shoqëri miqësore për të gjitha moshat.

Aktivitetin tonë me të moshuarit e mbështetën edhe disa vogëlushë të cilët realizuan një program artistik për ta bërë ditën e gjyshërve më të bukur.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2019

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK

Gjatë muajit Tetor 2019 Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka përfunduar draft raportin mbi kontrollin e realizuar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Shkodër.

Janë monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin Tetor. Gjithashtu është monitoruar sistemi për hedhjen e familjeve ekstremisht të varfra në 12 qarqet e vendit.

Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark, si edhe është monitoruar procesi i mbledhjes së Këshillave Bashkiakë për marrjen e vendimeve.



#Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Gjatë muajit Tetor 2019, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka trajtuar 3 raste VT/VMT.

Është mbledhur Komisioni për Fëmijët, si rezultat janë pranuar 3 fëmijë në IPSH dhe janë transferuar 2 fëmijë në IPSH të tjera.

Është mbledhur Komisioni për të Moshuarit, ku janë shqyrtuar 12 raste, janë sistemuar në IPSH 6 prej tyre, ndërsa 4 të moshuar janë transferuar.


Është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit, ku janë shqyrtuar 100 raste, nga të cilat 44 raste janë paisur për herë të parë me Librezën e Statusit të Jetimit, ndërsa në 51 raste është bërë rinovimi i librezës.

Sipas planit të miratuar të Drejtorisë është bërë monitorimi i Shtëpisë së Fëmijës Durrës, Qendrës së Zhvillimit Rezidencial Durrës dhe Shtëpisë së të Moshuarve Kavajë, për të cilat janë lënë rekomandime për t'u plotësuar.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2019

#Institucionet e Përkujdesit Shoqëror



Denisi ishte një nga përfituesit e shërbimeve sociale pranë "Shtëpi-Familjes për të Rinjtë 16-18 vjeç Shkodër". Në prag të 18 vjetorit të tij, kur sipas ligjit përfundon afati i qëndrimit në institucion, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Shkodër mori masa që të riut t'i krijoheshin kushtet e përshtatshme për një jetesë normale.

Në sajë të ndërmjetësimit me shoqërinë "AbaniaTours Resort" u arrit punësimi dhe strehimi i Denisit, i cili tashmë ka një jetesë të pavarur pas daljes nga institucioni.

Punë të mbarë Denis!


Gjysh Andrean mbase e keni parë rrugëve të qytetit pasi jetonte i braktisur nga të afërmit e tij. Tashmë ai ka një shtëpi të re, të madhe dhe shumë mikpritëse.

Shërbimi Social Shtetëror, pas njohjes me rastin nga mediat, bëri të mundur sistemimin e menjëhershëm të të moshuarit në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, ku nuk do t'i mungojë kujdesi dhe dashuria!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2019

#DE-INSTTUCIONALIZIMI



Plani i De-Institucionalizimit ka marrë prej kohësh rrugën e zbatimit të tij në shumë prej institucioneve tona të përkujdesit shoqëror. Këtë herë ju prezantojmë me Klajdin, i cili gjatë muajit Tetor u kthye në familjen e tij biologjike.

Klajdi ka marrë shërbime sociale në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës për një periudhë 9 vjeçare dhe tani më falë përpjekjeve tona u kthye me sukses pranë gjirit të familjes.

Urime Klajdi, jetë të lumtur pranë familjes!

#NDËRMJETËSIMI PËR PUNËSIM NË TË GJITHA DREJTORITË RAJONALE TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Shërbimi Social Shtetëror beson se zgjidhja më e qëndrueshme për një familje është punësimi. Në kuadër të këtij misioni, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror po zhvillojnë takime bashkëpunimi me Zyrat e Punës në secilin Qark për të vendosur urat e bashkëpunimit për punësimin e anëtarëve madhore të familjeve që përfitojnë nga skema e Ndihmës Ekonomike.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Nëntor 2019

#11 NËNTORI – DITA NDËRKOMBËTARE E JETIMËVE



11 Nëntori është Dita Ndërkombëtare e Jetimëve. E kaluam këtë ditë me fëmijët e familjes sonë të Hanna dhe Rozafës.

Mes shumë emocionesh përcollëm edhe njëherë mesazhin se çdo fëmijë meriton të ketë një familje, shumë dashuri e përkushtim dhe ritheksuam edhe njëherë përpjekjet tona për de-institucionalizimin!

#MARIGLENI TANI ËSHTË I PAVARUR



Marigleni është një nga djemtë tanë të Shtëpisë-Familje 16-18 vjeç Shkodër, i cili tashmë mbushi 18 vjeç dhe sipas ligjit duhet të largohet nga institucioni.

Në kuadër të de-institucionalizimit Marigleni doli nga institucioni dhe po integrohet me sukses në shoqëri. Me mbështetjen e Kishës Ungjillore Delvinë dhe Oratorit "Don Bosko" Shkodër do të mbulohet pagesa e qirasë së shtëpisë ku do të banojë Marigleni.

Gjatë qëndrimit në institucionin tonë Marigleni ka ndjekur shkollën dhe një kurs profesional që do ta ndihmojë të integrohet në tregun e punës. Kujtojmë se Marigleni ka punuar me kontratë të rregullt pune edhe gjatë kohës së qëndrimit në institucion.

Mariglen fat të mbarë nga Shërbimi Social Shtetëror!

SHERBIMI SOCIAL

Buletini Informativ

Nëntor 2019

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK

Gjatë muajit Nëntor 2019 Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka realizuar kontroll mbi zbatimin e legjislacionit për vendimmarrjen e ndihmës ekonomike në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Elbasan.

Janë monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin Nëntor. Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark. Gjithashtu është monitoruar procesi i mbledhjes së Këshillave Bashkiakë për marrjen e vendimeve.



#Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Gjatë muajit Nëntor 2019, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 5 raste VT/VMT, si edhe është menaxhuar pritja e 1 rasti në kufi.

Është mbledhur Komisioni për Personat me Aftësi të Kufizuara, ku është shqyrtuar dokumentacioni dhe është bërë një transferim.

Është mbledhur Komisioni për Fëmijët, ku pas shqyrtimit të dokumentacionit janë pranuar 2 fëmijë në IPSH dhe janë bërë 2 transferime.

Është mbledhur Komisioni për të Moshuarit, ku janë shqyrtuar 19 raste. Janë sistemuar në IPSH 6 prej tyre, janë transferuar 2 raste dhe janë refuzuar 11 prej kërkesave.

Është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit, ku janë shqyrtuar 74 raste, ku të gjitha kanë përfituar status.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Nëntor 2019

#Institucionet e Përkujdesit Shoqëror



Të gjithë përfituesit e shërbimeve në institucionet tona, përveç shërbimeve sociale, marrin një paketë të plotë shërbimesh shëndetësore.

Në Qendrën Polivalente Ditore Kamëz, në bashkëpunim me Autoritetin e Shëndetit Publik dhe me Qendrën Shëndetësore Kamëz, është kryer vaksinimin kundër gripit për 30 të moshuarit që vizitojnë çdo ditë qendrën tonë.

Specialistët i dhanë të moshuarve këshillat përkatëse që do i ndihmojnë ata për të parandaluar virozat e stinës.

Stafi i Shërbimit Social Shtetëror është në krye të detyrës në të gjitha zonat e prekura nga tërmeti i 26 nëntorit.

Po ofrojmë ndihmë psiko-sociale 24 orë për qytetarët e traumatizuar, argëtime për fëmijët dhe evidentim të të gjitha nevojave të qytetarëve në mënyrë që ato të adresohen sa më shpejt dhe gjendja e krijuar të kalohet sa më lehtë.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2019

#FESTAT DUAN DASHURI



Ky fundvit ka qenë i mbushur me festa dhe aktivitete në të gjitha institucionet tona të përkujdesit. Atmosfera festive ka nisur me vendosjen e pemës nga vetë përfituesit në të gjitha institucionet tona.

Me mbështetjen e miqve tanë të Shërbimit Social kemi realizuar aktivitete festive me animatorë dhe si gjithmonë babagjyshi ka sjellë thesin e madh të dhuratave për të gjithë fëmijët dhe të moshuarit!

#FESTË EDHE PËR FËMIJËT E PREKUR NGA TËRMETI



Në të gjitha kampet ku janë vendosur familjet e prekura nga tërmeti Shërbimi Social Shtetëror përveç mbështetjes psiko-sociale dhe mbështetjes me pako ushqimore, ka organizuar festat e fundvitit për të gjithë fëmijët.

Ky fundvit duhet të ishte i bukur për të gjithë, ndaj ne u angazhuam në zbukurimin e festave të fundvitit për të gjithë fëmijët duke i dhuruar secilit prej tyre nga një pako të madhe dhuratash.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2019

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK

Gjatë muajit Dhjetor 2019 Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka realizuar dhe dërguar raportin e kontrollit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Elbasan.

Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark. Është monitoruar procesi i mbledhjes së Këshillave Bashkiakë për marrjen e vendimeve, si edhe monitorimi i kontrolleve të kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin Dhjetor.



#Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Gjatë muajit Dhjetor 2019, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 4 raste VT/VMT.

Është mbledhur Komisioni për Fëmijët, ku pas shqyrtimit të dokumentacionit janë pranuar 2 fëmijë në IPSH.

Është mbledhur Komisioni për të Moshuarit, ku janë shqyrtuar 15 raste. Janë sistemuar në IPSH 3 prej tyre, është transferuar 1 rast dhe janë refuzuar 11 prej kërkesave.

Është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit, janë pajisur me Status të Jetimit 16 raste të reja dhe janë kryer 4 rinovime.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2019

#Institucionet e Përkujdesit Shoqëror



Ka ardhur babagjyshi dhe elfët në Shtëpinë e Fëmijës "Zyber Hallulli"

Ne nuk pritëm ditën e fundit të vitit për të festuar. Me miqtë e Shërbimit Social Shtetëror organizuam një aktivitet festiv me koktejl dhe animatorë. Babagjyshi nuk e harroi thesin e dhuratave as këtë vit!

Mirënjohje për miqtë tanë që këtë fundvit vendosën të bënin më të bukura festat e fëmijëve të familjes sonë të Zyber Hallullit!

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Janar 2020

#SHËRBIMI SOCIAL GJITHNJË NË BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE



Bashkëpunimi është themeli i punës për arritjen e objektivave të përbashkëta, Si gjithmonë, edhe këtë fillim viti në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror u mbajt një takim me organizatat e shoqërisë civile lidhur me Planin e Veprimit 2020 në fushën e shërbimeve sociale.

Ky takim i shërben vazhdimësisë së bashkëpunimit mes Shërbimit Social dhe OJF për të çuar përpara objektivat për fëmijët, PAK, të moshuarit e kështu me radhë.

#TË GJITHË TË INTEGRUAR NË SHOQËRI


Qëllimi i punës së përditshme të institucioneve tona është integrimi me sukses në shoqëri i të gjithë përfituesve. Tashmë, një tjetër prej përfituesve të shërbimeve tona ka nisur rrugëtimin për t'u integruar në shoqëri. Jurgeni, i cili përfiton nga shërbimet e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial Durrës, nisi kursin profesional të kuzhinës në Qendrën Rajonale të Formimit Profesional Publik në Durrës.

Suksese Jurgen! Presim të gatuash ushqime super të shijshme!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Janar 2020

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Janar 2020 ka monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin. Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Është realizuar monitorimi i sistemit pilot të PAK në Qarkun e Tiranës. Gjatë muajit Janar 2020 janë vlerësuar 440 raste individësh me PAK.

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale



Gjatë muajit Janar 2020, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka kryer monitorimin e 3 IPSH (Qendra e Zhvillimit "Pëllumbat", QKTE dhe QKTVDHF), ku është monitoruar zbatimi i rekomandimeve të lëna më parë dhe realizimi i punës në përputhje me standardet.

Janë mbledhur komisionet për pranimet e përfituesve në institucionet e përkujdesit shoqëror. Janë trajtuar 85 kërkesa për Statusin e Jetimit, nga të cilat janë rinovuar 81 libreza. Janë sistemuar në institucion 3 fëmijë dhe është kryer 1 transferim.

Në lidhje me të moshuarit janë shqyrtuar 12 dosje, nga të cilët janë sistemuar në institucion 6 të moshuar dhe është trasnferuar 1 prej tyre.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Janar 2020

#PRANË TË GJITHË QYTETARËVE NË NEVOJË



Pas publikimit të rastit të familjes Pendi në media, Shërbimi Social Shtetëror ka reaguar në mënyrë të menjëhershme duke u gjendur pranë familjes. Falë koordinimit me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Shkodër, familja u mbështet me çdo gjë të nevojshme për jetesën, ushqime, veshmbathje, lodra dhe mjete shkollore për fëmijët, si edhe një karrocë për gjyshen e paralizuar.

Mbi këtë rast u njoftua Sektori Social i Bashkisë së Vaut të Dejës, të cilët e ndihmuan familjen me një sobë druri për të kaluar ditët e ftohta të dimrit.

Përveç ndihmës së menjëhershme, në vijim do të koordinohemi me Zyrën e Punës për të sistemuar në punë kryefamiljarin pasi mënyra më e mirë për ta ndihmuar familjen është t'i sigurojmë një burim të ardhurash të qëndrueshme.

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës me miqtë tanë nga Amerika, të cilët vizituan qendrën dhe ndanë me stafin tonë eksperiencat e tyre, praktikat dhe modelet më të mira që përdoren në vendin e tyre në punën e fëmijët me aftësi ndryshe.

Është gjithmonë shumë kënaqësi të presim miq të rinj që kanë shumë për të na ofruar në rrugëtimin tonë për t'i bërë shërbimet gjithnjë e më cilësore.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2020

#SHËRBIMI SOCIAL NË ÇDO MOMENT PRANË KATEGORIVE NË NEVOJË



Të gjtha strukturat e Shërbimit Social janë të përfshira në mënyrë aktive në mbështetjen e kategorive në nevojë. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Elbasan gjatë muajit SHkurt, me mbështetjen e disa partnerëve tanë, dhuroi produkte ushqimore për bebe të moshës 0-3 vjeç në Qendrën e Misionareve të Bamirësisë së Motrave të Nënë Terezës, Elbasan.

Mirënjohje partnerëve tanë për kontributin e tyre të vazhdueshëm për fëmijët e qendrave rezidenciale dhe ditore.

#EDHE ADI ËSHTË NË PUNË TASHMË

Shërbimi Social Shtetëror është angazhuar intensivisht në procesin e suksesshëm të de-institucionalizimit të përfituesve të shërbimeve. Po vendosim si objektiv që çdo ditë për ne të regjistrojë një rast suksesi të ri.

Adi merr shërbime në Shtëpinë e të Rinjve 16-18 vjeç Shkodër. Ai ndjek arsimin profesional në Hoteleri-Turizëm dhe së fundmi u ndërmjetësua për një punë që përputhet me fushën e tij të studimit. Kujtojmë se Adi pas disa muajsh mbush 18 vjeç dhe tashmë do jetë gati për t'ia dalë vetë!

Punë të mbarë Adi nga Shërbimi Social!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2020

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Shkurt 2020 ka realizuar kontroll mbi zbatimin e legjislacionit në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Vlorë, si edhe janë monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin.

Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Po ashtu, gjatë muajit Shkurt 2020 është kryer monitorimi i procesit të aplikimeve në sistemin pilot nëpërmjet raporteve të krijuara në sistem për aplikantët.

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale



Gjatë muajit Shkurt 2020, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 3 raste VT/VMT. Janë kryer monitorime në 4 IPSH (Qendra Polivalente Polican, Shtëpia e të Moshuarve Fier, Qendra për PAK “Horizont” dhe Qendra Multi-funksionale e Urës Vajgurore), lidhur me rekomandimet lëna më parë dhe realizimi i punës në përputhje me standardet.

Janë mbledhur komisionet për pranimet e përfituesve në institucionet e përkujdesit shoqëror. Janë shqyrtuar në komision 53 kërkesa për Statusin e Jetimit, nga të cilat janë rinovuar 51 libreza. Janë sistemuar në institucion 3 fëmijë dhe 5 të moshuar.

Në lidhje personat me aftësi të kufizuar është mbledhur komisioni dhe është kryer transferimi i një fëmije më AK.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2020

#AKTIVITETET NË INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Dita e zemrave erdhi me një aktivitet argëtues në mjedisin e Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë. Ky aktivitet i organizuar nga MASR, SHKR, Qendra Rinore Tiranë dhe dy gjimnaze të Tiranës, solli në shtëpinë tonë shumë këngë, kërcime, recitime, ëmbëlsira dhe libra të rinj në bibliotekë.

Çdo ditë një rast suksesi – kjo është motoja jonë e re!

Luftëtari është përfitues i shërbimeve tona pranë Qendrës së Zhvillimit Rezidencial Durrës. Ne kemi bërë një tjetër hap të sigurt për të ardhmen. Luftëtari filloi kursin profesional për t'u bërë mekanik në Qendrën e Formimit Profesional Publik Durrës.

SHSSH po bën përpjekje maksimale që të gjithë përfituesit tanë të kenë një të ardhme më të mirë dhe t'i ndërmjetësojmë në tregun e punës pas përfundimit me sukses të kurseve profesionale.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2020

#DITA E GRUAS PRANË SHTËPISË SË TË MOSHUARVE TIRANË



Marsi është muaji i grave. Këtë 8- Mars ne vendosëm të ishim pranë grave të forta të Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë.

Një lule në dorë, një kafe e ngrohtë dhe shumë dashuri në një aktivitet të vetëm, i cili u realizua në bashkëpunim me Artisti Lounge, të cilët shprehën dëshirën për të bërë këtë 8 Mars më të bukur për zonjat tona.

Paralelisht me këtë aktivitet u realizuan aktivitete të tjera argëtuese edhe në institucionet e tjera të përkujdesit që kanë gra përfituese të shërbimeve të tyre.

#KARANTINA E SHËRBIMIT SOCIAL

Covid-19 për fat të keq ka mbërritur edhe në Shqipëri. Një sërë masash të rrepta për parandalimin e përhapjes së infeksionit janë marrë në të gjitha institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijët pa kujdes prindëror, për personat me aftësi ndryshe dhe të moshuarit e vetmuar.

Një pjesë e stafit të 12 institucioneve të përkujdesit janë vetëkarantinuar për të mbrojtur shëndetin e fëmijëve, të moshuarve e personave me aftësi të kufizuara. Punonjësit do të qëndrojnë të mbyllur së bashku me përfituesit e shërbimit derisa situata të ndryshojë.

Nga karantina e Shërbimit Social ata japin për të gjithë mesazhin frymëzues “Unë kujdesem, ti rri në shtëpi”



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2020

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK



Gjatë muajit Mars 2020 Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka përfunduar dhe dorëzuar projekt raportin e kontrollit të realizuar për zbatimin e legjislacionit në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Vlorë.

Është kryer monitorimi i raporteve nga moduli i kontrollit në sistemin e ndihmës ekonomike duke evidentuar dhe ndjekur rastet e mashtrimit dhe gabimeve. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale



Drejtoria e Shërbimeve Sociale gjatë muajit Mars 2020 ka menaxhuar 2 raste VT/VMT dhe 4 raste fëmijësh të cilët kanë qenë raste emergjente për sistemim.

Janë mbledhur komisionet për pranimet e përfituesve në institucionet e përkujdesit shoqëror. Janë shqyrtuar në komision 52 kërkesa për Statusin e Jetimit, prej të cilave 25 e kanë përfituar këtë status për herë të parë, ndërsa 26 libreza janë rinovuar, 1 është refuzuar.

Në kuadër të Covid19 janë hartuar disa urdhra për mbrojtjen e përfituesve të shërbimeve sociale në IPSH, si edhe është krijuar një grup pune i përbërë nga psikologë të cilët do të japin mbështetje psikologjike virtuale gjatë periudhës së karantinimit.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2020

#DREJTORITË RAJONALE



Qytetin e Shkodrës do ta kthejmë në qytetin më miqësor për personat me aftësi të kufizuara. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Shkodër në bashkëpunim me shoqatën "The Door" kanë dhuruar gjatë muajit Mars 20 karroca skuter dhe me bateri për personat me probleme të lëvizjes.

T'i gëzoni karrocat të gjithë e të shëtisni sa më lirshëm në Shkodrën e bukur. Faleminderit "The Door" për mbështetjen e pakushtëzuar!

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR

Prej kohësh në institucionet tona të përkujdesit shoqëror po punohet intensivisht për integrimin në shoqëri të përfituesve të shërbimeve. Motoja e punës sonë është "1 zanat për të gjithë"!

Edhe në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës po e kthejmë ditë pas dite integrimin e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri në prioritetin tonë më madhor. Këtë herë ju prezantojmë me Sarën, një përfituese e shërbimeve në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës, e cila filloi kursin profesional të parukerisë në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën e Formimit Profesional Publik Durrës.

Suksese Sara, jemi të bindur të gjithë që do bëhesh një parukiere shumë e zonja!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2020

#COVID19 – SHËRBIMI SOCIAL PRANË FAMILJEVE NË NEVOJË DHE TË MOSHUARVE TË VETMUAR NË TË GJITHË SHQIPËRINË



Durrës

Si gjithmonë Shërbimi Social Shtetëror ka qëndruar pranë të gjithë qytetarëve në nevojë në momente të vështira. Edhe në luftën me armikun e padukshëm nuk mund të ishte ndryshe.

Në të gjitha qytetet Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror kanë bashkëpunuar ngushtësisht me Bashkitë për shpërndarjen e ndihmave ushqimore në familjet që kanë nevojë.

Stafi i Shërbimit Social ka pritur kërkesat e qytetarëve në të gjitha mënyrat e komunikimit dhe kanë referuar e ndjekur çdo rast deri në shpërndarjen e ndihmave tek familjet dhe të moshuarit.



Tiranë



Shkodër

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill 2020

#SHTËPITË TONA TË TË MOSHUARVE – ASNJË RAST I PREKUR NGA COVID-19



Më datë 30 Prill stafet e institucioneve të përkujdesit shoqëror përfunduan karantinën 50 ditore, për t'u zëvendësuar nga punonjës të tjerë. Ajo që mund të thuhet me shumë siguri është se menaxhimi i situatës së Covid-19 në institucionet e përkujdesit ka qenë një sukses i vërtet sepse nuk kemi asnjë përfitues të prekur.

Fokusi më i shtuar ka qenë sigurisht mbi Shtëpitë e të Moshuarve duke qenë se janë kategoria më e prekur nga Covid-19. Që në ditët e para të pandemisë u morën masa të rrepta falë së cilave jemi krenarë që nuk kemi asnjë rast të prekur nga COVID-19. Ky rezultat është padyshim meritë e punonjësve tanë të institucioneve të përkujdesit të cilët dhanë shembullin e tyre të solidaritetit dhe përkujdesit ndaj atyre që kanë më shumë nevojë.

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Gjatë muajit Prill 2020 është kryer monitorim i skemës së NE dhe dinamikës së saj në rang kombëtar, ku është monitoruar procedura e aplikimeve pas datës 10 Prill. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale dhe janë raportuar problematikat e konstatuara.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill 2020

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR

Aktivitet në institucionet tona të përkujdesit nuk i ndalon as karantina. Ne kemi gjetur mënyra inovative për të qenë aktivë edhe gjatë periudhës së izolimit.

Në Shtëpinë Familje për të Rinjtë 16-18 vjeç periudha e karantinës është shfrytëzuar për të kryher trajnime online mbi punësimin. Misioni ynë mbetet si gjithmonë garantimi jo vetëm i shërbimeve cilësore në qendër, por edhe i mundësive të qëndrueshme pas daljes nga institucioni.



#NE I DUAM GJYSHËRIT

Një vullnetar, një i moshuar i vetmuar! Kjo është motoja jonë drejtuese! Vullnetarët do të jenë çdo ditë pranë të moshuarve për t'i blerë ilaçet, ushqimet, dërgimin e pensionit në shtëpi deri tek dërgimi i ushqimeve të gatuara për ata të moshuar që nuk mund të gatuajnë vetë.

Pavlo dhe Redjoni, të cilët i shihni në foto, do jenë çdo ditë pranë një çifti të moshuarish. Do të kryejnë për ta çdo lloj shërbimi, do të gatuajnë dhe do të plotësojnë çdo nevojë tjetër që gjyshërit mund të kenë. Ju falenderojmë për kontributin dhe zemërgjerësinë tuaj!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill 2020

#COVID19 – VEPRIMTARIA E DREJTORIVE RAJONALE TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR



Elbasan

Edhe gjatë muajit Prill Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror kanë punuar intensivisht për të ndihmuar të moshuarit e vetmuar dhe familjet në nevojë në të gjithë Shqipërinë.

Kushdo që ka kërkuar ndihmë në Portalin e Bashkëqeverisjes, rrjetet sociale zyrtare të Shërbimit Social Shtetëror dhe në Linjën e Gjelbër është ndihmuar në mënyrë të menjëhershme me pako ushqimore.

Përpos shpërndarjes së pakove ushqimore për familjet pa të ardhura është vijuar normalisht me patronazhimin e të moshuarve që nuk mund të dilnim për të bërë pazaret ose shërbimet të tjera vetë.



Fier



Vlorë

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Maj 2020

#DITA KOMBËTARE E JETIMËVE – 01 MAJ 2020



Dita Kombëtare e Jetimëve këtë vit ishte ndryshe nga vitet e tjera. Pandemia e Covid-19 ndryshoi jetesën e të gjithëve, përfshirë edhe atë të fëmijëve dhe stafeve të institucioneve të përkujdesit shoqëror.

Këtë vit falenderimet në Ditën Kombëtare të Jetimëve shkojnë për stafet e institucioneve tona që janë kurdo dashuria e përditshme e fëmijëve të familjes sonë të shërbimit social.

#DITA E FAMILJES NË KARANTINË

15 Maji këtë vit u kalua në karantinë. Izolimi nuk na dha mundësinë e zhvillimit të aktiviteteve megjithatë shikoni pak sa bukur e shprehën vogëlushët tanë konceptin e tyre për familjen.

Misioni ynë është garantimi i një strehe të ngrohtë ku fëmijët të rriten të shëndetshëm, gjithmonë me urimin që ata të kenë sa më shpejt një familje të bukur!



#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Maj 2020 ka monitoruar Skemën e Ndihmës Ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamikën e NE. Janë përpunuar listat e gjeneruara për secilën bashki. Është ndjekur procesi i verifikimit dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Janë ndjekur problematikat si pasojë e situatës së Covid-19, duke u dhënë Drejtorive Rajonale udhëzime me verifikimin me zyrat e punës.

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale



Gjatë muajit Maj 2020, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 5 raste VT/VMT dhe 3 raste dhune.

Janë mbledhur komisionet për pranimet e përfituesve në institucionet e përkujdesit shoqëror. Janë rinovuar 28 libreza për Statusin e Jetimit, janë trajtuar 4 raste fëmijësh, 1 i moshuar dhe 1 PAK për sistemim në institucion.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Maj 2020

#AKTIVITETET NË INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Në institucionet tona të përkujdesit ofrohen shërbime me standarde bashkëkohore dhe ne punojmë që përfituesve të shërbimit të mos u mungojë asgjë. Ama dhuratat na bëjnë të gjithëve të ndihemi të përkëdhelur.

9 të rinjtë e Shtëpisë-Familje 16-18 vjeç Shkodër morën dhurata shumë të bukura nga Ambasada e Izraelit në Shqipëri, nën kujdesin e veçantë të ambasadorit, z. Noah Gal Gendler.

Në emër të të rinjve të familjes sonë të Shërbimit Social shprehim vlerësim dhe mirënjohje për z. Gendler dhe Ambasadën e Izraelit, Shqipëri. Kontributi juaj ka bërë më të këndshme ditët e karantinës në institucion.

Solidariteti me moshën e tretë vazhdon. Gjatë periudhës së karantinës kemi qenë pranë shtëpive të të moshuarve që marrin shërbime në Qendrën Polivalente Ditore Kamëz.

Në pamundësi për të ofruar shërbime në qendër për shkak të Covid-19 po shkojmë në shtëpitë e të gjithë përfituesve tanë për t'i çuar ushqim.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2020

#QERSHORI ËSHTË I FËMIJËVE



Ky 1 Qershor u prit ndryshe nga çdo herë tjetër. Për të garantuar mbrojtjen e shëndetit të përfituesve stafet e institucioneve tona vazhdojnë të jenë në karantinë.

Këtë 1 Qershor fëmijët krijuan së bashku me stafin kopështin e perimeve. E ardhmja do të jetë e shëndetshme. E gëzofshi çdo ditë si të ishte një ditë feste kalamaja!

#GJYSH ZEQIRI IU BASHKUA FAMILJES SË MADHE TË SHËRBIMIT SOCIAL

Gjysh Zeqirit iu shërbye me dashuri dhe përkushtim për dy javë në Qendrën Polivalente Ditore Kamëz, në pritje të procedurës së sistemimit në institucionet për të moshuar.

Për të garantuar mbrojtjen e shëndetit të përfituesve, gjyshi u testua për Covid-19 dhe tashmë është banori më i ri i Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë.

Qëndrim të mbarë në shtëpinë tonë të madhe!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2020

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Gjatë muajit Qershor 2020 Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka monitoruar Skemën e Ndihmës Ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamikën e NE. Janë përpunuar listat e gjeneruara për secilën bashki. Është ndjekur procesi i verifikimit dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Janë ndjekur problematikat si pasojë e situatës së Covid-19, duke u dhënë Drejtorive Rajonale udhëzime me verifikimin me zyrat e punës. Janë ndjekur të gjitha problematikat në MIS dhe NE dhe janë raportuar për t'u zgjidhur.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Qershor 2020, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 3 raste VT/VMT dhe dhune.

Janë mbledhur komisionet për pranimet e përfituesve në institucionet e përkujdesit shoqëror, në të cilët janë shqyrtuar rastet e 5 fëmijëve për sistemim. Janë rinovuar 30 libreza për Statusin e Jetimit. Specialistët kanë marrë pjesë në seanca gjyqësore për 5 raste fëmijësh.

Është zhvilluar trajnim mbi implementimin e Regjistrit Elektronik të Shërbimeve Shoqërore në Qarkun Elbasan.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2020

#AKTIVITETET NË INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Surprizëëëë!

Më 25 Qershor ishim pranë gjyshi Gjonit dhe nëna Sofias të cilët kishin ditëlindjen. Stafi i Qendrës Polivalente Ditore Kamëz i ka uruar gëzuar ditëlindjen përmes një surprize në shtëpitë e tyre.

Gëzuar ditëlindjen gjyshër nga Shërbimi Social Shtetëror!

Karantinimi nuk vazhdon më, por solidariteti po. Gjatë muajit Qershor 2020 stafi i Qendrës Polivalente Ditore Kamëz ka vazhduar të qëndrojë pranë të moshuarve që marrin shërbime duke i ndihmuar me paketa ushqimore në ambientet e shtëpive të tyre.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2020

#AKTIVITETET NË DREJTORITË RAJONALE TË SHËRBIMIT SOCIALE SHTETËROR



Gjatë muajit Qershor Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Elbasan ka zhvilluar trajnime me punonjësit socialë dhe punonjësit e shërbimeve sociale të Njësive Administrative në shtatë Bashkitë e Qarkut Elbasan.

Fokusi i trajnimeve ishte rritja e kapaciteteve të stafeve lidhur me implementimin e suksesshëm të Regjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve Shoqërore. Këto trajnime po zhvillohen dhe do të vazhdojnë edhe në vijim nga të gjitha Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Korrik 2020

#30 KORRIK- DITA BOTËRORE KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE



Trafikimi është shkelje e të drejtave themelore të njeriut dhe çon në dëmtimin fizik, mendor e emocional të viktimave të trafikimit duke i kthyer në grupe vulnerabël të shoqërisë.

Në betejën tonë të përbashkët të parandalimit të trafikimit duhet të informojmë, ndërgjegjësojmë, të lartësojmë dhe mbrojmë të drejtat e viktimave të trafikimit.

Edhe këtë vit, Shërbimi Social Shtetëror përmes QKPVT shpërndau mesazhe informuese dhe ndërgjegjësuese kundër këtij fenomeni. Vetëm duke përcjellë informacion dhe duke ndërgjegjësuar mund të "shkulim" me rrënjë trafikimin e qenieve njerëzore.

#NË FAMILJEN E MADHE TË SHËRBIMI SOCIAL KA GJITHMONË ZGJIDHJE

Tashmë e kemi kthyer në traditë sigurimin e integrimit në shoqëri përpara daljes nga institucionet tona të përkujdesit shoqëror.

Shpëtimtarja është aktualisht përfituese e shërbimeve sociale në Shtëpinë Familje 16-18 vjeç Shkodër. Ajo vazhdon shkollën e mesme profesionale në Hoteleri-Turizëm dhe përveç angazhimit shkollor është punësuar si ndihmës kuzhiniere në një biznes.

Shpëtimtarja sapo ka mbushur moshën 18 vjeç, por dalja nga institucioni për të nuk do të jetë më e vështirë. Urimet më të mira dhe suksese nga Shërbimi Social Shtetëror.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Korrik 2020

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Korrik 2020 ka realizuar programin e kontrollit në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë, ku janë shqyrtuar në sistem verifikimet automatike dhe janë trajtuar mospërputhjet. Është monitoruar Skema e Ndihmës Ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Janë përpunuar listat e gjeneruara për secilën bashki. Është ndjekur procesi i verifikimit dhe vendimmarrjes.

Janë ndjekur problematikat si pasojë e situatës së Covid-19, duke u dhënë Drejtorive Rajonale udhëzime lidhur me deklaratat 3 mujore.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Korrik 2020 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 4 raste VT/VMT dhe dhune.

Janë mbledhur komisionet për pranimet e përfituesve në institucionet e përkujdesit shoqëror ku është shqyrtuar dokumentacioni për sistemimin e 3 fëmijëve dhe 1 personi me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit, në të cilin janë rinovuar 35 libreza.

Specialistët kanë marrë pjesë në seanca gjyqësore për 5 raste fëmijësh, një pjesë e së cilave janë realizuar dhe një pjesë janë ende në proces.

Është zhvilluar trajnim mbi implementimin e Regjistrit Elektronik të Shërbimeve Shoqërore në Qarkun Fier.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Korrik 2020

#AKTIVITETET NË DREJTORITË RAJONALE TË SHËRBIMIT SOCIAL



Shqipëria ka shumë fshatra të largët, por Shërbimi Social gjen çdo mënyrë për të qenë pranë qytetarëve në nevojë. Në bashkëpunim me FoodBank dhe organizatën "The Door" shpërndamë me varkë ushqime dhe veshmbathje për 14 familje në nevojë në Njësinë Administrative Iballë, Bashkia Fushë-Arrëz .

#AKTIVITETET NË INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR

Karantinimi nuk vazhdon më, por solidariteti po. Stafi i Qendrës Polivalente Ditore Kamëz edhe gjatë muajit Korrik 2020 ka vazhduar me vizitat në shtëpitë e gjyshërve me qëllim identifikimin e nevojave, mbështetjen me paketa ushqimore dhe ofrimin e mbështetjes psiko-sociale sipas rasteve.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Gusht 2020

#VAPA E GUSHTIT, POR MASKËN MOS E HARRO



Stafi i Shërbimit Social Shtetëror i është bashkuar apelit të mjekëve infeksionistë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për parandalimin e përhapjes së Covid-19.

Që prej fillimit të pandemisë Shërbimi Social Shtetëror ka marrë të gjithë masat për parandalimin e përhapjes së Covid-19 të tilla, si: ruajtja e distancimit social për stafin dhe qytetarët, mbajtja e maskave, paisja me disifektantë në të gjitha ambientet e institucionit, vendosja e pullave sinjalizuese e kështu me radhë.

Mos harro asnjëherë se maska jote më mbron mua, ndërsa maska ime të mbron ty.

#SHKËLZENI U KTHYE NË SHTËPI

Përfunduam me sukses rikthimin e Shkëlzenit në gjirin e familjes. Shkëlzeni është 17 vjeç dhe përgjatë 6 viteve të qëndrimit të tij në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës ka marrë të gjitha shërbimet shëndetësore dhe psiko-sociale.

Familja është e shenjtë, ndaj punojmë çdo ditë për ta fuqizuar atë. Shumë urime për bashkimin me familjen Shkëlzen!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Gusht 2020

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Gusht 2020 ka përgatitur raportin e kontrollit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë. Është monitoruar Skema e Ndihmës Ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Janë përpunuar listat e gjeneruara për secilën bashki. Është ndjekur procesi i verifikimit dhe vendimmarrjes.

Janë ndjekur problematikat si pasojë e situatës së Covid-19, duke u dhënë Drejtorive Rajonale udhëzime lidhur me deklaratat 3 mujore.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Gusht 2020 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 3 raste VT/VMT dhe 2 raste viktimash të dhunës në familje.

Janë mbledhur komisionet për pranimet e përfituesve në institucionet e përkujdesit shoqëror ku është shqyrtuar dokumentacioni për sistemimin e 5 fëmijëve dhe 1 personi me aftësi të kufizuara. Është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit, në të cilin janë rinovuar 60 libreza.

Specialistët janë njohur me 5 raste fëmijësh, për të cilët është bërë njohja me rastet dhe përgatitja për seancat gjyqësore.

Është zhvilluar terapi online për lehtësimin e ngarkesës emocionale të stafeve të institucioneve të cilat ishin në karantinë.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Gusht 2020

#AKTIVITETET NË DREJTORITË RAJONALE TË SHËRBIMIT SOCIAL



Nëna Zenepja nga Shkodra jeton e vetme dhe Shërbimi Social Shtetëror Shkodër është gjendur gjithnjë pranë saj.

Përveç ndihmës gjatë periudhës së pandemisë, nënës iu sigurua një dyshek spitalor i përshtatur për nevojat e personave që nuk ecin, si edhe karrocë dhe ndihma të tjera.

Kjo është realizuar me ndihmën e vyer të "the Door" që prej kohësh është pranë familjeve në nevojë në Shkodër.
Nënë Zenepja tashmë do të shëtisë dhe do marrë ajër në oborrin e shtëpisë së saj!

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shtator 2020

#DITA E PARË E SHKOLLËS



Me shumë emocione, fëmijët dhe të rinjtë e familjes sonë të madhe dhe të bukur nisën vitin e ri shkollor '20-'21.

Ky vit shkollor është i pazakontë, por ne do të përshtatemi me normalitetin e ri sepse dëshira jonë për dije është më e madhe se çdo gjë tjetër. Së bashku me kujdestaret, fëmijët përgatitën çantat e shkollës, librat, fletoret dhe sigurisht maskat, të cilat do të jenë shoqëruesetona këtë vit.

Suksese fëmijë! Bota e madhe e dijes ju pret, mësoni shumë që të na bëni krenarë.

#FLOGERTA DHE ARMANDO U BASHKUAN ME FAMILJEN



Flogerta dhe Armando, pas një qëndrimi 2 vjeçar në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës, ku morën të gjitha shërbimet sipas nevojave të tyre, iu bashkuan më në fund familjes së tyre biologjike.

Realizuam edhe njëherë me sukses de-institucionalizimin, si një nga prioritet tona në fushën e shërbimeve. Më në fund, Flogerta dhe Armando do të jenë në gjirin e ngrohtë të familjes! Urime dhe qofshi gjithmonë kaq të buzëqeshur sa në foto!

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Shtator 2020 ka monitoruar Skemën e Ndihmës Ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamikën e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit dhe vendimmarrjes.

Janë ndjekur problematikat si pasojë e situatës së Covid-19, duke u dhënë Drejtorive Rajonale udhëzime lidhur me deklaratat 3 mujore. Gjithashtu po ndiqet procesi i reformimit të sistemit të aftësisë së kufizuar, ku është diskutuar mbi rishikimin e metodologjisë së kontrollit të PAK pilot dhe janë nxjerrë urdhrat për indeksimin e aftësisë së kufizuar.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Shtator 2020 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka realizuar komisionimet për sistemimet në institucionet e përkujdesit shoqëror, nga të cilat janë sistemuar 2 fëmijë, 3 PAK dhe 22 të moshuar, si edhe janë transferuar 16 fëmijë dhe 1 i moshuar.

Është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit, në të cilin kanë përfituar status 36 persona.

Janë ndjekur seancat gjyqësore për vendosje kujdestarie për 6 fëmijë dhe në tërësi gjatë muajit janë menaxhuar 20 raste në nevojë.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shtator 2020

#SHËRBIMI SOCIAL PRANË GRUPEVE NË NEVOJË



Duam të ndajmë me ju kënaqësinë e dhurimit të një motorri Skuter për Agimin nga Tirana. Shërbimi Social u njoh me rastin e Agimit nga një kronikë lajmesh në televizion, ku Agimi kishte dalë me shpresën se do të dëgjohej apeli i tij për t'i siguruar një motorr të ri. Motorri që Agimi kishte në momentin e daljes në media ishte i krijuar prej tij dhe rregullimi i tij sa herë paraqiste defekte ishte shumë i vështirë.

Me gjithë dëshirën për ta ndihmuar Agimin, bashkëpunuam menjëherë me partnerin tonë të vyer, organizatën "The Door" me qëllim që Agimit t'i vihej sa më shpejt në dispozicion motorri.

Motorrat janë të llojeve të ndryshme, ndaj me Drejtuesin e organizatës "The Door", z. Kastriot, i dhamë mundësinë Agimit që të zgjidhte motorrin që ai dëshironte dhe që përputhej më mirë me nevojat e tij.

Mos harroni, nga sot, Agimin në qytet do ta shihni me një motorr të ri fringooo!

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2020

#TETORI I ANTI-TRAFIKUT



Shërbimi Social Shtetëror si çdo vit ka realizuar fushatat e ndërgjegjësimit në kuadër të tetorit si muaj kundër trafikut të qenieve njerëzore. Përmes Drejtorive Rajonale dhe QKPVT janë realizuar fushata informimi në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në të gjithë Shqipërinë, ku u ndanë mesazhe lidhur me trafikimin, format dhe efektet që mund të ketë tek viktimat e trafikimit.

#1 TETOR – DITA NDËRKOMBËTARE E MOSHËS SË TRETË

Duke respektuar me rigorozitet protokollet për parandalimin e përhapjes së Covid-19, në 1 Tetor u zhvilluan festimet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Moshës së Tretë. Kjo është dita e ndërgjegjësimit dhe empatisë lidhur me mirëqenien e gjyshërve dhe kontributin e tyre në shoqëri.



Duke qenë në kushtet e Covid-19, me praninë e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, filluam fushatën e vaksinimit kundër gripit stinor. Vaksinimi nisi nga Shtëpia e Gjyshërve në Tiranë dhe vazhdoi në të gjitha Shtëpitë e të Moshuarve në Shqipëri.

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Tetor 2020 ka përfunduar dhe hedhur në sistem raportin përfundimtar për Drejtorinë Rajonale Dibër.

Është monitoruar Skema e Ndihmës Ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Janë ndjekur problematikat si pasojë e situatës së Covid-19, duke u dhënë Drejtorive Rajonale udhëzime lidhur me deklaratat 3 mujore.



#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajit Tetor 2020 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka realizuar komisionimet për sistemimin në institucionet e përkujdesit shoqëror të fëmijëve, nga i cili janë sistemuar 9 fëmijë.

Janë menaxhuar dhe referuar 15 raste qytetarësh sipas nevojave të tyre sociale. Gjithashtu janë ndjekur seancat gjyqësore për vendosje kujdestarie për 2 fëmijë.

Janë ndjekur trajnimet për Regjistrin Elektronik të Shërbimeve Sociale në qarkun e Tiranës, nga ku janë nxjerrë problematikat e hasura gjatë procesit.



#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Ardiasi ka qëndruar 12 vjet në institucionet tona të përkujdesit shoqëror dhe aktualisht është në Shtëpinë Familje për të Rinjtë 16-18 vjeç Shkodër.

Ardiasi ndjek shkollën e mesme profesionale në degën Hoteleri-Turizëm dhe njëkohësisht punon çdo ditë me përkushtim duke respektuar edhe masat anti covid-19.

Nëpërmjet strukturave tona ndihmojmë të rinjtë të integrohen në tregun e punës me qëllim përballimin e jetesës normale dhe në mënyrë të pavarur pas daljes nga institucionet tona të përkujdesit shoqëror.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Nëntor 2020

#16 DITËT E AKTIVIZIMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE



Dëgjo! Beso! Mbështet!

Ky është sllogani që udhëhoqi fushatën e përvitshme të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore, të cilën e startuam nga Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje.

Situata e vështirë e pandemisë në vend nuk na kufizon për t'i thënë STOP përuljes, vetëmohimit, shfrytëzimit të vajzave dhe grave!

#20 NËNTORI – DITA BOTËRORE E FËMIJËVE

20 Nëntori është Dita Botërore e Fëmijëve, një ditë në të cilën çdo vit promovohet përmirësimi i mirëqenies së fëmijëve.


20 Nëntori 2020 përkon me një ditë ndryshe për shkak të pandemisë së Covid-19. Këtë vit Kombet e Bashkuara e kanë vendosur theksin në "imagjinimin e një bote më të qëndrueshme për çdo fëmijë" duke ftuar fëmijët t'i bashkohen thirrjes duke pikturuar mënyrën sesi e perceptojnë botën pas Covid-19.

Edhe fëmijët e institucioneve tona iu bashkuan kësaj thirrjeje me pikturat e tyre.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Nëntor 2020

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Nëntor 2020 ka dërguar njoftimin dhe programin e kontrollit në Drejtorinë Rajonale të SHSSH Kukës.

Është monitoruar Skema e Ndihmës Ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale. Janë ndjekur problematikat si pasojë e situatës së Covid-19, duke u dhënë Drejtorive Rajonale udhëzime lidhur me deklaratat 3 mujore.

Është në proces kontrolli në bazë të programit të kontrollit tek Dispanceria dhe Qendra Shëndetësore nr.2.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Nëntor2020 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka shqyrtuar dokumentacionin për sistemimin e 12 të moshuarve në institucionet e përkujdesit shoqëror. Është mbledhur komisioni për Jetimët dhe janë rinovuar 35 libreza.

Janë menaxhuar dhe referuar 12 raste qytetarësh sipas nevojave të tyre sociale. Janë ndjekur seancat gjyqësore për vendosje kujdestarie për 2 fëmijë.

Specialistët kanë marrë pjesë në Konferencën e TAIEX për implementimin e politikave sociale për grupet në nevojë.

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Antonio është super djali që ne kemi në Shtëpinë Familje për të Rinjtë Shkodër. Antonio është i apasionuar pas futbollit dhe ne e mbështesim pafundësisht në pjesëmarrjet e tij në aktivitete të ndryshme sportive.

I jemi mirënjohës Nismës Shoqërore për Ndryshim - Arsis, të cilët mbështesin djaloshin tonë me fanellat dhe veshjet sportive.

Forcaaa Antonio, presim të bëhesh futbollist i madh!

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2020

#VIT TË MBARË NGA FAMILJA JONË E MADHE



Çdo fundvit Shërbimi Social Shtetëror kishte traditë nismën "Festat Duan Dashuri". Për fat të keq Covid-19 na detyroi të ruajmë distancat e të mos organizojmë festa me miq si çdo vit.

Këtë vit treguam se midis nesh ka dashuri dhe përkujdes të pakushtëzuar gjatë të gjithë vitit. Stafet tona të institucioneve të përkujdesit shoqëror realizuan detyrën e tyre sublime duke u karantinuar së bashku me përfituesit.

Atmosfera e festave trokiti shumë bukur në të gjitha institucionet tona të përkujdesit shoqëror. Dashuri, përkushtim dhe dhurata pafund për fëmijët, personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit dhe grupet në nevojë.

Gëzuar 2021! Vit të mbarë nga familja jonë e bukur!

#RASTET E SUKSESIT NË SHSSH

Bledi është djali jonë 16 vjeçar, një ndër djemtë shembullorë të Shtëpisë-Familje për të Rinj Shkodër.

Ne në shtëpinë tonë të ngrohtë kemi djem dhe vajza shumë të mirë. Bledi ndjek shkollën, ndjek kurse profesionale dhe paralelisht punon në një mobileri të qytetit të Shkodrës. Ndërmjetësimi për punësim u mundësua në bashkëpunim me Qendrën Rinore Arka.

Bravo Bledi, jemi krenarë për ty!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2020

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Dhjetor 2020 ka përfunduar dhe hedhur në sistem raportin përfundimtar për Drejtorinë Rajonale Kukës.

Është monitoruar Skema e Ndihmës Ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Janë ndjekur problematikat si pasojë e situatës së Covid-19, duke u dhënë Drejtorive Rajonale udhëzime lidhur me deklaratat 3 mujore.

Në kuadër të reformimit të sistemit të PAK është kryer kontroll tek Dispanceria dhe Qendra Shëndetësore nr. 3.



#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajit Dhjetor 2020 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka realizuar komisionimet për sistemimin në institucionet e përkujdesit shoqëror të fëmijëve, nga i cili janë sistemuar 3 fëmijë. Janë sistemuar në IPSH 10 të moshuar dhe 1 person me aftësi të kufizuara.

Gjithashtu janë ndjekur seancat gjyqësore për vendosje kujdestarie për 4 fëmijë.

Është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit në të cilin janë shqyrtuar 51 raste.



#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Me nismën e shoqatës "Edu Innovation" dhe projektit të GIZ "Nxitja e mundësive dhe përmirësimi i aftësive digjitale për viktimat e trafikimit", u mundësuan pesë kompjutera në qendrën tonë të trajtimit të viktimave të trafikimit.

Përveç kësaj janë realizuar 10 sesione trajnuese gjatë periudhës Nëntor - Dhjetor 2020 mbi njohuritë bazë të përdorimit të kompjuterit dhe janë pajisur vajzat me certifikatat përkatëse.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Janar 2020

#SHËRBIMI SOCIAL GJITHNJË NË BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE



Bashkëpunimi është themeli i punës për arritjen e objektivave të përbashkëta, Si gjithmonë, edhe këtë fillim viti në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror u mbajt një takim me organizatat e shoqërisë civile lidhur me Planin e Veprimit 2020 në fushën e shërbimeve sociale.

Ky takim i shërben vazhdimësisë së bashkëpunimit mes Shërbimit Social dhe OJF për të çuar përpara objektivat për fëmijët, PAK, të moshuarit e kështu me radhë.

#TË GJITHË TË INTEGRUAR NË SHOQËRI


Qëllimi i punës së përditshme të institucioneve tona është integrimi me sukses në shoqëri i të gjithë përfituesve. Tashmë, një tjetër prej përfituesve të shërbimeve tona ka nisur rrugëtimin për t'u integruar në shoqëri. Jurgeni, i cili përfiton nga shërbimet e Qendrës së Zhvillimit Rezidencial Durrës, nisi kursin profesional të kuzhinës në Qendrën Rajonale të Formimit Profesional Publik në Durrës.

Suksese Jurgen! Presim të gatuash ushqime super të shijshme!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Janar 2020

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Janar 2020 ka monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin. Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Është realizuar monitorimi i sistemit pilot të PAK në Qarkun e Tiranës. Gjatë muajit Janar 2020 janë vlerësuar 440 raste individësh me PAK.

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale



Gjatë muajit Janar 2020, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka kryer monitorimin e 3 IPSH (Qendra e Zhvillimit "Pëllumbat", QKTE dhe QKTVDHF), ku është monitoruar zbatimi i rekomandimeve të lëna më parë dhe realizimi i punës në përputhje me standardet.

Janë mbledhur komisionet për pranimet e përfituesve në institucionet e përkujdesit shoqëror. Janë trajtuar 85 kërkesa për Statusin e Jetimit, nga të cilat janë rinovuar 81 libreza. Janë sistemuar në institucion 3 fëmijë dhe është kryer 1 transferim.

Në lidhje me të moshuarit janë shqyrtuar 12 dosje, nga të cilët janë sistemuar në institucion 6 të moshuar dhe është trasnferuar 1 prej tyre.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Janar 2020

#PRANË TË GJITHË QYTETARËVE NË NEVOJË



Pas publikimit të rastit të familjes Pendi në media, Shërbimi Social Shtetëror ka reaguar në mënyrë të menjëhershme duke u gjendur pranë familjes. Falë koordinimit me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Shkodër, familja u mbështet me çdo gjë të nevojshme për jetesën, ushqime, veshmbathje, lodra dhe mjete shkollore për fëmijët, si edhe një karrocë për gjyshen e paralizuar.

Mbi këtë rast u njoftua Sektori Social i Bashkisë së Vaut të Dejës, të cilët e ndihmuan familjen me një sobë druri për të kaluar ditët e ftohta të dimrit.

Përveç ndihmës së menjëhershme, në vijim do të koordinohemi me Zyrën e Punës për të sistemuar në punë kryefamiljarin pasi mënyra më e mirë për ta ndihmuar familjen është t'i sigurojmë një burim të ardhurash të qëndrueshme.

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës me miqtë tanë nga Amerika, të cilët vizituan qendrën dhe ndanë me stafin tonë eksperiencat e tyre, praktikat dhe modelet më të mira që përdoren në vendin e tyre në punën e fëmijët me aftësi ndryshe.

Është gjithmonë shumë kënaqësi të presim miq të rinj që kanë shumë për të na ofruar në rrugëtimin tonë për t'i bërë shërbimet gjithnjë e më cilësore.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2020

#SHËRBIMI SOCIAL NË ÇDO MOMENT PRANË KATEGORIVE NË NEVOJË



Të gjtha strukturat e Shërbimit Social janë të përfshira në mënyrë aktive në mbështetjen e kategorive në nevojë. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Elbasan gjatë muajit SHkurt, me mbështetjen e disa partnerëve tanë, dhuroi produkte ushqimore për bebe të moshës 0-3 vjeç në Qendrën e Misionareve të Bamirësisë së Motrave të Nënë Terezës, Elbasan.

Mirënjohje partnerëve tanë për kontributin e tyre të vazhdueshëm për fëmijët e qendrave rezidenciale dhe ditore.

#EDHE ADI ËSHTË NË PUNË TASHMË

Shërbimi Social Shtetëror është angazhuar intensivisht në procesin e suksesshëm të de-institucionalizimit të përfituesve të shërbimeve. Po vendosim si objektiv që çdo ditë për ne të regjistrojë një rast suksesi të ri.

Adi merr shërbime në Shtëpinë e të Rinjve 16-18 vjeç Shkodër. Ai ndjek arsimin profesional në Hoteleri-Turizëm dhe së fundmi u ndërmjetësua për një punë që përputhet me fushën e tij të studimit. Kujtojmë se Adi pas disa muajsh mbush 18 vjeç dhe tashmë do jetë gati për t'ia dalë vetë!

Punë të mbarë Adi nga Shërbimi Social!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2020

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Shkurt 2020 ka realizuar kontroll mbi zbatimin e legjislacionit në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Vlorë, si edhe janë monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin.

Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Po ashtu, gjatë muajit Shkurt 2020 është kryer monitorimi i procesit të aplikimeve në sistemin pilot nëpërmjet raporteve të krijuara në sistem për aplikantët.

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale



Gjatë muajit Shkurt 2020, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 3 raste VT/VMT. Janë kryer monitorime në 4 IPSH (Qendra Polivalente Polican, Shtëpia e të Moshuarve Fier, Qendra për PAK “Horizont” dhe Qendra Multi-funksionale e Urës Vajgurore), lidhur me rekomandimet lëna më parë dhe realizimi i punës në përputhje me standardet.

Janë mbledhur komisionet për pranimet e përfituesve në institucionet e përkujdesit shoqëror. Janë shqyrtuar në komision 53 kërkesa për Statusin e Jetimit, nga të cilat janë rinovuar 51 libreza. Janë sistemuar në institucion 3 fëmijë dhe 5 të moshuar.

Në lidhje personat me aftësi të kufizuar është mbledhur komisioni dhe është kryer transferimi i një fëmije më AK.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2020

#AKTIVITETET NË INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Dita e zemrave erdhi me një aktivitet argëtues në mjedisin e Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë. Ky aktivitet i organizuar nga MASR, SHKR, Qendra Rinore Tiranë dhe dy gjimnaze të Tiranës, solli në shtëpinë tonë shumë këngë, kërcime, recitime, ëmbëlsira dhe libra të rinj në bibliotekë.

Çdo ditë një rast suksesi – kjo është motoja jonë e re!

Luftëtari është përfitues i shërbimeve tona pranë Qendrës së Zhvillimit Rezidencial Durrës. Ne kemi bërë një tjetër hap të sigurt për të ardhmen. Luftëtari filloi kursin profesional për t'u bërë mekanik në Qendrën e Formimit Profesional Publik Durrës.

SHSSH po bën përpjekje maksimale që të gjithë përfituesit tanë të kenë një të ardhme më të mirë dhe t'i ndërmjetësojmë në tregun e punës pas përfundimit me sukses të kurseve profesionale.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2020

#DITA E GRUAS PRANË SHTËPISË SË TË MOSHUARVE TIRANË



Marsi është muaji i grave. Këtë 8- Mars ne vendosëm të ishim pranë grave të forta të Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë.

Një lule në dorë, një kafe e ngrohtë dhe shumë dashuri në një aktivitet të vetëm, i cili u realizua në bashkëpunim me Artisti Lounge, të cilët shprehën dëshirën për të bërë këtë 8 Mars më të bukur për zonjat tona.

Paralelisht me këtë aktivitet u realizuan aktivitete të tjera argëtuese edhe në institucionet e tjera të përkujdesit që kanë gra përfituese të shërbimeve të tyre.

#KARANTINA E SHËRBIMIT SOCIAL

Covid-19 për fat të keq ka mbërritur edhe në Shqipëri. Një sërë masash të rrepta për parandalimin e përhapjes së infeksionit janë marrë në të gjitha institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijët pa kujdes prindëror, për personat me aftësi ndryshe dhe të moshuarit e vetmuar.

Një pjesë e stafit të 12 institucioneve të përkujdesit janë vetëkarantinuar për të mbrojtur shëndetin e fëmijëve, të moshuarve e personave me aftësi të kufizuara. Punonjësit do të qëndrojnë të mbyllur së bashku me përfituesit e shërbimit derisa situata të ndryshojë.

Nga karantina e Shërbimit Social ata japin për të gjithë mesazhin frymëzues “Unë kujdesem, ti rri në shtëpi”



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2020

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK



Gjatë muajit Mars 2020 Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka përfunduar dhe dorëzuar projekt raportin e kontrollit të realizuar për zbatimin e legjislacionit në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Vlorë.

Është kryer monitorimi i raporteve nga moduli i kontrollit në sistemin e ndihmës ekonomike duke evidentuar dhe ndjekur rastet e mashtrimit dhe gabimeve. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale



Drejtoria e Shërbimeve Sociale gjatë muajit Mars 2020 ka menaxhuar 2 raste VT/VMT dhe 4 raste fëmijësh të cilët kanë qenë raste emergjente për sistemim.

Janë mbledhur komisionet për pranimet e përfituesve në institucionet e përkujdesit shoqëror. Janë shqyrtuar në komision 52 kërkesa për Statusin e Jetimit, prej të cilave 25 e kanë përfituar këtë status për herë të parë, ndërsa 26 libreza janë rinovuar, 1 është refuzuar.

Në kuadër të Covid19 janë hartuar disa urdhra për mbrojtjen e përfituesve të shërbimeve sociale në IPSH, si edhe është krijuar një grup pune i përbërë nga psikologë të cilët do të japin mbështetje psikologjike virtuale gjatë periudhës së karantinimit.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2020

#DREJTORITË RAJONALE



Qytetin e Shkodrës do ta kthejmë në qytetin më miqësor për personat me aftësi të kufizuara. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Shkodër në bashkëpunim me shoqatën "The Door" kanë dhuruar gjatë muajit Mars 20 karroca skuter dhe me bateri për personat me probleme të lëvizjes.

T'i gëzoni karrocat të gjithë e të shëtisni sa më lirshëm në Shkodrën e bukur. Faleminderit "The Door" për mbështetjen e pakushtëzuar!

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR

Prej kohësh në institucionet tona të përkujdesit shoqëror po punohet intensivisht për integrimin në shoqëri të përfituesve të shërbimeve. Motoja e punës sonë është "1 zanat për të gjithë"!

Edhe në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës po e kthejmë ditë pas dite integrimin e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri në prioritetin tonë më madhor. Këtë herë ju prezantojmë me Sarën, një përfituese e shërbimeve në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës, e cila filloi kursin profesional të parukerisë në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën e Formimit Profesional Publik Durrës.

Suksese Sara, jemi të bindur të gjithë që do bëhesh një parukiere shumë e zonja!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2020

#COVID19 – SHËRBIMI SOCIAL PRANË FAMILJEVE NË NEVOJË DHE TË MOSHUARVE TË VETMUAR NË TË GJITHË SHQIPËRINË



Durrës

Si gjithmonë Shërbimi Social Shtetëror ka qëndruar pranë të gjithë qytetarëve në nevojë në momente të vështira. Edhe në luftën me armikun e padukshëm nuk mund të ishte ndryshe.

Në të gjitha qytetet Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror kanë bashkëpunuar ngushtësisht me Bashkitë për shpërndarjen e ndihmave ushqimore në familjet që kanë nevojë.

Stafi i Shërbimit Social ka pritur kërkesat e qytetarëve në të gjitha mënyrat e komunikimit dhe kanë referuar e ndjekur çdo rast deri në shpërndarjen e ndihmave tek familjet dhe të moshuarit.



Tiranë



Shkodër

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill 2020

#SHTËPITË TONA TË TË MOSHUARVE – ASNJË RAST I PREKUR NGA COVID-19



Më datë 30 Prill stafet e institucioneve të përkujdesit shoqëror përfunduan karantinën 50 ditore, për t'u zëvendësuar nga punonjës të tjerë. Ajo që mund të thuhet me shumë siguri është se menaxhimi i situatës së Covid-19 në institucionet e përkujdesit ka qenë një sukses i vërtet sepse nuk kemi asnjë përfitues të prekur.

Fokusi më i shtuar ka qenë sigurisht mbi Shtëpitë e të Moshuarve duke qenë se janë kategoria më e prekur nga Covid-19. Që në ditët e para të pandemisë u morën masa të rrepta falë së cilave jemi krenarë që nuk kemi asnjë rast të prekur nga COVID-19. Ky rezultat është padyshim meritë e punonjësve tanë të institucioneve të përkujdesit të cilët dhanë shembullin e tyre të solidaritetit dhe përkujdesit ndaj atyre që kanë më shumë nevojë.

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Gjatë muajit Prill 2020 është kryer monitorim i skemës së NE dhe dinamikës së saj në rang kombëtar, ku është monitoruar procedura e aplikimeve pas datës 10 Prill. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale dhe janë raportuar problematikat e konstatuara.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill 2020

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR

Aktivitet në institucionet tona të përkujdesit nuk i ndalon as karantina. Ne kemi gjetur mënyra inovative për të qenë aktivë edhe gjatë periudhës së izolimit.

Në Shtëpinë Familje për të Rinjtë 16-18 vjeç periudha e karantinës është shfrytëzuar për të kryher trajnime online mbi punësimin. Misioni ynë mbetet si gjithmonë garantimi jo vetëm i shërbimeve cilësore në qendër, por edhe i mundësive të qëndrueshme pas daljes nga institucioni.



#NE I DUAM GJYSHËRIT

Një vullnetar, një i moshuar i vetmuar! Kjo është motoja jonë drejtuese! Vullnetarët do të jenë çdo ditë pranë të moshuarve për t'i blerë ilaçet, ushqimet, dërgimin e pensionit në shtëpi deri tek dërgimi i ushqimeve të gatuara për ata të moshuar që nuk mund të gatuajnë vetë.

Pavlo dhe Redjoni, të cilët i shihni në foto, do jenë çdo ditë pranë një çifti të moshuarish. Do të kryejnë për ta çdo lloj shërbimi, do të gatuajnë dhe do të plotësojnë çdo nevojë tjetër që gjyshërit mund të kenë. Ju falenderojmë për kontributin dhe zemërgjerësinë tuaj!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill 2020

#COVID19 – VEPRIMTARIA E DREJTORIVE RAJONALE TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR



Elbasan

Edhe gjatë muajit Prill Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror kanë punuar intensivisht për të ndihmuar të moshuarit e vetmuar dhe familjet në nevojë në të gjithë Shqipërinë.

Kushdo që ka kërkuar ndihmë në Portalin e Bashkëqeverisjes, rrjetet sociale zyrtare të Shërbimit Social Shtetëror dhe në Linjën e Gjelbër është ndihmuar në mënyrë të menjëhershme me pako ushqimore.

Përpos shpërndarjes së pakove ushqimore për familjet pa të ardhura është vijuar normalisht me patronazhimin e të moshuarve që nuk mund të dilnim për të bërë pazaret ose shërbimet të tjera vetë.



Fier



Vlorë

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Maj 2020

#DITA KOMBËTARE E JETIMËVE – 01 MAJ 2020



Dita Kombëtare e Jetimëve këtë vit ishte ndryshe nga vitet e tjera. Pandemia e Covid-19 ndryshoi jetesën e të gjithëve, përfshirë edhe atë të fëmijëve dhe stafeve të institucioneve të përkujdesit shoqëror.

Këtë vit falenderimet në Ditën Kombëtare të Jetimëve shkojnë për stafet e institucioneve tona që janë kurdo dashuria e përditshme e fëmijëve të familjes sonë të shërbimit social.

#DITA E FAMILJES NË KARANTINË

15 Maji këtë vit u kalua në karantinë. Izolimi nuk na dha mundësinë e zhvillimit të aktiviteteve megjithatë shikoni pak sa bukur e shprehën vogëlushët tanë konceptin e tyre për familjen.

Misioni ynë është garantimi i një strehe të ngrohtë ku fëmijët të rriten të shëndetshëm, gjithmonë me urimin që ata të kenë sa më shpejt një familje të bukur!



#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Maj 2020 ka monitoruar Skemën e Ndihmës Ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamikën e NE. Janë përpunuar listat e gjeneruara për secilën bashki. Është ndjekur procesi i verifikimit dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Janë ndjekur problematikat si pasojë e situatës së Covid-19, duke u dhënë Drejtorive Rajonale udhëzime me verifikimin me zyrat e punës.

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale



Gjatë muajit Maj 2020, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 5 raste VT/VMT dhe 3 raste dhune.

Janë mbledhur komisionet për pranimet e përfituesve në institucionet e përkujdesit shoqëror. Janë rinovuar 28 libreza për Statusin e Jetimit, janë trajtuar 4 raste fëmijësh, 1 i moshuar dhe 1 PAK për sistemim në institucion.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Maj 2020

#AKTIVITETET NË INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Në institucionet tona të përkujdesit ofrohen shërbime me standarde bashkëkohore dhe ne punojmë që përfituesve të shërbimit të mos u mungojë asgjë. Ama dhuratat na bëjnë të gjithëve të ndihemi të përkëdhelur.

9 të rinjtë e Shtëpisë-Familje 16-18 vjeç Shkodër morën dhurata shumë të bukura nga Ambasada e Izraelit në Shqipëri, nën kujdesin e veçantë të ambasadorit, z. Noah Gal Gendler.

Në emër të të rinjve të familjes sonë të Shërbimit Social shprehim vlerësim dhe mirënjohje për z. Gendler dhe Ambasadën e Izraelit, Shqipëri. Kontributi juaj ka bërë më të këndshme ditët e karantinës në institucion.

Solidariteti me moshën e tretë vazhdon. Gjatë periudhës së karantinës kemi qenë pranë shtëpive të të moshuarve që marrin shërbime në Qendrën Polivalente Ditore Kamëz.

Në pamundësi për të ofruar shërbime në qendër për shkak të Covid-19 po shkojmë në shtëpitë e të gjithë përfituesve tanë për t'i çuar ushqim.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2020

#QERSHORI ËSHTË I FËMIJËVE



Ky 1 Qershor u prit ndryshe nga çdo herë tjetër. Për të garantuar mbrojtjen e shëndetit të përfituesve stafet e institucioneve tona vazhdojnë të jenë në karantinë.

Këtë 1 Qershor fëmijët krijuan së bashku me stafin kopështin e perimeve. E ardhmja do të jetë e shëndetshme. E gëzofshi çdo ditë si të ishte një ditë feste kalamaja!

#GJYSH ZEQIRI IU BASHKUA FAMILJES SË MADHE TË SHËRBIMIT SOCIAL

Gjysh Zeqirit iu shërbye me dashuri dhe përkushtim për dy javë në Qendrën Polivalente Ditore Kamëz, në pritje të procedurës së sistemimit në institucionet për të moshuar.

Për të garantuar mbrojtjen e shëndetit të përfituesve, gjyshi u testua për Covid-19 dhe tashmë është banori më i ri i Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë.

Qëndrim të mbarë në shtëpinë tonë të madhe!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2020

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Gjatë muajit Qershor 2020 Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka monitoruar Skemën e Ndihmës Ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamikën e NE. Janë përpunuar listat e gjeneruara për secilën bashki. Është ndjekur procesi i verifikimit dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Janë ndjekur problematikat si pasojë e situatës së Covid-19, duke u dhënë Drejtorive Rajonale udhëzime me verifikimin me zyrat e punës. Janë ndjekur të gjitha problematikat në MIS dhe NE dhe janë raportuar për t'u zgjidhur.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Qershor 2020, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 3 raste VT/VMT dhe dhune.

Janë mbledhur komisionet për pranimet e përfituesve në institucionet e përkujdesit shoqëror, në të cilët janë shqyrtuar rastet e 5 fëmijëve për sistemim. Janë rinovuar 30 libreza për Statusin e Jetimit. Specialistët kanë marrë pjesë në seanca gjyqësore për 5 raste fëmijësh.

Është zhvilluar trajnim mbi implementimin e Regjistrit Elektronik të Shërbimeve Shoqërore në Qarkun Elbasan.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2020

#AKTIVITETET NË INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Surprizëëëë!

Më 25 Qershor ishim pranë gjyshi Gjonit dhe nëna Sofias të cilët kishin ditëlindjen. Stafi i Qendrës Polivalente Ditore Kamëz i ka uruar gëzuar ditëlindjen përmes një surprize në shtëpitë e tyre.

Gëzuar ditëlindjen gjyshër nga Shërbimi Social Shtetëror!

Karantinimi nuk vazhdon më, por solidariteti po. Gjatë muajit Qershor 2020 stafi i Qendrës Polivalente Ditore Kamëz ka vazhduar të qëndrojë pranë të moshuarve që marrin shërbime duke i ndihmuar me paketa ushqimore në ambientet e shtëpive të tyre.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2020

#AKTIVITETET NË DREJTORITË RAJONALE TË SHËRBIMIT SOCIALE SHTETËROR



Gjatë muajit Qershor Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Elbasan ka zhvilluar trajnime me punonjësit socialë dhe punonjësit e shërbimeve sociale të Njësive Administrative në shtatë Bashkitë e Qarkut Elbasan.

Fokusi i trajnimeve ishte rritja e kapaciteteve të stafeve lidhur me implementimin e suksesshëm të Regjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve Shoqërore. Këto trajnime po zhvillohen dhe do të vazhdojnë edhe në vijim nga të gjitha Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Korrik 2020

#30 KORRIK- DITA BOTËRORE KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE



Trafikimi është shkelje e të drejtave themelore të njeriut dhe çon në dëmtimin fizik, mendor e emocional të viktimave të trafikimit duke i kthyer në grupe vulnerabël të shoqërisë.

Në betejën tonë të përbashkët të parandalimit të trafikimit duhet të informojmë, ndërgjegjësojmë, të lartësojmë dhe mbrojmë të drejtat e viktimave të trafikimit.

Edhe këtë vit, Shërbimi Social Shtetëror përmes QKPVT shpërndau mesazhe informuese dhe ndërgjegjësuese kundër këtij fenomeni. Vetëm duke përcjellë informacion dhe duke ndërgjegjësuar mund të "shkulim" me rrënjë trafikimin e qenieve njerëzore.

#NË FAMILJEN E MADHE TË SHËRBIMI SOCIAL KA GJITHMONË ZGJIDHJE

Tashmë e kemi kthyer në traditë sigurimin e integrimit në shoqëri përpara daljes nga institucionet tona të përkujdesit shoqëror.

Shpëtimtarja është aktualisht përfituese e shërbimeve sociale në Shtëpinë Familje 16-18 vjeç Shkodër. Ajo vazhdon shkollën e mesme profesionale në Hoteleri-Turizëm dhe përveç angazhimit shkollor është punësuar si ndihmës kuzhiniere në një biznes.

Shpëtimtarja sapo ka mbushur moshën 18 vjeç, por dalja nga institucioni për të nuk do të jetë më e vështirë. Urimet më të mira dhe suksese nga Shërbimi Social Shtetëror.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Korrik 2020

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Korrik 2020 ka realizuar programin e kontrollit në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë, ku janë shqyrtuar në sistem verifikimet automatike dhe janë trajtuar mospërputhjet. Është monitoruar Skema e Ndihmës Ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Janë përpunuar listat e gjeneruara për secilën bashki. Është ndjekur procesi i verifikimit dhe vendimmarrjes.

Janë ndjekur problematikat si pasojë e situatës së Covid-19, duke u dhënë Drejtorive Rajonale udhëzime lidhur me deklaratat 3 mujore.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Korrik 2020 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 4 raste VT/VMT dhe dhune.

Janë mbledhur komisionet për pranimet e përfituesve në institucionet e përkujdesit shoqëror ku është shqyrtuar dokumentacioni për sistemimin e 3 fëmijëve dhe 1 personi me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit, në të cilin janë rinovuar 35 libreza.

Specialistët kanë marrë pjesë në seanca gjyqësore për 5 raste fëmijësh, një pjesë e së cilave janë realizuar dhe një pjesë janë ende në proces.

Është zhvilluar trajnim mbi implementimin e Regjistrit Elektronik të Shërbimeve Shoqërore në Qarkun Fier.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Korrik 2020

#AKTIVITETET NË DREJTORITË RAJONALE TË SHËRBIMIT SOCIAL



Shqipëria ka shumë fshatra të largët, por Shërbimi Social gjen çdo mënyrë për të qenë pranë qytetarëve në nevojë. Në bashkëpunim me FoodBank dhe organizatën "The Door" shpërndamë me varkë ushqime dhe veshmbathje për 14 familje në nevojë në Njësinë Administrative Iballë, Bashkia Fushë-Arrëz .

#AKTIVITETET NË INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR

Karantinimi nuk vazhdon më, por solidariteti po. Stafi i Qendrës Polivalente Ditore Kamëz edhe gjatë muajit Korrik 2020 ka vazhduar me vizitat në shtëpitë e gjyshërve me qëllim identifikimin e nevojave, mbështetjen me paketa ushqimore dhe ofrimin e mbështetjes psiko-sociale sipas rasteve.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Gusht 2020

#VAPA E GUSHTIT, POR MASKËN MOS E HARRO



Stafi i Shërbimit Social Shtetëror i është bashkuar apelit të mjekëve infeksionistë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për parandalimin e përhapjes së Covid-19.

Që prej fillimit të pandemisë Shërbimi Social Shtetëror ka marrë të gjithë masat për parandalimin e përhapjes së Covid-19 të tilla, si: ruajtja e distancimit social për stafin dhe qytetarët, mbajtja e maskave, paisja me disifektantë në të gjitha ambientet e institucionit, vendosja e pullave sinjalizuese e kështu me radhë.

Mos harro asnjëherë se maska jote më mbron mua, ndërsa maska ime të mbron ty.

#SHKËLZENI U KTHYE NË SHTËPI

Përfunduam me sukses rikthimin e Shkëlzenit në gjirin e familjes. Shkëlzeni është 17 vjeç dhe përgjatë 6 viteve të qëndrimit të tij në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës ka marrë të gjitha shërbimet shëndetësore dhe psiko-sociale.

Familja është e shenjtë, ndaj punojmë çdo ditë për ta fuqizuar atë. Shumë urime për bashkimin me familjen Shkëlzen!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Gusht 2020

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Gusht 2020 ka përgatitur raportin e kontrollit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë. Është monitoruar Skema e Ndihmës Ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Janë përpunuar listat e gjeneruara për secilën bashki. Është ndjekur procesi i verifikimit dhe vendimmarrjes.

Janë ndjekur problematikat si pasojë e situatës së Covid-19, duke u dhënë Drejtorive Rajonale udhëzime lidhur me deklaratat 3 mujore.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Gusht 2020 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 3 raste VT/VMT dhe 2 raste viktimash të dhunës në familje.

Janë mbledhur komisionet për pranimet e përfituesve në institucionet e përkujdesit shoqëror ku është shqyrtuar dokumentacioni për sistemimin e 5 fëmijëve dhe 1 personi me aftësi të kufizuara. Është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit, në të cilin janë rinovuar 60 libreza.

Specialistët janë njohur me 5 raste fëmijësh, për të cilët është bërë njohja me rastet dhe përgatitja për seancat gjyqësore.

Është zhvilluar terapi online për lehtësimin e ngarkesës emocionale të stafeve të institucioneve të cilat ishin në karantinë.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Gusht 2020

#AKTIVITETET NË DREJTORITË RAJONALE TË SHËRBIMIT SOCIAL



Nëna Zenepja nga Shkodra jeton e vetme dhe Shërbimi Social Shtetëror Shkodër është gjendur gjithnjë pranë saj.

Përveç ndihmës gjatë periudhës së pandemisë, nënës iu sigurua një dyshek spitalor i përshtatur për nevojat e personave që nuk ecin, si edhe karrocë dhe ndihma të tjera.

Kjo është realizuar me ndihmën e vyer të "the Door" që prej kohësh është pranë familjeve në nevojë në Shkodër.
Nënë Zenepja tashmë do të shëtisë dhe do marrë ajër në oborrin e shtëpisë së saj!

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shtator 2020

#DITA E PARË E SHKOLLËS



Me shumë emocione, fëmijët dhe të rinjtë e familjes sonë të madhe dhe të bukur nisën vitin e ri shkollor '20-'21.

Ky vit shkollor është i pazakontë, por ne do të përshtatemi me normalitetin e ri sepse dëshira jonë për dije është më e madhe se çdo gjë tjetër. Së bashku me kujdestaret, fëmijët përgatitën çantat e shkollës, librat, fletoret dhe sigurisht maskat, të cilat do të jenë shoqëruesetona këtë vit.

Suksese fëmijë! Bota e madhe e dijes ju pret, mësoni shumë që të na bëni krenarë.

#FLOGERTA DHE ARMANDO U BASHKUAN ME FAMILJEN



Flogerta dhe Armando, pas një qëndrimi 2 vjeçar në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës, ku morën të gjitha shërbimet sipas nevojave të tyre, iu bashkuan më në fund familjes së tyre biologjike.

Realizuam edhe njëherë me sukses de-institucionalizimin, si një nga prioritet tona në fushën e shërbimeve. Më në fund, Flogerta dhe Armando do të jenë në gjirin e ngrohtë të familjes! Urime dhe qofshi gjithmonë kaq të buzëqeshur sa në foto!

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Shtator 2020 ka monitoruar Skemën e Ndihmës Ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamikën e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit dhe vendimmarrjes.

Janë ndjekur problematikat si pasojë e situatës së Covid-19, duke u dhënë Drejtorive Rajonale udhëzime lidhur me deklaratat 3 mujore. Gjithashtu po ndiqet procesi i reformimit të sistemit të aftësisë së kufizuar, ku është diskutuar mbi rishikimin e metodologjisë së kontrollit të PAK pilot dhe janë nxjerrë urdhrat për indeksimin e aftësisë së kufizuar.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Shtator 2020 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka realizuar komisionimet për sistemimet në institucionet e përkujdesit shoqëror, nga të cilat janë sistemuar 2 fëmijë, 3 PAK dhe 22 të moshuar, si edhe janë transferuar 16 fëmijë dhe 1 i moshuar.

Është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit, në të cilin kanë përfituar status 36 persona.

Janë ndjekur seancat gjyqësore për vendosje kujdestarie për 6 fëmijë dhe në tërësi gjatë muajit janë menaxhuar 20 raste në nevojë.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shtator 2020

#SHËRBIMI SOCIAL PRANË GRUPEVE NË NEVOJË



Duam të ndajmë me ju kënaqësinë e dhurimit të një motorri Skuter për Agimin nga Tirana. Shërbimi Social u njoh me rastin e Agimit nga një kronikë lajmesh në televizion, ku Agimi kishte dalë me shpresën se do të dëgjohej apeli i tij për t'i siguruar një motorr të ri. Motorri që Agimi kishte në momentin e daljes në media ishte i krijuar prej tij dhe rregullimi i tij sa herë paraqiste defekte ishte shumë i vështirë.

Me gjithë dëshirën për ta ndihmuar Agimin, bashkëpunuam menjëherë me partnerin tonë të vyer, organizatën "The Door" me qëllim që Agimit t'i vihej sa më shpejt në dispozicion motorri.

Motorrat janë të llojeve të ndryshme, ndaj me Drejtuesin e organizatës "The Door", z. Kastriot, i dhamë mundësinë Agimit që të zgjidhte motorrin që ai dëshironte dhe që përputhej më mirë me nevojat e tij.

Mos harroni, nga sot, Agimin në qytet do ta shihni me një motorr të ri fringooo!

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2020

#TETORI I ANTI-TRAFIKUT



Shërbimi Social Shtetëror si çdo vit ka realizuar fushatat e ndërgjegjësimit në kuadër të tetorit si muaj kundër trafikut të qenieve njerëzore. Përmes Drejtorive Rajonale dhe QKPVT janë realizuar fushata informimi në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në të gjithë Shqipërinë, ku u ndanë mesazhe lidhur me trafikimin, format dhe efektet që mund të ketë tek viktimat e trafikimit.

#1 TETOR – DITA NDËRKOMBËTARE E MOSHËS SË TRETË

Duke respektuar me rigorozitet protokollet për parandalimin e përhapjes së Covid-19, në 1 Tetor u zhvilluan festimet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Moshës së Tretë. Kjo është dita e ndërgjegjësimit dhe empatisë lidhur me mirëqenien e gjyshërve dhe kontributin e tyre në shoqëri.



Duke qenë në kushtet e Covid-19, me praninë e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, filluam fushatën e vaksinimit kundër gripit stinor. Vaksinimi nisi nga Shtëpia e Gjyshërve në Tiranë dhe vazhdoi në të gjitha Shtëpitë e të Moshuarve në Shqipëri.

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Tetor 2020 ka përfunduar dhe hedhur në sistem raportin përfundimtar për Drejtorinë Rajonale Dibër.

Është monitoruar Skema e Ndihmës Ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Janë ndjekur problematikat si pasojë e situatës së Covid-19, duke u dhënë Drejtorive Rajonale udhëzime lidhur me deklaratat 3 mujore.



#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajit Tetor 2020 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka realizuar komisionimet për sistemimin në institucionet e përkujdesit shoqëror të fëmijëve, nga i cili janë sistemuar 9 fëmijë.

Janë menaxhuar dhe referuar 15 raste qytetarësh sipas nevojave të tyre sociale. Gjithashtu janë ndjekur seancat gjyqësore për vendosje kujdestarie për 2 fëmijë.

Janë ndjekur trajnimet për Regjistrin Elektronik të Shërbimeve Sociale në qarkun e Tiranës, nga ku janë nxjerrë problematikat e hasura gjatë procesit.



#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Ardiasi ka qëndruar 12 vjet në institucionet tona të përkujdesit shoqëror dhe aktualisht është në Shtëpinë Familje për të Rinjtë 16-18 vjeç Shkodër.

Ardiasi ndjek shkollën e mesme profesionale në degën Hoteleri-Turizëm dhe njëkohësisht punon çdo ditë me përkushtim duke respektuar edhe masat anti covid-19.

Nëpërmjet strukturave tona ndihmojmë të rinjtë të integrohen në tregun e punës me qëllim përballimin e jetesës normale dhe në mënyrë të pavarur pas daljes nga institucionet tona të përkujdesit shoqëror.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Nëntor 2020

#16 DITËT E AKTIVIZIMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE



Dëgjo! Beso! Mbështet!

Ky është sllogani që udhëhoqi fushatën e përvitshme të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore, të cilën e startuam nga Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje.

Situata e vështirë e pandemisë në vend nuk na kufizon për t'i thënë STOP përuljes, vetëmohimit, shfrytëzimit të vajzave dhe grave!

#20 NËNTORI – DITA BOTËRORE E FËMIJËVE

20 Nëntori është Dita Botërore e Fëmijëve, një ditë në të cilën çdo vit promovohet përmirësimi i mirëqenies së fëmijëve.


20 Nëntori 2020 përkon me një ditë ndryshe për shkak të pandemisë së Covid-19. Këtë vit Kombet e Bashkuara e kanë vendosur theksin në "imagjinimin e një bote më të qëndrueshme për çdo fëmijë" duke ftuar fëmijët t'i bashkohen thirrjes duke pikturuar mënyrën sesi e perceptojnë botën pas Covid-19.

Edhe fëmijët e institucioneve tona iu bashkuan kësaj thirrjeje me pikturat e tyre.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Nëntor 2020

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Nëntor 2020 ka dërguar njoftimin dhe programin e kontrollit në Drejtorinë Rajonale të SHSSH Kukës.

Është monitoruar Skema e Ndihmës Ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale. Janë ndjekur problematikat si pasojë e situatës së Covid-19, duke u dhënë Drejtorive Rajonale udhëzime lidhur me deklaratat 3 mujore.

Është në proces kontrolli në bazë të programit të kontrollit tek Dispanceria dhe Qendra Shëndetësore nr.2.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Nëntor2020 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka shqyrtuar dokumentacionin për sistemimin e 12 të moshuarve në institucionet e përkujdesit shoqëror. Është mbledhur komisioni për Jetimët dhe janë rinovuar 35 libreza.

Janë menaxhuar dhe referuar 12 raste qytetarësh sipas nevojave të tyre sociale. Janë ndjekur seancat gjyqësore për vendosje kujdestarie për 2 fëmijë.

Specialistët kanë marrë pjesë në Konferencën e TAIEX për implementimin e politikave sociale për grupet në nevojë.

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Antonio është super djali që ne kemi në Shtëpinë Familje për të Rinjtë Shkodër. Antonio është i apasionuar pas futbollit dhe ne e mbështesim pafundësisht në pjesëmarrjet e tij në aktivitete të ndryshme sportive.

I jemi mirënjohës Nismës Shoqërore për Ndryshim - Arsis, të cilët mbështesin djaloshin tonë me fanellat dhe veshjet sportive.

Forcaaa Antonio, presim të bëhesh futbollist i madh!

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2020

#VIT TË MBARË NGA FAMILJA JONË E MADHE



Çdo fundvit Shërbimi Social Shtetëror kishte traditë nismën "Festat Duan Dashuri". Për fat të keq Covid-19 na detyroi të ruajmë distancat e të mos organizojmë festa me miq si çdo vit.

Këtë vit treguam se midis nesh ka dashuri dhe përkujdes të pakushtëzuar gjatë të gjithë vitit. Stafet tona të institucioneve të përkujdesit shoqëror realizuan detyrën e tyre sublime duke u karantinuar së bashku me përfituesit.

Atmosfera e festave trokiti shumë bukur në të gjitha institucionet tona të përkujdesit shoqëror. Dashuri, përkushtim dhe dhurata pafund për fëmijët, personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit dhe grupet në nevojë.

Gëzuar 2021! Vit të mbarë nga familja jonë e bukur!

#RASTET E SUKSESIT NË SHSSH

Bledi është djali jonë 16 vjeçar, një ndër djemtë shembullorë të Shtëpisë-Familje për të Rinj Shkodër.

Ne në shtëpinë tonë të ngrohtë kemi djem dhe vajza shumë të mirë. Bledi ndjek shkollën, ndjek kurse profesionale dhe paralelisht punon në një mobileri të qytetit të Shkodrës. Ndërmjetësimi për punësim u mundësua në bashkëpunim me Qendrën Rinore Arka.

Bravo Bledi, jemi krenarë për ty!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2020

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Dhjetor 2020 ka përfunduar dhe hedhur në sistem raportin përfundimtar për Drejtorinë Rajonale Kukës.

Është monitoruar Skema e Ndihmës Ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Janë ndjekur problematikat si pasojë e situatës së Covid-19, duke u dhënë Drejtorive Rajonale udhëzime lidhur me deklaratat 3 mujore.

Në kuadër të reformimit të sistemit të PAK është kryer kontroll tek Dispanceria dhe Qendra Shëndetësore nr. 3.



#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajit Dhjetor 2020 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka realizuar komisionimet për sistemimin në institucionet e përkujdesit shoqëror të fëmijëve, nga i cili janë sistemuar 3 fëmijë. Janë sistemuar në IPSH 10 të moshuar dhe 1 person me aftësi të kufizuara.

Gjithashtu janë ndjekur seancat gjyqësore për vendosje kujdestarie për 4 fëmijë.

Është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit në të cilin janë shqyrtuar 51 raste.



#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Me nismën e shoqatës "Edu Innovation" dhe projektit të GIZ "Nxitja e mundësive dhe përmirësimi i aftësive digjitale për viktimat e trafikimit", u mundësuan pesë kompjutera në qendrën tonë të trajtimit të viktimave të trafikimit.

Përveç kësaj janë realizuar 10 sesione trajnuese gjatë periudhës Nëntor - Dhjetor 2020 mbi njohuritë bazë të përdorimit të kompjuterit dhe janë pajisur vajzat me certifikatat përkatëse.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Janar 2021

#AJO ËSHTË...NJË HISTORI SUKSESI



Ajo është E. H, një vajzë e qetë dhe e zgjuar, por me një histori të dhimbshme. Gjatë qëndrimit në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit zhvilloi potencialin e saj individual përmes shërbimeve të ofruara dhe aktiviteteve me karakter psiko-social, okupacional, argëtues, sportive e krijues.

Në moshën 18-vjeçare pasi mori çdo shërbim të nevojshëm në qendër, u referua për riintegrim në qendrat partnere. Falë bashkëpunimit të Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional nr.4 ndoqi dhe u çertifikua me sukses në kursin e kuzhinës, si edhe në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Punësimit u ndërmjetësua për punë në sektorin privat të shërbimeve.

Sot, E. H është shkëputur nga rrjeti i trafikimit dhe është riintegruar plotësisht në shoqëri!

#SOLIDARITETI MES NESH


Qendra Polivalente Ditore Kamëz është qendër ditore e cila ofron shërbime ditore për të moshuar në nevojë. Përveç shërbimeve të ofruara në ambientet e qendrës, ne vijojmë me traditën e ngritur gjatë karantinës, atë të ofrimit të shërbimeve në banesë.

Gjatë këtij muaji kemi vazhduar shpërndarjen e paketave ushqimore për të moshuarit përfitues në mjedisin e banesave të tyre.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Janar 2021

#Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Janar 2021 ka përfunduar, hedhur në sistem dhe dërguar raportin e monitorimit për Drejtorinë Rajonale të SHSSH Kukës.

Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale, shtimin e rasteve të reja dhe problematika të tjera. Janë miratuar planet e NE 2021 për Drejtoritë Rajonale.

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale



Gjatë muajit Janar 2021, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka kryer monitorim në "Shtëpinë e Përbashkët" Berat si edhe 5 shërbime sociale të financuara nga Fondi Social në Qarkun Tiranë.

Janë mbledhur komisionet për pranimet e përfituesve në institucionet e përkujdesit shoqëror. Janë rinovuar 51 libreza të statusit të jetimit. Janë shqyrtuar 10 kërkesa dhe janë sistemuar 7 të moshuar në IPSH. Janë kryer 7 sistemime emergjente në IPSH për fëmijë dhe është menaxhuar 1 rast dhune në familje.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2021


#ÇDO FËMIJË MERITON NJË FAMILJE



Edhe pse jemi në kohën e pazakontë të Covid-19, puna jonë për t'i dhënë një familje të bukur bebushave tanë pa kujdes prindëror nuk ndalet.
Pas qëndrimit 1 vit e gjysëm në Shtëpinë e Foshnjës "Hanna dhe Rozafa" i uruam mbarësi, shëndet dhe lumturi në familjen e re vogëlushit tonë A.
Do të na mungosh, por më e rëndësishme se çdo gjë për ne është që ti të rritesh i lumtur në mjedisin e familjes!

#NDIHMA EKONOMIKE DYFISHOHET SI PËRGJIGJE NDAJ SITUATËS SË COVID19

Për shkak të vështirësive ekonomike të shkaktuara nga pandemia e Covid-19 u vendos për herë të dytë dyfishimi i ndihmës ekonomike brenda një periudhe me pak se 1 vjeçare.
Dyfishimi i NE këtë herë do të jetë për një periudhë më të zgjatur prej 6 muajsh, duke i filluar efektet financiare që nga muaji Janar 2021-Qershor 2021.
Qëllimi i këtij ndryshimi është lehtësimi i efekteve të pandemisë së Covid-19 në familjet në nevojë që trajtohen nga Skema e Ndihmës Elonomike.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2021


#SHËNDETI I PËRFITUESVE I PARI



Shëndeti i përfituesve të shërbimeve sociale ka qenë parësor që në fillimet e pandemisë së Covid-19 ku kujtojmë se stafet tona u karantinuan bashkë me përfituesit.

Tashmë kemi nisur vaksinimin e të moshuarve në të gjithë Shtëpitë e të Moshuarve në Shqipëri në mënyrë që rezultatet tona në garantimin e shëndetit të mirë të përfituesve të vazhdojnë të jenë maksimale.

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Pasioni, puna dhe vullneti drejt vetë-aktualizimit mundësuan çertifikimin e përfitueses së shërbimeve në QKTVDHF në kursin profesional 6 mujor të parukerisë dhe estetikës.
Kualifikimet profesionale janë një mënyrë efikase për të qenë gjithmonë të përgatitur për sfidat e së ardhmes dhe një hap për integrimin në shoqëri.
Kjo u mundësua në sajë të marrëveshjes së bashkëpunimit midis MSHMS, SHSSH, "Nisma për Ndryshim Shoqëror Arsis" dhe QKTVDHF.

Gëzimi 12 vjeçar, i cili prej 6 vjetësh merr shërbime në Qendrën e Zhvillimit Durrës, falë punës së palodhshme të specialistes ortofoniste ka arritur të kuptojë shkronjat e para dhe të njohë tingujt e kafshëve.

Gëzimi ka një përmirësim të konsiderueshëm të gjendjes së tij krahasuar me gjendjen fillestare në momentin e sistemimit në qendër.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2021

#VAKSINIMI I STAFEVE & PËRFITUESVE



Ne mbrojmë me çdo kusht shëndetin e stafeve dhe përfituesve të shërbimeve tona. Që në fillim procesi i vaksinimit ka nisur me të moshuarit e institucioneve të përkujdesit, personat me aftësi të kufizuar si edhe stafet e institucioneve.

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË NË DHE PAK




Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK ka përgatitur dhe hedhur në sistem raportin përfundimar të kontrollit për Drejtorinë Rajonale të SHSSH Gjirokastër, si edhe ka kantrolluar zbatimin e detyrae të lëna për Drejtorinë Rajonale të SHSSH Dibër.

Është përgatitur projekt-raporti për zyrën e vlerësimit në Spitalin e Kavajës.

Është kryer monitorimi i skemës së ndihmës ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Ka përfunduar vendimmarrja e muajit mars për të gjitha Drejtoritë Rajonale.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2021

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Mars 2021 janë mbledhur komisionet për pranimet e përfituesve në institucionet e përkujdesit shoqëror. Janë rinovuar 30 libreza të statusit të jetimit. Janë shqyrtuar 7 kërkesa në komisionin e të moshuarve, nga të cilat 6 raste u sistemuan dhe 1 është në pritje. U transferuan 2 të moshuar.

Janë kryer 2 sistemime emergjente në IPSH. U mblodh komisioni për PAK, u sistemua 1 rast, ndërsa 2 të tjera u transferuan.

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Edhe pse jemi në kushte pandemie, ne vendosim maskën dhe nuk i lëmë punët e mira pa bërë. Të moshuarve të Qendrës Polivalente Ditore Kamëz nuk i mungon përkujdesi në familje.

Stafi ynë i Qendrës Polivalente vazhdon shpërndarjen e paketave ushqimore në banesë për të gjithë gjyshërit tanë!

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2021

#28 FESTA NË 28 INSTITUCIONE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR



Edhe këtë fundvit ka vijuar tradita "Festat duan Dashuri". Në 28 institucionet e përkujdesit shoqëror në të gjithë Shqipërinë janë zhvilluar 28 festa me pjesëmarrjen e personave të ftuar dhe aktivitete të shumta argëtuese.

Gëzuar Vitin e Ri 2022 të gjithëve! Ardhtë ky vit i mbarë dhe i bardhë!

#3 DHJETOR – DITA NDËRKOMBËTARE E PAK



Mes emocionesh të panumërta zhvilluam festimet për Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara. Kjo ditë është dita kulmore e vitit lidhur me punën e palodhshme që bëhet çdo ditë për përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi ndryshe dhe krijimin e mundësive për integrimin e tyre në shoqëri.

Këtë vit lançuam Nismën "Më jep një shans" ku fëmijët me aftësi ndryshe të 9 Qendrave të Zhvillimit në Shqipëri hapën përpara nesh të gjithë botën e tyre me ngjyra në një panair të dedikuar për punimet e tyre.

Një falenderim shumë të veçantë për stafet tona të shërbimeve sociale të cilët bëjnë një punë të mrekullueshme me fëmijët, MSHMS, Organizatës "Shpresë për Botën" dhe organizatave të tjera partnere.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2021

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Gjatë muajit Dhjetor 2021 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Është realizuar kontroll në Drejtorinë Rajonale të SHSSH Fier dhe është hedhur në sistem projekt raportimi për kontrollin e realizuar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Kukës. Është përgatitur raporti përfundimtar për kontrollin e realizuar tek komisioni i PAK pranë Iranianit.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Dhjetor 2021 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 3 raste emergjente.

Është mbledhur komisioni për statusin e jetimit nga i cili kanë përfituar statusin e jetimit 58 persona. Është mbledhur komisioni për PAK ku është trajtuar dhe sistemuar 1 rast.

Është ndjekur seanca gjyqësore për një fëmijë dhe është përfunduar vendimmarrja mbi këtë rast. Gjithashtu janë realizuar 8 prezantime në bashkitë kryesore lidhur me protokollin e shërbimit në banesë për moshën e tretë.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill 2021

#DJE DHE SOT



Ju kujtohen ambientet sportive të Shtëpisë-Familje për të Rinj 16-18 vjeç? Sot këto ambiente nuk kanë asnjë ngjashmëri me dje. Falë mbështetjes së miqve të përhershëm të Shërbimit Social Shtetëror, ky ambient është rikonstruktuar dhe përshtatur për të luajtur të paktën 3 lloje sportesh!

#SHËNDETI I PËRFITUESVE TË SHËRBIMEVE – PRIORITETI MË I MADH



Procesi i vaksinimit kundër Covid-19 në Shqipëri ka nisur të kryhet me sukses për të gjitha grupet e rrezikuara, midis tyre dhe për gjyshet dhe gjyshërit e institucioneve tona. Në çadrën gjigande të vaksinimi ka vazhduar ky proces me gjyshërit e Qendrës Polivalente Ditore Kamëz, pa harruar edhe vaksinimin e stafit që punon me ta.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill 2021

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Prill 2021 është mbledhur Komisioni për të Moshuarit, ku janë trajtuar 6 raste, nga të cilët janë sistemuar 3 dhe janë transferuar 2 raste.

Në mbledhjet e tjera të komisioneve janë rinovuar 50 libreza për statusin e jetimit. Është shqyrtuar dokumentacioni për sistemimin e PAK, proces nga i cili është bërë një pranim dhe 1 transferim.

Janë ndjekur proceset gjyqësore për fëmijët në nevojë, konkretisht 6 seanca gjyqësore për vendosje në kujdestari.

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK



Gjatë muajit Prill 2021 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale, ndërsa verifikimi me SHKP u krye manualisht për shkak të problemeve të sistemit të SHKP.

Është përgatitur dhe përfunduar raporti i kontrollit të DRSHSSH Gjirokastër, si edhe është përgatitur projekt-propozimi për DRSHSSH Dibër.

Është kryer kontroll në komisionin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar pranë QSH nr. 10, si edhe në KMCAP të nivelit të parë dhe Epror neurologji/para-tetraplegji.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Maj 2021

#20 MAJ- DITA KOMBËTARE E JETIMËVE



Në Ditën e Jetimëve kujtojmë sërish se çdo përpjekje e jona është në drejtim të rikthimit në gjirin e familjes biologjike ose pranë familjeve birësuese e kujdestare.

Kjo ditë u shoqërua me festime dhe aktivitete në të gjitha institucionet e përkujdesit shoqëror.

#DITA NDËRKOMBËTARE E FAMILJES



15 Maji trokiti edhe në familjen e madhe të Shërbimit Social Shtetëror, ku bashkë me gocat edhe çunat tanë sapo kemi nisur festën.
Ne jemi familja e madhe e shumë fëmijëve pa kujdes prindëror të cilët çdo ditë japin dhe marrin shumë dashuri dhe përkujdes nga stafet e institucioneve tona.
Kjo ditë i shërben rritjes së ndërgjegjësimit për çështjet e ndryshme demografike, ekonomike dhe sociale që prekin institucionin e familjes, duke e vendosur theksin në programet dhe politikat që mundësojnë kapërcimin e problemeve dhe zhvillimin e familjeve të shëndosha.
Sot na është bashkuar edhe familja birësuese e vogëlushit A, të cilët tregojnë qartazi përpjekjet tona që çdo fëmijë të ketë një familje të shëndoshë e të bukur!

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Maj 2021

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Maj 2021 janë mbledhur komisionet për sistemimet në IPSH, nga të cilët janë sistemuar 2 raste emergjente, janë sistemuar 6 të moshuar, ndërsa 2 janë në pritje për mungesë kapacitetesh.

Në mbledhjet e tjera të komisioneve janë rinovuar 40 libreza për statusin e jetimit. Është shqyrtuar dokumentacioni për sistemimin e PAK, proces nga i cili është bërë 1 pranim dhe 1 transferim.

Janë ndjekur 4 procese gjyqësore për vendosje në

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK



Gjatë muajit Maj 2021 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale, ndërsa verifikimi me SHKP u krye manualisht për shkak të problemeve të sistemit të SHKP.

Është përgatitur dhe përfunduar raporti i kontrollit të DRSHSSH Dibër, si edhe është zhvilluar kontroll në Drejtorinë Rajonale të SHSSH Tiranë.

Është kryer kontroll fizik në komisionin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar pranë QSH nr. 10.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2021

#1 QERSHOR NË FAMILJEN E MADHE TË SHËRBIMIT SOCIAL



Si çdo vit, në familjen e madhe të Shërbimit Social Shtetëror u zhvilluan festimet e 1 Qershorit. Nga të gjitha institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijë u organizua festë me kërcime, këngë e vjersha, pa harruar sigurisht edhe dhuratat.

Kalamaja qoftë e gjithë jeta juaj e gëzuar dhe e bukur si kjo ditë!

#LORENCI IA DOLI



Ju prezantojmë me Lorencin i cili ia doli!

Lorenci më parë ka qenë përfitues nga Skema e Ndihmës Ekonomike. Në bashkëpunim me Zyrën e Punës dhe në përmbushje të misionit për ta kthyer skemën e NE nga pasive në aktive, Lorenci u punësua në një subjekt privat në qytetin e tij të banimit!

Punë të mbarë Lorenc!

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2021

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Qershor 2021 janë mbledhur komisionet për sistemimet në IPSH, nga të cilët janë sistemuar 3 raste emergjente, janë sistemuar 6 të moshuar nga 21 raste të shqyrtuara.

Në mbledhjet e tjera të komisioneve janë rinovuar 43 libreza për statusin e jetimit. Është shqyrtuar dokumentacioni për sistemimin e PAK dhe është sistemuar 1 rast.

Janë ndjekur 3 procese gjyqësore për fëmijë në nevojë dhe për përfitim status jetimi.

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK



Gjatë muajit Qershor 2021 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale, ndërsa verifikimi me SHKP u krye manualisht për shkak të problemeve të sistemit të SHKP.

Është përgatitur dhe hedhur në sistem projekt- raporti i kontrollit të DRSHSSH Tiranë si edhe është zhvilluar kontroll në DRSHSSH Shkodër.

Është kryer kontroll në Zyrën e Komisionit Biopsikosocial në Kombinat.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Korrik 2021

#URIME GJYSH SMAJLI!



Gjysh Smajli nga Malësia e Madhe është një nga përfituesit e shërbimeve në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër. Gjatë të gjithë jetës ka ushtruar profesionin e mësuesit dhe tani pavarësisht se ka mbushur plot 80 vjeç vazhdon të shkruajë poezi.

Me mbështetjen e miqve tanë u bë i mundur botimi i librit të tij të dytë, të titulluar “Dashuri dhe Lot”.

#E MBYLLËM ME SUKSES VITIN SHKOLLOR

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Korrik 2021



Të gjithë përfituesit e shërbimeve tona ndjekin arsimin e detyruar ose profesional. Përfitueset e QKPVT kanë mbyllur me sukses vitin shkollor 2020-2021 së bashku me provimet e klasës së 9-të.

Pavarësisht strehimit në qendër dhe vështirësive të të qenurit një VT, vajzat kanë ndjekur shkollën si të gjithë fëmijët e tjerë, duke zbatuar kështu standardin e gjithëpërfshirjes.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Korrik 2021 janë mbledhur komisionet për sistemimet në IPSH, nga të cilët janë sistemuar 6 raste emergjente fëmijësh, është sistemuar dhe transferuar 1 PAK.

Në mbledhjen e Komisionit për Statusin e Jetimit janë rinovuar 60 libreza për statusin e jetimit.

Janë ndjekur 3 seanca gjyqësore për fëmijë në nevojë dhe për përfitim status jetimi.

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK



Gjatë muajit Korrik 2021 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Është përgatitur dhe hedhur në sistem projekt- raporti i kontrollit të DRSHSSH Shkodër si edhe është zhvilluar kontroll në DRSHSSH Berat.

Është përgatitur raporti i kontrollit në Zyrën e Komisionit Biopsikosocial në Kombinat si edhe është zhvilluar kontroll në sistem.

#VEPRIMTARIA E DREJTORIVE RAJONALE



Nazarino dhe Lediona janë dy të rinj që banojnë në qytetin e Shkodrës. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Shkodër në bashkëpunim me Qendrën Yea i dhuruan dy të rinjve kompjutera të rinj.

Ti gëzoni dhe urojmë t'ju ndihmojnë në kryerjen e detyrave, por edhe në argëtim!

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Gusht 2021

#NJIHUNI ME IZETIN



Izeti, djali i familjes sonë të madhe, vazhdon vitin e dytë të shkollës së mesme dhe gjatë stinës së verës është angazhuar në një kurs kuzhine për të ndjekur pasionin e tij.

Pas marrjes së certifikimit të kursit, Izeti po kryen praktikën në një pastiçeri në qytetin e Shkodrës, ku edhe do të punësohet shumë shpejt. Me vullnetin dhe këmbënguljen që e karakterizon, do të ndjekë edhe shkollën, edhe punën.

Bravo Izet dhe suksese në çdo hap që hedh!

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Gusht 2021 janë mbledhur komisionet për sistemimet në IPSH, nga të cilët janë sistemuar 3 raste emergjente, 2 pranime dhe 4 transferime fëmijësh. Është mbledhur komisioni për të moshuarit ku u trajtuan 14 kërkesa, u sistemuan 6 dhe 1 u transferua. Në mbledhjet e tjera të komisioneve janë rinovuar 40 libreza për statusin e jetimit.

Në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të SHSSH u përditësua harta e shërbimeve sociale në të gjithë vendin.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Gusht 2021

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË NE DHE PAK




Gjatë muajit Gusht 2021 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale, ndërsa verifikimi me SHKP u krye manualisht.

Është përgatitur dhe hedhur në sistem projekt- raporti i kontrollit të DRSHSSH Berat dhe raporti përfundimtar për DRSHSSH Shkodër.

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR

Muaji Gusht 2021 në të gjitha institucionet e përkujdesit shoqëror ka qenë i mbushur me aktivitete të ndryshme argëtuese dhe rekreative.

Fëmijët e të gjitha institucioneve i kanë kaluar ditët me vapë të gushtit në ambientet e pishinave ose nën freskinë e pemëve të parkut të liqenit artificial. Në shoqërinë e njëri-tjetrit dhe edukatorëve u përpoqëm të mësojmë notin dhe na doli frika e ujit!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shtator 2021

#DITA E PARË E SHKOLLËS PËR FËMIJËS E FAMILJES SONË TË MADHE



Fëmijët e familjes së madhe të Shërbimit Social Shtetëror kanë nisur vitin e ri shkollor në datën 27 Shtator. Edhe këtë vit, u përgatitëm për shkollë, mbështollëm librat, pajisëm fëmijët me të gjitha mjetet shkollore të nevojshme dhe duke u uruar shumë suksese i nisëm për shkollë.

Suksese dhe mbusheni regjistrin e klasës plot me 10!

#VOGËLUSHJA JONË NGA SOT DO TË KETË NJË FAMILJE TË RE


Vogëlushja jonë A u rrit në shtëpinë tonë të madhe dhe pas dy vitesh përkujdes dhe dashuri pa kushte nga stafi ynë, jemi të lumtur t'ju themi se vogëlushja jonë do ketë një familje të re dhe të bukur.

Zoti të bekoftë dhe lumturia qoftë me ty në çdo hap që do të hedhësh!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shtator 2021

#MODELI BIO-PSIKO-SOCIAL NË DURRËS



Prej muajit Shtator 2021 u shtri Skema e Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në të gjithë Qarkun e Durrësit.

Skema e re e vlerësimit bio-psiko-sociale është një qasje ndërkombëtare e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, e cila mundëson një vlerësim gjithëpërfshirës mjekësor dhe social të aftësisë së kufizuar.

#AGROTURIZËM NË PËRMET



Përfitueset e shërbimeve tona në QKPVT janë bërë pjesë e një aktiviteti gastronomik informativ në qytetin e Përmetit. Vajzat tona mësuan mbi procesin e prodhimit të glikosë, kanë mbajtur shënime, kanë bërë pyetje mbi produktet dhe këtë lloj biznesi.

Vizitën e mbyllën me një drekë tradicionale dhe një banjo dielli në ujrat termale.

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK



Gjatë muajit Shtator 2021 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Është përgatitur dhe përfunduar raporti i kontrollit të DRSHSSH Berat, si edhe është zhvilluar kontroll në Drejtorinë Rajonale të SHSSH Lezhë.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2021

#MUAJI TETOR I NDËRGJEGJËSIMIT KUNDËR TRAFIKUT TË QENIEVE NJERËZORE



Në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore, të gjitha Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror kanë zhvilluar fushata informuese dhe ndërgjegjësuese në shkolla.

Në fokus të takimeve me të rinjtë ka qenë shpërndarja e mesazheve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, përmes diskutimeve dhe shpërndarjeve të fletëpalosjeve.

Informacioni është pushtet dhe përmes transmetimit të tij mund të bëhemi të gjithë së bashku nismëtarë për ç'rrënjosjen e trafikimit!

#1 TETOR – DITA NDËRKOMBËTARE E MOSHËS SË TRETË

1 Tetori është Dita Ndërkombëtare e Moshës së Tretë. Gjatë kësaj dite në institucionet tona që ofrjnë shërbime për moshën e tretë janë realizuar aktivitete të ndryshme, të cilat kanë pasur në fokus rritjen e ndërgjegjësimit për krijimin e një mjedisi dhe shoqërie që është miqësore ndaj të gjitha moshave.

Ndër të tjera, përveç ndarjes së mesazheve kuptimplota për këtë ditë, ka pasur edhe aktivitete argëtuese.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2021

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Gjatë muajit Tetor 2021 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale. Janë përgatitur gjithashtu tabelat statistikore në lidhje me fondin 6% për muajin gusht.

Është përgatitur dhe hedhur në sistem projekt raportimi për kontrollin e realizuar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Lezhë.

#RISITË E BUXHETIT TË RI TË MBROJTJES SOCIALE

Projekt-Buxheti 2022 parashikon lajme shumë të mira për të gjithë sektorët e ekonomisë dhe mirëqenies së qytetarëve.

Një fokus të veçantë të Buxhetit 2022 e merr mbrojtja sociale, si një përpjekje e qeverisë për të garantuar shpërndarje të drejtë të mirëqenies dhe shërbimeve për të gjithë. Familjet që trajtohen me Ndihmë Ekonomike do të përfitojnë rritje të nivelit të pagesave nga 10% deri në trefishim të NE për disa grupe, të tilla, si: viktimat e trafikimit, viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët jetimë.

Rritja e përfitimeve nga Skema e NE do të ecë paralelisht me përpjekjet tona për integrimin e anëtarëve madhorë të këtyre familjeve në tregun e punës.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2021

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Institucionet e përkujdesit shoqëror në varësi të Shërbimit Social Shtetëror ofrojnë një shumëllojshmëri shërbimesh duke filluar nga shërbimet bazike, të tilla, si: strehimi, kujdesi shëndetësor, veshmbathje etj., deri tek shërbimet e ndryshme ri-integruese në shoqëri.

Në QKPVT, përveç ofrimit të një strehe të sigurt, gjatë kohës së rehabilitimit të VT/VMT ofrohen edhe shërbime edukimi sipas nevojave. Kurset profesionale të llojeve të ndryshme mundësojnë pasjen e një profesioni dhe nxitjen drejt jetesës së pavarur pas daljes nga qendra.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Tetor 2021 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 3 raste emergjente të cilat janë sistemuar në IPSH.

Është mbledhur komisioni për të moshuarit, janë trajtuar 14 kërkesa, nga të cilat 6 janë sistemuar ndërsa 1 tjetër rast është transferuar. Në komisionin për statusin e jetimit janë rinovuar 40 libreza për statusin e jetimit.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Janar 2022

#2022 NISI SHUMË MBARË ME ELVANËN TONË



Elvina është vajza jonë shembullore në Shtëpinë Familje për të Rinj 16-18 vjeç Shkodër. Ajo vazhdon shkollën e mesme profesionale në degën "Hoteleri-Turizëm".

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Shkodër, në bashkëpunim me mbështetjen e vazhdueshme të Qendrës Arka, bënë të mundur nënshkrimin e kontratës së punës së Elvinës me një biznes të zonës.

Elvina paradite ndjek shkollën, ndërsa pasdite do të punojë! Urime dhe suksese Elvina!

#STREHË E NGROHTË, ARSIMIM DHE INTEGRIM PËR PËRFITUESIT TANË

Lukasi banon në Shtëpinë Familje për të Rinjtë 16-18 vjeç Shkodër. Ai po ndjek kursin e formimit profesional të lyerjes së automjeteve. Krahas shkollës, të rinjtë tanë marrin profesione të pëlqyera prej tyre gjatë kohës së qëndrimit në qendër.

Faleminderit TRIAL për mundësinë e ofrimit të këtij kursi falas për tre të rinjtë e qendrës tonë.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Janar 2022

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Gjatë muajit Janar 2022 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale. Janë përgatitur gjithashtu tabelat statistikore në lidhje me fondin 6%.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Janar 2022 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 7 raste emergjente nga të cilat janë sistemuar në IPSH 3 fëmijë dhe 4 janë transferuar.

Në komisionin për statusin e jetimit janë rinovuar 30 libreza për statusin e jetimit. Është realizuar monitorim për cilësinë e shërbimeve pranë QKTVDHF dhe janë lënë rekomandime për përmirësimin e shërbimit. Specialistët e shërbimeve sociale kanë marrë pjesë në seancat gjyqësore për marrjen e vendimit të kujdestarisë për 2 fëmijë.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2022

NJË TJETËR VOGËLUSHE NË NJË FAMILJE TË RE



Lumturia më e madhe në familjen e Shërbimit Social Shtetëror është momenti kur mund t'i japim një familje të bukur çdo fëmije pa kujdes prindëror. Pas qëndrimit dhe kujdesit nga nënat e Shtëpisë së bukur të Foshnjave në Tiranë, përcollëm me festë një prej vogëlusheve tona e cila do t'i bashkohet familjes së saj të re!

Lamtumirat nuk janë kurrë të bukura, por kur ato lidhen me nisjen e një rrugëtimi të ri dhe të mbarë bëhen të tilla!

#STREHË E NGROHTË, ARSIMIM DHE INTEGRIM PËR PËRFITUESIT TANË

Antonio tashmë 18-vjeçar nisi rrugëtimin e tij të jetës duke lënë Shtëpinë tonë të të rinjve në Shkodër dhe duke u mirëpritur në "Shtëpinë e mundësive" HOP, për të rinj 18-25 vjeç në Elbasan, pikërisht në qytetin e tij. E falenderojmë këtë qendër për mikpritjen e të riut tonë, ku Antonio do ketë mundësi më shumë për edukim, aftësi për jetën, punësim dhe mirëqenie.

I gjithë stafi i uron Antonios shumë mbarësi e suksese!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2022

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Gjatë muajit Shkurt 2022 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale. Janë përgatitur gjithashtu tabelat statistikore në lidhje me fondin 6%.

Është realizuar kontroll në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Durrës, është përgatitur projekt raporti për DRSHSSH Durrës. Janë realizuar kontrolle në sistem për Modelin Biopsikosocial në Durrës.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Shkurt 2022 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka realizuar mbledhjet e komisioneve për pranimet në IPSH, nga të cilat është sistemuar 1 fëmijë, 9 të moshuar dhe 2 të moshuar të transferuar, 1 sistemim emergjent në QKTE, si edhe rinovim i statusit të jetimit për 50 qytetarë.

Specialistët e shërbimeve sociale kanë marrë pjesë në seancat gjyqësore për marrjen e vendimit të kujdestarisë për 3 fëmijë. Është kryer monitorim i ofrimit të shërbimeve në Qendrat e financuara nga Fondi Social në Qarkun Elbasan, Tiranë si dhe Durrës, Lushnje dhe Gjirokastër.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill 2022

#PAKETA E REZISTENCËS



Target grupet që trajtohen me përfitime nga Shërbimi Social Shtetëror janë pjesë e Paketës së Rezistencës për përballimin e vështirësive ekonomike të ardhura nga lufta në Ukrainë.

Në mbështetje të VKM nr. 159, datë 12.3.2022 "Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë" Shërbimi Social Shtetëror ka bërë kalimin e fondeve për mbështetjen financiare të personave që përfitojnë nga Skema e Ndihmës Ekonomike dhe Aftësisë së Kufizuar".

Çdo qytetar përfitues nga këto dy skema i është drejtuar Postës Shqiptare/Bankave të Nivelit të Dytë për të tërhequr pagesën prej 3000 lekësh.

#DITA NDËRKOMBËTARE E AUTIZMIT

Në Ditën Ndërkombëtare të Ndëgjegjësimit për Autizmit ndoqëm me kënaqësi ekspozitën e pikturave të fëmijëve me ç'rregullime të spektrit të autizmit që marrin shërbime në Qendrat e Zhvillimit në të gjithë Shqipërinë. Fëmijët prezantuan punimet e tyre dhe teknikat e përdorura për të prodhuar krijimtaritë e tyre.

Fëmijët që vuajnë nga çrregullime të spektrit të autizmit kanë nevojë çdo ditë, jo vetëm nga strukturat e Shërbimit Social Shtetëror, po për secilin prej nesh, për t'i integruar në një shoqëri gjithëpërfshirëse e të barabartë.

Kjo ekspozitë ishte e mbushur me aq shumë ngjyra dhe dashuri! Fëmijët dhuruan disa prej pikturave të tyre për vizitorët dhe të ftuarit!



#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Gjatë muajit Prill 2022 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Është realizuar kontroll për zbatimin e legjislacionit për Ndihmën Ekonomike dhe zbatimin e legjislacionit për Modelin Biopsikosocial në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Elbasan.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE




Gjatë muajit Prill 2022 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 2 raste emergjente të cilat janë sistemuar në IPSH.

Janë mbledhur komisionet për sistemim në institucionet e përkujdesit shoqëror, nga të cilët janë sistemuar 2 fëmjë, 5 të moshuar, 1 person me aftësi të kufizuara. Në komisionin për statusin e jetimit janë rinovuar 50 libreza për statusin e jetimit.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill 2022

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Lukasi është përfitues i shërbimeve pranë Shtëpisë-Familje për të Rinj 16-18 vjeç në Shkodër. Rreth 6 muaj më parë Lukasi shprehu dëshirën për të ndjekur një kurs profesional për lyerjen e makinave. Tashmë ai është çertifikuar me sukses dhe përmes ndërmjetësimit të strukturave tona në Shkodër kemi bërë të mundur punësimin e tij në një biznes të zonës.

Lukasi gjatë paradites do të vazhdojë të ndjekë shkollën, ndërsa pasditeve do t'i dedikohet një pune që e pëlqen e për të cilën e arriti me mjaft pasion.

Të urojmë shumë suksese Lukas!

Muaji Prill në institucionet tona ka qenë i mbushur me aktivitete. Në të gjitha institucionet u zhvilluan aktivitete për Ditën e Tokës dhe Ditën e Librit.

Në kuadër të Ditës së Tokës, edhe ne kontribuam në gjelbërimin e oborreve të institucioneve tona duke mbjellë lule dhe fidanë. Këto lule u mbollën nga duart e vogla të fëmijëve, të ndihmuar nga edukatorët e institucioneve!



Për Ditën Ndërkombëtare të Librit, Shtëpinë tonë në Shkodër e vizitoi një mik i veçantë dhe një burim i jashtëzakonshëm frymëzimi për të rinjtë, autori Frrok Gjikolaj, i cili me gjithë kufizimet që i ka sjellë humbja e shikimit, ka arritur të botojë 3 libra. Përveçse diskutuan së bashku mbi rëndësinë e librit dhe leximit, z. Frrok dhuroi disa prej librave të tij duke pasuruar bibliotekën e shtëpisë sonë!

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill 2022



Në Shtëpinë e Fëmijës "Zyber Hallulli" realizuam një aktivitet informues me Qendrën e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të rinjve, me përfaqësues nga Shoqata e Avokatëve Penalistë, si edhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas. Në fokus të takimit ishte informimi i fëmijëve për parimet e drejtësisë penale për të miturit, programet parandaluese, rehabilituese dhe riintegruese.

Sfida e vërtetë për ne është puna për të mundësuar integrimin e tyre në rrugën e duhur, të edukimit të tyre si qytetarë të mirë, për të parandaluar përfshirjen e tyre me grupe që influencojnë negativisht në komunitetin ku jetojnë.

#DREJTORITË RAJONALE TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR



Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në të gjithë Shqipërinë janë përfshirë në mënyrë aktive për integrimin në tregun e punës së anëtarëve madhorë të familjeve me Ndihmë Ekonomike.

Në zbatim të Urdhërit të Përbashkët të MSHMS dhe MF nr. 52, datë 26.01.2022 "Për miratimin e mekanizmit të referimit për punësimin dhe integrimin social të individëve në moshë aktive pune" Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social po vijojnë takimet me bashkitë dhe Zyrat e Punës për identifikimin dhe integrimin e suksesshëm në punë sipas aftësive.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Maj 2022

#DITA BOTËRORE E FAMILJES




Këtë vit, në Ditën Botërore të Familjes, një nga vogëlushët tanë të Shtëpisë së Foshnjës "Hanna dhe Rozafa" gjeti ngrohtësinë në një familje, pranë dy prindërve të cilët mezi kanë pritur për ta birësuar.

Me strategjinë e deinstitucionalizimit, ekipet tona punojnë çdo ditë që të gjithë fëmijët e institucioneve të përkujdesit shoqëror të kenë një familje!

#SHËRBIMI SOCIAL NË PANAIRIN E KARRIERËS 2022

Gjatë muajit Maj 2022 Shërbimi Social Shtetëror i'u përgjigj thirrjes së Universitetit të New Yorkut në Tiranë për pjesëmarrjen në Panairin e Punës 2022. Prezantuam në panair veprimtarinë e institucionit, mundësitë e punësimit dhe internshipet në të gjithë rrjetin e institucioneve tona.

Ky panair ishte një mundësi e shkëlqyer për të afruar në familjen e madhe të Shërbimit Social Shtetëror të sapo diplomuar të talentuar dhe të pasionuar për të punuar me njerëzit në nevojë.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Maj 2022

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Gjatë muajit Maj 2022 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Është realizuar kontrolli në Drejtorinë Rajonale të Elbasan, në kuadër të së cilës është përgatitur dhe hedhur në sistem projekt raporti për kontrollin e realizuar.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajit Maj 2022 në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale janë mbledhur komisionet për pranimet në institucionet e përkujdesit shoqëror. Në komisionin e fëmijëve janë transferuar 2 raste dhe janë pranuar 2 raste emergjente. Janë rinovuar librezat e statusit të jetimit për 50 jetimë. Në komisionin e të moshuarve, nga 20 kërkesa gjithsej janë sistemuar 8 të moshuar dhe është transferuar 1 prej tyre.



Gjatë muajit është rihapur Qendra Pritëse për Personat e kthyer nga Siria dhe Iraku, ku është koordinuar e gjithë puna për hapjen dhe ka nisur trajtimi i tyre.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Maj 2022

#VEPRIMTARITË E INSTITUCIONEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR



Në Ditën Ndërkombëtare të Muzeve, me të rinjtë tanë realizuam një vizitë në Muzeun Kombëtar të Fotografisë "Marubi" dhe në Shtëpinë-Muze të Oso Kukës në Shkodër.

Këto dy muze në qytetin e Shkodrës na mundësojnë një udhëtim në kohë, rreth shekujve XVIII-XX, duke shpalosur para nesh shumë elementë me natyrë historike, artistike, kulturore dhe etnografike të kohës.

Kjo vizitë është shumë e rëndësishme pasi për të qenë qytetarë të mirë të vendit tonë duhet së pari të jemi njohës të mirë të trashëgimisë sonë historike, kulturore e më gjerë.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2022

#1 QERSHORI I FËMIJËVE



Në sheshin "Italia" i cili më 1 Qershor mirëpriti fëmijët në një super festë argëtuese me maskota, lojra dhe kërcim.

Së bashku me Ministret Manastirliu, Kushi dhe Muzhaqi, si edhe me përfaqësuesin e UNICEF në Shqipëri z. De Bernardi, vizituam tendat e ngritura për shërbimet, mjedisin dhe krijimtarinë, ku fëmijët ndanë me ne dëshirat e tyre për të ardhmen, ndërsa ne u zotuam për t'i realizuar.

#QENDRA E ZHVILLIMIT REZIDENCIAL DURRËS

Jemi shumë të lumtur që po shkojnë drejt përfundimit punimet në Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës, ku ofrohen një sërë shërbimesh për fëmijët me aftësi ndryshe.

Kjo qendër po rikonstruktohet me mbështetjen e Distriktit të Korpusit të Inxhinierëve të Ushtrisë Amerikanë në Evropë dhe do të ofrojë kushte bashkëkohore dhe standardet më të larta për përfituesit e saj.



SHERBIMI SOCIAL

Buletini Informativ

Qershor 2022

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Gjatë muajit Qershor 2022 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka përfunduar kontrollin në Drejtorinë Rajonale Elbasan, hartuar projekt raporti i kontrollit dhe dërguar DRSHSSH Elbasan/OSHKSH. Në kuadër të shtrirjes së Skemës së Vlerësimit Bio-Psiko-Social janë ndjekur dhe monitoruar grupet e punës së vlerësimit të AK në Vlorë.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajit Qershor 2022 në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale janë mbledhur komisionet për pranimet në institucionet e përkujdesit shoqëror. Në komisionin e fëmijëve janë pranuar 5 raste dhe 3 raste emergjente. Janë rinovuar librezat e statusit të jetimit për 25 jetimë. Në komisionin e PAK janë sistemuar 2 PAK në institucione.

Gjatë muajit Qershor është realizuar monitorim në bashkitë e qarkut Shkodër mbi planet sociale, NJVNNR, dhe IPSH të moshuar, 16-18 për fëmijë dhe "Madoninna del Grapa".



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2022

#AKTIVITETET E INSTITUCIONEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR



Muajt e verës kanë nisur bukur në të gjitha institucionet e përkujdesit shoqëror. Me studentë të UNYT dhe Toptani Jungle fëmijët e Shtëpisë së Hanna dhe Rozafës do të argëtohen në saj të një mini programi veror të krijuar posaçërisht për ta.

E kemi nisur me magjinë e xhunglës dhe freskinë e pishinave, për të vazhduar gjatë muajit me shumëllojshmëri aktivitetesh të tjera.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Gusht 2022

#PAK ART N'PEDONALE



Gjatë datave 29-31 Gusht 2022 Shërbimi Social Shtetëror organizoi aktivitetin tri ditor "PAK Art n'Pedonale", në të cilin u promovuan punimet e fëmijëve me aftësi ndryshe nga Qendrat e Zhvillimit në Shqipëri.

PAK Art n'Pedonale u mbajt në pedonalet e Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Vlorës dhe Beratit. Qëllimi i aktivitetit ishtë promovimi dhe shitja e artit të fëmijëve. Të ardhurat e mbledhura do të përdoren për blerjen e mjeteve të domosdoshme për të punuar në vijim në atelietë e qendrave.

#SHËRBIMI SOCIAL PRANË QYTETARËVE

Nëse je i/e pamundur të vish pranë Shërbimit Social, Shërbimi Social mund të vijë pranë teje. Gjatë muajit Gusht 2022, Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, znj. Xholi, ka vizituar në banesë një zonjë nga Saranda dhe një zotëri nga Dibra. Qëllimi i vizitës ka qenë komisionimi në banesë duke qenë se qytetarët e kishin të pamundur për shkak të gjendjes shëndetësore që të shkonin pranë komisioneve. Në këtë mënyrë komisioni shkoi pranë tyre.

Gatishmëria për t'i shërbyer qytetarëve derë më derë për vlerësimin e gjendjes së atyre që janë të pamundur është ndër prioritetet kyçe të Shërbimit Social sot!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Gusht 2022

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Gjatë muajit Gusht 2022 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale.

Është përgatitur raporti përfundimtar i kontrollit për Qendrën Shëndetësorë nr. 1 Sarandë. Është realizuar kontrolli në Drejtori Rajonale dhe është përfunduar projekt raporti për Bashkinë Delvinë.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajit Gusht 2022 në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale janë mbledhur komisionet për pranimet në institucionet e përkujdesit shoqëror. Në komisionin e fëmijëve janë menaxhuar 5 raste dhe pranuar 3 raste emergjente. Janë rinovuar librezat e statusit të jetimit për 30 jetimë.

Në datat 29-31 Gusht 2022 u realizua aktiviteti “PAK Art n’Pedonale” gjatë të cilit u koordinua puna në secilën prej pedonaleve ku u prezantuan punimet e fëmijëve me aftësi ndryshe.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shtator 2022

#DITA E PARË E SHKOLLËS



Dita e parë e shkollës është një moment shumë i rëndësishëm për të gjithë fëmijët. Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, znj. Reme Xholi, shoqëroi fëmijët e familjes së madhe të Zyber Hallullit në këtë ditë të dashur të tyre.

Me urimin për nisjen e ditës së parë të shkollës, Melisa dhe Danieli hodhën hapat e para në rrugën e gjatë e të bukur të dijes.

Urime kalamaja dhe mbusheni çantën plot me nota të shkëlqyera ☺

#SUKSESET E FËMIJËVE TË FAMILJES SË SHSSH

Ju prezantojmë me Valentinën, vajzën e shkëlqyer të Shtëpisë së të Rinjve 16-18 vjeç Shkodër, e cila është padyshim shembëlltyra e një pune të jashtëzakonshme që bëhet në institucionet tona të përkujdesit shoqëror.

Valentina ndjek arsimimin profesional në drejtimin "Përpunim druri" dhe aktualisht është simbol i promovimit të arsimit profesional në Rrugët e Shkodrës ☺

Jo vetëm Valentina, por edhe djemtë dhe vajzat e tjera të shtëpisë sonë kanë zgjedhur arsimin profesional, si një mundësi e shkëlqyer për t'u integruar lehtësisht në tregun e punës!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shtator 2022

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Gjatë muajit Shtator 2022 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Ka përfunduar vendimmarrja për disa prej DRSHSSH dhe është në proces për disa të tjera.

Është përfunduar dhe hedhur në sistem raporti përfundimtar për DRSHSSH Vlorë dhe Bashkinë Delvinë.

Janë ndjekur dhe monitoruar grupet rajonale lidhur me integrimin në punë të anëtarëve madhorë të familjeve me NE.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajit Shtator 2022 në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale janë mbledhur komisionet për pranimet në institucionet e përkujdesit shoqëror. Janë sistemuar në institucione 2 fëmijë, 22 të moshuar, 3 PAK dhe janë transferuar 16 fëmijë dhe 1 i moshuar.

Është mbledhur komisioni për statusin e jetimit, ku janë vlerësuar 39 raste dhe kanë përfituar këtë status 36 prej tyre.

Janë kryer monitorime në IPSH e Qarkut Vlorë dhe Korçë, për të cilat janë zbardhur raportet dhe lënë rekomandimet përkatëse.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2022

#1 TETOR ME TË MOSHUARIT



1 Tetori është Dita Ndërkombëtare e Moshës së Tretë. Gjatë kësaj dite në institucionet tona që ofrjnë shërbime për moshën e tretë janë realizuar aktivitete të ndryshme, të cilat kanë pasur në fokus rritjen e ndërgjegjësimit për krijimin e një mjedisi dhe shoqërie që është miqësore ndaj të gjitha moshave.

Këtë vit realizuam një aktivitet të veçantë me të moshuarit e qendrave tona në Tiranë dhe Shkodër me praninë e Ministres së MSHMS, znj. Ogerta Manastirliu dhe Drejtoreshës së Përgjithshme të SHSSH, znj. Xholi. Përveç ndarjes së mesazheve mbi moshimin dhe dashurinë që duhet të tregojmë ndaj gjyshërve, çertifikuam disa prej tyre për kontributin që ata kanë dhënë në fushat e tyre.

#TETORI I NDËRGJEGJËSIMIT KUNDËR TRAFIKIMIT

Në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe në veçanti 18 Tetorit si Dita Europiane kundër Trafikimit në Persona, u mbajt një aktivitet ndërgjegjësues në QKPVT.

Ky aktivitet u organizua nga vetë vajzat që marrin shërbime në këtë qendër, të cilat ia kanë dalë të shpëtojnë nga trafikimi dhe na rrëfyen përmes punimeve të tyre copëza të rrugëtimit të dhimbshëm të trafikimit.

Ne ia kemi dalë, jemi në rrugën e mbarë të rehabilitimit dhe integrimit në shoqëri. Bashkë bëhemi më të fortë në ç'rrënjosjen e trafikimit!



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2022

#DITËLINDJA E 20 E QENDRËS POLIVALENTE DITORE KAMËZ



Në datë 21 Tetor festuam me gjyshërit energjikë të familjes së madhe të Shërbimit Social ditëlindjen e 20 të Qendrës Polivalente Ditore për Moshën e Tretë.

Prej 20 vitesh në Qendrën Polivalente Ditore në Kamëz mundësojmë çdo ditë kushtet që të moshuarit të jenë aktivë në grupet e tyre shoqërore dhe në komunitet në dimensionin social, psikologjik, kulturor etj.

Jemi krenarë që puna e këtyre 20 viteve ka marrë gjithmonë vlerësim maksimal dhe ndihemi të motivuar për të bërë akoma më shumë në të ardhmen kur vlerësimet më të sinqerta i marrim nga gjyshër dhe gjyshe që janë pjesë integrale e jona prej vitesh!

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajit Tetor 2022 në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale janë mbledhur komisionet për pranimet në institucionet e përkujdesit shoqëror. Janë sistemuar në institucione 4 fëmijë, 3 nga të cilët kanë qenë raste emergjente. Është mbledhur komisioni për statusin e jetimit, ku janë rinovuar 45 statuse të jetimit.

Janë kryer monitorime në Qendrëne Zhvillimit Shkodër dhe Shtëpinë e Fëmijës 5-16 vjeç Shkodër dhe janë zbardhur gjetjet për secilin prej institucioneve.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2022

SURPRIZË PËR BELËN NË DITËN NDËRKOMBËTARE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR



Në Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar ishim pranë Qendrës së Zhvillimit "Pëllumbat" për të festuar këtë ditë dhe për t'i dhënë një lajm të bukur Belës.

Bela është rritur në familjen tonë të Pëllumbave dhe 3 Dhjetorit është pjesë e stafit tonë të qendrës.

Urime dhe suksese Bela! Jemi të bindur që do japësh më të mirën tënde për djemtë dhe vajzat e qendrës!

#10 DITËT E AKTIVIZIMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE

Përmbyllëm fushatën e 10 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore në Qendrën e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, ku biseduam me gratë dhe vajzat përfituese të shërbimit, të cilat na rrëfyen historitë e tyre të jashtëzakonshme që ia kanë dalë me sukses të fitojnë lirinë.

Përgëzuam stafin e palodhur të shërbimit social, të cilët kanë bërë një punë shëmbullore për trajtimin dhe integrimin e tyre në shoqëri.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Dhjetor 2022

#FESTË NË SHTËPINË E ZYBER HALLULLIT



Në shtëpinë e madhe të Zyber Hallullit, e cila mirëpriti një mik shumë special nga jashtë, z. Buddy Mullins, President i Shoqatës "Shpresë për Botën"

Shpresë për Botën është një organizatë mike e fëmijëve tanë, e cila ka ofruar mbështetje të pakushtëzuar gjatë këtyre 30 viteve.

E ku ka më bukur sesa mirënjohjen për mbështetjen z. Mullins ta merrte me këngët dhe vjershat e fëmijëve dhe një shporte simbolike produktesh autentike shqiptare.

#GËZUAR KRISHTLINDJEN NGA SHSSH



Në shtëpinë e Zyber Hallullit festuam mëngjesin e ngrohtë të krishtlindjes, së bashku me Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. Ogerta Manastirliu.
Ne dhe fëmijët kaluam një ditë të bukur me maskotat e skuadrës së Hamleys.

Hamleys ishte pranë shërbimit Social me dhuratat e tyre për fëmijët e institucioneve, si edhe fëmijët e familjeve me ndihmë ekonomike.

Faleminderit Hamleys! ☺

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Janar 2023

#2023 ME ADMINISTRATORËT SHOQËRORË



Ditët e para të vitit të ri 2023 kanë nisur me takime me administratorët shoqëror në të gjithë Shqipërinë.

Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, znj. Xholi, e nisi nga Fieri, ku u ndanë arritjet e vitit të kaluar, si edhe u diskutuan sfidat e përbashkëta për zbatimin me sukses të Programeve të Mbrojtjes Sociale.

#PAKO-JA E MADHE



Ky vit ka nisur me mbështetjen e menjëhershme financiare për shumë kategori, duke përfshirë familjet me ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar, gratë kryefamiljare me tri fëmijë etj.

Kjo Pako e Madhe do të shërbejë për të lehtësuar barrën e inflacionit në familjet shqiptare.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Janar 2023

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Gjatë muajit Janar 2023 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Ka përfunduar vendimmarrja për disa prej DRSHSSH dhe është në proces për disa të tjera.

Janë ndjekur dhe monitoruar grupet rajonale lidhur me integrimin në punë të anëtarëve madhorë të familjeve me NE.

#SHTËPIA E TË MOSHUARVE TIRANË

Karolina dhe "Primera Group", miq të dashur të gjyshërve tanë na surprizuan me dhuratat e tyre. Kjo kohë e ftohtë do të përballohet më mirë në sajë të paneleve diellore më të reja në shtëpinë tonë.

Mirënjohje për Karolinën dhe miqtë e familjes sonë të cilët janë si gjithnjë solidarë ndaj të moshuarve.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2023

#PROGRAMI I MBËSHTETJES PËR NËNAT ME SHUMË FËMIJË



Në Janar 2023 Qeveria Shqipëtare miratoi programin e mbështetjes për nënat e papuna me tre ose me shumë fëmijë. Në kuadër të zbatimit të këtij programi, Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim të ngushtë me MSHMS po zhvillojnë takime me gratë përfituese të programit, për të diskutuar mbi këtë politikë dhe ndarë nevojat për t'u plotësuar në të ardhmen.

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK

Gjatë muajit Shkurt 2023 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Ka përfunduar vendimmarrja për 12 Drejtoritë Rajonale dhe janë asistuar lidhur me rekomandimet për fondin deri në 6%.

Janë zhvilluar takime në Shkodër, Lezhë, Berat dhe Korçë lidhur me punësimin e anëtarëve madhorë nga familjet me NE dhe janë monitoruar të gjitha grupet rajonale lidhur me këtë tregues.

Është realizuar kontroll në DRSSSH Gjirokastër lidhur me zbatimin e legjislacionit të NE dhe po përgatitet projekt raporti i kontrollit.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shkurt 2023

#BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL

Gjatë muajit Shkurt Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, znj. Reme Xholi, ka vijuar turin e takimeve me pushtetin vendor, si një hallkë shumë e rëndësishme në përmbushjen e misionit të programeve tona të mbrojtjes sociale.

Elbasani, Berati, Korça, Shkodra ishin qytetet ku u ndalëm këtë muaj në diskutimet me administratorët shoqëror për të identifikuar dhe trajtuar në kohë reale kërkesat e qytetarëve.



#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë “Zyber Hallulli” nënshkroi me Qendrën Multifunksionale “New Generation” një Marrëveshje 4- vjeçare bashkëpunimi në fokus të së cilës është identifikimi dhe zhvillimi i pasioneve të fëmijëve.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është një gur themeli për të ardhmen e atyre fëmijëve të cilët kanë dëshirë të aftësohen në fushat profesionale të estetikës, parukerisë, etj.

Mirënjohje për New Generation dhe modele të tilla bashkëpunimi shpresojmë të zhvillojmë edhe në të ardhmen!

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2023

TAKIMET PËRMBYLLËSE ME ADMINISTRATORËT SHOQËRORË



Gjatë muajit Mars 2023 Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror znj. Xholi ka përbyllur turin e takimeve me Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe administratorët shoqëror të pushtetit vendor.

Këtë muaj u zhvilluan takimet në Elbasan dhe Berat, të cilat i shëryen diskutimit të problematikave të punës së përditshme dhe adresimit në kohë reale të problematikave të qytetarëve.

#8 MARS

Në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, me Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. Manastirliu dhe Kryetarin e Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj zhvilluam një takim me nënat me më shumë se tri fëmijë të cilat prej Janarit 2023 janë përfituese të Programit të Mbështetjes së Qeverisë për Nënat me më shumë si tri fëmijë.

Prej muajit Janar 2023 në Bashkinë Tiranë janë mbështetur nga ky program 700 nëna të papuna me tri fëmijë, të cilave po u subvencionohen sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Mars 2023

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Mars 2023 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 5 raste viktima trafikimi ose viktima të mundshme të trafikimit, si edhe 3 raste dhune.
Janë zhvilluar komisionimet për sistemim në institucione të përkujdesit shoqëror, nga të cilat janë sistemuar 4 fëmijë, 1 i moshuar, 1 fëmijë me aftësi ndryshe, si edhe janë rinovuar 28 libreza të Statusit të Jetimit.

#14 MARS NË INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Në traditën tonë shqiptare 14 marsi shënon ditën e rëndësishme të verës dhe përtëritjes së natyrës. Sikurndër të gjitha ditët e tjera të festave zyrtare, atmosfera e kësaj feste ka ardhur në mënyra të ndryshme në të gjitha institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijë, të moshuar, PAK etj.

Gjyshërit energjikë të Qendrës Polivalente Ditore Kamëz kaluan një super ditë ashtu si ata janë, energjike dhe me diell, në Elbasanin mikpritës të kësaj feste.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill - Maj 2023

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Në 31 Maj në ditën Botërore kundër Duhanit, në institucionet e përkujdesit shoqëror është realizuar aktivitet ndërgjegjësues me përfituesit lidhur me rrezikun që sjell konsumimi i duhanit në sëmundjet e ndryshme.

Përfituesit e institucioneve u angazhuan në aktivitete me karakter informjues, sensibilizues dhe krijues.

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK

Gjatë muajve Prill-Maj 2023 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Ka përfunduar vendimmarrja për 12 Drejtoritë Rajonale.

Është realizuar kontroll në DRSSSH Shkodër, është përgatitur projekt- raporti përfundimtar për Drejtorinë Rajonale Shkodër dhe Tiranë.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Prill - Maj 2023

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajve Prill-Maj 2023 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 5 raste viktima trafikimi dhe 3 raste dhune.

Janë mbledhur komisionet e sistemimeve në institucion, nga të cilat janë sistemuar në institucion 4 fëmijë, 1 I moshuar, 1 fëmijë me aftësi ndryshe.

Janë rinovuar 28 libreza për Statusin e Jetimit.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2023

#1 Qershor me Fëmijët e familjes së madhe të shërbimit social



Në Ditën Botërore të Fëmijëve së bashku me Ministren Ogerta Manastirliu festuam me vogëlushët e Hana dhe Rozafës. Nën shoqërinë e maskotave të Hamleys kënduam dhe shpërndamë dhurata për të gjithë fëmijët.

Gëzuar 1 Qershorin fëmijë! Festofshi çdo ditë si të ishte 1 Qershor!

#Akses për të gjithë



Në Muzeun Historik "Oso Kuka" të Shkodrës në bashkëpunim me Organizatën "The Door", mbështetësin e përhershëm të shërbimit social dhe të gjithë personave me aftësi të kufizuar të Shkodrës, mundësuam dhurimin e rampës ku këta persona do ta kenë më të lehtë ta vizitojnë muzeun sa herë të dëshirojnë.

Me një grup përfaqësuesish të personave me aftësi të kufizuar u realizua vizita e parë në ambientet e muzeut e cila u drejtua me shumë përkushtim drejtoresha e muzeut znj.Amila Gjyrezi.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Qershor 2023

#Drejtoria e Shërbimeve Sociale



Gjatë muajit Qershor 2023 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar dy raste emergjente. Janë mbledhur komisionet për sistemimin në institucione, nga të cilat janë sistemuar dy raste PAK, 7 sistemime të moshuarish dhe 1 transferim. Është mbledhur komisioni për statusin e jetimit nga i cili kanë përfituar status 33 raste.

Janë kryer monitorime në IPSH publike "Shtëpia e Fëmijës Sarandë" dhe " Qendra Polivalente Sarandë".

#Shtëpia e Fëmijës Zyber Hallulli



Shkolla mbaroi, tani le të shijojmë diellin! Pushime verore sapo kanë nisur. Fëmijët e familjes sonë të Zyber Hallullit prej datës 19 Qershor po ndjekin aktivitetet e kampit veror të mundësuar nga miqtë tanë besnikë të "Shpresë për Botën". Në shoqërinë e shokëve dhe shoqeve po kalojnë ditë të mbushura me të qeshura dhe lojra të shumëllojshme.

Mirënjohje për miqtë tanë të "Shpresë për Botën" që si gjithmonë zgjedhin aktivitetet më të bukura për të argëtuar fëmijët.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Korrik 2023

#REFORMA E VLERËSIMIT BIO-PSIKOSOCIAL



Gjatë muajit korrik u zhvillua takimi me 150 punonjës të komisioneve të vlerësimit bio-psiko-social.

Në këtë takim u ritheksua rëndësia e përkushtimit ndaj detyrës së çdo punonjësi në shërbimin ndaj qytetarëve.

Takimi u organizua në formatin e një trajnimi për rifreskimin e njohurive, sqarimin e situatave të reja me të cilat përballen çdo ditë.

#MOSHIMI AKTIV

Në kuadër të përpjekjeve për moshimin aktiv u mbajt një tryezë diskutimi mbi shërbimet e integruara për moshën e tretë.

Në takim u prezantua përvoja e Njësisë Administrative Sukth mbi ngritjen e regjistrit elektronik të moshës së tretë, sfidat dhe metodologjinë e ndjekur.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Korrik 2023

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajt korrik 2023 janë mbledhur komisionet për sistemimin në institucionet e përkujdesit shoqëror, ku janë sistemuar 2 fëmijë, 4 të moshuar si edhe 16 transferime mbrenda institucioneve të përkujdesit.

Janë rinovuar 60 statuse të jetimit si dhe janë trajtuar 5 raste emergjente fëmijësh.

Po punohet në vazhdimësi për hartëzimin e shërbimeve sociale në Shqipëri, ku aktualisht është përfunduar procesi i rishikimit të draftit të parë të hartës së shërbimeve.

#PUSHIMET VERORE NË IPSH

Përfituesit e shërbimeve shoqërore në institucionet në varësi të Shërbimit Social Shtetëror po shijojnë ditë të freskëta në bregdetin tonë, në ambientet e shtëpisë sonë të pushimit në Velipojë dhe Palasë.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Gusht 2023

#PUSHIMET VERORE



Fëmijet e familjes sonë të madhe të Shërbimit Social Shtetëror, kaluan momente të bukura në qëndren e pushimit Velipojë dhe Palasë, të shoqëruar nga stafi i përkushtuar institucioneve tona.

#DREJTORIA E NE DHE PAK

Gjatë muajit Gusht 2023 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Ka përfunduar vendimmarrja për 12 Drejtoritë Rajonale dhe janë asistuar lidhur me rekomandimet për fondin deri në 6%.

Është përfunduar kontroli në drejtorinë rajonale të SHSSH Fier si edhe njësitë administrative përkatëse, si dhe është dërguar raporti përfundimitar i kontrollit.


Është kryer kontrolli në zyrat e vlerësimit Bio-Psiko-Social në qarkun Korçë.



#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËRORË

Vajzat përfituese të shërbimeve pranë QKPVT përveçë shërbimeve bazë që marrin në qëndër, përfitojne dhe trajnime profesionale si pjesë e paktës së ndihmës që ne përfitojmë, duke mundësuar orientimin e karrierës për të ardhmen,

Vajzat e qendrës vazhdojnë të ndjekin kursin e manikyr-pedikyr.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Shtator 2023

#VITI I RI SHKOLLOR 2023



Fëmijët e familjës së madhe të Zyber Hallullit, nisën vitin e ri shkollor me urimin e ngrohtë të Drejtoreshës së Përgjithshme znj. Reme Xholi dhe shoqërimin në shkollë me personazhin e tyre të preferuar Luiz Ejlli.

Shumë suksese kalamaja! Marrshi vetëm 10 😊

#DREJTORIA E NE DHE PAK

Gjatë muajit Shtator 2023 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE.

Është dërguar projekt raporti i kontrollit për zyrat e vlerësimit bio-psiko-social në Qarkun Berat,. Është realizuar kontroll në komisionet bio-psiko-sociale të qarkut Fier, ku janë kontrolluar 600 dosje për 3 komisionet e vlerësimit.



#Drejtoritë Rajonale të SHSSH

Drejtoria Rajonale e SHSSH Tiranë, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë realizuan një takim informues me anëtarët e komisoneve bio-psiko-sociale të Qarkut Tiranë.

Në këtë takim, drejtuesit e qendrave komunitare multidisiplinare në Bashkinë Tiranë prezantuan sherbimet, kapacitet, pozicionin gjeografik dhe zonat e mbulimit të tyre.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2023

#DITA BOTËRORE E TE MOSHUARVE



Në kuadër të Ditës Botërore të Moshuarve, stafi i Shtëpisë së Moshuarve Shkodër në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, organizuan një aktivitet festiv për gjyshërit dhe gjyshet tona.

Në këtë atmosferë festive u bashkuan deputetë të parlamentit, drejtues të institucioneve, vullnetarë të ndryshëm dhe gjithashtu nuk munguan dhe artistët të cilët për disa orë dhuruan momente të bukura në ambientet e Shtëpisë së Moshuarve Shkodër.

#DITA EUROPIANE E ANTI-TRAFIKIMIT NË PERSONA

Në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit kundër trafikimit dhe Ditës Europiane të Anti-Trafikut, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror organizoi një fushatë ndërgjegjësimi në ambientet e Pedonales së Tiranës.

Pjesë e kësaj fushate sensibilizuese u bënë qytetarë, turistë dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore duke vendosur mesazhet e tyre motivuese në kubin gjigand të vendosur në Pedonale.

Në fund të ditës ky kub i'u dhurua përfituesve që marrin shërbim në Qendrën Kombëtare Pritëse të Trajtimit të Viktimave të Trafikimit.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Tetor 2023

#TALENTET E FËMIJËVE TË SHTËPISË SONË TË MADHE

Në mbështetje të ëndrrave dhe pasioneve të fëmijëve të familjes tonë të madhe të Shërbimit Social Shtetëror, në ambientet e Zyber Hallullit, Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror znj. Reme Xholi mirëpriti Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. Albana Koçiu.



Fëmijët dhe të rinjtë prezantuan talentet dhe pasionet që ato ndjekin në art, muzikë, sport e kulturë.

#REALIZIMI I ËNDRRAVE TË FËMIJËVE TË FAMILJES SË SHSSH

Belkisa, një prej vajzave të shkathta të shtëpisë së Zyber Hallullit, mori surprizën e veçantë të znj. Goldi Halili e cila e ftoi zyrtarisht për t'iu bashkuar ekipit të futbollit të Tiranës për femra.



Nga tani, Belkisa ka hedhur hapin e parë në përmbushjen e pasionit të saj për futbollin.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
Nëntor2023

#16 DITËT E AKTIVIZIMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE



Në ambientet e Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje u zhvillua një takim i ngrohtë me përfitueset e qendrës. Ndarjes së historive frymëzuese të këtyre grave, ju bashkua dhe Drejtoresha Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dhe perfaqësues nga OSBE, ku përcollën mesazhe të ndryshme sensibilizuese me qëllim parandalimin e dhunës.

#FESTAT E NËNTORIT NË IPSH-TONA

Në kuadër të festave kombëtare të 28-29 Nëntorit, në të gjitha Institucionet të Përkujdesjes Shoqërore për fëmijë, PAK, të moshuar, viktima të dhunës etj u organizuan aktivitete të ndryshme me këngë dhe valle, gjithashtu u valvit dhe flamuri kuq e zi në të gjitha institucionet tona.



#DREJTORIA E NE DHE PAK

Gjatë muajit Nëntor 2023 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Ka përfunduar vendimmarrja për 12 Drejtoritë Rajonale dhe janë asistuar lidhur me rekomandimet për fondin deri në 6%.



Gjatë muajit Nëntor 2023 është përfunduar kontrolli në zyrat e vlerësimit bio- psiko -social të Qarkut Berat dhe Qarkut Fier, si edhe njësitë administrative përkatëse.

Është dërguar Projekt raporti i kontrollit dhe raporti përfundimtar për zyrat e vlerësimit bio- psiko - social në Qarkun Berat dhe Fier.

SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
DHJETOR 2023

#FESTAT E FUNDVITIT NË FAMILJEN TONË



Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror znj. Reme Xholi së bashku me Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. Albana Koçiu, uruan përzemërsisht fëmijët e Shtëpisë së foshnjës "Hannah dhe Rozafa". Ashtu si çdo vit nuk munguan dhuratat dhe animatorët e veshur me personazhet e preferuara të të vegjëlve.

#MIQTË E SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

KF Vllaznia ka suprizuar të moshuarit e Shtëpisë të Moshuarve Shkodër, duke iu dhuruar një autoveturë e cila ka qënë mëse e domosdoshme për nevojat e gjyshërve tanë.

KF Vllaznia, përpos dorëzimit të çelsave të makinës kanë kaluar dhe disa momente festive, duke uruar festa të gëzuara për të gjithë gjyshërit e familjes tonë të madhe.



SHERBIMI SOCIAL
Buletini Informativ
DHJETOR 2023

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK

Gjatë muajit Dhjetor 2023 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Ka përfunduar vendimmarrja për 12 Drejtoritë Rajonale dhe janë asistuar lidhur me rekomandimet për fondin deri në 6%.



Gjatë muajit Dhjetor 2023 është kryer kontrolli për zbatimin e legjislacionit të PAK në Drejtorinë Rajonale të SHSSH Dibër dhe është dërguar projekt-raporti i kontrollit.

Janë ndjekur grupet teknike për 12 Drejtoritë Rajonale të SHSSH dhe Drejtoritë e AKPA-s për integrimin në tregun e punës të anëtarëve madhorë të familjeve përfituese nga skema e NE.

#DE-INSTITUCIONALIZIMI

Në kuadër të De-Institucionalizimit, Drejtoria e Shërbimeve Sociale pranë Shërbimit Social Shtetëror ka kryer gjatë muajit Dhjetor 2023 një seri trajnimesh mbi procesin e De-institucionalizimit të fëmijëve nga institucionet e përkujdesit.



Pjesë e këtyre trajnimeve u bënë 66 persona, staf në institucionevet e përkujdesit shoqëror "Shtëpia e Foshnjës 0-5 vjeç Tiranë, Shtëpia e fëmijës "Zyber Hallulli" Tiranë, si edhe Shtëpia e Foshnjës 0-5 vjeç Durrës.